



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Elbasan: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.07.2022 DERI
31.01.2023, BASHKIA ELBASAN”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-40
	<i>Drejtimet e Auditimit.....</i>	4
	<i>A.Masa Organizative.....</i>	4-21
	<i>B. Masa Shpërblim dëmi</i>	22-30
	<i>B.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....</i>	31-35
	<i>C.Masa Disiplinore.....</i>	35-35
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	25-39

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 629/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Elbasan, më datë 28.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. H. I., z. S. H. dhe Z. V. S., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Elbasan rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, ndërsa nga Bashkia nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, shkronja (j)- *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 26.03.2023. Nga ana e Bashkisë Elbasan nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 25 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 25 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 13, janë zbatuar pjesërisht 1 masa dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 9 masa në vlerë 8,625,434 lekë, të pranuar 100% nga subjekti. Prej tyre janë zbatuar plotësisht 2 masa në vlerë 617,212 lekë, janë zbatuar pjesërisht 7 masa në vlerë 8,008,222 lekë.

Për masat shpenzim në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet 1 masë në vlerën 2,499 mijë lekë, e cila është analizuar dhe zbatuar si dhe janë rekomanduar 3 masa për arkëtim të vlerës 907,961 mijë lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 600 mijë lekë, është në proces vlera 907,361 mijë lekë si dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim në vlerën 26,600 mijë lekë
Për masat disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Elbasan që ti kërkoj komisionit disiplinor marrjen e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtarë të KLSH-së, masë e cila nuk është zbatuar.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 25.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe përputhshmërië” të ushtruar në Bashkinë Elbasan, sipas programit të auditimit nr. 629/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. H. I., përgjegjës i grupit;
2. S. H., anëtar,
3. V. S., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Elbasan në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, rezulton se nga **43** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **22** masa ose 51% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **21** masa ose 49% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 50%, nga ana e Bashkisë Elbasan, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Elbasan rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, ndërsa nga Bashkia Elbasan nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, shkronja (j)- *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Pa Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Elbasan, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 25.04.2023.

Nga ana e Bashkisë Elbasan nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Pa Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Elbasan ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr371/9 prot., datë 25.10.2022, **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Pa Zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Elbasan 25 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masë organizative, janë në proces zbatimi 13 masa organizative është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative si dhe nuk janë zbatuar 4 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm konstatohet se; Bashkia Elbasan nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune, nuk është bërë përditësimi i saj duke mos reflektuar ndryshimet strukturore të bëra për periudhën objekt auditimi. Edhe pse janë miratuar regjistrat e riskut, bashkia nuk ka hartuar një strategji në menaxhimin e riskut, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke u mjaftuar vetëm me trajnimet e organizuara nga ASPA, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh në njësinë vendore. Nuk janë hartuar programe për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafi si dhe nuk janë planifikuar pozicione me status “*ekselen*”, si dhe pozicione me status “*Grup i veçantë*”, ku përfshihen 17 kategori të ndryshme. Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, nuk ka programe të licencuara e për rrjedhojë programet me të cilat punohet nuk garantojnë mbrojtjen e të dhënave të sistemit elektronik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017” Për financat e vetëqeverisjes. vendore”, urdhrin e Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Elbasan të marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

1.1.1 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Elbasan ka marrë masa për njohjen dhe menaxhimin nga stafi të ligjit për MFK dhe manualit përkatës të tij duke përfshirë në planin vjetor të trajnimeve Nr.1532 datë 25.03.2022 disa trajnime me këtë objekt. “Trajnim Menaxhimi financiar baza ligjore elementët e përmirësuar”, zhvilluar në datat 30-31.01.2023 si dhe tema “Trajnim për SIFQ”, zhvilluar në datat 29-30 datë 03.2023. Gjithashtu nga Drejtoria e Financës në bashkëpunim me drejtoritë e tjera ka hartuar regjistrin e riskut.

Zbatuar

1.2 Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa për përditësimin e rregullores duke përcaktuar qartë detyrat dhe funksionet për çdo pozicioni pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Me urdher nr.1223, datë 17.11.2022 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës për hartimin e rregullores në përshtatje me strukturën aktuale të Bashkisë.

Me urdhër nr.1223/1, datë 17.11.2022 të Zv/Kryetares së Bashkisë, njëherazi kryesuese e grupit të punës është bërë ndarja e detyrave midis anëtarëve të grupit të punës.

Urdhërat i janë njoftuar dhe dërguar të gjithë Drejtorëve të Përgjithshëm dhe Drejtorëve të Drejtorive me e-mailin e datës 22.11.2022. Në përgjigje të këtij e-maili janë administruar projekt-rregullore të propozuara nga strukturat përkatëse.

Pas miratimit të strukturës organike së Bashkisë për vitin 2023, grupi i punës ka përgatitur pjesën e përgjithshme të rregullores së Bashkisë, e cila është miratuar me vendimin nr.1065, datë 28.02.2023 të Kryetarit të Bashkisë, duke lënë kohë 3 muaj për përpilimin e rregulloreve të çdo Drejtorie të Përgjithshme. Në kushtet kur nga ana e Kryetarit të Bashkisë është nxjerrë urdhëri nr.1188, datë 18.05.2023 “Për krijimin e Komisionit për Ristrukturimin e Bashkisë Elbasan dhe Institucioneve Vartëse të saj”, duke bërë i bërë njoftimin përkatës të gjithë punonjësve të Bashkisë dhe Institucioneve Vartëse të saj, është pezulluar përpilimi i rregulloreve të Drejtorive të Përgjithshme, deri në përfundimin e procesit të rristrukturimit të Institucionit.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Elbasan dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxhetet vjetore gjatë viteve kanë pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Elbasan.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Kështu për *në vitin 2020*, kanë ndodhur 17 ndryshime buxhetore me vlerë 236,398 mijë lekë, si dhe në vitin 2021 kanë ndodhur 13 ndryshime me vlerë 217,710 mijë lekë, veprime që tregojnë për planifikime optimiste të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve, duke e kthyer procesin e planifikimit dhe buxhetit, si edhe atë të përlllogaritjes së kostos së produkteve, në një mjet joreal, të qëndrueshëm dhe efektiv (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Financë/Buxhetit, në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Elbasan, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme.

Menjëherë dhe vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Drejtoria e Buxhet-Financës në bashkëpunim me Drejtoritë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Elbasan, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH ka kryer një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, kjo është reflektuar dhe në numrin e ulët të transferimeve dhe ndryshimeve në programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Grupi i KLSH konstatohet se, niveli i realizmit të investimeve të planifikuara për vitin 2020 paraqitet në masën 58 %, nga vlera planifikuar prej 722,661 mijë lekë është realizuar vlera prej 419,333 mijë lekë, në vitin 2021 në masën 43 %, nga vlera planifikuar prej 562,859 mijë lekë është realizuar vlera prej 244,308 mijë lekë.

Sipas Grupit të KLSH, kjo vjen nga planifikim i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/ shërbime/blerje mali), në raport me nivelin e planifikimit të të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre, nivel ky i cili nuk kalon limitet e 60% për asnjërin nga vitet objekt auditimi. Gjithashtu, bashkia në planifikimin e procedurave, **fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditorë), të cilat nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës**, kjo për të shmangur rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Financë/Buxhet Bashkia Elbasan, të marrë masa që;

-Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

- Planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar ato shërbim dhe investime më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Elbasan.

- Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Menjëherë dhe vijimësi

3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 137 datë 23.12.2021 mbi "Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan" për vitin 2022, rezulton se në miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet kanë zënë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat është bërë përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, detyrime që janë raportuar dhe në MFE Bashkia Elbasan përgjatë vitit 2022 ka ulur vlerën e detyrimeve të prapambetura.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, KLSH-ja konstaton se për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa mbi afatin **30 ditor** të faturave për shpenzime/ shërbime/investime të mbërritura në institucion në **169** raste në vlerën **1,266,050 mijë** lekë nga e cila: për vitin 2020 janë **123** fatura me vlerë **1,202,951 mijë** lekë dhe për vitin 2021 janë **46** fatura me vlerë **63,099 mijë** lekë. Ky fenomen vjen nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26/06/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52 .

-Nga Bashkia Elbasan (Drejtoria e Financë/Buxhet), ka fatura të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për periudhën objekt auditimi 01/01/2020 – 31/12/2021, paraqiten gjithsej **5** fatura me vlerë **43,373 mijë** lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Financë dhe Sektori i Buxhetit të Bashkia Elbasan, të marrin masa në respektim të afateve dhe likuidim të plotë të përcaktuar në faturat e ardhura nga operatorët ekonomike, pasi penalitetet kontraktuale janë dëme të pakthyeshme dhe të paparashikuara në buxhetet vjetore të miratuara.

Menjëherë dhe vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Realizimi i të ardhurave jo në nivelet e planikuara vjen për shkak të zërave të veçantë si p.sh taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet informale (e cila ka sjell vështirësi nga respektivisht në paragrafin ku citohej se “Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi është Shfuqizuar me Ligj Nr. 98/2020, datë 23.07.2020), të ardhurat nga shitja e aksioneve të Klubit të futbollit (për të cilën është hapur një proces gjyqësor) etj.. Gjithashtu Bashkia Elbasan ka si agjent tatimor UKE e cila në vitin e fundit u përfshi nga një ristrukturim duke u përthithur nga shoqëria UKRQE, duke sjellë vonesa dhe mungesa në transferimin e të ardhurave të arkëtuara për llogari të bashkisë Elbasan, gjë që ka sjell në raste të caktuara moslikujdimin e faturave brenda afatit 30 ditor. Nga të dhënat rezultojn se bashkia Elbasan nuk ka detyrime nga kamatëvonesa dhe penalitete kontraktuale në detyrimet e saj.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Sektorit të Buxhetit për periudhën 01/01/2020 - 31/12/2021, në lidhje me investimet publike, u konstatua se, kontratat nuk janë likuiduar sipas afateve të përcaktuara por në periudha të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Ministritë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Elbasan nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/ tarifatat vendore, të dhëna të cilat paraqiten, si vijon:

a-Për financimet nga Ministritë e linjës dhe donatorë të tjerë,

Për vitin 2020 janë lidhur 4 kontrata në shumën 29,695 mijë lekë, nga të cilat 2 kontrata në vlerën 15,231 mijë lekë financuar brenda vitit 2020 dhe 2 kontrata në vlerën 14,464 mijë lekë, me financim 2020-2021 sipas kontratës, nga e cila: financuar në vitin 2020 vlera 11,650 mijë lekë dhe në vitin 2021 vlera prej 2,814 mijë lekë.

Për kontratat e vitit 2021, gjithsej 2 kontrata në vlerën 18,032 mijë lekë, kontraktuar me dy vite financim (2021-2022), nga të cilat financuar në vitin 2021 vlera prej 8,278 mijë lekë, diferenca 9,754 mijë lekë sipas afateve të kontratave mbetet për financim në vitin 2022.

b-Për financimet nga buxheti Bashkisë Elbasan dhe Grande.

Janë lidhur për vitin 2020 gjithsej 33 kontrata në vlerën 180,793 mijë lekë, janë likuiduar gjatë vitit 2020 vlera prej 46,294 mijë lekë. Financuar me vonesë vlera 75,588 mijë lekë në vitin 2021, por meqenëse vlera 6,482 mijë lekë është mosrealizim kontrate mbetet për tu likuiduar vlera 52,429 mijë lekë, **kjo për mungesë të realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore.**

Gjatë vitit 2021 janë lidhur gjithsej 35 kontrata në vlerën 143,631 mijë lekë, është likuiduar gjatë vlera prej 86,035 mijë lekë, mbetet për likuidim me vonesë vlera 57,596 mijë lekë, **kjo për mungesë të realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore.**

Nga të dhënat e mësipërme, konstatohet se fondet e akorduara nga Ministritë e Linjës nuk janë të planifikuara në vlerën e plotë në momentin e kryerjes së procedurës, por janë të ndara në periudha. Ndërsa në lidhje me zbatimin e procedurave me fondet e vetë Bashkisë Elbasan për vitin 2020-2021 dhe grandeve të qeverisë, mos likuidimi i kontratave nuk vjen nga ndarja me vite të financimit, por nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore dhe planifikimi i procedurave pa një studim të mirëfilltë.

Në planifikimin e procedurave për vitet vijuese Bashkia Elbasan (Sektori i buxhetit), nuk merren në konsideratë realizimet faktike të të ardhurave nga taksat/tarifatat vendore, ku niveli i tyre nuk kalon 65%, nuk ka marrë në konsideratë nevojën për fonde në likuidimin e detyrimeve të prapambetura të cilat janë në vlera të larta. Shih Aneksin 2.3.5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Strukturat drejtuese të Bashkisë Elbasan, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

- Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

- Drejtoria Financës dhe Sektori i Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

Menjëherë dhe vijimësi

5.1. ga verifikimi rezultoi se: Me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 190 datë 27.12.2022 mbi “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan” për vitin 2023 Drejtoria e Buxhet-Financës në bashkëpunim me Drejtorinë dhe Sektorët e tjerë në Bashkinë Elbasan, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH ka kryer një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, kjo është reflektuar dhe në numrin e ulët të transferimeve dhe ndryshimeve në programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023. **Për financimet nga buxheti Bashkisë Elbasan** të pasqyruara nga grupi i kontrollit në Aneksin 2.3.5 nga verifikimet rezulton se nga totali 119,778,700 lekë mbetet për likuidim vetëm një objekt me vlerë 8,900,000. Tregues ky se planifikimi i buxhetit dhe investimeve është kryer duke marrë parasysh realizimin e të ardhurave.

Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se për vitet objekt auditimi ka regjistrime të reja dhe mbyllje aktiviteti, gjithsej **645** subjekte të reja dhe **364** subjekte mbyllur aktiviteti, nga të cilat: për vitin 2019 janë hapur **399** subjekte të reja dhe janë mbyllur **162** subjekte, për vitin 2020 janë hapur **104** subjekte të reja dhe janë mbyllur **162** subjekte dhe për vitin 2021, janë hapur **142** subjekte të reja dhe janë mbyllur **40** subjekte.

Kryesisht luhatshmëria e hapjes dhe e mbylljes së subjekteve, ka qenë bizneset e vogla, të cilët kanë pasur regjistrime me prioritet rritës për vitin 2019. Gjatë fillimit të pandemisë COVID-19, dhe në vitin 2020, ky trend rritje ka qenë i ulët, ku dhe ka pasur më të lartë mbyllje biznesesh se hapje biznesesh. Gjatë 2020 po ashtu, vërehet i njëjti trend dhe për bizneset e mëdha, ku ka pasur më shumë mbyllje, sesa hapje, përkatësisht **4** biznese të mëdha të hapura dhe **12** biznese të mëdha të mbyllura.

Ky është një tregues i qartë i efekteve të pandemisë, ku edhe pse me VKB nr.55 datë 18.06.2020 “Për një ndryshim në VKB nr. 179, datë 04.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Elbasan, për vitin 2020”, është lehtësuar tarifa e zënies së hapësirës publike, përsëri efekti pandemisë ka qenë dukshëm me ndikim në mbylljen e **150** bizneseve të vogla dhe **12** bizneseve të mëdha.

Gjithashtu vlen të theksohet dhe evidentohet dhe statistika e numrit të bizneseve aktive dhe joaktive si dhe gjendja debitore e tyre për vitet 2019, 2020 dhe 2021. Referuar të dhënave të D.T.T.V.M.A të Bashkisë Elbasan, vlera e detyrimit pra debisë së subjekteve jo aktive, në përqindje ndaj debisë totale, është 46,28% për vitin 2019, 41,57% për vitin 2020 si dhe 39,37% për vitin 2021. Kjo përbën një risk serioz për Bashkinë Elbasan, pasi pothuaj gjysma e debisë ndër vite, një debi kjo e cila paraqitet si llogari e arkëtueshme në Bilancet Kontabël të Bashkisë Elbasan, **përbëhet nga debi të subjekteve jo aktive, që do të thotë risk për mos tu**

mbledhur apo arkëtuar ndonjëherë kjo pjesë e detyrimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan, në kuadër të marrjes së masave të menjëhershme për të arkëtuar borxhin, i cili po kalon në fazën e borxhit të keq, të marrë masat për mbledhjen me forcë si dhe kalimin e çështjes në hapin e fundit që parashikon ligji, duke iu drejtuar strukturave të Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

Menjëherë dhe vijmësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Gjatë periudhës Janar – dhjetor 2022 përsa i përket subjekteve debitorë ndaj Bashkisë Elbasan, bazuar në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave e tarifave vendore”, i ndryshuar, janë zbatuar proçedurat e masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të prapambetura.

Masat e marra më konkretisht, paraqiten si më poshtë:

1.Janë berë bllokimet e llogarive bankare si me poshtë:

Nr.	Shkresa	nr.subjekte	vlera
1	Nr.112 prot, dt.20.01.2022	1	182,702.40
1	Nr.138 prot, dt.28.01.2022	1	55,982.22
2	Nr.319 prot, dt.28.02.2022	1	116,996.32
3	Nr.320 prot, dt.28.02.2022	1	142,941.39
4	Nr.323 prot, dt.28.02.2022	1	915,239.84
5	Nr.523 prot, dt.15.04.2022	1	95,229.90
6	Nr.577 prot, dt.27.04.2022	1	996,771.73
7	Nr.604 prot, dt.10.05.2022	1	111,929.00
8	Nr.605 prot, dt.10.05.2022	1	116,905.29
9	Nr.690 prot, dt.20.05.2022	1	1,525,621.49
10	Nr.691 prot, dt.20.05.2022	1	1,008,406.49
11	Nr.1099 prot, dt.05.08.2022	1	68,300.00
12	Nr.1180 prot, dt.31.08.2022	1	1,962,995.52
13	Nr.1297 prot, dt.26.09.2022	1	487,720.60
14	Nr.1300 prot, 28.09.2022	87	18,549,953.84
15	Nr.1373 prot, dt.14.10.2022	1	74,775.39
16	Nr.1481 prot, dt.14.11.2022	1	422,198.06
17	Nr.1535-1551 prot, dt.02.12.2022	17	96,285,526.76
18	Nr.1631 prot, dt.30.12.2022	952	58,396,509.64
19	Nr.1632 prot, dt.30.12.2022	200	58,149,401.24
		1271	239,483,404.72

- Janë dërguar pranë Raiffeisen Bankë urdhrat individuale te bllokimit te llogarive bankare për **807** subjekte debitorë në vlerën **177,962,259** lekë.

Nr.	Shkresa	Nr. subjekte	Vera
1	Nr.321 prot, dt.28.02.2022	89	19,385,468.38
2	Nr.327 prot, dt.01.03.2022	131	73,095,855.37
3	Nr.338 prot, dt.03.03.2022	120	42,787,892.64
4	Nr.432 prot, dt.25.03.2022	97	10,781,625.44
5	Nr.450 prot, dt.29.03.2022	96	9,023,693.55
6	Nr.680 prot, dt. 18.05.2022	78	13,771,487.24
7	Nr.706 prot, dt. 24.05.2022	99	6,579,262.49
8	Nr.714 prot, dt. 26.05.2022	97	2,536,974.33
		807	177,962,259.44

- Pra gjithsej jane kryer **2078** bllokime te subjekteve debitore ne vleren **417,445,664.16** leke.

- **Gjate kesaj periudhe kane paguar 1224 subjekte ne vleren 43,116,389.29 leke.**
- Jane bere 37 urdhra ekzekutimi ne vleren 3,445,723.63 lekë.
- Për periudhën Janar –Qershor 2023 janë kryer gjithësej 70 bllokime të subjekteve debitorë në vlerën 14,365,126 lekë. Gjatë kësaj periudha janë bërë 6 Urdhëra Ekzekutimi mbi balancën e llogarive bankare në vlerën 470,703 lekë.
- Me Urdhërin Administrativ **nr.987, datë 16.02.2023** “Për bashkëpunimin midis drejtorive” urdhërohen drejtoritë e përcaktuara në Urdhër që bashkëpunim cdo praktike aplikimi pranë tyre, subjektet janë të detyruara të paraqesin vërtetim nga D.T.T.V.M.A për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Elbasan.
 - Me shkresën **nr.336 prot, dt.03.03.2022** u është dërguar kërkesë për bashkëpunim institucioneve në lidhje me mosofrimin e shërbimeve subjekteve debitorë ndaj Bashkisë Elbasan: DRT, ASHK, DRSHTRR, DEGA DOGANES Elbasan, Dega Thesarit Elbasan, QKB Tirane.
 - Me shkresën **nr.346 prot, dt.04.03.2022** është dërguar shkresa drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Tirane për kërkim informacioni në lidhje me të dhënat mjetet në pronësi të 106 subjekteve debitorë, për të vazhduar me procedurën e vendosjes së barres siguroese pranë RBS.
 - Me shkresën **nr.530 prot, dt.20.04.2022** i është kërkuar informacion DPSHTRR, Tirane në lidhje me të dhënat e mjeteve në pronësi për 106 subjekte juridike debitorë.
 - Me shkresën **nr.638 prot, dt.12.05.2022** i është kërkuar informacion DPSHTRR, Tirane në lidhje me të dhënat e mjeteve në pronësi për 213 subjekte fizike debitorë.
 - Me shkresat **nr.400-425 prot, date 24.03.2022** është dërguar vendosja e barres siguroese për mjetet në pronësi të 25 subjekteve debitorë (për 87 mjete në pronësi të tyre) pranë Regjistratit të Barreve Siguroese, Tirane.
 - Jane dërguar në rrugë zyrtare njoftimet për vendosjen e barres siguroese dhe hipotekore për 272 subjekte juridike debitorë (shkresat 267 prot,dt.16.02.2022, nr.393 prot, dt.18.03.2022, nr.393 prot dt.23.03.2022).
 - Me shkresën nr.1573/1 prot, date 12.12.2022 i është kërkuar Drejtorisë Buxhet – Finance, Sektorit të Buxhetit kërkesa për parashikimin e fondit në buxhetin e vitit 2023 në vlerën 200,000 leke, shpenzime operative në lidhje me tarifatat për vendosjen e barrës siguroese dhe hipotekore, përkatësisht në RBS dhe ASHK.
 - Me **shkresën nr.571 Prot., datë 17.07.2023** D.T.T.V.M.A ka vënë në dispozicion të Drejtorisë Juridike Bashkia Elbasan subjektet debitorë për të cilët do të iniciohen procedurat ligjore konform parashikimeve të nenit 181, të ligjit Nr.7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 1,269,777,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 748,813,000 lekë ose 58,97 % me një diferencë në vlerën 520,964,000 lekë. Në fakt realizimi i të ardhurave paraqitet në masën 57,9%, pasi në faktin e vitit 2019 është paraqitur vlera gjithësej 13,232 mijë lekë, nga e cila: të ardhurat nga taksa e pullës 627 mijë lekë, sponsorizime 1,600 mijë lekë dhe granti nga Këshilli i Qarkut Elbasan në shumën 11,005 mijë lekë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e planit për vitin 2019 , edhe pse janë menaxhuar dhe përfituar nga Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan.

Për vitin 2020, të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore nga 1,251,909,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 765,784,000 lekë ose 61 % me një diferencë në vlerën 486,125,000 lekë. Në fakt realizimi i të ardhurave paraqitet në masën 59,5%, pasi në faktin e vitit 2020 është paraqitur vlera gjithësej 20,232 mijë lekë, nga e cila: të ardhurat nga taksa e pullës 452

mijë lekë, sponsorizime 18,880 mijë lekë dhe granti nga Këshilli i Qarkut Elbasan në shumën 900 mijë lekë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e planit për vitin 2020, edhe pse janë menaxhuar dhe përfituar nga Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan.

Për vitin 2021, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore nga 1,241,300,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 803,513,000 lekë ose 64,73 % me një diferencë në vlerën 437,787,000 lekë. Në fakt realizimi i të ardhurave paraqitet në masën 59,5%, pasi në faktin e vitit 2020 është paraqitur vlera gjithsej 20,232 mijë lekë, nga e cila: të ardhurat nga taksat e pullës 452 mijë lekë, sponsorizime 18,880 mijë lekë dhe granti nga Këshilli i Qarkut Elbasan në shumën 900 mijë lekë, të cilat nuk kanë qenë pjesë e planit për vitin 2020, edhe pse janë menaxhuar dhe përfituar nga Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan.

Niveli mesatar i realizimit të të ardhurave shkon deri në 60% dhe varion nga 7,69% që është tarifa e regjistrimit deri në 97,47% që është tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël. Në total nga 68 zëra fiskal që administrojnë Bashkia Elbasan, paraqiten me realizime 12 zëra ose 17,6% e totalit të tyre dhe nuk janë realizuar 82,4 % e totalit.

Kështu realizimi i të ardhurave, nivel ky shumë i ulët tregon punën e pamjaftueshme të kësaj administrate në planifikimin e të ardhurave dhe më kryesorja në arkëtimin e tyre, ku si rezultat i mos arkëtimeve bën që një pjesë e investimeve të parashikuara në buxhetet e viteve përkatëse, në fund të periudhave ushtrimore, të kenë rritje në gjendjen e faturave të palikujduara, duke sjellë kështu dhe rritjen e nivelit të borxhit.

Niveli i arkëtimeve për taksat vendore nga njëra periudhë në tjetër, në krahasim me nivelin e detyrimit përkatës, vjen në ulje, ku për vitin 2019 raporti arkëtim ndaj detyrim paraqitet në nivel realizimi 96%, në vitin 2020 paraqitet në nivel realizimi 82% si dhe në vitin 2021 paraqitet në nivel realizimi 76%.

Planifikimi i gabuar i TNI-së, në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ka pasur një efekt 16%, 14% dhe 19% për vitet përkatëse 2019, 2020 dhe 2021 në mosrealizim. Pra efekti i saj është relativisht i lartë, duke pasur parasysh peshën e ponderuar që ka kjo taksë në krahasim me taksat dhe tarifave të tjera.

Kjo tregon punën jo të mjaftueshme të administratës fiskale të Bashkisë Elbasan në planifikimin dhe menaxhimin e tyre, për të mundur rritjen e tyre dhe përdorimin e të ardhurave në favor të komunitetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan të marrë masa për një proces planifikimi të të ardhurave sa më real dhe në raport me kushtet e zhvillimit ekonomik dhe numrit të subjekteve që operojnë në Bashkinë Elbasan.

Të përqendrohet puna në rritjen e nivelit të arkëtimeve të planifikuara në mënyrë që të ulët borxhi tatimor, si dhe të analizohet situata dhe nxirren përgjegjësitë për rënien e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetër.

Menjëherë dhe vijmësi

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 5 subjekteve për shfrytëzim të fondit pyjor me objekt të veprimtarisë “gurorë” në Bashkinë Elbasan, rezultoi se:

A- Për subjektin “Y.” SHPK me NIPT L.....T

Nga auditimi i dokumentacionit të studimit tekniko ekonomik së bashku me anekset e përcaktuara dhe në udhëzimin nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të

*miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor Dhe Kulloror Publik”, nuk ka dalë asnjë VKM për heqjen nga Fondi Pyjor/Kulloror për 12 hektar shfrytëzim nga subjekti ekonomik “Y.” SHPK, aq më tepër të kemi dhe një ndryshim të zërit kadastral për këto 12 hektar. Nisur nga QKB si dhe duke parë aktivitetin dhe pagesën e taksave të subjektit “Y.” SHPK me NIPT L.....T, ndër to dhe Tarifën për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit siç referohet nga Inspektoriati i Mjedisit të Bashkisë Elbasan, duket qartë që ky subjekt ekonomik, **po ushtron aktivitet të plotë duke shfrytëzuar lejen minerare shfrytëzimi PN-3593-05-2012 që prej vitit 2013**, pa pasur një kontratë përdorimi të Fondit Pyjor/Kulloror me bashkinë Elbasan, që prej vitit 2012.*

B- Për subjektin “S.” SHPK me NIPT K....D

Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qeraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kulloror me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2007, si dhe me Komunën Shushicë për vitet 2011, 2012 dhe 2013. Megjithatë subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 5 ha prej vitit 2014 pa kontratë qeraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kulloror të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

C- Për subjektin “R.” SHPK me NIPT J....O

Nga auditimi është konstatuar se në dosje administrohen disa kontrata qeraje 1 vjeçare për përdorimin e fondit pyjor/kulloror me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, për vitin 2013, 2014 të cilat janë ripërsëritur. Ky subjekt ekonomik, shfrytëzon sipërfaqen prej 0,5 hektar që prej vitit 2015 pa kontratë qeraje si dhe nuk ka përmbushur detyrimet për heqjen nga fondi pyjor/kulloror të cilin e shfrytëzon dhe ky fond është aset i Bashkisë Elbasan.

D- Për subjektet U. SHPK me NIPT J....Q dhe V.SHPK me NIPT K....C

Për këto subjekte ekonomike, nga Bashkia Elbasan, Agjencia e Shërbimeve Pyjore, nuk administrohet asnjë dosje subjekti, pra praktikisht Bashkia Elbasan nuk ka asnjë informacion për aktivitetin e **U. SHPK dhe V.SHPK** në territorin e saj dhe nuk ka asnjë informacion për sa i përket shfrytëzimit të aseteve të saj (fondit pyjor/kulloror në total prej 4,58 ha) për efekt të nxjerrjes së gurit gëlqeror siç parashikohet në aktet e miratimit të lejes minerare, përkatësisht nr.922/1 datë 10.05.2016 për U.SHPK dhe nr. 1304/3 datë 26.01.2009 për V.SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, të merren masa në mënyrë të menjëhershme që të bllokohet aktiviteti ekonomik i këtyre guroveve, deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore në lidhje me heqjen nga fondi pyjorë dhe ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve përkatëse të guroveve të sipërcituara. Gjithashtu para momentit të zhbllokimit, pasi të jenë kryer të gjitha procedurat ligjore për heqjen nga fondi pyjorë, Bashkia Elbasan të bëjë një vlerësim për dëmin e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i sipërfaqeve të fondit pyjor dhe kulloror, dhe tua faturojë subjekteve përkatëse private me aktivitet gurore.

Menjëherë dhe vijimësi

8.2. Nga verifikimi rezultoi se: Struktura e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Elbasan për gjetjen nr.8 përgatiti njoftimet përkatëse për subjektet që ushtrjnë aktivitet minerar në fondin pyjor të bashkisë Elbasan për pezullimin e aktivitetit minerar deri në momentin e përfundimit të procedurave ligjore në lidhje me heqjen nga fondi pyjor dhe ndryshimin e zërit kadastral të sipërfaqes përkatëse të gurove ku është bërë me dije Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

Në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 6 kontratave të qirave të lidhura mes Bashkisë Elbasan dhe subjekteve private me aktivitet hidroenergjinë (HEC), në 5 prej tyre nuk u konstatuan gabime në aplikimin e çmimit sipas VKM 1064 datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të

kullotave". Në kontratën e qirasë nr...., datë 28.02.2018, për HEC A., nga rillogaritja sipas tabelës në aneksin 2.6.11, tarifa vjetore arrin vlerën 821,643 lekë për vitin e parë. Në vitin e dytë kësaj tarife i zbritet vlera e bimësisë pyjore (52,240 lekë) dhe arrin 769,403 lekë. Pas vitit të dytë, kësaj tarife i zbritet dhe përdorimi i fondit pyjor për përdorimin e rrugës së përkohshme (34,773 lekë), duke rezultuar kështu në një tarifë konstante **prej vitit të tretë dhe në vazhdim në vlerën 734,638 lekë.**

Referuar kontratës, vlera për vitin e parë dhe të dytë do të jetë 803,225 lekë si dhe për vitin e tretë dhe në vazhdim, kjo vlerë do të jetë 587,630 lekë. Siç shihet kemi diferenca për vitin e parë , të dytë, si dhe për vitin e tretë dhe në vazhdim si më poshtë:

Diferenca në Tarifimi Qeraje	Sipas Grupit të Auditimit	Sipas Kontratës	Diferenca
Tarifa viti I	821,643	803,225	18,418
Tarifa Viti II	769,403	587,630	181,773
Tarifa Viti III dhe në vazhdim	734,638	587,630	147,008

Formulimi i kësaj kontrate, e cila nuk ka filluar efektet financiare, sipas këtyre kushteve **që nga momenti i fillimit të efekteve financiare për 9 vite jetëgjatësi, do të sjellë të ardhura më pak për Bashkinë e Elbasanit në vlerën 1,229,247 lekë.** (18,418 lekë vitin e parë, 181,773 lekë vitin e dytë si dhe 7 vite x 147,008 lekë vitet e tjera). Pra konstatohen diferenca të dukshme midis vlerës së përlllogaritur sipas VKM-së nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe sipas përlllogaritjes së Bashkisë Elbasan. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan si dhe nga Drejtoria e Shërbimeve Pyjore, Bujqësore, Veterinarisë dhe Mjedisit, të merren masa që kontrata e qirasë nr.1323, datë 28.02.2018, ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe qiramarrësit I. SHPK, t'i bashkëngjitet një amendament, ku të rishikohet vetëm neni i llogaritjes së tarifës vjetore, pasi në kushtet aktuale, **që nga momenti që do të fillojnë efektet financiare, kjo kontratë, për 9 vite jetëgjatësi, do të sjellë të ardhura më pak për Bashkinë e Elbasanit në vlerën 1,229,247 lekë.**

Menjëherë dhe vijimësi

9.2.Nga verifikimi rezultoi se: Për sa më sipër Bashkia Elbasan ka përgatitur Amendimin e kontratës dhe ia ka dërguar subjektit për nënshkrimin e sajë me shkresën nr. 3566/1, date 30.06.2023. Dokumentet gjenden bashkëngjitur.

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, objektet e inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 3,008,943,334 lekë, nuk janë pajisur plotësisht me titull pronësie dhe sipas llogarive, paraqiten si më poshtë:

- llog 210 "Toka troje terrene", elementë në vlerën neto 451,251,163 lekë

-llog. 211 "Pyje plantacione", elementë në vlerën neto 43,084,021 lekë,

-llog. 212 "Ndërtesa e konstruksione", 43 objekte me vlerën neto 629,860,704 lekë

-Për rrjedhojë ka rezultuar se kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është mbështetur në një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor). Pavarësisht evidentimit të tyre në inventarin e aktiveve, dokumenti i cili vërteton pronësinë mbi pasuritë e paluajtshme është titulli i pronësisë, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 "Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme", Kreu VI "Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë dhe vijimësi

10.1.Nga verifikimi rezultoi se: Nisur nga fakti që Agjencia Shtetërore e Kadastrës është një Institucion me vetëfinancim, Bashkia Elbasan ashtu si çdo institucion tjetër duhet të paguajë për të gjitha shërbimet e kërkuara ku përfshihet edhe regjistrimi i pronave të transferuara në pronësi të saj. Ne vitet e fundit Bashkia Elbasan ka kryer një numër të konsiderueshëm shpronësimesh në funksion të projekteve me interes publik duke rritur koston e regjistrimit të pasurive të prekura, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Konstatojmë se procesi i regjistrimit vijon të kryhet sipas planifikimeve përkatëse të pasqyruara në buxhetin e çdo viti, duke marrë në konsideratë prioritetet e Institucionit.

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën neto 17,576,923 lekë, dhe në fund të vitit 2020 në vlerën neto 2,819,739 lekë. Diferenca në rritje vjen për shkak të projekteve infrastrukturore dhe projekte të ndryshme me kosto 17,858,995 lekë. Sipas inventarit kontabël, gjendja e kësaj llogaritje është në vlerën neto 17,576,923 lekë dhe përbëhet nga 19 projekte të Bashkisë Elbasan si dhe 13 projekte të njësive administrative, për investime të kryera , nga të cilat janë të hershme dhe nuk janë shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Pikërisht kjo vlerë konsiston në 15 projekte të Bashkisë Elbasan si dhe 13 projekte të trashëguara dhe nga ish komunat sot njësi administrative, me VKN prej 2,819,739 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6; të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 2,819,739 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

11.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar pasqyrave financiare të vitit 2022 dërguar në degën e thesarit Rezulton se për llogaritë përkatëse sintetike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuar për të cilat janë realizuar objektet dhe vlera e studimit i është bashkëngjitur vlerës së objektit dhe nuk janë sistemuar llogaritë përkatëse sintetike për 2 tipologji të studim projekteve si vijon:

1.Ato që trashëgohen nga ish komunat sot Njësitë administrative për të cilat nuk kemi të dhëna për investimet për të cilat janë hartuar këto studim projekte.

2.Studim projekte në llogarinë sintetike 202 të cilat datojnë herët në kohë dhe nuk lidhen me një investim specifik sepse janë në tipologji studime urbanistike ose harta dhe nuk kanë një objekt specifik të cilit t'i bashkëngjiten.

Zbatuar pjesërisht

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Elbasan, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.a. me NUIS “L43121201L” e cila është shoqëri aksionere me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të furnizimit të ujit të pishëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 1 me vlerë nominale 729,777,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej **2,145,432,331** lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Elbasan në “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” Sh.A. në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020 dhe 2021 ,më konkretisht në llogarinë **26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”** në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. Në rastin tonë investimi përbën aksionet me vlerë kontabël (kosto) **2,145,432,331** lekë dhe investori është Bashkia Elbasan.Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime ne pjesëmarrje me vlerë kontabël **2,145,432,331** lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.a me vlerë kontabël **2,145,432,331** lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

12.2.Nga verifikimi rezultoi se; Nga Bashkia Elbasan, janë marrë masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.a me vlerë kontabël **2,145,432,331** lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet, në datë 30.05.2022. Për shkak të ndryshimit të formës së organizimit të shoqërisë UKE dhe ndryshimit të përqindjes në pjesëmarrje, në aksionet e shoqërisë së re UKR sh.a, qarku Elbasan regjistruar në QKB datë 22.09.2022 aksionet e Bashkisë Elbasan në këtë shoqëri janë 28.52 % reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2022.

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Elbasan, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 16,691,799 lekë dhe vlerën e pullave të gjendjes civile të muajit dhjetor në shumën 1,025,003 lekë. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Elbasan.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020 dhe 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës (Shih Tabela 1 në Aneks).

Përfundimisht për vitin 2021;

Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për **12,748,706 lekë për vitin 2021**, për të cilat duhet të bëhet sistemimi i llogarisë, në kundërshtim me Ligjin 28/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10”; ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

13.2.Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Financës, janë marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466. Janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës. Referuar aneksit 1 të raportit të auditimit rezulton se nga vlera **12,748,706 lekë për vitin 2021** ka mbetur pa u likuiduar deri më datën 28.07.2023 vlera **9,518,680 lekë**.

Zbatuar pjesërisht

14. Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime Gjyqësore dhe investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 916,368,823 lekë. Kjo llogaria 467 paraqitet në vlerën **916,368,823 lekë** e përbërë nga:

Gjendje e letrave me vlere ne arke dhe sipas kartela per shumen 12,016,625 lekë të pasqyruara ne llog.532,468,4341.

Detyrimet per buxhetin e shtetit nga KLSH ne vite pasqyruar ne llog.468 per shumen 247,590,520 lekë;

Detyrimet nga debitorët e taksave ne vite pasqyruar ne llog.468 per shumen 878,593,179 lekë.

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Elbasan nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022 por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021 me vlerë totale **8,000,000 lekë**. Kjo procedurë mospasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022 por me kompetencë vitin 2021, përbën shtrembërim të informacionit financiar, duke qenë së detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 8,000,000 lekë, në kundërshtim me Ligji 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 5, 6, 7, 9 dhe 10, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, nëpërmjet Drejtorisë së Financës, të bëhen sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” e cila është nënvlerësuar për vlerën **8,000,000 lekë për vitin 2021**. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

14.2.Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura ka bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 467 “**Kreditorë të ndryshëm**” Gjithashtu rezulton që vlera e detyrimit të konstatuar si të pa raportuar ne MFE është likuiduar.

Zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 23 procedurave me vlera të larta, janë konstatuar shkelje në aplikimin e kriterëve jo në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP, ku kriteret nuk janë në përputhje me zërat e preventivit, si dhe nuk janë argumentuar në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 e nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me ndryshime. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 51-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Elbasan, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kriterëve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bazuar në rekomandimin e grupit të auditimit Titullari i autoritetit kontraktor për procedurat në vazhdimësi ka ngritur grup pune me specialistë të fushës sipas llojit të procedurës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogatritjen e fondit limit apo edhe të një pjese të kriterëve të veçanta.

Për hartimin e specifikimeve dhe kriterëve janë mbajtur proces verbalet përkatëse dukë argumentuar çdo kriter të vendosur. Argumentimi është bërë dukë u mbështetur në zërat e preventivave, volumet apo grafikun e punimeve.

Në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Në auditimin i procedurave të prokurimit për punë publike, është vendosur në 3 raste si kriter për punonjësit, dëshmia e sigurimit teknik, bazuar në ligjin me nr. 8734, datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, ndërkohë që objekti i punëve publike dhe stafi i nevojshëm për kryerjen e këtyre punimeve, nuk është në kushtet për të qenë i pajisur me këtë dëshmi, pasi nuk ka zëra punimesh që lidhen me objektin e ligjit. Gjithashtu, në 3 raste është hartuar një tabelë për t’u plotësuar me të dhëna mbi stafin e punonjësve sipas një formati të pa përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, ndërkohë që këto të dhëna plotësohen sipas formularit përkatës të vetëdeklarimit mbi disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1 Rekomandim: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit Bashkia Elbasan, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tilla, të cilat nuk mbështeten në kriterë ligjore, por krijojnë pengesë për operatorët ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.2.Nga verifikimi rezultoi se: Autoriteti Kontraktor në procedurat e shpallura në vazhdimësi ka mbajtur në konsideratë rekomandimin tuaj dhe ka shmangur vendosjen e kriterëve të lartpërmendura apo të ngjashme me to të cilat nuk gjejnë mbështetje ligjore.

Në proces zbatimi

17. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 2 procedurave të prokurimit për blerje mjetesesh, rezulton se specifikimet teknike të vendosura janë me diferenca minimale apo fikse për parametrat teknike.

Specifikimet teknike për mjetet, të cilët duhet të jenë të vitit të fundit, përcaktimi i ngjyrës apo llojit të karburantit, janë kërkesa të cilat mund të pengojnë konkurrencën, dhe janë në kundërshtim me nenin 23 të Ligjit me nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1 Rekomandim: Titullari i AK, të marrë masa për vendosjen nëpër komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat që në procedurat e shpallura në vazhdimësi të emërojë në komisionet e vlerësimit të ofertave persona në përputhje me parashikimet ligjore ku të paktën njëri nga anëtarët është specialist i fushës sipas llojit të prokurimit dhe anëtarët e tjerë janë persona me eksperiencë në fushën e prokurimeve.

Në hartimin e specifikimeve teknike janë marrë masat që hartimi i tyre të bëhet nga specialistë të fushës si dhe duke shamgur çdo përcaktim që pengon konkurrencën dhe bie në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit publik për blerje mallrash, në 2 raste procedura duhej të ishte ndarë në lote, pasi mallrat objekt prokurimi nuk janë të njëjta, veprime këto në kundërshtim me nenin 29 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar me nenin 42 të VKM-në nr. 285/2021. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.1. Nga verifikimi rezultoi se: Autoriteti Kontraktor në procedurat e shpallura në vazhdimësi ka mbajtur në konsideratë rekomandimin tuaj duke ndarë në lotë ato procedura për të cilat është e mundur ndarja në lote dhe duke hartuar kërkesat e veçanta për kualifikim për secilin lot në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

Në proces zbatimi

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 66 procedurave të prokurimit publik, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 13 procedura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, në kundërshtim me VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe me nenin 42 të VKM-në nr. 285/2021. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 56-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Elbasan, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e vlerësimit të ofertave, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar, të cilët në shpalljen fitues të OE, të vlerësojnë në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, dhe të udhëhiqen nga kriteri kryesor “Çmimi më i leverdishëm”, midis OE pjesëmarrës, kjo për të bërë të mundur përdorimin më me efektivitet të fondeve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Titullarit të AK janë marrë masat që në procedurat e shpallura në vazhdimësi të emërojë në komisionet e vlerësimit të ofertave persona në përputhje

me parashikimet ligjore ku të paktën njëri nga anëtarët është specialist i fushës sipas llojit të prokurimit dhe anëtarët e tjerë janë persona me eksperiencë në fushën e prokurimeve. Në procedurat në vazhdim vlerësimi i ofertave është bërë duke vlerësuar maksimalisht kriteret e DST dhe janë shpallur fitues OE të cilët i plotësojnë kriteret kualifikuese të DST.

Në proces zbatimi

20. Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 6 raste personat përgjegjës që administrojnë procesin në *e-leje*, i kanë miratuar ato në mospërbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin. Në 2 raste janë evidentuar mangësi që lidhen me distancat ndërmjet pronave kufitare dhe trupit të rrugës, në 1 rast mangësi që lidhet me lartësinë e objektit, në 2 raste mangësi që lidhen projektin e instalimeve të ngrohje – ftohje dhe në 1 rast mungesë e QKL për ekspertin e MNZ, veprime në kundërshtim me nenin 15, pika 1, germa (e, ë, g), pika 1.1/iii, nenin 32, nenin 35, nenin 36/b, neni 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 104-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Elbasan, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi në lidhje me distancat ndërmjet pronave kufitare si dhe lartësitë e objekteve.

20.1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, përsa i përket gjetjeve në pikën 20, ka zbatuar të gjitha parashikimet ligjore për ruajtjen e distancave objekt-kufi prone, objekt-objekt si dhe objekt-trup rruge. Në të treja rastet është zbatuar formula e përcaktuar në nenet 34, 35 dhe 36 të VKM-së Nr. 408/2015 e ndryshuar, përsa i përket distancave. Është zbatuar dhe parashikimi ligjor sipas nenit 37, të kësaj VKM-je, përsa i takon lartësive të objekteve. Gjithashtu, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit është verifikuar i gjithë dokumentacioni (projekt arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidrosanitar, MNZ, efience...etj), sipas llojit të lejes së aplikuar.

Në proces zbatimi

20.2 Rekomandim: Në shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, subjektet e licencuara për hartimit e projekteve, të jenë subjekte që krahas licencimit përkatës, të disponojnë edhe QKL/Nipt-et përkatëse për ushtrimin e aktivitetit përkatës.

20.2.1.Nga verifikimi rezultoi se:*Në shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, subjektet e licencuara për hartimin e projekteve, janë subjekte që krahas licencimit përkatës, disponojnë edhe Nipt-et përkatëse për ushtrimin e aktivitetit. Kjo pasi që në momentin që plotësohet formulari i aplikimit, gjenerohen të gjithë të dhënat e projektuesëve (përfshirë dhe Nipt-et përkatëse) automatikisht nga sistemi.*

Zbatuar

20.3 Rekomandim: Referuar aplikimeve për leje ndërtimi, bazuar në sipërfaqen e objektit, të plotësohen me projektet teknike përkatëse të instalimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

20.3.1.Nga verifikimi rezultoi se:*Bazuar në Nenin 15, pika 1/3 të VKM 408/2015 me të gjitha ndryshimet, për objekte me sipërfaqe ndërtimi mbi tokë nën 250 m² nuk kërkohen projektet e instalimeve (projekti i instalimeve hidrosanitare, projekti elektrik dhe projekti i instalimeve të ngrohje-ftohjes), ndërsa për objekte me sipërfaqe ndërtimi mbi tokë mbi 250 m² kërkohen projektet e instalimeve (projekti i instalimeve hidrosanitare, projekti elektrik dhe projekti i instalimeve të ngrohje-ftohjes), me përjashtim të rasteve kur në projektin dhe relacionin arkitektonik parashikohet që nuk do të ketë instalime për ngrohje-ftohjen dhe ajrimi i objektit do të bëhet në mënyrë natyrale, si në rastin e objekteve për banim.*

Në proces zbatimi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit rezulton se, KLSH ka rekomanduar 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën **2,379,607 lekë** (1,825,587 lekë pa TVSH nga BOE “M.” SHPK dhe “V.” SHPK dhe 554,020 lekë pa TVSH, nga OE “E.” SHPK). Nga ana e Bashkisë Elbasan janë nxjerrë urdhrat zhdëmtimit nr. 65 datë 16.01.2019 dhe nr. 66 datë 16.01.2019 dhe është kontabilizuar e gjithë vlera në momentin e daljes së urdhrit. Gjithashtu, janë nisur njoftimet për të dy urdhrat e zhdëmtimit, respektivisht urdhri nr. 65 datë 16.01.2019 i është njoftuar subjektit “E.” SHPK me shkresën nr. 6860/35-A datë 18.03.2019 dhe urdhri nr.66 datë 16.01.2019 i është njoftuar subjektit “V.” SHPK me shkresën nr. 6860 /34-A dhe “M.” SHPK me shkresën 6860/35-A datë 18.03.2019, por nuk ka filluar arkëtimi. Rezulton se për të dy rastet janë hartuar paditë gjyqësore dhe rekomandimi është në proces zbatimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 111-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan të vazhdojë ndjekjen e të gjitha shkallëve të proceseve gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën **2,379,607 lekë** (1,825,587 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomik “M.” SHPK, dhe “V.” SHPK dhe 554,020 lekë pa TVSH, nga Operatori Ekonomik “E.” SHPK).

Në vijimësi

21.1.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Elbasan vazhdon të ndjek proceset gjyqësore për arkëtimin e dëmit në vlerën **2,379,607 lekë** (1,825,587 lekë pa TVSH nga Operatori Ekonomik “M.” SHPK, dhe “V.” SHPK dhe 554,020 lekë pa TVSH, nga Operatori Ekonomik “E.” SHPK).

Për Operatori Ekonomik “E.” SHPK nga momenti i hapjes së procesit gjyqësor gjykata nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për vazhdimin e procesit.

Për Operatori Ekonomik “M.” SHPK, dhe “V.” SHPK jemi në fazën e pagesës së taksës gjyqësore njoftimi për të cilën ka ardhur nga gjykata në datë 14.07.2023.

Në proces zbatimi

22. Gjetje nga auditimi: Nisur nga Projektraporti i auditimit në drejtimin e zbatimit të punimeve, për objektin “Rikonstrukcion i konviktit (vajzave) “Ymer Tola” të shkollës pedagogjike”, Bashkia Elbasan, është paraqitur, nëpërmjet emailit zyrtar të datës 14.09.2022, një procesverbal i mbajtur ndërmjet Sipërmarrësit të punimeve, Mbikëqyrësit dhe ing. E. A., si përfaqësues i Bashkisë, në të cilin citohet që janë realizuar zërat e punës II.16, III.3 dhe III.17, respektivisht “Ulluk shkarkimi vertikal me bakër d=120 mm, çmimi”, “FV kabinë dushi 80x80 cm e thjeshtë” dhe “Shuarës të thatë, kategoria A,B,C,D,E, 6 kg”. Nga Bashkia Elbasan nuk është paraqitur dokumentacioni i plotë për këtë procedurë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 89-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan, nëpërmjet një grupi pune të ngritur me Urdhër të Titullarit të Bashkisë Elbasan, të vazhdojë ndjekjen e punimeve deri në përfundimin e tyre, duke i formalizuar me procesverbal të nënshkruar nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi dhe personat e ngarkuar nga Bashkia Elbasan.

Menjëherë

22.2. Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën e verifikimit nuk është ngritur grupi i punës

Pa zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”,

nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **8,625,434 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, janë verifikuar dokumentacionet dhe listat paraprake të D.T.T.V si dhe listat përfundimtare të Inspektoriatit të Mjedisit të Bashkisë Elbasan për të tre vitet objekt auditimi 2019, 2020 dhe 2021. Gjithashtu janë verifikuar tarifimet, arkëtimi si dhe detyrimi i parafuar/paarkëtuar i këtyre tarifave. Nga verifikimi i listës së subjekteve ku paraqitet vlera e tarifuar , vlera e arkëtuar, vlera e paarkëtuar pra detyrimi i mbetur, për të tre vitet objekt auditimi, rezulton në detyrimi i paarkëtuar në vlerën **2,032,000 lekë (Aneksi 2.6.1)**, në kundërshtim me nenin 12 të Ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” . Nga ana tjetër, pasi janë verifikuar subjektet objekt të Tarifës për Mbrojtjen dhe Përmirësimin e Mjedisit, është vënë re që disa prej tyre nuk janë tarifuar ose janë tarifuar jo në përputhje me fashat e përcaktuara në paktetat fiskale për tre vitet 2019, 2020 dhe 2021, raste të trajtuara sipas problematikës përkatëse si më poshtë;

a- Nuk është tarifuar nga Sektori i Vlerësimit Tatimor për shkak se lista përfundimtare e Inspektoriatit të Mjedisit i ka përjashtuar nga subjektet objekt tarifimi (S. A. me NIPT J.....K për vitin 2019; R. me NIPT K.....V për vitet 2019 dhe 2020; E. me NIPT L.....C për vitin 2019; M. me NIPT L.....D për vitet 2020 dhe 2021).

b- Nuk është tarifuar nga Sektori i Vlerësimit Tatimor edhe pse bën pjesë në listat përfundimtare të Inspektoriatit të Mjedisit për subjektet objekt tarifimi (E. SHPK me NIPT K.....C për vitet 2019, 2020 dhe 2021).

c- Janë tarifuar jo në përputhje me fashat e përcaktuara në Paktetat Fiskale 2019, 2020 dhe 2021 (subjektet A., M. dhe Y.).

Përjashtimi nga tarifimi për arsye se nuk janë në listat e Inspektoriatit të Mjedisit, përgjegjësi kjo e drejtpërdrejt e këtij inspektoriatit, si dhe për arsye se është aplikuar gabim fasha e tarifimit në paketë fiskale, përgjegjësi kjo e drejtpërdrejt e Sektorit të Vlerësimit Tatimor. Nga kjo problematikë rezulton vlera e paarkëtuar **3,104,000 lekë (Aneksi 2.6.2)**. ***Pra në total vlera e paarkëtuar nga Bashkia Elbasan është 5,136,000 lekë.*** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave të Bashkisë Elbasan, të koordinohet me Drejtorinë Rajonale Tatimore të Elbasanit, që për 7 subjektet e identifikuar si të pa tarifuar ose tarifuar jo në përputhje me fashat e përcaktuara në paketat fiskale (Aneksi 2.6.2), të kontrollohet objekti i aktivitetit nëpërmjet kontrollit të faturimeve në sistem (librat e blerjeve dhe shitjeve përkatës), për vitet 2019, 2020 dhe 2021, si dhe të mbahen dhe akt konstatime në këto subjekte, duke përcaktuar përfundimisht nëse këto subjekte kanë ushtruar aktivitet ose jo, përgjatë viteve objekt auditimi. Pas këtij procesi, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën përfundimtare të mbrojtjes në mjedis duke bërë likuidimin e të ardhurave të pambledhura.

Brenda datës 30.06.2023

1.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në kuadër të auditimit të ushtruar pranë DTTVMA, për tre vite objekt auditimi përkatësisht 2019-2020-2021, në zbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi tarifimin e subjekteve që kanë ndikim në mjedis, nga ana e Drejtorisë së Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave rezulton se:

Me shkresën nr.1170 Prot., datë 30.08.2022 DTTVMA, i ka kërkuar DRTE informacion lidhur me deklaratimet e kryera nga subjektet e përcaktuara nga KLSH, sipas listës bashkangjitur kësaj kërkesë, lidhur me llojin e të ardhurave të deklaruara në Raportet Vjetore 2019-2020-2021. D.R.T.E nëpërmjet shkresës nr.8267/1 datë 02.09.2022 referuar të dhënave të sistemit informatik C@TS dhe deklaratës së Tatimit mbi Fitimin ka sjellë informacion lidhur me të ardhurat e deklaruara për subjektet: E., Y. dhe E. sh.p.k.

Me shkresën nr.586 Prot., datë 20.07.2023 DTTVMA, i ka kërkuar DRTE informacion lidhur me faturimet e deklaruara (libra shitje-libra blerje përkatës) për vitet 2019-2020-2021 për subjektet: S. A., R., E., M., E. sh.p.k dhe A..

Me shkresën nr.235 Prot., datë 09.03.2023 D.T.T.V.M.A i ka kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me llojin e të ardhurave të deklaruara në raportet vjetore për vitet 2019-2020-2021 për subjektet S. A., R. dhe A..

Në zbatim të **Urdhërit të Brendshëm nr.242 prot., datë 13.03.2023** është mbajtur relacioni përmbledhës **nr.242/5 Prot., datë 30.03.2023**, në të cilin është kryer verifikimi për subjektet dhe ka rezultuar:

Subjekti M. N. P., NIPT:L.....D, adresa: 5 Maji, rruga "Teqe e madhe" Ky subjekt nuk është tarifuar në vitin 2021 për tarifën për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit si pasojë e ndryshimit në QKB të objektit të aktivitetit në dt.03.12.2019 me Vendim dt.24.11.2019 "Për ndryshim objekti", pasqyruar kjo në ekstarktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar".

Konkretisht ky subjekt përpara dt.03.12.2019 ka pasur edhe aktivitetin, grumbullim e tregtim me shumicë e pakicë të skrapit, pas kësaj date ky subjekt nuk e ka ushtruar me këtë aktivitet e për rrjedhojë konform paketës fiskale të vitit 2021 nuk është tarifuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Referuar Akt Kontrollit nr.242/3 Prot., datë 24.03.2023 kjo adresë është shtëpi banimi dhe nuk u gjet asnjë e dhënë që të mund të vërtetonte që subjekti ushtron aktivitetin e grumbullimit dhe tregtimit të skrapit në lagjen 5 Maji. Aktualisht në këtë adresë nuk ushtrohet aktivitet. Ky subjekt rezulton në statusin pasiv nga data 31.01.2023.

Subjekti E. shpk, NIPT: K.....C, adresa: Labinot Mal. Ky subjekt nuk është tarifuar në vitin 2021 për tarifën për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit si pasojë e mbylljes së kësaj adrese në QKB në dt.24.04.2018 me Vendim dt.23.04.2018 "Për mbylljen e një adrese dytësore" pasqyruar kjo në ekstarktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", duke e mbyllur aktivitetin në adresën Labinot Mal, rrjedhimisht dhe nuk është tarifuar për vitin 2021. Nga akt kontrolli i mbajtur, sipas relacionit të sipërcituar rezultoi se subjekti është i mbyllur dhe nuk u gjet asnjë e dhënë që të mund të vërtetonte që subjekti ushtron aktivitetin e shfrytëzimit të pyjeve dhe minierave në njësinë administrative Labinot Mal. Subjekti nuk ushtron aktivitet në këtë adresë.

Subjekti S. A., NIPT:J.....K, adresa: Bradashesh. Bazuar në ekstarktin historik të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", selia e ushtrimit të aktivitetit është në qytetin e Durrësit me adresë Kalata Lindore, Porti Durrës. Në qytetin e Elbasanit ky subjekt figuron depo materiali, me adresë ish Uzina 12, Metalurgji, Bradashesh, (shiko fq2 ekstrakti). Për sa më sipër ky biznes nuk është subjekt prodhues dhe rrjedhimisht nuk tarifohet si i tillë bazuar në paketën fiskale miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak përkatës. S. A. tarifohet si biznes i madh tregti dhe për këtë arsye nuk i takon tarifa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit. Pas verifikimit të kryer referuar Akt Kontrollit nr.242/4 Prot., datë 24.03.2023 në objektin me nr. pasurie 350/2 ish Uzina 12 Nikel Cobalti metalurgji rezultoi se ky objekt është depo materialesh dhe në momentin e inspektimit ishte bosh.

Subjekti E. A., NIPT:L.....C, adresa: Bradashesh. Ky subjekt në vitin 2019 nuk është tarifuar për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit pasi sipas shkresës nr.2256/1 prot., dt.10.06.2019 ardhur nga Inspektoriati i Mjedisit, është konstatuar se aktiviteti që ushtron ky subjekt nuk ka ndikim negativ në mjedis. Pas verifikimit të kryer referuar Akt Kontrollit nr.242/2 Prot., datë 24.03.2023 subjekti rezultoi i çregjistruar dhe nuk ushtron më aktivitet ekonomik, bazuar kjo dhe në ekstraktin historik në QKB.

Subjekti M. A. B., NIPT: K.....G, adresa: Papër. Ky subjekt është tarifuar sipas llojit të aktivitet të paraqitur në QKB “Kërkim, Zbulim, shfrytëzim, studim, projektim, zhvillim etj .. të mineralit të hekurit në sipërfaqe”, pra adresa në Elbasan është Dampa e mineralit të hekurit jo gurorë. Sipas Projekt Raportit është marrë në konsideratë observacioni lidhur me subjektin M..

Subjekti Y., Y. S., NIPT: L.....T, adresa: Gjinar, Derstile, zona 64. Ky subjekt është tarifuar sipas rekomandimeve të lëna në Projekt Raport, është faturuar dhe subjekti ka shlyer detyrimin lidhur me tarifën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit më datë 12.07.2023.

Subjekti A. S. G, NIPT:L.....H, adresa: Bradashesh. Subjekti është ngarkuar lidhur me tarifën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit dhe nëpërmjet shkresës nr.589 Prot., datë 20.07.2023 është njoftuar lidhur me këtë detyrim ndaj Bashkisë Elbasan.

Subjekti R. R. G., NIPT:K.....V, adresa: Labinot-Fushë. Ky subjekt është tarifuar në vitet 2019 dhe 2020 për tarifën për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit por kjo tarifë është anuluar me shkresat ardhur nga Inspektoriati i Mjedisit. Konkretisht duke ju referuar shkresave nr.235/1 dt.11.01.2019 dhe 2412/2, dt 09.11.2020. Pas rekomandimeve të lëna subjekti R. është njoftuar për detyrimet lidhur me tarifën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit dhe me shkresën nr.589 prot., datë 20.07.2023

Nëpërmjet shkresës nr.589 datë 20.07.2023 subjektet e sipërcituara janë njoftuar lidhur me detyrimet ndaj Bashkisë Elbasan përsa i përket tarifës së mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit.

Referuar subjekteve të tarifuar por të paarkëtuara për vitet 2019-2020-2021 në zbatim të **Urdhërit nr.252 Prot. datë 16.03.2023** është mbajtur relacioni përmbledhës ku janë verifikuar subjektet:

M. me NIPT – L.....D është objekt banimi dhe nuk u gjet asnjë e dhënë që mund të vërtetonte se subjekti ka pas ushtruar aktivitetin e grumbullimit dhe tregtimit të skrapit në lagjen 5 Maji. Subjekti aktualisht nuk ushtron aktivitet në këtë adresë, gjithashtu është lajmëruar për debinë e vitit 2019 ndaj Bashkisë Elbasan për shumën 200 000 lekë.

M. me NIPT – K.....G subjekti nuk e ka ushtruar këtë aktivitet në adresën e deklaruar në QKB. Subjekti gjithashtu është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 336 000 lekë.

A. me NIPT – L.....H. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 636 000 lekë.

F. me NIPT – L....J. Subjekti nuk gjendet në adresën e deklaruar në QKB. Subjekti është debitor për shumën 648 000 lekë ndaj Bashkisë Elbasan.

A. me NIPT – J....Ë. Subjekti aktualisht nuk ushtron aktivitet në këtë adresë, pasiv nga dt. 26.04.2019 gjithashtu është lajmëruar për debinë e vitit 2019 ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 74,667 lekë.

A. me NIPT – K.....U. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 25 000 lekë.

A. S. me NIPT – L.....O. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 8 000 lekë.

G. L. me NIPT – L...H. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 8 000 lekë.

H. me NIPT – L....K. Subjekti aktualisht nuk ushtron aktivitet në adresën e deklaruar nga data 26.04.2019. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 20 000 lekë.

A. me NIPT – L....E. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 25 000 lekë.

E. J. me NIPT – M....S. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 16 000 lekë.

Petrit Çili me NIPT – M....C. Subjekti është lajmëruar për debinë ndaj Bashkisë Elbasan në vlerën 6 000 lekë.

Subjektet e sipërcituar janë njoftuar lidhur me detyrimet ndaj Bashkisë Elbasan, përsa i tarifës së mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit nëpërmjet shkresës nr.585 Prot., datë 20.07.2023.

Nga vlera totale e paarkëtuar që është konstatuar në verifikimin e kryer nga KLSH në shumën 2,032,000, lekë aktualisht është pa shlyer vlera 2,002,667 lekë dhe është shlyer diferenca. Subjektet e cituar si më poshtë kanë shlyer detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Elbasan lidhur me tarifën e mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit:

Nr.	NIPT	Emri i Subjektit	Adresa	data pageses	tarife ndotje mjedisi
1	L....T	J. M.	Lagja Shenkoll, Rr.Thoma Kalefi, ndertesa nr.3387	07.07.2022	8,000
2	M....A	R. B.	L.Dyli Haxhire,Rr. Hafiz Sulejman Kungulli, ZK.8526, pas. 8713	14.07.2022	5,333
3	L....P	A. P.	Bradashesh, Katund I ri, km 5	30.09.2022	8,000
4	K....R	M. N. D.	Lagja Partizani, Rr. Mehmet Karadaku, zk.8527, pasuria 2/657	24.10.2022	8,000

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit ku u kryqëzuan të dhënat e marra nga Sektori i Investimeve në lidhje me subjektet që kishin lidhur kontratë publike me bashkinë, dhe të dhënavë të marra nga Drejtorinë e Taksave për pagimin e tarifave në lidhje me pagesën e tarifave përkatëse të këtyre subjekteve, u konstatuan dy fenomene;

1- Operatorë ekonomikë të cilët e kishin mbyllur Nipti sekondar përpara mbarimit të kontratës duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim ndriçimit dhe për kantierin e ndërtimit.

2- Operatorë ekonomikë të cilët kanë lidhur kontrata gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021 dhe nuk kanë hapur Nipt sekondar, duke mos ju llogaritur në këtë mënyrë edhe tarifa e pastrim, gjelbërim ndriçimit dhe për kantierin e ndërtimit

Këto subjekte (*operatorë ekonomikë në Aneksin 2.6.3 dhe 2.6.4*) janë në shkelje të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1. **Vlera totale prej 528,917 lekë, e cila përfaqëson mosfaturim dhe mosarkëtim të tarifave të pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit si dhe tarifave të kantierit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues gjatë procedurave të prokurimeve publike, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të Bashkisë Elbasan. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

2.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e shumës prej 528,917 lekë si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim për subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Elbasan.

Brenda datës 30.06.2023

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi Tarifatat Vendore për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në prokurimet publike të zhvilluara nga Bashkia Elbasan, Sektori i Vlerësimit dhe Kadastrës Fiskale, pranë D.T.T.V.M.A ka bërë rregjistrimin, ngarkesën me detyrime përkatësisht për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit dhe njoftimin nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a për operatorët ekonomike, si më poshtë:

1.“B. shpk”, përfaqësuar nga **Z. B. T.** me nr. NUIS-i **K.....A** për objektin e aktivitetit “Rinkonstruksioni i rrugës **A. Ç. sheshet e pallateve, rr. A. Ç., L. S. D.,** Elbasan. Kontrata për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 31.10.2019 dhe me afat 2 muaj dhe 1 muaj e 20 ditë. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2019-2020 rezulton në vlerën 23,499.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

2.“S. shpk”, përfaqësuar nga **Z. G. B.** me nr. NUIS-i **K....N** për objektin e aktivitetit “Rivitalizimi i lulishtes “Kozma Naska”, Lagjia “Kongresi Elbasanit”, Elbasan. Kontrata për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 30.12.2019 dhe me afat 1 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2019 rezulton në vlerën 8,333.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

3.“N. shpk”, përfaqësuar nga **Z. S. N.,** me nr. NUIS-i **J....U** për objektin e aktivitetit “Rehabilitimi i sheshit para pallateve, lulishte midis rrugëve **Q. S. si dhe Loti I: Mbrojtje nga përroi i Goatimës,** të tokës bujqësore fshati Buajras, Njësia Administrative Gjergjan (A.SH.P.), Elbasan. Kontratat për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan janë lidhur më datë 17.12.2020 dhe me afat 2 muaj; dhe datë 16.09.2021 me afat 12 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2020 rezulton në vlerën 18,334.00 lekë dhe njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2021 rezulton në vlerën 11,833.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

4.“C shpk”, përfaqësuar nga **Z. D. L.,** me nr. NUIS-i **J....E** për objektin e aktivitetit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitet e varfëra, Elbasan”. Kontrata për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 12.10.2020 dhe me afat 3 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2020 rezulton në vlerën 5,917 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

5.“F. shpk”, përfaqësuar nga **Z. F. M.,** me nr. NUIS-i **K....C** për objektin e aktivitetit “Ndërtimi i veprave të artit në rrugët rurale dhe konvicionale A.SH.P., Elbasan,”. Kontrata për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 04.02.2020 dhe me afat 3 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2020 rezulton në vlerën 17,750.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

6.“N shpk”, përfaqësuar nga **Z. N. S.,** me nr. NUIS-i: **L.....L** për objektin e aktivitetit “Rinkonstruksioni në objektet arsimore **Q.E.A. Elbasan**”. Kontrata për lejin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 28.10.2020 dhe me afat 1 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2020 rezulton në vlerën 11,833.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

7.“S. shpk”, përfaqësuar nga **Z. S. K.,** me NIPT-i: **K....Ë** për objektin e aktivitetit “Rehabilitimi i sheshit urban në lindje të rrugës Iliaz Kosova tek xhamia Fushë-Mbret Elbasan”. Kontrata për

lejimin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 30.08.2021 dhe me afat 2 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2021 rezulton në vlerën 11,833.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

8. "I. shpk", përfaqësuar nga **Z. F. M.** me NIPT-i: **J.....L** për objektin e aktivitetit "Kryerja e rikonstruksionit dhe ndërhyrjes në linjën dhe ndërtimin e sheshit të parkimit pranë Varrezave Publike, Elbasan". Kontrata për lejimin e kryerjes së punimeve në territorin e Bashkisë Elbasan është lidhur më datë 07.03.2022 dhe me afat 5 muaj. Njoftim detyrimi dhe fatura e arkëtimit për tarifën e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, viti 2022 rezulton në vlerën 29,853.00 lekë. Njoftuar me njoftim detyrimi **nr. 551 prot., datë 11.07.2023.**

Operatorët ekonomikë si më lart janë njoftuar me njoftim detyrimet **nr. 551 prot., datë 11.07.2023** me rrugë postare.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga aplikimi i pasaktë i çmimit të gazoilit në faturimin që kanë bërë operatorët ekonomik, ka bërë të mundur që pagesat e faturave të gazoilit të Bashkisë Elbasan të jenë përtej çmimit real sipas kushteve CIF në Shqipëri. Si rezultat kjo ka sjellë pagesa të tepërta ndaj furnitorit **"G." SHPK, me efekt 879,159 lekë, që përbën dëm ekonomik shkaktuar Bashkisë Elbasan.** Rillogaritja është bërë për urdhër shpenzimet si më poshtë (Aneks 2.6.14);

a- Me Urdhër shpenzimin nr. 536, dt. 17.09.2019 është likuiduar vlera prej 3,266,600 lekë me TVSh. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 71,500 lekë.

b- Me Urdhër shpenzimin nr. 301, dt. 23.06.2020 është likuiduar vlera prej 1,000,000 lekë me TVSh, me urdhër shpenzimin nr.513 dt.23.09.2020 është likuiduar vlera prej 730,000 lekë me TVSh, si dhe me urdhër shpenzimin nr. 721 dt.17.12.2020 është likuiduar vlera prej 1,463,000 lekë me TVSh, të gjitha këto në funksion të likuidimit të faturës nr. 1819 datë 17.09.2019 me vlerë 3,193,000 lekë. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 124,740 lekë.

c- Me Urdhër shpenzimin nr. 302, dt. 24.06.2020 është likuiduar vlera prej 1,616,400 lekë me TVSh. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 60,233 lekë.

d- Me Urdhër shpenzimin nr. 323 dhe 327, dt. 28.05.2021 është likuiduar vlera prej 3,734,070 lekë me TVSh për faturën nr.113/2021 datë 17.03.2021 me vlerë 4,464,380 lekë. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 553,930 lekë.

e- Me Urdhër shpenzimin nr. 329, dt. 28.05.2021 është likuiduar vlera prej 1,497,000 lekë me TVSh. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 39,961 lekë.

Me Urdhër shpenzimin nr. 619, dt. 27.07.2020 është likuiduar vlera prej 799,908 lekë me TVSh. Nga rillogaritja, dëmi ekonomik i shkaktuar nga pagesa e tepërt për këtë faturë është 28,795 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës ,të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **879,159** lekë me TVSh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti **"G."** SHPK, përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat

bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Brenda datës 30.06.2023

3.2.Nga verifikimi rezultoi se:, për diferencën prej 879,159 lekë me tvsh Bashkia Elbasan ka lëshuar urdhërin nr.1363, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 4 datë 24.07.2023, për shumën 879,159 lekë dhe me shkresën nr. 6194 1, datë 20,07.2023 ka njoftuar shoqërinë debitore “G.” për likuidimin e sajë .

Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“B.” dhe rikonstruksioni i rrugës “Haki Ballshi”, lagjja “Emin Matraxhiu”, Bashkia Elbasan,** me vlerë të kontratës (me TVSh) 32,390,143 lekë, fituar nga OE **“B.”** SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 946,555 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3421/6 prot datë 28.06.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE **“B.”** SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **946,555 lekë pa TVSh** nga OE **“B.”** SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3421/6 prot datë 28.06.2019, me objekt **“B.”** dhe rikonstruksioni i rrugës **“Haki Ballshi”, lagjja “Emin Matraxhiu”,** Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

*4.2.Nga verifikimi rezultoi se:, për diferencën prej 946,555 lekë pa tvsh Bashkia Elbasan ka lëshuar urdhërin nr.1362, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 3 datë 24.03.2023, për shumën 946,555 lekë dhe me shkresën nr. 6193/1, datë 31.03.2023 ka njoftuar shoqërinë debitore **“B.”** sh.p.k, për likuidimin e sajë. Deri në momentin e verifikimit nuk është likuiduar asnjë lekë*

Zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i rrugëve “Ali Caushi” dhe sheshet e pallateve 108/3-12, Lagjja S. D.”,** Bashkia Elbasan, me vlerë të kontratës (me TVSh) 23,019,527 lekë, fituar nga OE **“B.”** SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 42,280 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4169/11 prot datë 31.10.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE **“B.”** SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **42,280 lekë pa TVSh** nga OE **“B.”** SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4169/11 prot datë 31.10.2019, me objekt **“Rikonstruksioni i rrugëve “Ali Caushi” dhe sheshet e pallateve 108/3-12, Lagjja S. D.”,** Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

*5.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Elbasan referuar urdhrit nr.1359, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 7 datë 31.03.2023, për shumën 42,280 lekë dhe me shkresën nr. 9190/1, datë 31.03.2023 ka njoftuar shoqërinë debitore **“B.”**, për likuidimin e sajë. Deri në momentin e verifikimit nuk është likuiduar asnjë lekë.*

Zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Asfaltim i rrugës “Shpëtim Arapi” dhe sheshet e pallateve 580/15-30, Lagjja “11 Nëntori”, Bashkia Elbasan,** me vlerë të kontratës (me TVSh) 31,454,799 lekë, fituar nga OE “E.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 207,242 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4456/6 prot datë 07.12.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE “E.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **207,242 lekë pa TVSh** nga OE “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4456/6 prot datë 07.12.2020, me objekt “Asfaltim i rrugës “Shpëtim Arapi” dhe sheshet e pallateve 580/15-30, Lagjja “11 Nëntori”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Elbasan sipas urdhrit nr.1361, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 2 datë 31.03.2023, për shumën 207,242 lekë dhe me shkresën nr. 9192/1, datë 31.03.2023 ka njoftuar shoqërinë debitorë “E. shpk” për likuidimin e sajë dhe më datë 26,07,2023 në filialet e BKT është paguar shuma 207,242 lekë nga OE “E. shpk”

Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksioni i rrugëve “Ymer Stringa” + “Mitat Stringa” + “Ismail Haxhimusaj”dhe sheshet e pallateve 579, 579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, Bashkia Elbasan,** me vlerë të kontratës (me TVSh) 32,455,070 lekë, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 149,421 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2098/7 prot datë 07.06.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE “B.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

7.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **149,421 lekë pa TVSh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2098/7 prot datë 07.06.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve “Ymer Stringa” + “Mitat Stringa” + “Ismail Haxhimusaj”dhe sheshet e pallateve 579, 579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Elbasan sipas urdhrit nr.1357, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 4 datë 31.03.2023, për shumën 149,421 lekë dhe me shkresën nr. 6193/1, datë 31.03.2023 ka njoftuar shoqërinë debitorë “B.” sh.p.k, për likuidimin e sajë. Deri në momentin e verifikimit nuk është likuiduar asnjë lekë.

Zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Sistemimi i rrugës kryesore të kishës së Shën Thanasit, fshati Shelcan, Nj.A. Shushicë”, Bashkia Elbasan,** me vlerë të kontratës (me TVSh) 26,000,000 lekë, fituar nga OE “B.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 409,970 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 745/6 prot datë 20.04.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE “B.” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

8.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **409,970 lekë pa TVSh** nga OE “**B.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 745/6 prot datë 20.04.2021, me objekt “Sistemimi i rrugës kryesore të kishës së Shën Thanasit, fshati Shelcan, Nj.A. Shushicë”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

8.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Elbasan sipas urdhrit nr.1360, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. ekstra datë 24.07.2023, për shumën 409,970 lekë dhe më datë 24,07,2023 nga BKT është paguar shuma e mësipërme nga “B. shpk”.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion i konviktit (vajzave) “Ymer Tola” të shkollës pedagogjike”, Bashkia Elbasan,** me vlerë të kontratës (me TVSh) 32,118,879.2 lekë, fituar nga OE “**B.**” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 324,890 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3786/6 prot datë 15.10.2020, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Elbasan dhe OE “**B.**” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1, faqe 89-104 të Projektraportit të Auditimit).

9.1. Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **325,890 lekë pa TVSh** nga OE “**B.**” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3786/6 prot datë 15.10.2020, me objekt “Rikonstruksion i konviktit (vajzave) “Ymer Tola” të shkollës pedagogjike”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

9.2.Nga verifikimi rezultoi se:; Bashkia Elbasan sipas urdhrit nr.1358, datë 30.12.2022, ka lëshuar faturë për arkëtim nr. 6 datë 31.03.2023, për shumën 325,890 lekë dhe me shkresën nr. 6193/1, datë 31.03.2023 ka njoftuar shoqërinë debitorë “B.” sh.p.k, për likuidimin e sajë. Deri në momentin e verifikimit nuk është likuiduar asnjë lekë

Zbatuar pjesërisht

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi:. Referuar të dhënave të Sektorit të Menaxhimit të Tokës Bashkia Elbasan dhe nga auditimi i dokumentacionit, konstatohet se nga sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej 16,629 Ha, është ndarë 13,774 Ha dhe janë pa ndarë 2855 Ha.

Për sipërfaqen e tokës së pandarë prej 2855 Ha, rezulton se **650 Ha** janë në dispozicion të Agjencisë të Trajtimit të Pronave Tiranë në mbështetje të VKM nr.770 datë 12.11.2014 "Për kalimin në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes tokës bujqësore” dhe **47 Ha** janë dhënë me qira. Ndërsa pjesa e mbetur e tokës së pandarë me sipërfaqe prej **1998 Ha, 71% e saj, ose 1419 Ha, e cila është e pandarë dhe pa kontratë qiraje me bashkinë është zaptuar nga të tretë dhe mbjellë për nevojat e tyre pa shpërblim për Bashkinë Elbasan.**

Efkti i financiar i shfrytëzimit të tokave bujqësore me sipërfaqe 1419 ha, pa kontratë qiraje me Bashkinë Elbasan dhe të zaptuara nga të tretë përllëgaritet në shumën **8,634,000 lekë (1419 ha x 6000 leke/ha çmimi minimal)**, në zbatim të pikës 10 të Udhëzimit të KM nr. 1 date 18.07.2012 "Per procedurat e dhënies me qira te tokave bujqësore te pandara".

Nga Bashkia Elbasan për 45 fshatra nuk është përfunduar azhurnimi i tokave, duke mos aplikuar për certifikatë pronësie për ta dhënë me qira. Ndërsa për 200 ha tokë bujqësore të ish- N.B (NJA Paper), nuk është nën juridiksionin e Bashkisë Elbasan për dhënien në përdorim (kontratë qiraje), pasi është pronë e Ministrisë Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Nga Drejtoria e Koordinimit të Njësive administrative dhe Lagjeve, së bashku me strukturat mbështetëse të Bashkisë Elbasan, të merren masa të evidentohen në terren sipërfaqet e zaptuara, të kryhet matja dhe piketimi i tyre, të evidentohen personat përgjegjës, si dhe hartohen kontratat e qerasë për mbledhjen e të ardhurave në vazhdimësi, duke llogaritur dhe detyrimet që nga momenti i zaptimit deri në momentin e hartimit të kontratës

Brenda datës 31.12.2022

1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë me Urdhrin Nr.1365 datë 30.12.2022 ka urdhëruar drejtorinë e Koordinimit të Njësive Administrative dhe Lagjeve që në bashkëpunim me strukturat e njësive administrative të marrim masa për evidentimin e tokave bujqësore pandarë dhe pa kontratë qiraje me bashkinë është zaptuar nga të tretë dhe mbjellë për nevojat e tyre pa shpërblim për Bashkinë Elbasan duke i lënë afat deri në muajin dhjetor 2023 , duke qënë se ky është një proces i komplikuar dhe i shtrirë në territor, për të vazhduar më tej me proceset e matjes dhe hartimit të kontratave.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për aplikimin dhe arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Elbasan për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021, në zbatim të legjislacionit të taksave dhe tarifave vendore, vendimeve të Këshillit Bashkiak, si dhe VKM për përcaktimin dhe llogaritjen e taksave dhe tarifave vendore për Licencë karburanti, (autorizime), u konstatua se:

-Në 32 subjekte, për licencat e dhëna nga periudha 18.10.2019 deri në 31.12.2021, nuk është respektuar afati për vlefshmërinë e licencës për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve, për 5 vite por janë dhënë me afat 1-2 vite.

- Në 8 subjekte për stacionet e shitjes së karburanteve për periudhën 01.01.2019-31.12.2021, nuk kanë qenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit.

Veprimet e mësipërm janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Nga administrata e Bashkisë Elbasan, Sektori i Transportit, të merren masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **20,600,000 lekë**, (sipas anekseve 2.6.5.dhe 2.6.6 bashkëlidhur Raportit të Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Brenda datës 31.12.2022

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar anekseve 2.6.5.bashkëlidhur Raportit të Auditimit Bashkia Elbasan me shkresën nr. 3890, datë 25.07.2023 ka njoftuar 8 subjekteve të tregtimit me pakicë të karburanteve dhe GLN. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se

Subjekti K. sh.p.k me adresë kryqëzimi i ish kombinatit metalurgjik, Bradashesh , Elbasan është një subjekt që ka mbyllur licencën dhe ka shlyer detyrimet përkatëse që në periudhën e auditimit dhe reflektimi i detyrimit të tij prej 600,000 është reflektuar gabim.

Me shkresën nr. 3888, datë 25.07.2023 është njoftuar policinë bashkiake për marrje masash, për bllokimin e veprimtarisë së subjekteve të tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe GLN.

Me shkresën nr. 3889, datë 25.07.2023 “Për bashkëpunim për rregullimin e veprimtarisë së subjekteve të tregëtimit me pakicë të karburanteve dhe GLN” është njoftuar dhe i ka kërkuar bashkëpunim Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave, rezultojnë se më datën 31.12.2021, detyrimet ndaj Bashkisë Elbasan, janë në vlerën gjithsej **878,727,000** lekë. Kjo gjendje debitorësh është krijuar nga subjektet fizike dhe juridike, për vlerën **626,717,000** lekë, si dhe debitorët familjarë për detyrime të pa përlogaritura për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën prej **252,010,000** lekë.

Nga të dhënat konstatohet se për NJA dhe Bashkinë Elbasan, kjo bashki ka informacion të saktë për të dhëna mbi numrin e subjekteve fizike, juridike dhe abonentëve familjarë debitorë ndaj bashkisë. Në totalin e debitorëve, konstatohet se debitorët e subjekteve fizike dhe juridike zënë peshën më të konsiderueshme të totalit të debitorëve, në nivelin deri në 74,8% për vitin 2019, 72,87% për vitin 2020 si dhe 71,32% për vitin 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan, në kuadër të marrjes së masave të menjëhershme për të arkëtuar borxhin **878,727,000** lekë, i cili po kalon në fazën e borxhit të keq, të marrë masat për mbledhjen me forcë si dhe kalimin e çështjes në hapin e fundit që parashikon ligji nr.7895 datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, neni 181, duke iu drejtuar strukturave të Prokurorisë së Rrethit Elbasan.

Menjëherë dhe vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Gjatë periudhës Janar – dhjetor 2022 përsa i përket subjekteve debitorë ndaj Bashkisë Elbasan, bazuar në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave e tarifave vendore”, i ndryshuar, janë zbatuar proçedurat e masave shtrënguese për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të prapambetura.

Masat e marra më konkretisht, paraqiten si më poshtë:

2.Janë berë bllokimet e llogarive bankare si me poshtë:

Nr.	Shkresa	nr.subjekte	vlera
1	Nr.112 prot, dt.20.01.2022	1	182,702.40
1	Nr.138 prot, dt.28.01.2022	1	55,982.22
2	Nr.319 prot, dt.28.02.2022	1	116,996.32
3	Nr.320 prot, dt.28.02.2022	1	142,941.39
4	Nr.323 prot, dt.28.02.2022	1	915,239.84
5	Nr.523 prot, dt.15.04.2022	1	95,229.90
6	Nr.577 prot, dt.27.04.2022	1	996,771.73
7	Nr.604 prot, dt.10.05.2022	1	111,929.00
8	Nr.605 prot, dt.10.05.2022	1	116,905.29
9	Nr.690 prot, dt.20.05.2022	1	1,525,621.49
10	Nr.691 prot, dt.20.05.2022	1	1,008,406.49
11	Nr.1099 prot, dt.05.08.2022	1	68,300.00
12	Nr.1180 prot, dt.31.08.2022	1	1,962,995.52

13	Nr.1297 prot, dt.26.09.2022	1	487,720.60
14	Nr.1300 prot, 28.09.2022	87	18,549,953.84
15	Nr.1373 prot, dt.14.10.2022	1	74,775.39
16	Nr.1481 prot, dt.14.11.2022	1	422,198.06
17	Nr.1535-1551 prot, dt.02.12.2022	17	96,285,526.76
18	Nr.1631 prot, dt.30.12.2022	952	58,396,509.64
19	Nr.1632 prot, dt.30.12.2022	200	58,149,401.24
		1271	239,483,404.72

- Janë dërguar pranë Raiffeisen Bankë urdhrat individuale te bllokimit te llogarive bankare për **807** subjekte debitorë në vlerën **177,962,259** lekë.

Nr.	Shkresa	nr.subjekte	vlera
1	Nr.321 prot, dt.28.02.2022	89	19,385,468.38
2	Nr.327 prot, dt.01.03.2022	131	73,095,855.37
3	Nr.338 prot, dt.03.03.2022	120	42,787,892.64
4	Nr.432 prot, dt.25.03.2022	97	10,781,625.44
5	Nr.450 prot, dt.29.03.2022	96	9,023,693.55
6	Nr.680 prot, dt. 18.05.2022	78	13,771,487.24
7	Nr.706 prot, dt. 24.05.2022	99	6,579,262.49
8	Nr.714 prot, dt. 26.05.2022	97	2,536,974.33
		807	177,962,259.44

- Pra gjithsej jane kryer **2078** bllokime te subjekteve debitore ne vleren **417,445,664.16** leke.
- **Gjate kesaj periudhe kane paguar 1224 subjekte ne vleren 43,116,389.29** leke.
- Jane bere 37 urdhra ekzekutimi ne vleren 3,445,723.63 lekë.
- Për periudhën Janar –Qershor 2023 janë kryer gjithësej 70 bllokime të subjekteve debitorë në vlerën 14,365,126 lekë. Gjatë kësaj periudha janë bërë 6 Urdhëra Ekzekutimi mbi balancën e llogarive bankare në vlerën 470,703 lekë.
- Me Urdhërin Administrativ **nr.987, datë 16.02.2023** “Për bashkëpunimin midis drejtorive” urdhërohen drejtoritë e përcaktuara në Urdhër që bashkangjitur cdo praktike aplikimi pranë tyre, subjektet janë të detyruara të paraqesin vërtetim nga D.T.T.V.M.A për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore ndaj Bashkisë Elbasan.
 - Me shkresën **nr.336 prot, dt.03.03.2022** u është dërguar kërkesë për bashkëpunim institucioneve ne lidhje me mos ofrimin e shërbimeve subjekteve debitorë ndaj Bashkisë Elbasan: DRT, ASHK, DRSHTRR, DEGA DOGANES Elbasan, Dega Thesarit Elbasan, QKB Tirane.
 - Me shkresën **nr.346 prot, dt.04.03.2022** është dërguar shkresa drejtuar Drejtorisë se Përgjithshme te Shërbimeve te Transportit Rrugor, Tirane për kërkim informacioni ne lidhje me te dhënat mjetet ne pronësi te 106 subjekteve debitorë, për te vazhduar me procedurën e vendosjes se barrës siguroese pranë RBS.
 - Me shkresën **nr.530 prot, dt.20.04.2022** i është kërkuar informacion DPSHTRR, Tirane ne lidhje me te dhënat e mjeteve ne pronësi për 106 subjekte juridike debitorë.
 - Me shkresën **nr.638 prot, dt.12.05.2022** i është kërkuar informacion DPSHTRR, Tirane ne lidhje me te dhënat e mjeteve ne pronësi për 213 subjekte fizike debitorë.
 - Me shkresat **nr.400-425 prot, date 24.03.2022** është dërguar vendosja e bares siguroese për mjetet ne pronësi te 25 subjekteve debitore (per 87 mjete ne pronësi te tyre) prane Regjistrit te Barreve Siguroese, Tirane.
 - Jane derguar ne rruge zyrtare njoftimet per vendosjen e bares siguroese dhe hipotekore per 272 subjekte juridike debitore (shkresat 267 prot,dt.16.02.2022, nr.393 prot, dt.18.03.2022, nr.393 prot dt.23.03.2022).

-Me shkresën nr.1573/1 prot, date 12.12.2022 i është kërkuar Drejtorisë Buxhet – Finance, Sektorit të Buxhetit kërkesa për parashikimin e fondit në buxhetin e vitit 2023 në vlerën 200,000 leke, shpenzime operative në lidhje me tarifën për vendosjen e barrës sigurore dhe hipotekore, përkatësisht në RBS dhe ASHK.

-Me shkresën nr.571 Prot., datë 17.07.2023 D.T.T.V.M.A ka vënë në dispozicion të Drejtorisë Juridike Bashkia Elbasan subjektet debitorë për të cilët do të iniciohen procedurat ligjore konform parashikimeve të nenit 181, të ligjit Nr.7895, datë 27.11.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Në proces zbatimi

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave të mësipërme Bashkia Elbasan (Sektori i Financës dhe Buxhetit), në vitin 2019 nuk ka asnjë fond të deleguar fondi për subvencionimin e investimit të Ujësjetillës Kanalizime Elbasan, por ka bërë mbulimin e këtij investimi me të ardhurat e veta në **vlerë totale 2,499,750 lekë**.

Nisur nga fakti që kjo ndërmarrje është SHA, Bashkia Elbasan nuk ka bazë ligjore për financimin e këtij investimi, duke pasur parasysh që dhe në planifikimin e nevojave për investime si në PBA 2019-2021 ashtu dhe në buxhetin vjetor të vitit 2019, nuk është konstatuar një shprehje nevojë nga ana e U.K Elbasan për mbulim financimi për këtë projekt, por Bashkia Elbasan ka të drejtën për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve (U.K.Elbasan) nëse ato nuk paguhen në kohë. PAGESA E KËTYRE DETYRIMEVE TË SHA-SË, CITOHEK NË LIGJIN NR.10340, DATË 28.10.2010 “Për pagesën e detyrimeve ndaj të tretëve të ndërmarrjeve dhe SHA-ve në pronësi të pushtetit vendor”, të nenit nr. 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 28-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe Sektorit i Buxhetit të Bashkia Elbasan, në miratimin e buxhetit të viteve në vijim të mos prokurojë fondet e krijuara nga të ardhurat e veta për të subvencionuar investimet e kryera dhe që i ka kompetencë “U.K Elbasan” SHA, pasi klasifikimi për të cilat destinohen fondet është në kundërshtim me akte ligjore.

Menjëherë dhe vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Drejtoria e Financës dhe Sektorit i Buxhetit të Bashkia Elbasan, në miratimin e buxhetit të vitit 2023 në vijim nuk ka prokuruar fondet e krijuara nga të ardhurat e veta për të subvencionuar investimet e kryera dhe që i ka kompetencë “U.K Elbasan” sh.a. investimi në **vlerë totale 2,499,750 lekë** i është transferuar me VKB shoqërisë “U.K Elbasan” sh.a.

Zbatuar

F. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Elbasan** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Nga verifikimi rezultoi se deri në momentin e verifikimit nuk na u vu në dispozicion ndonjë dokument vërtetues ku të jenë vlerësuar rekomandimet e KLSH.

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Elbasan për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Elbasan 25 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masë organizative, janë në proces zbatimi 13 masa organizative është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative si dhe nuk janë zbatuar 4 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, Bashkia Elbasan të marrë masa për një proces planifikimi të të ardhurave sa më real dhe në raport me kushtet e zhvillimit ekonomik dhe numrit të subjekteve që operojnë në Bashkinë Elbasan. Të përqendrohet puna në rritjen e nivelit të arkëtimeve të planifikuara në mënyrë që të ulët borxhi tatimor, si dhe të analizohet situata dhe nxirren përgjegjësitë për rënien e nivelit të arkëtimeve nga njëra periudhë në tjetër.

Menjëherë

10.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë Ekonomike të përllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Menjëherë

11.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet për kalimin e vlerës së atyre projekteve për të cilat investimi ka mbaruar (specifikisht ato projekte të trashëguara nga ish komunat) si vlerë e shtuar çdo aktiviteti afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve, si dhe të rishihet dhe vet llogaria 202 studime e kërkime për vlerën kontabël neto 2,819,739 lekë.

Menjëherë

13.1 Rekomandim: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës, të merren masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” duke rakorduar me Drejtorinë e Shërbimeve çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466 si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Menjëherë

22.1 Rekomandim: Bashkia Elbasan, nëpërmjet një grupi pune të ngritur me Urdhër të Titullarit të Bashkisë Elbasan, të vazhdojë ndjekjen e punimeve deri në përfundimin e tyre, duke i formalizuar me procesverbal të nënshkruar nga Sipërmarrësi i punimeve, Mbikëqyrësi dhe personat e ngarkuar nga Bashkia Elbasan.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga KLSH janë rekomanduar 9 masa për shpërblim dëmi me vlerën 8,625,434 lekë, të pranuar 100% nga subjekti. Prej tyre janë zbatuar plotësisht 2 masa në vlerë 617,212 lekë, janë zbatuar pjesërisht 7 masa në vlerë 8,008,222 lekë, për të cilat KLSH kërkohet që për rekomandimet për shpërblim dëmi, Bashkia Elbasan të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1. Rekomandimi 1.1: Nga Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave të Bashkisë Elbasan, të koordinohet me Drejtorinë Rajonale Tatimore të Elbasanit, që për 7 subjektet e identifikuar si të pa tarifuar ose tarifuar jo në përputhje me fashat e përcaktuara në paketat fiskale (*Aneksi 2.6.2*), të kontrollohet objekti i aktivitetit nëpërmjet kontrollit të faturimeve në sistem (librat e blerjeve dhe shitjeve përkatës), për vitet 2019, 2020 dhe 2021, si dhe të mbahen dhe akt konstatime në këto subjekte, duke përcaktuar përfundimisht nëse këto subjekte kanë ushtruar aktivitet ose jo, përgjatë viteve objekt auditimi. Pas këtij procesi, Drejtoria e Tatimeve, Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave, të nxjerrë njoftim vlerësimet për tarifën përfundimtare të mbrojtjes në mjedis duke bërë likuidimin e të ardhurave të pa mbledhura.

Menjëherë

2. Rekomandimi 2.1: Bashkia Elbasan të marrë masa për arkëtimin e shumës prej **528,917 lekë** si rezultat i mos aplikimit të tarifave vendore për pastrim, gjelbërim dhe ndriçim për subjektet që kanë kryer investime me fonde publike në territorin e Bashkisë Elbasan.

Menjëherë

3. Rekomandimi 3.1: Nga Bashkia Elbasan, Drejtoria e Financës ,të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, për arkëtimin e vlerës prej **879,159 lekë** me TVSh e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “G.” SHPK, përfituar padrejtësisht si rezultat i mos respektimit të çmimit të miratuar sipas kontratave për furniturat bazuar çmimit referuar bursës REUTERS për datat përkatëse të furniturave, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri në këtë moment.

Menjëherë

4 Rekomandimi 4.1.: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **946,555 lekë pa TVSh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3421/6 prot datë 28.06.2019, me objekt “B.” dhe rikonstruksioni i rrugës “Haki Ballshi”, lagjja “Emin Matraxhiu”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Rekomandimi 5.1.: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **42,280 lekë pa TVSh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4169/11 prot datë 31.10.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve “Ali Caushi” dhe sheshet e pallateve 108/3-12, Lagjja S. D.”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

6. Rekomandimi 7.1.: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **149,421 lekë pa TVSh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2098/7 prot datë 07.06.2019, me objekt “Rikonstruksioni i rrugëve “Ymer Stringa” + “Mitat Stringa” + “Ismail Haxhimusaj” dhe sheshet e pallateve 579, 579/3, 579/4, 579/5, 580/1”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

7. Rekomandimi 9.1.: Nga Bashkia Elbasan të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **325,890 lekë pa TVSh** nga OE “B.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3786/6 prot datë 15.10.2020, me objekt “Rikonstruksion i konviktit (vajzave) “Ymer Tola” të shkollës pedagogjike”, Bashkia Elbasan, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

Për masat shpenzim në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohet 1 masë në vlerën 2,499 mijë lekë, e cila është analizuar dhe zbatuar si dhe janë rekomanduar 3 masa, për arkëtim të vlerës 907,961 mijë lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 600 mijë lekë, është në proces vlera 907,361 mijë lekë si dhe nuk është zbatuar 1 rekomandim në vlerën 26,600 mijë lekë, për të cilat KLSH rikërkon përsheptimin e punës për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe zbatimin e një rekomandimi të pa zbatuar si vijon:

1. Rekomandimi 2.1: Nga administrata e Bashkisë Elbasan, Sektori i Transportit, të merren masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **20,600,000 lekë**, (sipas anekseve 2.6.5 dhe 2.6.6 bashkëlidhur Raportit të Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë

F. MASA DISIPLINORE

KLSH i rikërkon Kryetarit të Bashkisë Elbasan t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse. Gjithashtu i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Elbasan që bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, si dhe në kontratën e punës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Rekomandim mbas verifikimit KLSH i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Elbasan të analizoj dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, si dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

Aneksi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Elbasan, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	25	25	7	1	13	4
Masa shpërblim dëmi (Nr.)	9	9	2	7		

Masa shpërblim dëmi (vlerë)	8,625,434	8,625,434	617,212	8,008,222		
Masa për 3E në të ardhura (Nr.)	3	3			3	
Masa për 3E në të ardhura (vlerë)	907,961,000	907,961,000	600,000		907,361,000	
Masa për 3E në shpenzime (Nr.)	1	1	1			
Masa për 3E në shpenzime (vlerë)	2,499,750	2,499,750	2,499,750			
Masa Disiplinore/Administrative	1	1				1

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Divjakë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUdhËN 01.07.2022 DERI
31.01.2023, BASHKIA DIVJAKË”.**

Tiranë, 2023

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 04228485 E-mail: klsh.org.al; website www.klsh.org.al

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-29
	<i>Drejtimet e Auditimit.....</i>	4
	<i>A.Masa Organizative.....</i>	4-18
	<i>B.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....</i>	18-22
	<i>C.Masa Disiplinore.....</i>	22-26
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	26-28

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 629/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Divjakë, më datë 28.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. H. I., z. S. H. dhe Z. V. S., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Divjakë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 886/8 prot., datë. 19.01.2023, ndërsa nga Bashkia Divjakë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 4527/38 prot datë. 07.01.2023. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë përpara dërgimit të raportit përfundimtar, Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Divjakë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën 4527/38 prot datë. 07.01.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 886/8 prot., datë. 19.01.2023, për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 19.07.2023. Nga ana e Bashkisë Divjakë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH pasi referuar programit të auditimit nr. 629/5 prot datë 07.07.2023 përpara përmbushjes së afatit 6 mujor. Si rrjedhojë përgjigja 6 mujore do të konsiderohet e ezauruar nga Bashkia Divjakë sipas ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 27 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 27 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa, janë në proces zbatimi 13, janë zbatuar pjesërisht 1 masa dhe 5 masa nuk janë zbatuar.

Për masat shpenzim në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohen 7 masë në vlerën 531,898 mijë lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 1,000 mijë lekë, është në proces vlera 531,898 mijë lekë si dhe nuk është arkëtuar vlera 11,000 mijë lekë.

Për masat disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Divjakë që ti kërkoj komisionit disiplinor marrjen e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtarë të KLSH-së, për 27 persona, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë vendosur 9 masa disiplinore si dhe nuk është vendosur masë disiplinore për 18 punonjës.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 19.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Divjakë, sipas programit të auditimit nr. 629/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. H. I., përgjegjës i grupit;
2. S. H., anëtar,
3. V. S., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 886/8 prot., datë. 19.01.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Divjakë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 3886/8 prot., datë. 19.01.2023, rezulton se nga **61** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **33** masa ose 52% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **28** masa ose 48% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 50%, nga ana e Bashkisë Divjakë, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Divjakë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 886/8 prot., datë. 19.01.2023, ndërsa nga Bashkia Divjakë për zbatim e

rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 4527/38 prot datë. 07.01.2023. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë përpara dërgimit të raportit përfundimtar, Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Divjakë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën 4527/38 prot datë. 07.01.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Divjakë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 886/8 datë. 19.01.2023 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 19.07.2023.

Nga ana e Bashkisë Divjakë nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH pasi referuar programit të auditimit nr. 629/5 prot datë 07.07.2023 përpara përmbushjes së afatit 6 mujor. Si rrjedhojë përgjigja 6 mujore do të konsiderohet e ezauruar nga Bashkia Divjakë sipas ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Divjakë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 4527/38 prot datë. 07.01.2023, **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku *përcaktohet se*: 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

Pa zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Divjakë 27 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 27 masa, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 8 masë organizative, janë në proces zbatimi 13 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Nuk është hartuar “Harta e procesit për proceset kryesore të veprimtarisë së institucionit”.
- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.
- Nuk është miratuar plani i zhvillimit strategjik me afat 5 vjeçar.
- Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish, si dhe nuk ka sisteme kompjuterike të liçencuara.
- Drejtoria e Financës nuk përdor program të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit por operon me programin “EXCEL” ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të bashkisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë, është angazhuar për të hartuar regjistrin e riskut vjetor dhe 6 mujore, duke përcaktuar ato risqe që kanë nivel të lartë rreziku për realizimin e objektivave, për keto risqe me nivel të lartë janë hartuar planin e minimizimit të risqeve. Persa i përket një strategjie të mirfillte të riskut Bashkia Divjakë ende nuk e ka miratuar një të tillë.

Pa zbatuar

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të liçencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.1. Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë, me urdherin nr 36, datë 06.02.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i është drejtuar me shkresën numer 3166 prot, date 20.06.2023, “Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, e cila ka përgatitur dokumentacionin vertetuar kjo dhe me shkresën me numer 3166/1 prot, date 21.07.2023, kanë realizuar rregullimin e sistemit Hrmis, i cili ka patur problem me hedhjen e dosjeve dhe është plotësuar dhe me hedhjen e dosjeve të puonojesve pasi po skanohet ëdo dosje e do kalohet në sistem.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Divjakë, mbi funksionimin dhe veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm gjatë vitit 2021, u konstatua se:

- Sektori i auditimit të brendshëm ka dy punonjës, në kundërshtim me pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësia e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës.
- Nuk është kryer auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.
- Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lena në auditimet e mëparshme.
- Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit.

- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete të cilat janë me risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, Prokurimet publike etj.
- Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njërive publike nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e sektorit të auditimit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me shkronjën “ç” të nenit 6, nenin 13, shkronjën “ç” të nenit 14 të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Urdhërin nr. 4, datë 10.01.2020 të MFE “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdherin nr. 100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr. 42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 29-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në njësinë e auditimit të brendshëm Divjakë, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar.

- Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

2.1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr. 36, datë 06.02.2023, ka ngarkuar Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, e cila e cila ka përgatitur dokumentacionin vertetur kjo dhe me shkresën me numer 3166/1 prot, date 21.07.2023, kanë realizuar plotësimin e pozicioneve vakante, për përgjegjës sektori dhe auditues, e cila është plotësuar si strukturë.

Zbatuar

2.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Divjakë, të bëjë program të veçantë për auditimin e rekomandimeve të lena, si dhe të kryejë procesin e kontrollit të cilësisë për çdo auditim. Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk të lartë, siç janë ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkinë Divjakë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2023

2.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 35, datë 06.02.2023, ka ngarkuar sektorin e AB “Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, dhe me shkresën numër 3165 prot, date 20.06.2023, i është drejtuar Zyrës së Auditit të Brendshëm, e cila ka përgatitur dokumentacionin me shkresën me numer 4063 prot, date 21.07.2023. ku citon faktin se “Zyra e Auditit të Brendshëm, në zbatim të Ligjit numer 114/2015, date 22.10.2015, “Per Auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar me Ligjin numer 12, date 02.02.2023, “Per disa ndryshime e shtesa në Ligjin numër 114/2015”, Kapitulli IV, pika 4.1.12, në Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik, miratuar me UMF numer 100 date 25.10.2016, ndryshuar me urdherin numer 4, datë 10.01.2020, nuk bën program të veçantë auditimi por në auditimin pasardhës pika e parë vendoset zbatimi i rekomandimeve të lena nga auditimi i meparshëm.

Zbatuar

2.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Divjakë, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

2.3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 35, datë 06.02.2023, ka ngarkuar sektorin e AB “Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” dhe me shkresën 3165 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Sektorit të Auditit të Brendshëm. Gjate vitit 2022 janë protokolluar dhe arkivuar në arkivin e Institucionit të Bashkisë Divjakë si vijon:

- *Auditim ne Sektorin e Mbrojtejs nga Zjarri dhe Shpetimi, me numer 1972 prot, date 29.04.2022.*
- *Auditim Drejtoari e Rrugeve Rurale me numer 2972 prot, date 05.07.2022.*
- *Auditim Tematik Sektiori i Sherbimeve Turistike me numer 3114 prot, date 12.07.2022.*
- *Auditim Drejtoria e Finances me numer 4241 prot, date 19.09.2022.*

Zbatuar

2.4. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Divjakë, të marrë masa që çdo vit të kryejë auditim për vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, me qëllim ofrimin e sigurisë dhe këshillave për titullarin e njësisë publike, nëse sistemet e MFK janë ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit financiar.

Në vijimësi

2.4.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 35, datë 06.02.2023, “Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Larë i Shtetit”, dhe me shkresën nr. 3165 prot, date 20.06.2023 ka ngarkuar sektorin e AB për marrjen e masave në vijimësi për të bërë auditimin për vlerësimin dhe monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm me qëllim që të ofroje siguri dhe këshillim për titullarin e njësisë publike.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me hapat e ndjekura për hartimin e PBA-së dhe dokumentimit të procesit rezulton se:

- Nuk është miratuar nga Këshilli Bashkiak raporti i vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Tavanet Përgatitore të PBA-së 2022-2024, janë miratuar jashtë afateve;
- Nuk është dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;
- Në dokumentin e PBA-së nuk janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, nuk janë analizuar risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, si dhe nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe përcaktimet e Udhëzimit nr. 7, datë 26.02.2021 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë dhe Drejtoria e Financës e Buxhetit, të marrin të gjitha masat që për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:

- Të dërgojnë për miratim në Këshillin Bashkiak raportin e vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave;
- Të respektohen afatet gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore të PBA-së;
- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së dhe puna e bërë nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të dokumentohet në çdo fazë;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë, të cilat cenojnë drejtpërdrejt arritjen e objektivave të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 37, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorinë e Drejtorisë së Finances dhe Buxhetit. rezulton se:

Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 është përgatitur duke u bazuar në udhëzimin nr.6 date.28.02.2023 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”.

Janë miratuar Tavanet Parapërgatitore me Vkb Nr. 17 datë.21.03.2023 “Mbi miratimin e Tavanëve Përgatitore të shpenzimeve për Pba 2024-2026”. Në datë 27.03.2023 është ngritur Udhëzimi i Brëndëshëm nr.87 datë.27.03.2023 “Për Përgatitjen e PBA 2024-2026” I cili u

është Shpërndare Drejtorive dhe Sektorëve. Grupi i Menaxhimit Strategjik si edhe Ekipi i Menaxhimit të Programeve Filluan nga puna në mbështetje të udhëzimit të Brëndëshëm duke respektuar edhe kalendarin e vendimëmarrjeve nga secili Ekip në mënyrë që të vijohet më fazat e tjera të përgatitjes së PBA 2024-2026. Janë mbajtur Procesverbale të mbledhjeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik ku përcaktojnë detyra dhe udhëzimeoërvijimësinë e punës nga ana e EMP. Gjithashtu janë mbajtur procesverbale të Takimeve të Emp ku reflektojnë ecurinë e punës deri në atë fazë dhe njoftojnë GMS.

Për PBA 2024-2026 është mbajtur dëgjesa Publike në datën 29.05.2023, Pas degjesës Publike EMP bëri rishikimet e nevojshme dhe përfundoi dokumentin e PBA Vendor 2024-2026. Në datën 01/06/2023 është nisur PBA 2024-2026 në Ministrinë e Financave. Në datën 19.06.2023 MFE nis pranë Bashkisë Divjakë Analizën për dokument në PBA, Kjo Shlkresë është protokolluar në Bashkinë Divjakë me nr.3260 datë.26.06.2023. Në datë 30.06.2023 është mbledhur Këshilli i Ri i Bashkisë Divjakë dhe është Miratuar “Programi Buxhator Afatmesëm 2024-2026 faza I-re” me Vkb nr.31 datë.30.06.2023. Aktualisht jemi në pritje të mbledhjesë së Këshillit Bashkiak në Datë 24.07.2023 për të miratuar Tavanet Përfundimtare të PBA 2024-2026.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e buxhetit rezultoi si vijon:

1. Niveli i treguesve të buxhetit për vitin 2021 paraqitet irealizuar në vlerën **805,745** mijë lekë nga **1,056,589** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 76%. Në nivelin e realizimit të buxhetit ka ndikuar niveli i ulët i realizimit të të ardhurave për vitin 2021 i cili paraqitet në 44%. Për periudhën Janar-Shtator 2022 paraqitet irealizuar në vlerën **540,220** mijë lekë nga vlera **767,543** mijë lekë të planifikuara, ose në masën 70%.

2. Në fund të 9 mujorit 2022 (30.09.2022), Bashkia Divjakë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në vlerën **63,690,532 lekë**. Ndërsa detyrimet nga buxheti i shtetit janë në vlerën **4,154,257 lekë**.

Nga analiza e detyrimeve të prapambetura në fund 9 mujorit 2022 (30.09.2022), janë të pa likuiduara gjithsej 149 raste me vlerë **49,698,550 lekë**. Sipas zërave detyrimet janë të ndara si vijon:

- a. 30 fatura për shpenzime për investime në vlerën 32,200,102 lekë.
- b. 37 fatura për mallra në vlerën 6,725,906 lekë.
- c. 78 fatura për shërbime në vlerën 6,169,113 lekë.
- d. 4 vendime gjyqësore në vlerë 4,603,429 lekë.

3. Për vitin 2022 janë planifikuar fonde për projekte dhe investime në shumën 166,252 mijë lekë, me burim financimi nga të ardhurat dhe transfertat e pakushtëzuar. Aktualisht Bashkia Divjakë ka 41 kontrata të lidhura që nga viti 2018-2022 me vlerë totale 902,972,468 lekë, ku 3 kontrata janë për afate që përfshijnë vitin 2023 dhe 2024 për likuidim. Për të gjitha këto kontrata është likuiduar deri më 31.12.2020 vlera 217,033,450 lekë, gjatë vitit 2021 është likuiduar vlera 196,789,674 lekë, deri më 30.09.2022 është likuiduar vlera 75,122,971 lekë dhe mbetet ende për t'u likuiduar vlera **39,326,998 lekë** që i përket kontratave të përfunduara.

Vlera e detyrimeve të prapambetura më 30.09.2022 është 9.85% e shpenzimeve vjetore të miratuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Buxhetit bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara.

Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 37, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorinë e Drejtorise se Finances dhe Buxhetit. rezulton se:

Për vitin 2022 kemi planifikuar një buxhet për funksionimin normal të Bashkisë, me qëllim që të menxhohet me mire stoku i detyrimeve të prapambetura dhe rezultati është ulja e D.P ne masen 65% dhe konkretisht në fillim të vitit 2022 ke mitrasheguar detyrime me vlere 92,060,205 leke dhe në 31.12.2022 vlere e D.P është 32,407,787 leke.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave në Bashkinë Divjakë u konstatua se për vitin 2021 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave paraqitet në masën 44%, nga 316,869 mijë lekë të parashikuara janë realizuar 139,357 mijë lekë, ose 117,512 mijë lekë më pak. Niveli i ulët i realizimit i të ardhurave nga taksat dhe tarifave ka ardhur si rezultat i:

1. Mos planifikimi i saktë i të ardhurave sipas zërave. Lidhur me planifikimin e taksave të ndara apo atyre që vilen nga agjentët tatimore si tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale, taksa mbi automjetet e përdorura, Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në Bashkinë Divjakë nuk ka një bazë të dhënash të subjekteve që duhet të paguajnë këtë detyrim.

2. Mosmarrjen e masave të duhura ligjore ndaj taksapaguesve familjarë dhe privat për mos pagesën e taksave dhe tarifave në mënyrë vullnetare brenda afatit.

Procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar si duhet. Nuk ka dokumentacion të plotë lidhur me kërkesat që Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore dërgon për informacion në drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi për të grumbulluar të dhëna lidhur me planifikimin e të ardhurave vjetore. Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga DTV për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021*” dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “*Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi:Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë.

Të marrë masa që të vendosë një korrespondencë me institucionet e tjera që administrojnë të dhënat lidhur me taksat e ndara me qëllim marrjen prej tyre të informacionit të duhur për të bërë një planifikim sa më të saktë të të ardhurave për këto taksa. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë nuk ka matë masa për grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë dhe për faktin se raporti i auditimit të KLSH i është dërguar bashkisë me shkresën nr. 886/8 datë.19.01.2023.

Pa zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Administrimi i dokumentacionit dhe procesi i menaxhimit të të ardhurave nga taksapaguesit privat dhe abonentët familjarë në Bashkinë Divjakë kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe të Ardhura Vendore nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Divjakë i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTAV që mund të rezultojë në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTAV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; neni 4, zbatimimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit , ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Dhjetor 2023

6.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë nuk ka marrë masa për ngritjen e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: 1. Nga krahasimi i pasqyrave financiare hartuara nga Bashkia Divjakë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në Bashki, vlera është 5,329,592,175 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 5,239,247,615 lekë, me një diferencë prej 90,344,560 lekë më pak në PF në subjekt. Kjo diferencë tregon se në sistemin e thesarit nuk është paraqitur vlera 90,344,560 lekë. Nga verifikimi i zërave të bilancit, u konstatua se kjo diferencë korrespondon në Pasivin e Bilancit me shumën e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në vlerën 30,589,616 lekë dhe llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”, në vlerën 59,754,945 lekë.

2. Nga auditimi, u konstatua se llogaria 215 “Mjete transporti” është shtuar për vlerën neto 62,201,067 lekë, për makineri dhe pajisje sipas Aneksit PF19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”, e cila është pakësuar për të njëjtën vlerë. Sa më sipër, këto dy llogari të aktivitetit nuk paraqesin vlerën reale.

3. Nga verifikimi i regjistrave të aktiveve, u konstatua se për llogaritë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 215 “Mjete transporti”, paraqiten probleme në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivësh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëposhme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Regjistrat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për këtë arsye, vlera e këtyre dy llogarive (214 dhe 215) në pasqyrat financiare, nuk jep siguri të arsyeshme se është e saktë.

4. Nga Bashkia Divjakë nuk janë ngritur komisione për marrjen në dorëzim të aseteve, përkatësisht në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në llogarinë 211 “Pyje, kullota,

plantacione”, në llogarinë 212 “Ndërtim e konstruksione” dhe në llogarinë 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” dhe rrjedhimisht nuk është kryer marrja në dorëzim, kolaudimi, vlerësimi, nuk është kryer inventarizimi kontabël dhe fizik, nuk është aplikuar në ASHK Lushnjë për regjistrimin e të gjitha aseteve, resurseve dhe pasurive të tjera, si dhe nuk është bërë regjistrimi në kontabilitet i këtyre pasurive veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pikat 20, 21 dhe 22, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, me pikat 37, 42-60, 74, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

5.Nga auditimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të ardhurat dhe debitorët nga taksat dhe tatimet, u konstatua se vlerat debitorë të familjarëve, bizneseve, etj, nuk janë kontabilizuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. Në listën e debitorëve mungojnë disa persona të cilët janë gjobitur nga IMTV, lista e debitorëve progresivë, e disponueshme në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore mbyllet me numër rendor 418, ndërkohë që lista analitike e kontabilitetit mbyllet me numër rendor 162, etj. Gjithashtu, konstatohet se nuk janë përlllogaritur dhe kontabilizuar kamatëvonesat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi:Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të marrë masa për të bërë sistemimet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

7.1.2Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr. 3170 prot, date 20.06.2023, i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, e cila ka pregatitur shkresën, bashkë me dokumentacionin bashkëngjitur ku rezulton në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 janë bërë sistemimet e llogarive perkatëse si dhe rakordimi analitik i vlerave të llogarive me Thesarin duke bërë rakordimin e të ardhurave të trashëgueshme, rakordimin e detyrimeve të prapambetura, Llogaria 466 si dhe rakordimin e klasës 2 nepermjet dhe kodifikimit 7 shifror nepermjet balances vjetore. Gjithashtu dhe rakordimi i llogarive shpenzuese te cilat ndiqen analitikisht nepermjet partitarevete cdo llog. Shpenzuese.

Zbatuar

7.2. Rekomandimi:Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakëtë merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

7.2.Nga verifikimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, e cila ka pregatitur shkresën, bashkë me dokumentacionin bashkëngjitur.

Në proces zbatimi

7.3. Rekomandimi:Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Divjakë të merren masa për nxjerrjen e Urdhërave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të painventarizuara, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtim e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

7.3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit, i cila ka pregatitur shkresën, bashkë me dokumentacionin bashkëngjitur.

Në proces zbatimi

7.4. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në Bashkinë Divjakë, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke plotësuar analizën e llogarive, ku të merren në konsideratë edhe vlerat e gjetura gjatë auditimit nga KLSH, duke llogaritur edhe kamatëvonesat përkatëse. Gjithashtu, gjatë vitin ushtrimor në vazhdim, të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifatat vendore, për vitet përkatëse në llogarinë 1210 “Rezultat i mbartur i seksionit të funksionimit”.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

7.4.1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 është bërë dhe përmbledhësja e llogarisë 468 (debitore) në të cilat janë pasqyruar debitorët familiar dhe biznesit, gjobat e policiës, gjobate IMT, Debitore individuale dhe operatore ekonomike të lëna nga auditimi i KLSH-së. Sipas rakordimit me deget përkatëse është bërë përmbledhësja a nalitike e debitoreve dhe është pasqyruar në mbylljen vjetore të pasqyrave.

Zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2021 paraqitet përkatësisht 99,323,241 lekë për llogarinë 231, në total 99,148,142 lekë. Vlera e prokuruar për investimet në proces gjatë vitit 2021 ka qenë 497,139,142 lekë, të cilat janë me fonde të deleguara. Vlera e kontraktuar (me TVSh), për investimet në proces gjatë vitit 2021 është 497,148,142 lekë, nga të cilat 496,126,333 lekë për objektin “Furnizim me ujë për zonat bregdetare Remas, Bashkia Divjakë” me kontratë nr. 360/12 datë 02.04.2021 me operator ekonomik “A.” shpk dhe 1021,809 lekë për “Mbikëqyrje punimesh për objektin furnizim me ujë zonat bregdetare Remas”, me kontratë nr. 545/1 datë 01.04.2021, me operator C. Group.

Për sa më sipër, zëri “Investime në proces”, i përbërë nga llogaritë 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, në datën 31.12.2021 nuk paraqet vlerën reale, pasi duhet të pasqyronin vlerën 497,139,142 lekë, e cila përbëhet nga shuma e kontratave të lidhura, të cilat nuk kanë përfunduar dhe nuk janë marrë në dorëzim nga Bashkia Divjakë.

Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e palikuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”, Kreu I, “Të përgjithshme”, pika 8, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 32, etj. Investimet që kanë ndodhur gjatë vitit 2021, janë paraqitur në Aneksin PF24, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Financës të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave me saktësi sipas posteve në bilancin kontabël, për llogaritë 230/231 “Investime në proces”.

8.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. e cila ka berë mbyllja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore duke berë rakordimet me degen e thesarit si dhe është berë pasqyrimi i llog. 231 “Investime në proces” e cila trajtohet në dy objekte në mbyllje të vitit respektivisht “Furnizimi me uje pishem zona bregdetare Remas”, “Ndërtim palestere dhe rikonstruksion i shkollës Çerm Sektor” janë kontabilizuar fondet në mbyllje të ushtrimit.

Zbatuar

8.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe e Financës të marrë masa për kryerjen e veprimeve kontabël duke respektuar të gjitha hapat e regjistrimit në kontabilitet, si më poshtë:

1. Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe në kredi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”.

2. Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 404 “Furnitorë për investime”.

3. Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “Furnitorë për investime” dhe në kredi të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”.

4. Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi të llogarisë 720 “Grant korrent i brendshëm” dhe në kredi të llogarisë 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

5. Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizmi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe në kredi të llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”.

6. Me kapitalizmin e aktivitetit, (për aktivet e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”, në kredi llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “Shtesa të fondit bazë” dhe në debi të llogarisë 105 “Grante të brendshme kapitale” për vlerën e aktiveve të blera.

Me mbylljen e Pasqyrave Financiare të vitit 2022

8.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Divjakë, me urdherin nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. e cila ka berë mbyllja dhe raportimi i pasqyrave financiare vjetore duke berë sistemimet e llogarive perkatëse si dhe rakordimi analitik i vlerave te llogarive me Thesarin duke bere rakordimin e te ardhurave te trashëgueshme, rakordimin e detyrimeve te prapambetura, Llogaria 466 si dhe rakordimin e klasës 2 nepermjet dhe kodifikimit 7 shifror nepermjet

balances vjetore. Gjithashtu dhe rakordimi i llogarive shpenzuese te cilat ndiqen analitikisht nepermjet partitaveve çdo log. Shpenzuese.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2021 ka qenë 30,589,616 lekë ose me rritje në vlerën 8,026,368 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë Divjakë ndaj subjekteve për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga verifikimi analitik i llogarisë 466 rezultojnë një diferencë prej 116,905 lekë e pasqyruar më shumë në pasqyrat financiare. Për sa më sipër, llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” nuk paraqet vlerën e saktë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 58-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhbllokimin e fondeve të ngurtësuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar pasqyrave financiare të vitit 2022 she sipas urdherit nr 40, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, dhe me shkresën nr 3170 prot, date 20.06.2023 i është drejtuar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk ka bërë sistemimin e vlerës 116,905 në bilancin e vitit 2022.

Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022 për punë publike dhe mallra, rezultojnë se në 5 raste në dokumentet standarde të tenderit, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e çdo kriteri për kualifikim, si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me tipologjinë e objektit të prokuruar dhe kontratës së lidhur. Veç sa më sipër, në përbërjen e NJP dhe KVO, për 2 raste është konstatuar mungesa e specialistëve të fushës, në përputhje me objektin e prokurimit, ndërsa në 1 rast rezultojnë se ka pasur copëzim të fondeve dhe shmangie nga procedurat standarde të prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, 3 të nenit 34, neni 73, pika 1 në nenin 80, pika 3 në nenin 92, shkronja “d” në pikën 1 në nenin 98 në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 73, pika 2 e nenit 74, paragrafi 1 i nenit 75, pika 2 në nenin 76, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi : Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, që në përbërjen e NJP dhe KVO, të ketë specialist të fushës në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që vendimmarrja, menaxhimi dhe vlerësimi të jenë objektiv.

10.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 39, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike. Në vijim të korespondencës sipas shkresës nr. 3169/1 prot, date 21.06.2023 citon faktin se; “Kriteret e veçanta për kualifikim në DST, janë vendosur në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës përkatëse që është prokuruar, duke zbatuar gjithashtu edhe rekomandimet e dërguara nga Agjencia e Prokurimit Publik, nëpërmjet kërkesave për asistencë mbi Dokumentat Standarde të Tenderit, drejtuar APP-së.

Në proces zbatimi

10.2. Rekomandimi:Njësia e Prokurimit Bashkia Divjakë të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

10.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 39, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Larte i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike. Në vijim të korespondencës sipas shkresës nr. 3169/1 prot, date 21.06.2023 citon faktin se; “Kriteret e veçanta për kualifikim në DST, janë vendosur në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës përkatëse që është prokuruar, duke zbatuar gjithashtu edhe rekomandimet e dërguara nga Agjencia e Prokurimit Publik, nëpërmjet kërkesave për asistencë mbi Dokumentat Standarde të Tenderit, drejtuar APP-së.

Në proces zbatimi

10.3. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor të Bashkisë Divjakë, të marrë masat e nevojshme, për eliminimin e copëzimit të fondeve në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

10.3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 39, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Larte i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike. Në vijim të korespondencës sipas shkresës nr. 3169/1 prot, date 21.06.2023 citon faktin se; për objektet të cilat janë të së njëjtës natyrë dhe fushave primarie, në mënyrë që zhvillimi i tyre të jetë në përputhje dhe konform Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në proces zbatimi

11. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se në 2 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe shkronjën “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr. 285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Divjakë për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetin e institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 39, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Larte i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike. Në vijim të korespondencës sipas shkresës nr. 3169/1 prot, date 21.06.2023 citon faktin se; “Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka marrë masat e nevojshme, duke dokumentuar çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave / shërbimeve, si edhe ka ndjekur me korrektësi gjithë procesin e vlerësimit të ofertave, kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

Në proces zbatimi

12. Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.07.2021-30.09.2022, rezultoi se:

Në 8 raste nuk dokumentohet përllogaritja e fondit limit;

Në 9 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit përcaktuar në ftesën për ofertë, si dhe një 1 rast nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion;

Në 6 raste OE shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret fituese të kërkuara nga AK;
Në 6 raste nuk është respektuar afati i dorëzimit të mallit nga operatori ekonomik, si dhe nuk janë llogaritur penalitetet për mosdorëzimin e mallit në afat sipas afatit të kontratave. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52. Gërma “dh”, “ë”, “gj” të pikës 5 në nenin 26, pikën 3 të nenit 40, pika 1 paragrafi 2 në nenin 73, pikën 3 në nenin 74 në VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjetet elektronike”, i ndryshuar. Shkronjën “a” në pikën 5, pikën 6 në Udhëzimin nr. 8, datë 01.09.2021, “Mbi hartimin e planit të zbatimit të kontratës”. Neni 12, 13 i Normave Teknike Profesionale për Arkivat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Kryetari Bashkisë Divjakë dhe komisioni i blerjeve të vogla, të marrë masat e nevojshme, që të dokumentojë çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve. Në rastet kur OE i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e vendosura nga AK, duhet të bëhet skualifikimi dhe kalimi tek operatori ekonomik i radhës. Gjithashtu në rastet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, të bëhet verifikimi i formës dhe përmbajtjes së tij, si dhe të llogariten penalitetet për mos dorëzimin e mallit në afat sipas kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 39, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Larte i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin Juridik dhe Prokurimeve Publike. Në vijim të korespondencës sipas shkresës nr. 3169/1 prot, date 21.06.2023 citon faktin se: “Komisioni i Blerjeve të Vogla, ka marrë masat e nevojshme, duke dokumentuar çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave / shërbimeve, si edhe ka ndjekur me korrektësi gjithë procesin e vlerësimit të ofertave, kualifikimin dhe s’kualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël.

Në proces zbatimi

13. Gjetje nga auditimi:1. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Shtesë anësore + shtesë 1 kat në objektin ekzistues 1 kat, me zhvillues A. M. adresë Tërbuf, Rikonstruksion dhe shtesë anësore + shtesë kati 1 kat, me zhvillues A. S. adresë Babunjë, Shtëpi banimi 1 kat në A. Z., adresë Divjakë, rezultoi se nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës.

2. Nga auditimi i lejeve të ndërtimit: Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve buqësore, me zhvillues F. K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf si dhe Magazinë bujqësore me zhvillues R. shpk, adresë fshati Mizë, rezultoi se nuk është respektuar intesiteti i lejuar sipas Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar për lejet e ndërtimit.

3. Nga auditimi i lejes së ndërtimit: Godinë bujtinë 2 kate + papafingo, me zhvillues D. T., me adresë Kamenicë, Divjakë, rezultoi se nuk është marrë mendim pozitiv nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 15, “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi” pika “ë”, neni 35 “Distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës” dhe neni 38 “Intensiteti i ndërtimit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 103-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga ana e DPZHKT, Bashkia Divjakë, të merren masa që në lejet e ndërtimit të respektohet distanca e lejuar nga kufiri i pronës, si dhe intesiteti i lejuar, sipas planit të përgjithshëm vendor dhe legjislacionit në fuqi.

Në vijimësi

13.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 41, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Larte i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ka përgatitur shkresën me numër 3172/1 prot,

date 20.06.2023 lidhur me distancat e lejuara nga kufiri i pronës për çdo aplikim të kryer të gjitha rregullave të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i lejes së ndërtimit “Magazinë për grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore me zhvillues F. K. në Cermë Shkumbin, Tërbuf”, rezultoi se:

1. Objekti i ndërtuar nuk ka zbatuar plotësisht projektin e miratuar, duke u pajisur dhe me Certifikatë përdorimi, në kundërshtim me VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27 “Certifikata e përdorimit”.

2. Në lidhje me zbatimin e projektit të miratuar u konstatuan ndryshime në fasadë dhe volume, konkretisht në pjesën anësore nuk është respektuar vendosja e dritareve sipas projektit të miratuar dhe në fasadën ballore, në pjesën e majtë ka një shtesë volumi e cila nuk paraqitet në projektin e miratuar. Nga ana e IMT Bashkia Divjakë nuk është mbajtur asnjë procedurë në lidhje me këto ndryshime të projektit të miratuar me zbatimin e tij në terren në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundraligjshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 103-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Nga ana e DPZHTK, Bashkia Divjakë, të merren masa për të mos miratuar certifikatë përdorimi për objekte të cilat nuk kanë respektuar projektin e miratuar.

14.1.1. Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 41, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ka përgatitur shkresën me numër 3172/1 prot, date 20.06.2023 lidhur me zbatimin e rekomandimeve për lejet e ndërtimit Magazine bujqësore për të gjithë aplikuesit dhe u është kërkuar që të riaplikojnë për leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit dhe është miratuar leje e re e ndërtimit me intensitetin e lejuar sipas kondicioneve të zhvillimit të zones, në zbatim të rregullores së planit të përgjithshëm të zhvillimit të territorit të Bashkisë Divjakë dhe Legjislacionit në fuqi.

Në proces zbatimi

14.2. Rekomandimi: Nga ana e IMT të merren masa për tu inspektuar të gjithë objektet të cilat janë me leje ose pa leje ndërtimi dhe të vazhdojë procedurat ligjore për objektet të cilat kanë shkelur lejen e ndërtimit dhe ato pa leje.

Në vijimësi

14.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar pasi IMT nuk ka bërë verifikimin e lejeve të sipërcituara si deh dhe nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit.

Pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 57 rekomandime të dhëna janë pranuar plotësisht nga subjekti, ndërsa 28 rekomandime ose 49% prej tyre janë zbatuar.

Nga 20 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar 8, janë zbatuar pjesërisht 2, janë në proces zbatimi 4 dhe nuk janë zbatuar 6 prej tyre.

Nga 2 masa për shërblim dëmi të rekomanduara në vlerën 9,867 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, por nuk janë zbatuar.

Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në menaxhimin e fondeve publike të rekomanduara në vlerën 552,673 mijë lekë, janë pranuar plotësisht, 1 masë është zbatuar, 2 janë në proces zbatimi në vlerën 481,313 mijë lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 28,000 mijë lekë dhe 2 masa nuk janë zbatuar në vlerën 120,000 mijë lekë.

Nga 19 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 19.

Nga 10 masa administrative të rekomanduara në vlerën 6,100 mijë lekë, në zbatim të shkresës së APP për mangësi të evidentuara, rezulton se nga titullari i institucionit nuk janë nxjerrë urdhërat për arkëtimin vullnetar të gjobave, si dhe nuk janë marrë masat për arkëtimin e vlerës,

rekomandimi nuk është zbatuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 107-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 686/22 datë 07.01.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Divjakë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Menjëherë

15.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar pasi bashkia Divjak nuk ka kryer asnjë procedur për zbatimin e rekomandimeve.

Pa zbatuar

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, qytetarët/individët që kanë përfituar legalizimin e sipërfaqeve të caktuara nuk kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përkatesisht për vitin 2021 nuk kanë paguar detyrimin 174 qytetarë me vlerë totale **8,009,732 lekë**, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin 25 qytetarë me vlerë totale **1,091,511 lekë**. Gjithashtu, nuk kanë paguar ende detyrimin 416 individë/qytetarë për sipërfaqet e legalizuara përpara vitit 2021 me vlerë totale **14,144,742 lekë**. **Në total vlera e detyrimeve nga mos pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton në 23,245,985 lekë për 615 objekte të legalizuara, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-në nr. 61, datë 28.12.2020 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2021”, dhe VKB-në nr. 65, datë 28.12.2021 “Paketa fiskale për sistemin e taksave dhe tarifave vendore dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 615 debitorë në vlerën 23,245,985 lekë**, si dhe në vijimësi për të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 38, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorin e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për ndjekjen e procedurave për arkëtimin e vlerës debitorë nga ku rezulton se, nga vlera debitorë e raportuar prej 23,245,985 lekë nga 615 debitor, janë arkëtuar 2,438,300 lekë nga 56 qytetarë. Janë dërguar 91 urdhër bllokime në llogari bankare me shkresën nr. 4594 prot, datë 05.10.2022 si dhe shkresën nr. 4723 prot, datë 06.10.2022. Gjithashtu janë nisur 578 emra debitorë në DRT dhe hipotekorenë ASHK. Po ashtu është bashkëpunuar me ASHK për të marrë informacion periodik për legalizimet e reja.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Divjakë rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën **86,473,273 lekë** dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifatat për personat fizikë/juridikë, detyrimet

nga taksat dhe tarifate vendore për familjet dhe detyrimet nga taksa e tokës bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifa e vaditjes.

Detyrimet për taksat dhe tarifate vendore në mënyrë progresive në Bashkisë Divjakë më datë 31.12.2021 janë në vlerën **440,270,998 lekë**.

Më datë 30.09.2022 janë në vlerën **507,492,800 lekë** të përbëra nga:

- Detyrime për taksën e ndërtesës në vlerën **31,869,336lekë**;
- Detyrime për taksën e tokës bujqësore në vlerën **326,826,181lekë**;
- Detyrime nga taksa e truallit në vlerën **1,204,743lekë**;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën **32,823,179lekë**;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën **8,664,192lekë**;
- Detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.) në vlerën **104,945,289lekë**;
- Detyrime nga tarifa e ujitjes në vlerën **409,050lekë**.

Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se deri më datë 31.12.2021 shuma e arkëtuar nëpërmjet Ujësjetllës Kanalizime SH.A Divjakë në rolin e agjentit tatimor të bashkisë është 1,368,100 lekë dhe detyrime progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë **1,754,400 lekë**. Deri më datë 30.09.2022 sipas akt rakordimit shuma e arkëtuar për taksat e bashkisë është 1,033,000 lekë dhe detyrimet progresive që Ujësjetllësi ka kundrejt Bashkisë Divjakë janë në vlerën **2,684,100 lekë**.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifate vendore në vlerën totale **507,492,800 lekë**, e përbërë nga:

- **31,869,336lekë** detyrime për taksën e ndërtesës;
- **326,826,181lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore;
- **1,204,743lekë** detyrime nga taksa e truallit;
- **32,823,179lekë** detyrime nga biznesi i vogël;
- **8,664,192lekë** detyrime nga biznesi i madh;
- **104,945,289lekë** detyrime për taksat familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim, etj.);
- **409,050lekë** detyrime nga tarifa e ujitjes.

a- T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c- Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DTAV të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DTAV të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Divjakë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për të koordinuar punën me strukturat e Ujësjetllësit me qëllim kalimin e detyrimeve që ky i fundit ka ndaj Bashkisë Divjakë për taksat dhe tarifate vendore për llogari të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 38, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për ndjekjen e procedurave për arkëtimin e vlerës debitorë nga ku rezultoi se:

Nga subjektet familjare në total nga vlera debitore deri më 30.06.2023 është arkëtuar në total 1235 familjarë për taksa të pasurisë së paluajtshme dhe tarifa vendore në vlerën 17 596 690 lekë. Janë dërguar 619 urdhër bllokime në llogari bankare me nr prot. 305-389 dt 18-19.01.2023, nr prot.5069-5158 dt 12.10.2022, nr 6704 prot dt 12.12.2022; nr 6697 dt 12.12.2022, nr prot.5477 dt.01.11.2022, nr prot.6217. Gjithashtu janë dërguar Njoftime detyrimi për 6 650 familjarë me nr prot.73 dt.11.05.2023, 75 dt.17.05.2023, nr prot. 530-535 dt.30.01.2023, nr prot.839-840 dt.16.02.2023, nr prot. 788,792,796 dt.14.02.2023 ,nr prot. 1040 dt.28.02.2023, nr prot. 451-452 dt.05.10.2022, nr prot.194-195 dt.30.05.2023, nr prot.23/5 dt.08.05.2023 si dhe nr prot. 60/1-140 dt.17.07.2023.

Nga biznesi në total nga vlera debitore deri më 30.06.2023 është arkëtuar në total 73 biznese në vlerë 5,117,862 lekë. Janë dërguar 372 urdhër bllokime në llogari bankare si subjekte biznes nr. 6557 prot 6.12.2022, nr 6571 prot dt 06.12.2022 si dhe nr 3671 prot. date 10-11.07.2023. Po ashtu janë dërguar 290 emra debitorësh për barrë siguruese dhe hipotekore me shkresën nr. 1953 prot dt 04.04.2023.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Divjakë në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e asetëve në pronësi, ka lidhur 12 kontrata për dhënie me qira të tyre me qëllim krijimin e të ardhurave. Këto kontrata janë lidhur me afat kohor nga 1-20 vjet. Nga auditimi rezulton se pagesat e qirasë për vitin 2021 janë kryer rregullisht nga të gjithë qiramarrësit, ndërsa për vitin 2022 nuk kanë paguar detyrimin ndaj Bashkisë Divjakë 4 qiramarrës (P. M., H. M., L. Shpk, F. S.), me **vlerë totale të detyrimit 1,159,880 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave përkatëse.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa që qiramarrësit P. M., H. M., L. Shpk, F. S. të zbatojnë me përpikmëri kushtet e kontratave me qëllim pagesën e detyrimeve për qiranë në afat. Për qiramarrësit që tejkalojnë afatet e pagesës të aplikohet kamatë vonesa referuar kushteve të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Divjakë, referuar urdherit nr 43, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka ngarkuar Sektorin e Mbrotjtjes së Tokës dhe Menaxhimit të Aretëve, konfirmojnë për pagesat e subjekteve **debitore nga ku rezulton se:**

- P. M., ka kryer pagesën e Kontrates se Qerase.
- H. M., ka kryer pagesën e Kontrates se Qerase.
- F. S., ka kryer pagesën e Kontrates se Qerase në vlerën 43 200 lekë.
- L. Shpk, nuk ka kryer pagesën e Kontrates se Qerase.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në territorin e Bashkisë Divjakë, për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 19 subjekte. Këto subjekte përpara fillimit të aktivitetit pajisen me autorizimet përkatëse, referuar kuadrin ligjor në fuqi për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje. Lidhur me pagesën e autorizimit Bashkia Divjakë përgjithësisht për subjektet që nuk kanë paguar menjëherë të gjithë vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite, ka ndjekur praktikën e pagesës me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë duke i pajisur ato me autorizime 1 vjeçare.

Nga auditimi rezulton se:

1. Subjekti "M. SHPK" është pajisur me autorizim 5 vjeçar më datë 11.02.2020 dhe është dakordësuar për të kryer pagesën e autorizimit me këste vjetore 200,000 secili. Nga auditimi rezulton se, subjekti ka kryer vetëm një pagesë deri në Nëntor 2022 nga 3 pagesa që duhet të bënte. Vlera totale e detyrimit ndaj Bashkisë Divjakë është **800,000 lekë**.

2. Subjekti "K. SHPK" ka qenë i pajisur me autorizim deri më datë 04.12.2020 në vijim nuk është pajisur me autorizim të ri për ushtrimin e aktivitetit. Subjekti "K. SHPK" ka paguar një vlerë prej 100,000 lekë në vitin 2022 por nuk është pajisur me autorizim. Detyrimet që ka ndaj

bashkisë për autorizimin janë në vlerën **900,000lekë**, vlerë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë. Për subjektin K. nga Bashkia Divjakë është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Divjakë është bllokuar aktiviteti me urdhrin nr. 180 datë 11.10.2022.

3. Subjekti “M. SHPK” nuk ka paguar vlerën prej **200,000 lekë** për vitin 2022.

4. Subjekti “L. SHPK” që nga viti 2020 nuk është i pajisur me autorizim, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën **1,000,000 lekë**. Për subjektin L. SHPK është dërguar urdhër bllokimi i llogarive bankare të gjitha bankave të nivelit të dytë, si dhe është bërë bllokimi i aktivitetit nga Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore me urdhrin nr. 182 datë 11.10.2022.

Për periudhën objekt auditimi është konstatuar se subjektet “M. SHPK”, “K. SHPK”, “M. SHPK”, “L. SHPK” kanë ushtruar aktivitet në kundërshtim me përcaktimet ligjore duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Divjakë në vlerën totale 2,900,000 lekë**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 4, neni 15 , neni 20 dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e gjyqësore në arkëtimin e vlerës 1,000,000 lekë, nga e cila:

- Vlera 800,000 lekë në ngarkim të subjektit “M. SHPK”.
- Vlera 200,000 në ngarkim të subjektit “M. SHPK”.

4.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkisë Divjakë, ka ngritur urdherin me numer 43, date 06.02.2023, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ku ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe e të Ardhurave Vendore nga ku rezulton se:

Për subjektin M. SHPK është ngritur urdhëri i kryetarit nr 198 datë 14.07.2023 për bllokimin në terren të tij. Pas verifikimit më datë 14.07.2023 rezulton se subjekti është i mbyllur dhe do të vazhdojë të jetë objekt verifikimi nga Policia Bashkiake dhe DTAV. Nga verifikimi i grupit të kontrollit të Policisë bashkiake datë 18.07.2023 me procesverbal nr serie 0000073 subjekti rezultoi përsëri i mbyllur.

-Subjekti M. SHPK ka likuaduar detyrimet me datë 15.02.2023 pranë Union Bank.

- **Zbatuar**

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Juridik Bashkia Divjakë, të ndjekin të gjitha hapat ligjore ndaj subjekteve “K. SHPK” dhe “L. SHPK” me qëllim fillimin e aktivitetit vetëm pas pajisjes me autorizimin përkatës dhe kryerjes së pagesave për llogari të bashkisë për shumën 1,900,000 lekë, nga e cila:

- Vlera 900,000 lekë nga subjekti “K. SHPK”.
- Vlera 1,000,000 lekë nga subjekti “L.” SHPK.

Menjëherë

4.2.1 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkisë Divjakë, ka ngritur urdherin me numer 43, datë 06.02.2023 ku ka ngarkuar Drejtorinë e Taksave dhe tarifave vendore Ardhurave Vendore, Për zbatimin e rekomandimeve të lena nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ku rezulton:

Për subjektet K., L. SHPK sipas urdhërit 198 datë 14.07.2023 është bërë kontrolli dhe verifikimi në terren i tyre.

Subjekti L. SHPK i është bërë bllokimi fizik dhe do të jetë në vazhdimësi objekt verifikimi për zbatueshmërinë e kësaj procedure.

Nga verifikimi i grupit të kontrollit të Policisë bashkiake datë 18.07.2023 me procesverbal nr serie 0000074 subjekti L. SHPK rezultoi i mbyllur.

Subjekti K. pas verifikimit në terren rezulton i mbyllur si aktivitet dhe vazhdon të jetë objekt verifikimi nga DTAV dhe Inspektoriat i Policisë Bashkiake .

Nga verifikimi i grupit të kontrollit të Policisë bashkiake datë 18.07.2023 me procesverbal nr serie 0000072 subjekti L. SHPK subjekti rezultoi përsëri i mbyllur

Për këto subjekte i është dërguar shkresë Sektorit juridik dhe prokurimeve publike nr prot. 3991 datë 18.07.2023, për vazhdimësinë e procedurës të mbledhjes së detyrimeve me force.

Në proces zbatimi

4.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore të ndërpresë praktikën e ndarjes e këste të pagesës së tarifës për licencat/autorizimet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.3.1 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkisë Divjakë, ka ngritur urdherin me numer 43, datë 06.02.2023 ku ka ngarkuar Drejtorin e Taksave dhe tarifave vendore Ardhurave Vendore, Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ku rezulton:

Drejtoria e Taksave dhe e të Ardhurave Vendore, ka ndërprerë përfundimisht praktika e ndarjes së kësteve të pagesës së tarifës për licencat / autorizimet por edhe për taksapaguesit familjare dhe biznes pasi u vu re që afatet e pagesës dhe kushtet e aktmarrëveshjes nuk zbatoheshin nga taksapaguesit.

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Divjakë gjatë vitit 2021 ka konstatuar 23 raste të shkeljes së legjislacionit në fushën e mbrojtjes së territorit. Për këto raste janë mbajtur proces verbalet përkatëse të konstatimit të kundërvajtjes ku në 22 raste është vendosur masa administrative “gjobë” me vlerë 500,000 lekë për secilin kundërvajtës, ndërsa në 1 rast është marrë vendim për pezullim punimesh. Vlera totale e gjobave të vendosura është 11,000,000 lekë. Për gjobat e vendosura në vitin 2021 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, Kryeinspektori i IMTV në bashkëpunim me Sektorin Juridik nuk ka ndjekur procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV dhe Sektori Juridik nuk kanë “dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë”, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 30, pika 4, rrjedhimisht nuk kanë ndjekur as hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë. Gjithashtu, rezulton se për gjobat që nuk janë paguar brenda afateve ligjore nuk është llogaritur kamatëvonesa në masën 2% për çdo ditë vonesë, deri në një muaj, në vlerën 6,600,000 lekë. Si rezultat, **për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 17,600,000 lekë (11,000,000 nga gjobat dhe 6,600,000 nga kamatëvonesat).**

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 39-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të ndjekin të gjitha hapat për të dërguar në gjykatë 22 gjobat e vendosura me qëllim shndërrimin e tyre në “titull ekzekutiv”, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitin 2021 në vlerën **11,000,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar.

Pa zbatuar

C. MASA DISIPLINORE.

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për

dhënien e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësit e mëposhtëm:

Lista analitike e masave të rekomanduara dhe zbatuara

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni Zyrtar	Rekomandimi i KLSH dhe I APP	Masa e zbatuar	
				Shkresa apo vendimi nr data	Lloji i masës së zbatuar
1	F. M.	Drejtor i Drejtorisë së financës dhe buxhetit	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
2	P. T.	Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Inventarëve	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
3	F. V.	Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
4	R. B.	Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Tërbuf	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
5	D. Q.	Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Gradishtë	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
6	X. M.	Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Remas	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
7	E. M.	Inspektor i Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
8	J. Z.	Inspektor i Vlerësimit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
9	A. B.	Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 89, date 28.03.2023	Vrejtje
10	S. S.	Specialiste e Prokurimeve Publike	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
11	E. H.	Përgjegjës i Sektorit të zbatimit të Projekteve dhe Zhvillimit të Territorit	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 96, date 28.03.2023	Vrejtje
12	L. T.	Specialiste e Projekteve dhe Investimeve	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 95, date 28.03.2023	Vrejtje
13	I. K.	Specialiste Buxheti	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 93, date 28.03.2023	Vrejtje
14	V. L.	Specialiste e Prokurimeve Publike	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
15	A. J.	Inspektore e Taksave Vendore dhe Kadastres Fiskale	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
16	E. Z.	Specialiste Juriste	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
17	E. M.	Inspektore Biznesi	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 91, date 28.03.2023	Vrejtje
18	E. D.	Specialiste Juriste	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
19	J. L.	Inspektore Biznesi	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 94, date 28.03.2023	Vrejtje
20	S. T.	Specialist Inxhinier	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
21	A. L.	Specialiste Inxhiniere	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 88, date 28.03.2023	Vrejtje
22	A. M.	Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 90, date 28.03.2023	Vrejtje
23	R. M.	Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
24	E. H.	Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Grabian	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”	nr 92, date 28.03.2023	Vrejtje
25	I. K.	Punonjes i Menaxhimit të Mjeteve	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
26	D. S.	Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Aseteve	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		
27	E. N.	Drejtores e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil”		

1. **Znj. F. M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së financës dhe buxhetit, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

2. **Z. P. T.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Inventarëve, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

3. **Z. F. V.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

4. **Z. R. B.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Tërbuf, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

5. **Z. D. Q.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Gradishtë, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

6. **Z. X. M.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Remas, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
7. **Z. E. M.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
8. **Z. J. Z.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
9. **Z. A. B.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 89, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
10. **Znj. S. S.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
11. **Z. E. H.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të zbatimit të Projekteve dhe Zhvillimit të Territorit, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 96, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
12. **Znj. L. T.**, me detyrë Specialiste e Projekteve dhe Investimeve, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 95, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
13. **Znj. I. K.**, me detyrë Specialiste Buxheti, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 93, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
14. **Znj. V. L.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
15. **Znj. A. J.**, me detyrë Inspektore e Taksave Vendore dhe Kadastres Fiskale, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
16. **Znj. E. Z.**, me detyrë Specialiste Juriste, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
17. **Znj. E. M.**, me detyrë Inspektore Biznesi, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 91, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
18. **Znj. E. D.**, me detyrë Specialiste Juriste, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
19. **Znj. J. L.**, me detyrë Inspektore Biznesi, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 94, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
20. **Z. S. T.**, me detyrë Specialist Inxhinier, *Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.*
21. **Znj. A. L.**, me detyrë Specialiste Inxhinier, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 88, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*

D. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*”, kontratën individuale të punës, neni 8 “*Masat Disiplinore*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Divjakë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënie e masave disiplinore përkatëse nga “*Verejtje*” deri në “*Zgjidhje e kontratës së punës*”, për punonjësit e mëposhtëm:

22. **Znj. A. M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, *Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 90, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.*
23. **Z. R. M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore, *(nga data*

01.07.2021 deri në datën 31.01.2022 ka qënë përgjegjës sektori i vlerësimit dhe kontrollit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim drejtor i drejtorisë së taksave e të ardhurave vendore), Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

24. **Znj. E. H.**, me detyrë Inspektore e Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Grabian, Nga verifikimi rezultoi se me urdherin nr 92, date 28.03.2023 të kryetarit të Bashkisë është vendosur masesë disiplinore “Verejtje”.

25. **Z. I. K.**, me detyrë Punonjes i Menaxhimit të Mjeteve, (nga data 01.07.2021 deri në datën 17.01.2022 ka qënë Inspektor IVMT, nga data 18.01.2022 deri në datën 30.09.2022 ka qënë Kryeinspektor IVMT dhe nga data 03.10.2022 është punonjes i menaxhimit të mjeteve), Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

26. **Z. D. S.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Aseteve, Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

27. **Znj. E. N.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022, ka qënë specialiste e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim është drejtore e drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit), Nga verifikimi rezultoi se: deri në datën 28.07.2023 nuk është ndërmarr asnjë mas disiplinore.

Zbatuar pjesërisht

E. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Divjakë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecuresë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar

Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandi do të konsiderohet i pa zbatuar pasi Drejtoria e burimeve njerëzore nuk ka njoftuar shërbimin civil për vendosjen e masës disiplinore për punonjësit që trajtohen me status së nëpunësit civil.

Pa zbatuar

Përmbledhëse e Masave Disiplinore dhe Administrative

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

Nr	Lloji i masës rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar
a	b	1	2	3
1	Verejtje me shkrim	27	9	18
2	Gjoha IMTV			
3	Gjoha APP			
	Gjithsejt	27	9	18

Sa sipër nga 27 masa të rekomanduara gjithsej nga KLSH, rezulton se janë zbatuar 9, masa duke mos u zbatuar 18 masa disiplinore

IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Divjakë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Divjakë 27 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht 27 masa, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 8 masë organizative, janë në proces zbatimi 13 masa organizative, zbatuar pjesërisht 1 masë si dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Rekomandimi 1.1: Kryetari i Bashkisë Divjakë në bashkëpunim me strukturat drejtuese të Bashkisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin, identifikimin, analizën, kontrollin dhe përditësimin 2 herë në vit të risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

2. Rekomandimi 1.2: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara (për mbajtjen e kontabilitetit) në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve të brendshme për ngritjen profesionale të stafit.

Menjëherë

3. Rekomandimi 5.1: Drejtoria e Taksave dhe të Ardhurave Vendore të bashkëpunojë me strukturat e tjera të Bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të Bashkisë.

Të marrë masa që të vendosë një korrespondencë me institucionet e tjera që administrojnë të dhënat lidhur me taksat e ndara me qëllim marrjen prej tyre të informacionit të duhur për të bërë një planifikim sa më të saktë të të ardhurave për këto taksa. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Menjëherë

4. Rekomandimi 6.1: Bashkia Divjakë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifatat vendore të Bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Menjëherë

5. Rekomandimi 14.2: Nga ana e IMT të merren masa për tu inspektuar të gjithë objektet të cilat janë me leje ose pa leje ndërtimi dhe të vazhdojë procedurat ligjore për objektet të cilat kanë shkelur lejen e ndërtimit dhe ato pa leje.

Menjëherë

6. Rekomandimi 15.1: Kryetari i Bashkisë Divjakë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, të pazbatuara dhe përsheptimin e zbatimit për ato që janë në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 686/22 datë 07.01.2022 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Divjakë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Menjëherë

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Divjakë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara si dhe përsheptimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi.

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Për masat shpenzim në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohen 7 masë në vlerën 531,898 mijë lekë, nga e cila janë zbatuar 3 masa në vlerë 1,000 mijë lekë, janë në proces zbatimi 3 masa në vlerë 531,898 mijë lekë si dhe nuk është zbatuar 1 masë në vlerën 11,000 mijë lekë, për të cilat KLSH rikërkon përshpejtimin e punës për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe zbatimin e një rekomandimi të pa zbatuar si vijon:

1. Rekomandimi 5.1: Inspektorati i Mbrojtës Territorit në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të ndjekin të gjitha hapat për të dërguar në gjykatë 22 gjobat e vendosura me qëllim shndërrimin e tyre në “titull ekzekutiv”, si dhe të marrin të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e gjobave të pa paguara për vitin 2021 në vlerën **11,000,000 lekë**.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Divjakë që ti kërkoj komisionit disiplinor marrjen e masave disiplinore për shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtarë të KLSH-së, për 27 persona, të cilat janë pranuar plotësisht, nga të pranuarat janë vendosur 9 masa disiplinore për 9 persona si dhe nuk është vendosur masë disiplinore për 18 punonjës, për të cilat KLSH i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Divjakë të analizoj dhe nxjerrjen e përgjegjësi, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 886/8 prot., datë. 19.01.2023, si dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar si vijon:

1. **Znj. F. M.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së financës dhe buxhetit.
2. **Z. P. T.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës dhe Inventarëve.
3. **Z. F. V.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore.
4. **Z. R. B.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Tërbuf.
5. **Z. D. Q.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Gradishtë.
6. **Z. X. M.**, me detyrë Inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në Njësinë Administrative Remas.
7. **Z. E. M.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontrollit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore.
8. **Z. J. Z.**, me detyrë Inspektor i Vlerësimit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore.
9. **Znj. S. S.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike.
10. **Znj. V. L.**, me detyrë Specialiste e Prokurimeve Publike.
11. **Znj. A. J.**, me detyrë Inspektore e Taksave Vendore dhe Kadastres Fiskale.
12. **Znj. E. Z.**, me detyrë Specialiste Juriste.
13. **Znj. E. D.**, me detyrë Specialiste Juriste.
14. **Z. S. T.**, me detyrë Specialist Inxhinier.

Menjëherë

D. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

1 Z. R. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022 ka qenë përgjegjës sektori i vlerësimit dhe kontrollit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim drejtor i drejtorisë së taksave e të ardhurave vendore).

2 Z. I. K., me detyrë punonjës i Menaxhimit të Mjeteve, (nga data 01.07.2021 deri në datën 17.01.2022 ka qenë Inspektor IVMT, nga data 18.01.2022 deri në datën 30.09.2022 ka qenë Kryeinspektor IVMT dhe nga data 03.10.2022 është punonjës i menaxhimit të mjeteve).

3 Z. D. S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit, Mbrojtjes së Tokës dhe Aseteve.

4 Znj. E. N., me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, (nga data 01.07.2021 deri në datën 31.01.2022, ka qenë specialiste e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nga data 01.02.2022 e në vazhdim është drejtore e drejtorisë së planifikimit dhe zhvillimit të territorit).

Menjëherë

Aneksi i zbatimit itë rekomandimeve në Bashkinë Divjakë, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	27	27	8	1	13	5
Masa për 3E në të ardhura (Nr.)	7	7	3		3	1
Masa për 3E në të ardhura (vlerë)	531,898,665	531,898,665	1,000,000		531,898,665	11,000,000
Masa Disiplinore/Administrative	27	27	9			18

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Lushnjë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.07.2022 DERI
31.01.2023, BASHKIA LUSHNJË”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-18
	<i>Drejtimet e Auditimit.....</i>	4
	<i>A.Masa Organizative.....</i>	4-11
	<i>B. Masa Shpërblim dëmi.....</i>	11-12
	<i>C.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....</i>	12-16
	<i>D.Masa Disiplinore.....</i>	16-17
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	17-18

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 629/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Lushnjë, më datë 28.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. H. I., z. S. H. dhe Z. V. S., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Lushnjë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 513/13 Prot, datë 30. 09.2022, ndërsa nga Bashkia Lushnjë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 8676/2 Prot. datë 21.10.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda 20 ditësh.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 13/13 prot, datë 30. 09.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 25.04.2023. Nga ana e Bashkisë Lushnjë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 2888 prot. datë 30.03.2023.Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH .

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 11 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 7, është zbatuar pjesërisht 1 masa dhe 1 masa nuk është zbatuar.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 2 masa me vlerë 390,000 lekë, deri me datë 28.07.2023, janë nisur njoftimet për 2 subjekte në vlerë 390,000 lekë.

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohen 3 masa në vlerën 30,041 mijë lekë e pranuar dhe zbatuar si dhe janë rekomanduar 2 masë në vlerën 1,555,429 mijë lekë, nga e cila për 1 masë në vlerën 1,527,929 mijë lekë është arkëtuar vlera 74,739 mijë lekë, është në proces zbatimi vlera 1,453,190 mijë lekë si dhe nuk është zbatuar 1 masë në vlerën 27,500 mijë lekë.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 30.09.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Lushnjë, sipas programit të auditimit nr. 629/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. H. I., *përgjegjës i grupit*;
2. S. H., anëtar,
3. V. S., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 513/13 Prot, datë 30.09.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Lushnjë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 513/13 Prot, datë 30. 09.2022, rezulton se nga **18** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **13** masa ose 72% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **5** masa ose 38% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 72%, nga ana e Bashkisë Lushnjë, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Lushnjë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 513/13 Prot, datë 30. 09.2022, ndërsa nga Bashkia Lushnjë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 8676/2 Prot. datë 21.10.2022. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda 20 ditësh, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Lushnjë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 513/13 datë. 30.09.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve.

Nga ana e Bashkisë Lushnjë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 2888 prot. datë 03.04.2023. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH .

Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Lushnjë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën 513/13 datë. 30.09.2022 **dhe ka raportuar rregullisht** në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Lushnjë 11 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 masë organizative, është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të komponentëve të MFK-së rezultoi si vijon:

Mjedisi i kontrollit:

- Rregullorja e Brendshme nuk është e plotë pasi mungojnë përshkrimet dhe detyrat e disa pozicioneve si në rastin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike: SNL për investimet dhe SNL për supervizimin e sipërmarrjeve.

- Nuk është miratuar Kodin Etik.

- Deri më 31.12.2021 në Bashkinë Lushnjë janë 10 pozicione vakante nga të cilët 4 drejtor, 2 përgjegjës, 3 specialistë dhe 1 polic bashkiak.

- Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA. Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut, si dhe në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit.

Menaxhimi i riskut:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistemin HRMIS, por të dhënat menaxhohen në programin Microsoft Office Excel. Gjithashtu edhe Drejtoria e Financave përdor programin Excel gjatë kryerjes së aktivitetit të saj dhe nuk ka programe kompjuterike specifike.

Informimi dhe komunikimi:

- Faqja zyrtare e internetit e Bashkisë Lushnjë nuk është azhurnuar. Komunikimi nëpërmjet email-it kryhet nëpërmjet adresave të email-it personal, në mungesë të email-ëve zyrtare.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë me qëllim zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së të marrë masat si vijon:

- Të përditësohet dhe të plotësohet Rregullorja e Brendshme me përkrahjet dhe detyrat e pozicioneve në përputhje me strukturën e miratuar të Bashkisë Lushnjë si dhe të hartojë Kodin Etik;

- Të kryejë shpallje mbi pozicionet vakante të punës;

- Të hartojë “Hartën e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, të hartojë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve;

- Të implementohen programe kompjuterike për Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Drejtorinë e Financave në mënyrë që të minimizohet hedhja e të dhënave manualisht.

- Të plotësohet faqja zyrtare e internetit me informacionet dhe dokumentacionin spërkatës si dhe të hapen adresat zyrtare të email-ëve për punonjësit për komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Menjherë dhe në vijimësi

1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Lushnjë me Urdhrin nr. 94 date 28/03/2023 ka miratuar “Kodi i Etikës” për Bashkinë Lushnjë”. Referuar korrespondencës së zhvilluar me AKSHIN është mundësuar rihapja e faqes zyrtare, pas problemit si dhe është realizuar hapjen e email –eve zyrtare. Gjithashtu është miratuar draft-rregullorja sipas strukturave përkatës si dhe për çdo pozicion hartohen shpallje për çdo pozicion vakant ,është proces i kryer ne te gjitha kohërat.

Në proces zbatimi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së NJAB rezulton se:

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13. Referuar Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka hartuar dhe miratuar “Kodin e Etikës” në Bashkinë Lushnjë.

- NJAB nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/ sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/ sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, duke mos zbatuar Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm”, Strategjinë së auditimit të brendshëm, bazuar në tre klasifikimet e mëposhtme, duhet të konsiderojë një frekuencë auditimi si vijon:

i - Fusha me risk të lartë – e këshillueshme një herë në vit;

ii - Fusha me risk të mesëm – e këshillueshme një herë në dy- tre vite;

iii - Fusha me risk të ulët – e këshillueshme jo më shumë se pesë vite.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**1**

2.1.Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm gjatë hartimit të planit vjetor të auditimeve të përfshijë auditimin në bazë rrisht duke planifikuar auditime në fushat me risk të lartë të veprimtarisë së institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Në programin e NJAB për vitin 2023 është planifikuar të krehen auditime me baze rrisht të lartë në institucion referuar shkresave dërguar Drejtorisë së Harmanizimit pran Ministrisë së Financave.

Zbatuar

3.Gjetje nga auditimi:Nga auditimi i zbatimit të buxhetit rezultojnë diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përta i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Të ardhurat e realizuara në vlerën 1,319,017 mijë lekë kundrejt atyre të planifikuara në vlerën 1,337,889 mijë lekë janë realizuar në masën 101.4 %, në vlerën 18,872 mijë nga e cila: Shtesa transfertë e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 12,225 mijë dhe shtesa transfertë e pakushtëzuar sektoriale në vlerën 6,647 mijë. Përta i përket shpenzimeve është planifikuar vlera 1,337,889 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 1,040,902 mijë lekë, në masën 77.8 % me diferencë 296,987 mijë lekë. Në faqen zyrtare të internetit, Bashkia Lushnjë nuk ka publikuar dhe azhornuar dokumentacionin përta i përket buxhetit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,15, 27 dhe 32, i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37, Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”, UMF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ndjekë hapat dhe të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Të publikohet dhe azhornohen dokumentacioni përta i përket buxhetit në faqen zyrtare në web të saj.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.1.Nga verifikimi rezultoi se:; Ne hartimin e buxhetit te vitit 2023 janë mbajtur parasysh treguesit financiar te vitit 2022 si dhe realizim faktik i çdo programi buxhetor. Bashkia Lushnjë publikon ne faqen e web-it buxhetin vjetor si dhe raportet e monitorimit dhe zbatimit te buxhetit (çdo 4 mujor).Këto raporte pasqyrohen ne këshill bashkiak dhe dërgohen edhe ne Min. Financave

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura rezulton se, Bashkia Lushnjë nuk ka dërguar në Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021. Në Pasqyrat Financiare të mbyllura për vitin 2021 llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundër parti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, detyrimet e prapambetura rezultojnë në vlerën 14,826,175 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga vitet e mëparshme, duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar raporteve 4 mujore të monitorimit për detyrimet e prapambetura në Min. e Financave Në fund të vitit 2022 janë ulur nga 7.4 % (2021) kundrejt totalit te shpenzimeve ne 2.5% (2022)

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Metodologjia që përdor Drejtoria e të Ardhurave Vendore për të realizuar planifikimin vjetor të taksave dhe tarifave vendore nuk bën të mundur një parashikim real të të

ardhurave të veta të Bashkisë Lushnjë. Strukturat e bashkisë nuk kanë një bashkëpunim efektiv midis tyre duke mos dërguar informacion në DAV i cili do të përdoret për planifikimin e të ardhurave të bashkisë. Si rezultat DAV për planifikimin e të ardhurave i referohet kryesisht nivelit të realizimit të vitit paraprak duke përfshirë në planifikim edhe një pjesë të të ardhurave që mund të vijnë nga pagesa e detyrimeve vendore nga subjektet apo familjet që janë debitor nga vitet paraardhëse sikurse e përcakton kuadri ligjor. Niveli i realizimit të taksës mbi ndërtesat në vitin 2021 është 71.2 % (planifikuar 96,977 mijë lekë dhe realizuar 69,009 mijë lekë), taksës së tokës bujqësore në vitin 2021 është 58 % (planifikuar 100,000 mijë lekë dhe realizuar 58,047 mijë lekë), taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është 61.7 % (planifikuar 70.250 mijë lekë dhe realizuar 43.343 mijë lekë). Taksa mbi truallin paraqitet me realizim në nivelet 155.8 % në vitin 2021 (planifikuar 12.000 mijë lekë dhe realizuar 18,695 mijë lekë) si dhe 140 mijë lekë dhe realizuar 313 mijë lekë). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e paketës fiskale për taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lushnjë për vitin 2021, e miratuar me VKB-në nr. 111, datë 23.12.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnjë të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me ASHK-në degën vendore me qëllim grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar nivelet e planifikimit dhe të realizimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore në Bashkinë Lushnjë janë realizuar kërkesat për bashkëpunim me ASHK, Dr. Rajonale Tatimore Fier, Degës se Doganës Fier, respektivisht si vijon;

Shkresa me nr. 280 prot . date 11.01.2023 me Dr. rajonale Tatimore Fier

Shkresa me nr. 278 prot date 11.01.2023 Dr. rajonale tatimore Fier

Shkresa me nr. 279 prot 11.01.20232 Degës se Doganës Fier

Shkresa me nr. 281 prot date 11.01.2023 ASHK-se)

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Lushnjë nuk janë kryer procedurat për inventarizimin e të gjitha aktiveve afat gjata jo materiale dhe materiale të investuara në vite nga Bashkia Lushnjë dhe ato që me miratim të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të kësaj bashkie, konkretisht për llogaritë (me kosto historike), Llogaria 210 “Toka, troje, terrene” për 15,786,107 lekë. Mungesa e analizës për vlerën 15,786,107 lekë ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, në kundërshtim me: UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në **llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”** dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar pasqyrave financiare konstatohet se Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” është regjistruar sipas të dhënave kontabël. Është në proces pjesa e inventarizimit faktik.

Zbatuar pjesërisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Lushnjë nuk është pasqyruar saktë vlera e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” të transferuara në pronësi të Bashkisë Lushnjë me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 8, shtojca nr. 23 me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Lushnjë, me nr. nga 1 (një) deri 55 (pesë dhjetë e pesë). Sipas këtij vendimi Bashkia Lushnjë ka në pronësi gjithsej 912.5 ha nga të cilët 563.3 ha pyje; 229.6 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 119.5 ha sipërfaqe djerrë. Nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite me qëllim evidentimin e vlerësimit e gjendjes aktuale dhe statusin e pyjeve e plantacioneve sipas listës se inventarit të pyjeve dhe kullotave të transferuara Bashkisë Lushnjë. Në kundërshtim me: VKM nr. 433, datë 08.06.2016 , UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lushnjë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit në pronësi të aktiveve në llogarinë ekonomike.211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar të transferuar për nxjerrjen e të dhënave për veprimet me to në vite, për të verifikuar saktësuat e analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar pasqyrave financiare konstatohet se Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” është regjistruar sipas të dhënave kontabël. Është në proces pjesa e inventarizimit faktik.

Në proces zbatimi

8.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnjë vunë re problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivesh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara. Kjo mënyrë e evidentimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos “certifikuar” vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë. Në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85. Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si dhe realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikim e tyre, vlerësimin dhe ekzistencën fizike.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

8.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkëshoqërues me bilancin është një regjistër historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite por që ka nevojë për përmirësimin e të dhënave.

Në proces zbatimi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuar në degën e Thesarit, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse. Konstatohet se: llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është për vlerën kontabël 34,425,404 lekë në fillim të vitit 2021. Sipas analizës së kësaj llogarie të rakorduar me degën e thesarit, kjo llogari është për vlerën 34,425,404 lekë dhe është e analizuar sipas objekteve për 44 raste, gjatë vitit 2021 është bërë çlirimi për 6 subjekte duke mbetur 36 subjekte në vlerë 31,938,511 lekë. Nga analiza e përmbajtjes së kësaj llogarie, konstatohet se për 36 subjekte në shumën 31,938,511 lekë gjenden në ngurtësuar fonde nga viti 2012-2019 për të cilat është përmbushur afati i garancisë dhe nuk është bërë zhblllokimi i tyre. Në kundërshtim me: UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022. dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës. Drejtoria e Financës, për këto raste të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Lushnjë për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

9.2.Nga verifikimi rezultoi se: Për zbatimin e këtij rekomandimi është ngarkuar komisioni i monitorimit të kantatave, i cili po e zbaton dhe ka filluar lekujdimi i një pjese te konsiderueshme të fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera.

Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Lushnjë për vitin 2021 kanë qenë në zbatim 6 kontrata, të lidhura gjatë vitit dhe në vitet ushtrimore të mëparshme, në vlerën totale 42,304,938 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria, FZHR dhe financime të huaja. Për këto kontrata nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t’u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël

në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2021 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht. Nga vlera e kontratave prej 42,304,938 lekë me TVSH është likuiduar gjatë vitit ushtrimorë vlera prej 26,093,358 mijë lekë ose 61.68% e vlerë së kontratave, duke lënë pa likuiduar vlerën 16,211,580, lekë ose 38,32 %, vlerë e cila është likuiduar në periudhat e mëvonshme dhe deri me 31.12.2021 kanë mbetur për likuidim vlera 16,211,580 lekë; ku vlera e tyre e mbetur e pa likuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “Të ardhura të caktuara për t’u përdorur”. Në kundërshtim me: VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël “Kapitulli I, pika 1. me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 ”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreu I pika 8, Kreu II pika 15/a,b,c,18/a,b, Kreu III pika 32, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Lushnjë të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizimin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyjnë pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin e tij.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

10.2.Nga verifikimi rezultoi se: ky rekomandim do të konsiderohet i pa zbatuar

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së rezultoi se:

- Janë rekomanduar 10 masa organizative, të cilat janë pranuar në masën 100%, janë zbatuara 2 masa (rekomandimi 2.1 dhe 7.1) dhe janë në proces 8 masa (rekomandimi 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 8.1, 9.1,10.1).

- Janë rekomanduar 4masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, të ardhurat e munguara të cilat janë në proces.

- Janë rekomanduar 3 masa shpërblim dëmi me vlerë **1,018,993lekë**, nga të cilat është zbatuar 1 masë (rekomandimi 3.1 me vlerë 86,218 lekë pa TVSH) dhe 2 masa janë në proces, **rekomandimi**

1.1 me vlerë 718,350lekë pa TVSH për shpërblim dëmi nga BOE “S.” SHPK & “E.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6535 Prot., datë 21.09.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “10 Korriku” dhe ambienteve sportive, Dushk”, Bashkia Lushnjë dhe rekomandimi **2.1 me vlerë 214,425 lekë pa TVSH** nga OE “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6425 Prot., datë 26.07.2019, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve në fshatin Toshkëz”. Vlera totale e dy rekomandimeve të pa zbatuara është **932,775 lekë pa TVSH**.

- Bashkia Lushnjë nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandim: Bashkia Lushnjë të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

- Të vijojë në ndjekjen e procesit të zbatimit të 8 masave organizative dhe 4 masave për eliminim e efekteve negative të konstatuara në mos menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, dhe të ardhurat e munguara, që kanë rezultuar ende në proces zbatimi sikurse janë trajtuar më gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit;

- Të marrë të gjitha masat administrative dhe ligjore për zbatimin e 2 rekomandimeve për shpërblim dëmi duke bërë të mundur arkëtimin e vlerës **932,775 lekë pa TVSH**, (718,350 lekë pa TVSH nga BOE “S.” SHPK & “E.” SHPK, në kontratën me nr. 6535 Prot., datë 21.09.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “10 Korriku” dhe 214,425 lekë nga OE “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6425 Prot., datë 26.07.2019, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve në fshatin Toshkëz”);

- Të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Brenda datës 31.12.2022

11.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar kontratave me nr. 6535 Prot., datë 21.09.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme të bashkuar “10 Korriku” nga BOE “S.” SHPK & “E.” SHPK ka bërë likuidimin e vlerës 718,350 lekë pa TVSH dhe nga OE “L.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 6425 Prot., datë 26.07.2019, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugëve në fshatin Toshkëz”) është bërë likuidimin i vlerës 214,425 lekë me TVSH të cilat janë shkarkuar nga llogaria 468 Debitorë të ndryshëm.

Zbatuar

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **390,000 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Sistemim asfaltim i rrugës Andrea Papaj”, Bashkia Lushnjë**, me vlerë të kontratës (pa TVSH) 19,270,475.83 lekë pa TVSH, realizuar nga OE “G.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **276,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9439 Prot., datë 06.12.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë, të përfaqësuar nga Titullari Z. F. T. dhe Operatorit Ekonomik “G.” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 94-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **276,000 lekë pa TVSH** nga OE “G.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9439 Prot., datë 06.12.2018, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Andrea Papaj”, Bashkia Lushnjë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2022

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Lushnjë me Vendimi nr. 202 Date 29.03.2023 ka pranuar rekomandimin e KLSH dhe ka njoftuar operatorin ekonomik mbi vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 2746, Date 29.03.2023. Deri në momentin e verifikimit rezulton se subjekti nuk ka paguar detyrimin.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: **“Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Karbunarë e Vogël”, Bashkia Lushnjë**, me vlerë të kontratës (pa TVSH) 19,270,475.83 lekë pa TVSH, realizuar nga OE “G.” Shpk, rezultuan

diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **114,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 10005 Prot., datë 27.12.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë, të përfaqësuar nga Titullari Z. F. T. dhe Operatorit Ekonomik OE “S.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 94-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **114,000 lekë pa TVSH** nga G.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 10005 Prot., datë 27.12.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Karbunarë e Vogël”, Bashkia Lushnjë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.12.2022

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Lushnjë me Vendimi nr. 203 Date 29.03.2023 ka pranuar rekomandimin e KLSH dhe ka njoftuar operatorin ekonomik mbi vendimin e sipërcituar me shkresën nr. 2780, Date 29.03.2023. Deri në momentin e verifikimit rezulton se subjekti nuk ka paguar detyrimin.

Zbatuar pjesërisht

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se:

- Detyrimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për periudhën 2015-2020 janë në vlerën 15,337,415.55 lekë për 529 subjekte të legalizuara.

- Për vitin 2021 detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 24,807,149.84 lekë për 639 objekte. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim” pika 5 si dhe VKB-së nr. 166, datë 23.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Lushnjë për vitin 2021”. Debia për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, taksën e ndërtesës dhe taksën e truallit ka arritur në vlerën 770,086,178 lekë nga të cilat:

-Vlera totale e debisë për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit (familjarëve) është 458,849,899 lekë, nga të cilat debia për vitin 2021 arrin në vlerën 50,025,221 lekë;

- Vlera totale e debisë për taksën e ndërtesës (familjarëve) është 294,522,353 lekë, nga të cilat debia për vitin 2021 arrin në vlerën 43,517,617 lekë;

- Vlera totale e debisë për taksën mbi truallin (familjarëve) është 16,713,926, nga të cilat debia për vitin 2021 arrin në vlerën 2,728,858 lekë. Veprime në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. Drejtoria e të Ardhurave Vendore, çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Lushnjë i administron në Excel. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DAV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Vlera e debitorëve për biznesin e vogël duke llogaritur edhe kamatë vonesat shkon në vlerën 78,523,836.05 lekë, për biznesin e madh 292,526,365.2 lekë, në total vlera e borxhit tatimor më 31.12.2021 është në vlerën 371,050,200.25 lekë, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnjë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marr masa për planifikimin dhe arkëtimin e detyrimeve për taksën e tokës në vlerën 346,649,296 lekë, për taksën e ndërtesës (familjarëve)

294,522,353 lekë, për tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit (familjarëve) 458,849,899 lekë dhe për taksën mbi truallin (familjarëve) 16,713,926 lekë. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar për **1,168 objekte** të legalizuara me **vlerë 40,144,565.3 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Lushnjë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë. Si dhe Bashkia Lushnjë të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifave vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj si dhe të marr masa për arkëtimin e vlerës debitorë të biznesit të vogël dhe të madh, në total 371,050,200.25 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnjë.

Brenda datës 31.12.2022

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar urdhrave të titullarit të autoritetit kontraktor, Gjendja e debisë për taksat dhe tarifave vendore me 31.12.2022 për detyrimet deri në vitin 2021.

Taksa e tokës bujqësore 352,463,909 lekë

Tarifa e pastrimit ndriçimit gjelbërimit (Kategoria Familjare) 437,090,753 lekë.

Taksa e Ndërtesës (Kategoria Familjare) 278,519,909 lekë

Taksa mbi Truallin (Kategoria Familjare) 15,416,470 lekë

Vlera e debisë për biznesin e vogël është 62,609,971 lekë

Vlera e debisë për biznesin e madh është 275,498,906 lekë

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë legalizuar 31,590,327 lekë

Në proces zbatimi

2.Gjetje nga auditimi: Në territorin e Bashkisë Lushnjë për periudhën objekt auditimi janë konstatuar pa licencën e tregtimit me pakicë të karburantit dhe licencën për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse 27 subjekte dhe 5 subjekte tregti të bombolave të gazit. Vlera e debisë së subjekteve që tregtojnë me pakicë karburantin, për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit arrin në vlerën 27,500,000 lekë, që përbën të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnjë. Veprime në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për arkëtimin e debisë së subjekteve që tregtojnë me pakicë karburantin, për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit në vlerën 27,500,000 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnjë.

Brenda datës 31.12.2022

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Lushnjë ka njoftuar me shkresë me nr. 11218 prot. date 21.12.2023 subjektet debitorë mbi vlerën e konstatuar, por nuk ka ndërmarr asnjë procedurë tjetër për likuidimin e vlerës si dhe pezullimin e aktivitetit për subjektet aktive.

Pa zbatuar

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1-5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 5 procedurave me vlerë kontrate **47,877 mijë lekë**, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP në 3 procedura me vlerë kontrate **24,285 mijëlekë** ose 51 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **24,285 mijë lekë**, respektivisht:

1- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Lushnjë”*, Viti 2021, me fond limit 31,409 mijë lekë (për 8 muaj), me fitues OE “R.” SHPK me vlerë të ofertës 16,243 mijë lekë për zbatimin e shërbimit nga datë 09.08.2021 deri më datë 31.12.2021 ku ka rezultuar se KLFLST dhe NJP nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP për llogaritjen e fondit limit, hartimin e kriterëve dhe specifikimet teknike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 66-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Shërbimi i gjelbërimit në Bashkinë e Lushnjës”*, Bashkia Lushnjë, Viti 2021, me fond limit **14,798 mijë lekë**, me fitues OE “G.” SHPK me vlerë të ofertës 10,423 mijë lekë pa TVSH, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **12,836,908 lekë me TVSH**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 66 – 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Rehabilitim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor parësor Toshkëz”*, Bashkia Lushnjë, Viti 2021, me fond limit **11,874 mijë lekë**, me fitues BOE “N.” SHPK & “S.” SHPK me vlerë të ofertës **8,414 mijë lekë** pa TVSH, ka rezultuar se në hartimin e kriterëve të DT, janë aplikuar kritere të paargumentuara, si dhe KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **10,097,738 lekë me TVSH**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 66 –94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: *“Ndërtimi i murit mbajtës në rrugën Hajdaraj, Njësia Administrative Golem”*, Bashkia Lushnjë, Viti 2021, me fond limit 1,325 mijë lekë, me fitues OE “N” SHPK me vlerë të ofertës 14,520 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën **1,350,600 lekë me TVSH**. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 66–94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: **“Blerje karburanti për Bashkinë dhe MNZSH”**, Viti 2021, me fond limit 4,658 mijë lekë, me fitues OE “G.” SHPK me ofertë 249,496 mijë lekë, ku ka rezultuar se Njësia e Prokurimit në procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit për blerje karburanti nuk ka argumentuar harxhimin e mjeteve që disponon bashkia në bazë të orëve të punës dhe kilometrave, në dosjen e tenderit nuk është pasqyruar saktë përlllogaritja e sasisë të karburantit që prokurohen, gjë e cila e bën hartimin e fondit limit të. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 66-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi” pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 “Parimet e përzgjedhjes” shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” pika 1, dhe nenin 55 “Shqyrtimi i ofertave” pika 3. (dhe VKM nr. 285 e ligjin nr. 162, për prokurimet e zhvilluar mbasi legjislacioni ka hyrë në fuqi).

1.1-5.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë përdorimi me paligjshmëri i fondeve publike për vlerën **24,285 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë

publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar procesverbalit nr. 3 datë 28.03.2023 të mbledhjes së GMS, është trajtuar materiali i KLSH dhe referuar situatës të ndodhur në bashkinë Lushnjë u tërhoq vëmendje punonjësve sipas Raportit të dërguar me shkresën nr. 513/13 datë. 30.09.2022.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “**Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane**”, **Bashkia Lushnjë**, me vlerë të kontratës (pa TVSH) 11,981,688.33 lekë, realizuar nga BOE “L.” Shpk & “H.” SHPK, rezultuan diferenca në volume shërbimi të pakryera në vlerën **2,757,609 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: DT, Specifikimet Teknike, Përlllogaritjen e FL, dhe Kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 10299 Prot., datë 01.01.2021 deri më datë 12.04.2021 dhe shtesë kontrate nr. 1872 Prot., datë 09.03.2021 me vlerë 2,875,605.20 lekë me TVSH. Afati 13.04.2021 -31.05.2021 lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lushnjë dhe BOE “L.” SHPK & “H.” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 94-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat në volumin e shërbimit të pastrimit, nga mosparaqitja e dokumentacionit tekniko-ligjor nga supervizimin i realizimit të shërbimit (referuar përlllogaritjes së FL, DT, Specifikimeve Teknike e Ofertës Fituese), në zbatimin e kontratës nr. 10299 Prot., datë 01.01.2021 deri më datë 12.04.2021 dhe shtesë kontrate nr. 1872 Prot., datë 09.03.2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane”, Bashkia Lushnjë duke shkaktuar përdorimin pa ekonomikitet të fondeve publike, për vlerën **2,757,609 lekë me TVSh**.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar procesverbalit nr. 3 datë 28.03.2023 të mbledhjes së GMS, është trajtuar materiali i KLSH dhe referuar situatës të ndodhur në bashkinë Lushnjë u tërhoq vëmendje punonjësve sipas Raportit të dërguar me shkresën nr. 513/13 datë. 30.09.2022. Aktualisht “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane” zhvillohet nga bashkia Lushnjë dhe jo nga kompani të kontraktuara për ofrimin e shërbimit.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: “**Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane**”, **Bashkia Lushnjë**, me vlerë të kontratës (pa TVSH) 16,243,735.10 lekë, realizuar nga OE “R.” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **2,999,263.98 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me: DT, Specifikimet Teknike, Përlllogaritjen e FL dhe Kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 5683 Prot., datë 09.08.2021 me vlerë 1,446,681.60 lekë me TVSH për furnizimin me karburant të mjeteve të sipërmarrësit për transportimin e mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi fillestar për në landfillin e ri pranë fshatit Vërrri tek Ura Mbrostar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 94-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lushnjë, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat në volumin e shërbimit të pastrimit, nga mosparaqitja e dokumentacionit tekniko-ligjor nga supervizimin i realizimit të shërbimit (referuar përlllogaritjes së FL, DT, Specifikimeve Teknike e Ofertës Fituese), në zbatimin e kontratës së shërbimit me nr. 10299 Prot., datë 01.01.2021 deri më datë 12.04.2021 dhe shtesë kontrate nr. 1872 Prot., datë 09.03.2021, me objekt: “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane”, Bashkia Lushnjë duke shkaktuar përdorimin pa ekonomikitet të fondeve publike, për vlerën **2,999,263 lekë me TVSH**.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar procesverbalit nr. 3 datë 28.03.2023 të mbledhjes së GMS, është trajtuar materiali i KLSH dhe referuar situatës të ndodhur në bashkinë Lushnjë u tërhoq vëmendje punonjësve sipas Raportit të dërguar me shkresën nr. 513/13 datë. 30.09.2022.

Aktualisht “Shërbimi i pastrimit dhe grumbullimi i mbetjeve urbane” zhvillohet nga bashkia Lushnjë dhe jo nga kompani të kontraktuara për ofrimin e shërbimit.

Zbatuar

F. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i **rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Lushnjë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara në dokumentet e auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.
- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, neni 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.
- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se Referuar procesverbalit nr. 3 datë 28.03.2023 të mbledhjes së GMS, është trajtuar materiali i KLSH dhe referuar situatës të ndodhur në bashkinë Lushnjë u tërhoq vëmendje punonjësve sipas Raportit të dërguar me shkresën nr. 513/13 datë. 30.09.2022 konfirmuar me procesverbalin me nr. 2756/1 prot datë 29.03.2023.

Zbatuar

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Lushnjë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Lushnjë 11 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 2 masë organizative, është zbatuar pjesërisht 1 masë organizative, janë në proces zbatimi 7 masa organizative dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Rekomandimi:6.1 Kryetari i Bashkisë Lushnjë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në **llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”** dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar

saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në Pasqyrat Financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë

2. 10.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Lushnjë të kryejë të gjitha veprimet e kontabilizimit sipas fazave të kryerjes së veprimeve ekonomike për kontratat e lidhura për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, duke pasqyruar të gjitha detyrimet financiare të lindura nga angazhimi i krijuar që nga çelja e fondeve, me konstatimin e shpenzimit (mbërritja e faturës), deri në kapitalizmin e aktivitetit dhe jo thjesht, kur ndërhyjnë pagesa, pasi evidentimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve është i domosdoshëm për njohjen reale të borxhit të akumuluar dhe marrjen e masave për zvogëlimin e tij.

Menjëherë

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Lushnjë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara si dhe përsheptimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi.

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga KLSH janë rekomanduar 2 masa për shpërblim dëmi me vlerën 390,000 lekë, të pranuar 100% nga subjekti. Prej tyre janë zbatuar pjesërisht 2 masa në vlerë 390,000 lekë, për të cilat janë nisur njoftimet për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve.

Sa më sipër KLSH kërkohet që për rekomandimet për shpërblim dëmi, Bashkia Lushnjë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përsheptuar punën për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1. Rekomandim 1.1.: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **276,000 lekë pa TVSH** nga OE “G.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9439 Prot., datë 06.12.2018, me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Andrea Papaj”, Bashkia Lushnjë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Rekomandim 2.1.: Nga Bashkia Lushnjë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **114,000 lekë pa TVSH** nga G.” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 10005 Prot., datë 27.12.2018, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Karbunarë e Vogël”, Bashkia Lushnjë, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Lushnjë ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat shpërblim dëmi të konsideruara zbatuar pjesërisht, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e Bashkisë.

Menjëherë

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të analizohen 3 masa në vlerën 30,041 mijë lekë e pranuar dhe zbatuar si dhe janë rekomanduar 2 masë në vlerën 1,555,429 mijë lekë, nga e cila për 1 masë në vlerën 1,527,929 mijë lekë është arkëtuar vlera 74,739 mijë lekë, është në proces zbatimi vlera 1,453,190 mijë lekë si dhe nuk është zbatuar 1 masë në vlerën

27,500 mijë lekë, për të cilat KLSH rikërkon përsheptimin e punës për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe zbatimin e një rekomandimi të pa zbatuar si vijon:

1. Rekomandimi 2.1: Drejtoria e Shërbimeve të marrë masa për arkëtimin e debisë së subjekteve që tregtojnë me pakicë karburantin, për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit në vlerën 27,500,000 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Lushnjë.

Menjëherë

Aneksi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Lushnjë, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	11	11	2	1	7	1
Masa shpërblim dëmi (Nr.)	2	2		2		
Masa shpërblim dëmi (vlerë)	390,000			390,000		
Masa për 3E në të ardhura (Nr.)	2	2			1	1
Masa për 3E në të ardhura (vlerë)	1,555,430	1,555,430		74,739	1,453,179	27,500
Masa për 3E në shpenzime(Nr.)	3	3	3			
Masa për 3E në shpenzime(vlerë)	30,041	30,041	30,041			
Masa Disiplinore/Administrative	1	1	1		-	-

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Dibër: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.07.2022 DERI
31.01.2023, BASHKIA DIBËR”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-28
	<i>Drejtimet e Auditimit.....</i>	4
	<i>A.Masa Organizative.....</i>	4-21
	<i>B.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike.....</i>	21-26
	<i>C.Masa Disiplinore.....</i>	26-28
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	28-30

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 629/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Dibër, më datë 28.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. H. I., z. S. H.dhe Z. V. S., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Dibër rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, ndërsa nga Bashkia nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, shkronja (j)- *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 25.04.2023. Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 28 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 28 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 4 masa, janë në proces zbatimi 16, janë zbatuar pjesërisht 2 masa dhe 6 masa nuk janë zbatuar.

Për masat eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 5 masa në vlerë 60,218 mijë lekë, të cilat janë pranuar plotësisht. Janë në proces zbatimi 5 masa në vlerë 60,218 mijë lekë.

Për masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Dibër dhënia e masës disiplinore ndaj 28 personave ndaj të cilëve është vendosur masë disiplinore.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 25.10.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Dibër, sipas programit të auditimit nr. 629/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. H. I., përgjegjës i grupit;
2. S. H., anëtar,
3. V. S., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Dibër në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, rezulton se nga **59** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **48** masa ose 81.3% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **11** masa ose 18.7% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 81%, nga ana e Bashkisë Dibër, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Dibër rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022, ndërsa nga Bashkia Dibër nuk është kthyer

përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, shkronja (j)- *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*.

Pa Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Dibër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 371/9 prot., datë 25.10.2022 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 25.04.2023.

Nga ana e Bashkisë Dibër nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*.

Pa Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Dibër ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr371/9 prot., datë 25.10.2022, **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

Pa Zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Dibër 28 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masë organizative, janë në proces zbatimi 16 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 6 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi:Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, u konstatua se gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Bashkinë Dibër, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, gjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra nëLigjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,

Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Sipas urdhrin nr. 8 datë 07.01.2022 është bërë ndryshimi i Grupit të Menaxhimit Strategjik si dhe me urdhrin nr 7 datë 07.01.2022 është caktuar Kordinatori i Riskut për Bashkinë Dibër. Aktualisht bashkia Dibër është në proces të Hertimit të një strategjie të menaxhimit të riskut.

Në process zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Dibër është organizuar dhe funksionon struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), e cila është e përbërë nga Përgjegjësi i Sektorit, i cili nuk është i pajisur me certifikatën e auditit të brendshëm, si dhe dy specialistë të cilët nuk janë të pajisur me këtë certifikatë. Nuk është bërë kontrolli i cilësisë së auditimit të kryer.

Për vitin 2021 nga 14 auditime të planifikuara janë realizuar 2, nga ku janë konstatuar 41 gjetje dhe janë lënë 41 rekomandime me karakter organizativ.

Njësia e Auditit të Brendshëm nuk ka kryer auditime në fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, të tilla si prokurimet publike, ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, taksat dhe tarifat vendore, etj. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Kryetarit të Bashkisë për arritjen e objektivave. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm i miratuar me UMF nr. 100, datë 25.10.2016, Kap. II, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga NJAB të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: NJAB Bashkia Dibër në planin vjetor 2023 dërguar drejtoris së harmonizimit pran MFE me shkresën nr. 4459/1 datë 14.10.2022 ka planifikuar në total 6 auditime për të cilat ka përcaktuar dhe riskun për secilin auditim. Gjuthashtu kanë mbaruar programin e certifikimit të Auditimit të Brendshëm z. E. M. dhe z. H. D. me date 18.07.2023.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatuan diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 32% deri 90%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Dibër dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit, për vitin 2021, e zënë pagat dhe sigurimet,

e ndjekur nga shpenzimet operative me 61,6% dhe Investimet me 45%.

Të ardhurat e Bashkisë Dibër për vitin 2021 janë realizuar në masën 94,2%, konkretisht nga 151,065 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 142,361 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vitin 2021 janë 17,578 mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar e vitit 2021 është 416,544 mijë lekë, transfera specifike faktike është 266,699 mijë lekë, nga FZHR është një shtesë me vlerë 245,141 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2021 është 1,178,850 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 79,3%, pra 935,266 mijë lekë.

Për vitin 2021, nga transfera e pakushtëzuar treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 443,093 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 311,592 mijë lekë ose në masën 73%.

Nga transfera specifike treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 297,643 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 266,699 mijë lekë ose në masën 89,6%.

Nga të ardhurat e veta treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 168,643 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 100,619 mijë lekë ose në masën 59,6%.

Nga fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 11,631 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 11,215 mijë lekë ose në masën 96,4%.

Nga fondet e FZHR, AKUM treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 257,840 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 245,141 mijë lekë ose në masën 95%.

Shpenzimet për vitin 2021 janë parashikuar në vlerën **921,012 mijë lekë** dhe janë realizuar në vlerën **690,132 mijë lekë** ose **74,9%**.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Dibër, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me VKB nr. 01 datë 13.01.2022 ka miratuar Buxhetin vjetor të vitit 2022, janë parashikuar në vlerën 1,018,008 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 836,379 mijë lekë ose 82,1%. Nuk është bërë analizë e realizimit të buxhetit për vitin 2022 sipas vendimit nr. 47 datë 07.04.2023 kondormuar nga prefekti i qarkut dibër me shkresën nr. 453/1 prot datë 14.04.2023.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli është bërë pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulta, ku për vitin 2021 është realizuar në një nivel prej 32,8%, ku nga vlera e planifikuar prej 378,719,798 lekë është realizuar vlera 305,546,000 lekë me një diferencë prej 73,173,798 lekë.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo mbi bazën e të ardhurave të planifikuara, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Dibër.

Në vijimësi

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me VKB nr. 1 datë 13.01.2022 është miratuar Buxhetin vijetor i vitit 2022 ku janë parashikuar investime me të ardhurat vendore dhe transfertat e pakushtëzuara në vlerën 211,839 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 134,636 mijë lekë ose 63.5%. Planifikimi i procedurave është bërë duke mbajtur parasysh realizimin e vitit parardhës.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua paraqitje e faturave në degën e thesarit pas afatit 30 ditor, nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura dhe planifikim jo i saktë jo i plotë dhe jo në rend kronologjik për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Për vitin 2021, detyrimet e raportuara në MFE janë në vlerën 282,143,863 lekë, por sipas ditarit të bankës dhe urdhër-shpenzimeve e dokumentacionit financiar shoqërues të vënë në dispozicion nga Drejtoria Ekonomike, rezultoi se gjendja e detyrimeve të palikujduara në fund të vitit 2021 është në shumën 428,026,632 lekë, pra me një diferencë prej 145,882,769 lekë të krijuara gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2021.

Në totalin e faturave të palikujduara për vitin 2021, faturat e artikullit 602 paraqiten në shumën 16,480 mijë lekë ose 3.9% të totalit. Shpenzimet për investime janë në shumën 321,216 mijë lekë ose 75% dhe shpenzime gjyqësore në shumën 90,330 mijë lekë ose 21% e totalit.

Është i pa argumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të vitit 2020, megjithëse në llogarinë 520 ka gjendje monetare të papërdorur, përsëri Bashkia Dibër ka detyrime kreditore të papaguara në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2020 në llogarinë 520 ka pasur gjendje në vlerën 89,281,105 lekë dhe në fund të vitit 2021 llogaria 520 paraqitet në vlerën 160,517,345 lekë (shumë nga e cila 51,910 mijë lekë përbëhet nga garancia e punimeve).

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Dibër, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2021, janë pa paguar gjithsej **135** fatura me vlerë **336,831 mijë lekë**.

Gjithashtu nga Bashkia Dibër (*Drejtoria e Financë/Buxhet*), ka një sasi faturash të cilat nuk janë likuiduar në vlerën e tyre të plotë, duke kryer pagesa pjesore të tyre kjo për efekt të mungesës së fondeve nga realizimi i të ardhurave vendore. Kështu për vitin 2021, paraqiten gjithsej **4** fatura me vlerë **19,037 mijë lekë**.

Nga auditimi i dokumentacionit për detyrime për vendime gjyqësore, u konstatua se deri në fund të vitit 2021 paraqitet gjithsej vlera prej 90,330 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 është likuiduar shuma prej 73,185 mijë lekë dhe mbetet për likuidim shuma prej 17,145 mijë lekë.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligjin nr. 9632, datë

30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3, etj.; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe detyrimeve për vendimet gjyqësore në të palikuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjithë radhën e pagesave për vlerën **336,831 mijë lekë**, nga faturat e papaguara dhe **90,327 mijë lekë** nga vendimet gjyqësore, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.

Menjëherë

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar shkresës nr. 851 prot datë 28.02.2023 drejtuar MFE është bërë raportimi i detyrimeve të prapambetura për vitin 2022, nga ku rezulton se:

Detyrimet e prapambetura të bashkisë janë në vlerën 158,152 mmijë lekë si dhe referuar akt rakordimit me thesarin bashkia Diber ka detyrime në vlerën 249,876 mijë lekë të krijuara nga ministrit e linjave në total vlere e dtyrimet e pasqyruar në PF është 408,028 mijë lekë të ndara sipas llogarive përkatëse.

Në proces zbatimi

5.2. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa që të ardhurat e papërdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t’i përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas radhës kronologjike të krijimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Me VKB nr. 1 datë 13.01.2022 është miratuar Buxhetin vjetor i vitit 2022 ku sipas pasqyrës së investimeve dhe shpenzimeve operative është planifikuar likuidimi i detyrimeve në vlerën 10.327 mijë lekë. Për vitin 2023 është parashikuar vlere 40,000 mijë lekë.

Në proces zbatim

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, ukonstatua se, për vitin 2021, të ardhurat nga 151,065,000 lekë të planifikuara janë realizuar 142,361,239 lekë ose 94%, pra me një mosrealizim në shumën 8,703,761 lekë. Të ardhurat tatimore janë parashikuar në vlerën 49,841,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 38,967,819 lekë ose 78%, ndërsa të ardhurat jotatimore janë parashikuar në vlerën 101,224,000 lekë dhe realizuar në vlerën 103,393,420 lekë ose 102%.

Për disa taksa dhe tarifa, realizimi paraqitet në vlere të ulta dhe për disa taksa dhe tarifa të tjera realizimi paraqitet mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim ose fryrje të pritshmërisë së arkëtimit, e cila kryesisht vjen për shkak të mosnjohjes së situatës dhe moskryerjes së rregullt të procedurave, gjë që ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos pasqyruar saktë burimin e të ardhurave.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE

nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të të ardhurave, Bashkia Dibër të marrë masa për planifikimin sa më real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e të ardhurave në periudhat paraardhëse duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet sipas zërave përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me VKB nr. 1 datë 13.01.2022 është miratuar Buxhetin vjetor i vitit 2022 ku janë mbajtur në konsiderat realizimet e viteve parardhës mbi realizimin e të ardhurave.

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në rregulloren e brendshme të Bashkisë Dibër nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Në lidhje me subjektet, detyrimet tatimore të të cilëve arkëtohen nga agjentët tatimorë, u konstatua se nga Bashkia Dibër nuk është krijuar një bazë të dhënash e plotë dhe e saktë, ku të përcaktohet numri i subjekteve tatimpagues, lloji i detyrimeve të tyre, periudha e ushtrimit të veprimtarisë, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa subjekte janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është bërë asnjëherë rakordim me këta agjentë në lidhje me detyrimet e tyre ndaj Bashkisë Dibër, pavarësisht konfirmimit të arkëtimeve nga dega e Thesarit.

Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se bashkia Dibër nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së banimit që ka secila familje, kujt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, si dhe nuk është plotësuar rregullisht njoftimi i detyrimit për çdo familje, si për taksën e ndërtesës edhe për tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit.

Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër Sh.A., nuk është caktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtesës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit. Për këtë çështje, nga Sektori i të ardhurave dhe tarifave vendore është relatuar disa herë në Këshillin Bashkiak, por nuk është realizuar marrëveshja për caktimin si agjent tatimor.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet dhe familjarët, tarifatat apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Dibër, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitete në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

7.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrit nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e

rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit nuk është krijuar regjistri i subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Pa zbatuar

7.2. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Dibër ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve bashkia Dibër. Deri në momentin e verifikimit rezultoi se nuk është miratuar si agjent.

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 88,410,386 lekë dhe në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 89,156,027 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie për vitin 2021 kjo vlerë përbëhet nga;

- Debitorë për taksat e tarifave vendore në vlerën 9,053,255 lekë, debitorë të rekomanduar nga KLSH në vlerën 73,085,749 lekë, debitorë të kopshteve e çerdheve në vlerën 1,913,542 lekë, debitorë për letrat me vlerë në shumën 5,103,481 lekë.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk rakordon për shumën 338 lekë, si diferencë ndërmjet pasqyrës dhe ditarit, ndërsa nuk janë të pasqyruar të gjitha detyrimet debitorë të subjekteve private të lindura nga mos pagimi i nivelit të taksave e tarifave vendore, pasi nga evidentimi që ka bërë Sektori i taksave dhe tarifave vendore, ka rezultuar se debitorët nga subjekte taksapagues privat dhe familjarë janë në vlerën prej 40,132,137 lekë dhe jo sa paraqiten në pasqyrat financiare me vlerë 8,619,354 lekë. Rezulton një diferencë prej 31,512,783 lekë më pak në Pasqyrat financiare. Në këtë mënyrë pasqyrat financiare për vitin 2021 nuk pasqyrojnë me vërtetësi gjendjen e detyrimeve debitorë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 71-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Dibër në bashkëpunim me sektorin e taksave dhe tarifave vendore, mbështetur në listën e debitorëve, të bëjë rregullimet përkatëse të vlerës së detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, si dhe për të gjitha llojet e tjera të detyrimeve.

Në mbylljen e PF të vitit 2022

8.1.Nga verifikimi rezultoi se Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e financës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Nga ku rezultoi se në bilancin e vitit 2022 është bërë pasqyrimi i debitorve në pasqyrat financiare konfirmuar me shkresën nr 1316 datë 29.03.2023 protokolluar në degën e thesarit dibër me shkresën nr. 218 datë 30.03.2023.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 40,742,260 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 34,630,920 lekë, me diferencë në vlerën 6,111,340 lekë më pak, e cila përfaqëson vlerën e amortizimit i llogaritur për vitin ushtrimor 2021, e cila paraqitet në mënyrë analitike në Pasqyrën PF2, bashkëlidhur PRA. Vlera prej **56,390,670 lekë** i përket 79 projekteve për investimet e kryera në objekte një pjesë e të cilave kanë përfunduar punimet para vitit 2021 dhe janë marrë në dorëzim nga Bashkia, vlerë e cila duhet të ishte sistemuar në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit, në kundërshtim me UMF nr. 08,

datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36, paragrafi 4, UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika c, nënpika b. VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël” Kap. II.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 71-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Financës të bëjë sistemimin e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” duke shpërndarë vlerën e secilit projekt sipas investimeve të kryera.

Në mbylljen e PF të vitit 2022

9.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në mbyllje të bilancit të vitit 2022 nuk është bërë sistemimi i llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” konfirmuar me shkresën nr 1316 datë 29.03.2023 protokolluar në degën e thesarit dibër me shkresën nr. 218 datë 30.03.2023.

Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 28,394,404 lekë, vlerë kjo e pandryshuar edhe në datën 31.12.2021. Në këtë llogari pasqyrohet vlerat e investimeve të kryera ndër vite, kryesisht për shpronësim truall Shkolla e Mesme, Konvikti dhe shpronësim rruge tek gjimnazi i ri. Në këtë llogari nuk janë përfshirë tokat, trojet dhe terrenet që njësia vendore ka në fakt si pasuri të saj, duke përfshirë edhe ish komunat, të cilat janë transferuar me VKM të posaçme në këtë njësi vendore. Njësia vendore nuk ka një listë përfundimtare të pronave në formën e regjistrit të aktiveve, sipas kërkesave të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Për mosinventarizimin dhe moskontabilizimin e të gjithë pasurisë për toka, troje, terrene kjo llogari nuk pasqyron vlerën e saktë të pasurisë së njësisë vendore.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 2,468,000 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,268,000 lekë me pakësim 1,200,000 lekë. Në këtë llogari është zbritur vlera e investimeve të kryer për “ndërtim lere” në vlerën 1,200,000 lekë përgjatë vitit 2020, e cila ka kaluar në llogarinë 213 “Vepra ujore”.

Në këtë llogari, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Dibër me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, pika 8, shtojca nr. 6, me listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Dibër, me nr. nga 1 (një) deri 2,327 (dymijë e treqind e njëzet e shtatë). Sipas këtij vendimi Bashkia Dibër ka në pronësi gjithsej 36,662 ha nga të cilët 25,351 ha pyje; 5,412 ha kullota, 534 ha sipërfaqe me bimësi pyjore, 3,417 ha sipërfaqe inproduktive, 1,889 ha sipërfaqe djerrë dhe 57 ha sipërfaqe ujore.

Gjithashtu, krahas sa më sipër, u konstatua se nuk është hartuar regjistri i Aktiveve afatgjata materiale dhe mungon lista e plotë e inventarit të tyre, me vlerat përkatëse kontabël.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 71-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve afatgjata materiale të painventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “Toka, troje terrene”; 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”; 212 “Ndërtime e konstruksione”; 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” dhe 215 “Mjete transporti”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

Në mbylljen e PF të vitit 2022

10.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar Drejtoria e financës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve ka bërë sistemimin e llogaris 215 “Mjete transporti” konfirmuar me shkresën

nr 1316 datë 29.03.2023 protokolluar në degën e thesarit dibër me shkresën nr. 218 datë 30.03.2023. Ndërsa për llogarit e tjera nuk është kryer procesi i Inventarizimit.

Zbatuar pjesërisht

11. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 230 “Aktive afatgjata jo materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 18,131,232 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet vlerën 41,625,665 lekë me diferencë për 23,494,433 lekë e cila përfaqëson vlerën e studime e projekte për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor.

- Gjendja e llogarisë 231 “Aktive afatgjata materiale” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 545,659,534 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 747,502,120 lekë me diferencë për 201,842,586 lekë e cila përfaqëson vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor.

Duke pasur parasysh se llogaria 230 “Aktive afatgjata jo materiale” dhe llogaria 231 “Aktive afatgjata materiale” do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre, kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë në llogari të Klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”, rezulton se në Pasqyrat financiare të vitit 2021 nuk është paraqitur vlera e saktë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 71-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës, të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave të këtyre llogarive, duke i saktësuar përkatësisht sipas posteve në bilancin kontabël.

Në mbylljen e PF të vitit 2022

11.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar Drejtoria e financës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve ka bërë sistemimin e llogarisë 230 “Aktive afatgjata jo materiale” dhe llogarisë 231 “Aktive afatgjata materiale”.

Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” gjendje më datë 31.12.2021, paraqitet në vlerën 51,910,379 lekë, e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj operatorëve ekonomikë për garanci në punime për objekte të përfunduara, si edhe për ato në proces.- *garancia e trashëguar nga periudhat paraardhëse vlera 49,637,102 lekë.*

- *diferenca e krijuar ndërmjet likuidimeve dhe garancisë në vlerën 2,273,277 lekë periudha 2021* Logaria 466 është e saktë si vlerë në pasqyrat financiare, por nuk është e analizuar për çdo objekt ndërtimi dhe operator ekonomik, si pasojë e mos pasqyrimin në aktrakordime dhe në evidencat analitike për të gjithë operatorët ekonomik që Bashkia ka detyrim në lidhje me vlerën e garancisë për punimet e përfunduara, apo ato në proces.

Për objektet e përfunduara e të marra në dorëzim nga Bashkia nuk është bërë likuidimi i vlerës, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Urbanistikës dhe e Financës, nuk janë marrë masa për likuidimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 71-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera, për të cilat subjektet përkatëse kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Dibër për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik. Për ato subjekte, të cilat kanë përmbushur detyrimet kontraktuale dhe është plotësuar afati i garancisë së punimeve, të bëhet likuidimi i vlerës të garancisë së fondeve.

Në mbylljen e PF të vitit 2022

12.2. Nga verifikimi rezultoi se; Referuar urdhrit nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar Drejtoria e financës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve, nga ku rezulton se nuk është bërë sistemimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” pasi vlera e mbartur vjen si rezultat i viteve parashse të cilat nuk kanë dokument justifikues për likuisim.

Pa zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në procedurat e prokurimit me objekt: “Furnizim me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë, faza e parë”, me vlerë të fondit limit 650,000,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Furnizim me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë, faza e dytë”, me vlerë të fondit limit 175,251,904 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; “Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi”, me vlerë të fondit limit 208,333,333.5 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Rehabilitimi i digës së Gramës Bashkia Dibër”, me vlerë të fondit limit 47,426,209 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Sistemim asfaltim i lagjes Bulke-Begjunec dhe blloku 6-katesh L tot=1730 ml”, me vlerë të fondit limit 45,217,237 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Dru zjarri për nevoja të institucioneve arsimore të Bashkisë Dibër”, me vlerë të fondit limit 9,994,535 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Dibër 2020”, me vlerë të fondit limit 10,000,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Mirëmbajtje dimërore e rrugëve rurale dhe mirëmbajtjen e rrugëve të zakonshme”, me vlerë të fondit limit 7,451,800 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020; “Riveshje me asfalt i rrugës “Abdyl Frashëri”, kryqëzimi i shkollës profesionale-Rruga e Lagjes “Aksioni” dhe Rruga Prefekturë-Kamen”, me vlerë të fondit limit 24,506,501 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme lagjia “Gjone” Nja. Maqellarë”, me vlerë të fondit limit 23,225,866 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kukaj”, me vlerë të fondit limit 18,752,173 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021; “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtare”, me vlerë të fondit limit 13,989,021 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021 dhe “Sistemim asfaltim i rrugës së lagjes Vraniçë dhe sistemim i sheshit të pallatit”, me vlerë të fondit limit 14,327,163 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, si dhe nuk janë argumentuar hollësisht në procesverbalet përkatëse, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme në hartimin e kritereve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat enenit 26, pika 5, nenit 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 46 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kritereve të veçanta të DST, si dhe për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve, duke dhënë argumente për secilin kriter, të cilat të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit. Njësia e Prokurimit, në hartimin dhe miratimin e kritereve të kërkesave për kualifikim, pjesë integrale e DST, të argumentojë me hollësi çdo kriter të kërkesave kualifikuese, bazuar mbi natyrën e kontratës, zërat e preventivit, volumet e punimeve, kohëzgjatjen e kontratës, orët e punës për njësi të zërave të preventivit, analizave sipas manualit teknik të çmimeve, numrin e nevojshëm të mjeteve, punonjësve, liçencave, etj, duke i pasqyruar në procesverbalin përkatës, i cili të jetë pjesë e dosjes së prokurimit.

13.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrit nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë mare masa konkrete si vijon: në çdo rast është janë ngritur komisionet përkatëse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verifikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

13.2. Rekomandimi: Specialisti i fushës në Njësinë e Prokurimit, Bashkia Dibër, të marrë masa për shmangien e kriterëve të tepërta dhe të paargumentuara, të cilat nuk mbështeten në bazën ligjore, por krijojnë pengesë dhe kufizojnë numrin e operatorëve ekonomikë për të konkurruar në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriterë të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në çdo rast është janë ngritur komisionet përkatse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verifikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: -Nga auditimi, rezultoi se në 2 procedura, KVO ka kryer vlerësimin e ofertave në tejkalim të afatit prej 15 ditësh, në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014, neni 66 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 2.;

- Nga auditimi, rezultoi se në rastet e mëposhtme të procedurave të prokurimit publik, janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, konkretisht si vijon:

1. “Furnizim me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë, faza e parë”, me vlerë të fondit limit 650,000,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është shpallur fitues OE “G.” ShPK;
2. “Furnizim me ujë nga burimi i Gramës për ujësjellësin e Peshkopisë, faza e dytë”, me vlerë të fondit limit 175,251,904 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues operatori ekonomik “S.” ShPK;
3. “Ndërtim i Linjës së Furnizimit me ujë të pijshëm Gurra e Epërme-Luzni-Peshkopi”, me vlerë të fondit limit 208,333,333.5 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “S.” SHPK& “G.” ShPK;
4. “Rehabilitimi i digës së Gramës Bashkia Dibër”, me vlerë të fondit limit 47,426,209 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “E.” ShPK;
5. “Sistemim asfaltim i lagjes Bulke-Begjunec dhe blloku 6-katesh L tot=1730 ml”, me vlerë të fondit limit 45,217,237 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S.” ShPK;
6. “Dru zjarri për nevoja të institucioneve arsimore të Bashkisë Dibër”, me vlerë të fondit limit 9,994,535 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “W.” ShPK;
7. “Blerje karburant për nevoja të Bashkisë Dibër 2020”, me vlerë të fondit limit 10,000,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “D.” ShPK;
8. “Mirëmbajtje dimërore e rrugëve rurale dhe mirëmbajtjen e rrugëve të zakonshme”, me vlerë të fondit limit 7,451,800 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2020, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A.” ShPK;
9. “Riveshje me asfalt i rrugës “Abdyl Frashëri”, kryqëzimi i shkollës profesionale-Rruga e Lagjes “Aksioni” dhe Rruga Prefekturë-Kamen”, me vlerë të fondit limit 24,506,501 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “N.” ShPK;
10. “Sistemim asfaltim i rrugëve të brendshme lagjia “Gjone” Nja. Maqellarë”, me vlerë të fondit limit 23,225,866 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S.” ShPK;
11. “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Kukaj”, me vlerë të fondit limit 18,752,173 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S.” ShPK;

12. “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Majtare”, me vlerë të fondit limit 13,989,021 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S.” ShPK;

13. “Sistemim asfaltim i rrugës së lagjes Vraniçë dhe sistemim i sheshit të pallatit”, me vlerë të fondit limit 14,327,163 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është kualifikuar dhe shpallur fitues OE “A.” ShPK.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1, germa ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa a).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit apo shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatëse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verifikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi: - Asnjë nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit dhe KVO nuk vërtetohet të kenë kryer trajnime të ndryshme;

- Asnjë nga dosjet e audituara nuk është e inventarizuar dhe e numërtuar;

- Procesverbalet mbi përshkrimin e veprimeve dhe Raportet Përmbledhëse të cilat janë miratuar nga Titullari i AK, nuk janë të detajuara dhe nuk përshkruajnë në mënyrë të plotë të gjithë procedurën, duke mos evidentuar argumentimin e fondit limit;

- Në të gjitha rastet e audituara, konstatohet se procesverbalet dhe DST nuk janë protokolluar në protokollin e Bashkisë Dibër;

- Nuk ka urdhër të Titullarit të AK për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të projekteve/preventivave (të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e bashkisë), kontratave të punimeve/shërbimeve dhe blerjes së mallrave.

- Personat që kanë përgatitur projektet, relacionet, preventivat dhe grafikët e punimeve nuk janë në të gjitha rastet të liçencuar nga autoritetet teknike përkatëse për kryerjen e projekteve në fusha të caktuara specifike.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që në komisionet e NJHDT dhe KVO, të emërojë persona me profil sipas llojit të procedurës dhe të trajnuar.

15.1.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatëse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verifikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

15.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me specialistë të fushës për hartimin e fondit limit në përputhje me aktet ligjore/nënligjore, me qëllim planifikimin e saktë të fondit dhe përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij.

15.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur

komisionet përkatse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verivikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

15.3. Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit, të marrë masat për inventarizimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit dhe të zbatimit të përfunduara dhe dorëzimin e tyre në Sektorin e Arkivës, Bashkia Dibër.

15.3.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë mare masa konkrete si vijon:

Është bërë e mundur inventarizimi i gjithë dosjevë të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të përfunduara dhe është bërë dorëzimi i tyre në Sektorin e Arkives, Bashkia Diber deri në periudhen Dhjetor 2020.

Për periudhën 2021 dhe në vazhdim është bërë pjeserisht inventarizimi i tyre dhe po punohet për plotesimin e dokumentacionit perkates për dorëzim pranë Sektorit të Arkivë Bashkia Diber.

Në proces zbatimi

15.4. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që e gjitha praktika e zhvillimit të procedurës së prokurimit, duke filluar nga urdhër prokurimi dhe deri në lidhjen e kontratës të protokollohet në protokollin e Bashkisë Dibër dhe jo me protokoll apo regjistër të veçantë.

15.4.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë mare masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verivikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

15.5. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e titullarit të AK, të marrë masa që asnjë pjesë e projekteve të mos bëhet nga punonjës të pakualifikuar dhe të papajisur me liçencat profesionale përkatëse, sipas fushës specifike të profesionit. Në rast se nuk është mundësia për të prokuruar projektet e investimeve, të merren masa për të kontraktuar specialistë të jashtëm, të cilët të kenë kualifikimet e nevojshme për të bërë projektet, sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.5.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë mare masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verivikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

16. Gjetje nga auditimi: Për kontratat e lidhura nga Bashkia Dibër, nga vlera totale e kontratave të lidhura gjatë vitit 2020 prej 1,188,268,194 lekë është mundësuar likuidimi i vlerës 327,270,857 lekë ose 27.5% e vlerës së kontratave të lidhura dhe ka mbetur pa likuiduar vlera 860,997,337 lekë ose 72.5%. Nga vlera totale e kontratave të lidhura gjatë vitit 2021 prej **361,160,777** lekë është mundësuar likuidimi i vlerës 64,638,548 lekë ose 17.9% e vlerës së kontratave të lidhura dhe ka mbetur pa likuiduar vlera 296,522,229 lekë ose 82.1%.

Likuidimi i pjesës tjetër nuk është bërë pasi në Vendimet e KB dhe më pas në kontrata është përcaktuar likuidimi në disa vite buxhetore, e cila ka shkaktuar që kontratat të lidhen në kundërshtim me nenin 70 “Lidhja e kontratës” të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014.

Nga auditimi, u konstatua se nga ana e titullarëve të Bashkisë Dibër nuk janë ngritur komisionet për marrjen në dorëzim të punimeve dhe rrjedhimisht punimet nuk janë marrë në dorëzim, duke shkaktuar mosregjistrimin e aseteve në kontabilitet, moskthimin e garancisë së punimeve për

objektet e përfunduara dhe amortizimin e tyre para se të bëhen pjesë e inventarëve të Bashkisë Dibër.

Për objektet e financuara nga qeveria ose nga institucione të tjera, si AKUM-i, FZHR, etj., likuidimet nuk kanë përfunduar jo për faj të AK, por për mungesën e likuidimeve nga institucionet përkatëse.

Autoriteti Kontraktor, gjatë periudhës së audituar, nuk ka kryer monitorim për zbatimin e kushteve të kontratave të lidhura duke i dokumentuar me procesverbal, njëkohësisht nuk ka përgatitur e hartuar raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre, nëse është rasti. Në të gjitha kontratat e përpiluara dhe të miratuara, nuk ka të përcaktuar personin, ose strukturën organizative përgjegjëse në emër të palës, për të ndjekur realizimin e kushteve të kontratës të lidhura me kontraktorët, veprim në mospërputhje me Kreun IX “*Ekzekutimi dhe mbikëqyrja e kontratës*”, neni 77 “*Mbikëqyrja e kontratës*”, pikat 3 dhe 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, si dhe kriteri i parashikuar në kontratën e lidhur me palët, neni përkatës “*Përfaqësimi i palëve*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa që në të ardhmen, të mos bëhen prokurime pa pasur në dispozicion paraprakisht të gjitha fondet e nevojshme për realizimin e punimeve, si dhe të mos bëhen prokurime të reja pa likuiduar më parë të gjitha faturat dhe situacionet e paraqitura nga OE.

16.1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatëse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verivikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

16.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK dhe Njësia e Prokurimit në Bashkinë Dibër të marrin masa dhe të analizojnë situatën, me qëllim që në të ardhmen, nga personi ose struktura organizative e caktuar si përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor, të hartohen raporte të hollësishme për korrektësinë, cilësinë dhe realizimin e suksesshëm të kontratave të lidhura.

16.2.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete si vijon: në cdo rast është janë ngritur komisionet përkatëse si dhe janë vendosur masa disiplinore sipas rubrikës “D” të akt verivikimit. Ky rekomandim do të konsiderohet në process pasi zbatimi.

Në proces zbatimi

16.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër, në cilësinë e Titullarit të AK, të nxjerrë urdhërat për krijimin e komisioneve/grupeve të punës për monitorimin dhe marrjen në dorëzim të të gjitha objekteve për të cilat kanë përfunduar punimet, duke bërë verifikimet përkatëse për zbatimin e projekt-preventivave dhe specifikimeve teknike të miratuara, si dhe dhe të marrë masa që në ngritjen e grupeve të punës, të përcaktohen qartë detyrimet dhe përgjegjësitë për secilin anëtar, në mënyrë që objektet e ndërtruara me financim nga Bashkia, t’i shërbejnë sa më mirë dhe sa më shpejt komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.3.1.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.11.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH janë marrë masa konkrete duke ngarkuar Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave sipas objekteve që prokurohen. (Bashkëlidhur Urdhrat përkatës).

Zbatuar

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave “Blerje e Vogël” për vitet 2020-2021, Autoriteti Kontraktor Bashkia Dibërnë 5 raste ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt për blerje malli, punë dhe shërbime publike me natyrë të njëjtë, ndërsa ka nxjerrë urdhëra për prokurim me procedurë “Vlerë e vogël”, mbi vlerën e kufirit të lejuar për këtë procedurë në shumën 800,000 lekë pa tvsh, duke copëzuar fondin publik në vlerë **7,303,336** lekë dhe duke shmangur procedurat e tjera të zakonshme të prokurimit, sa më poshtë:

Për periudhën ushtrimore raportuese 2020:

- 2 urdhëra prokurimi me të njëjtën natyrë me objekte; “Blerje materiale të ndryshme ndërtimi” me fond limit të copëzuar në vlerën totale prej **1,321,000 lekë pa tvsh**, ku:

- 1 blerje për “bazë materiale për përballimin e situatave të ngricave (kripë, skorje, granil)”.

- 1 blerje për “materiale për ndërhyrjen në trotuare, Bashkia Dibër 2020”.

- 2 urdhëra prokurimi me të njëjtën natyrë me objekte; “Blerje paketa ushqimore për mbrëmje dhe për ndihmë të familjeve në nevojë” me fond limit të copëzuar në vlerën totale **1,328,000 lekë pa tvsh**, ku:

- 1 blerje për “paketa ushqimore dhe joushqimore për familjet e dhunuara, Bashkia Dibër”.

- 1 blerje për “pako për mbrëmjen qendrore Bashkia Dibër 2020”.

- 3 urdhëra prokurimi me të njëjtën natyrë me objekte: “Blerje rroba pune, materiale ngrohje dhe vegla pune” me fond limit të copëzuar në vlerë totale **1,897,000 lekë pa tvsh**, ku:

- 1 blerje për “rroba pune për Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Bashkisë Dibër”;

- 1 blerje për “soba xingato dhe soba të thjeshtë për ngrohjen e objekteve arsimore të Bashkisë Dibër” ;

- 1 blerje për “vegla pune për sektorët e shërbimeve publike të Bashkisë Dibër, 2020”.

Për periudhën ushtrimore raportuese 2021:

- 2 urdhëra prokurimi me të njëjtën natyrë me objekte; “Blerje rroba pune, materiale ngrohje” me fond limit të copëzuar në vlerën totale **1,131,970 lekë pa tvsh**, ku:

- 1 blerje për “rroba pune për Drejtorinë e shërbimeve publike të Bashkisë Dibër”;

- 1 blerje për “soba xingato dhe soba të thjeshta për ngrohjen e objekteve arsimore të Bashkisë Dibër”. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me: VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 32 “Llojet e procedurave të prokurimit”, pika 8) e nenit 40 “Procedura e prokurimit me vlerë e vogël” dhe Udhëzimi nr. 03, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 02, datë 24.04.2017, pika 1) dhe pika 3), ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimi APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla” i ndryshuar, si edhe me ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 97-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

17.1. Rekomandimi: Sektori i njësisë së prokurimit të marrë masa mbi mos përsëritjen e rasteve të copëzimit të fondeve publike, të cilat përbëjnë shkak për shmangien e procedurave të tjera të zakonshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.1.Nga verifikimi rezultoi se: Për vitin 2022 Bashkia Diber ka marrë në konsiderat rekomandimet e KLSH sipas urdhrit nr. 636 datë 07.11.2022.

Në proces zbatimi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për lejet e ndërtimit dhe të zhvillimit, u konstatuan disa anomali si vijon:

Leja e ndërtimit me nr. protokollin, datë **03.09.2021** dhe nr. aplikimi **AN030920210039**.

Objekti: Stallë për 35 gjedhë në parcelën me nr. pas. 109/22, ZK.1320, **Leje zhvillimi:** “Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr./1, datë 26/08/2021”, **Leje ndërtimi:** “Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr./1, datë 09/11/2021”, **Aplikanti:** A. B., NID G.....F, **Zhvilluesi:** P. A., NID F.....I, **Projektuesi:** A. B., NID G....5F, **Pasuria:** Zona Kadastrale 1320, me nr. pasurie 109/22 sipërfaqe 6250 m², **Vlera e Preventivit:** 6,001,492 lekë, **Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë:** 300,470 lekë,

Të dhënat e objektit, Sipërfaqe prone: 6,250 m², Sipërfaqe ndërtimi gjurmë: 360 m², Sipërfaqja mbi toke: 360 m².

Nga auditimi i lejes së sipërcituar rezultojnë problematikat si më poshtë:

Në sistemin e-leje paraqiten mendimet e Institucioneve por konstatohet se mungon dokumenti “*Vërtetim për Riskun*”, për subjektet të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi/ndërtimi i cili përfshin studimin gjeologjik, sizmik, kundër rrezatimit, studimin hidrik të zonave ku do ndërtohet.

2. Leja e ndërtimit me nr. protokolli ..., datë 08.07.2021 dhe nr. aplikimi AN080720210202.

Objekti: “*Godinë banimi dhe shërbimi 3 kat*”, Leje zhvillimi: “*Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../1, datë 13.08.2021*”, Leje ndërtimi: Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../2, datë 25.11.2021”
Aplikanti: S. S. Zhvilluesi: D. Q., Projektuesi: S. S., Pasuria: Zona Kadastrale 2592, me nr. pasurie 459 sipërfaqe 321 m² me pronarë D. Q.. Vlera e Preventivit: 7,573,695 lekë, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë: 250.536 lekë, Të dhënat e objektit: Sipërfaqe prone: 918 m², Sipërfaqe ndërtimi gjurmë: 129 m², Sipërfaqja mbi toke (m²): 321 m², Leje ndërtimi nr. 8285/2, datë 25.11.2021 i përket - Njësia Strukturore A3.1.125.

Nga auditimi i lejes së sipërcituar rezultojnë si më poshtë:

Mungon raporti dhe relacioni i vlerësimit në mjedis (V.N.M) bashkë me miratimin e vendimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në kundërshtim me ligjin 10440, datë 07.07.2011 “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*” Shtojca II: pika 10 “*Prodhime infrastrukturore*” (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale si dhe dokumenti “*Vërtetim për Riskun*”.

3. Leja e ndërtimit me nr. protokolli .../2, datë 21.06.2021 dhe nr. aplikimi AN210620210010

Objekti: “*Bujtinë 2 kat + nënçati për hoteleri agroturistike – pritëse*” Leje zhvillimi: “*Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../1, datë 28.01.2021*”, Leje ndërtimi: “*Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../2, datë 24.05.2021*”, Aplikanti: Z. M., Zhvilluesi: S. V., Projektuesi: Z. M., Pasuria: Zona Kadastrale 3509, me nr. pasurie 814/10 sipërfaqe 1,125 m² me pronarë S. V.. Vlera e Preventivit: 13,791,094 lekë, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë: 296,366 lekë. Të dhënat e objektit: Sipërfaqe prone: 11,225 m², Sipërfaqe ndërtimi gjurmë: 160 m². Sipërfaqja mbi tokë (me ballkone) (m²): 355 m², Leje ndërtimi nr. .../2, datë 24.05.2021 i përket - Njësia Strukturore B.3.364.

Nga auditimi i lejes së sipërcituar rezultojnë problematikat si më poshtë:

Në sistemin e-leje nuk paraqiten mendimet e institucioneve. Konstatohet se mungon dokumenti “*Vërtetim për Riskun*”.

4. Leja e ndërtimit me nr. protokolli ..., datë **20.03.2021** dhe nr. aplikimi **AN 200320210018**

Objekti: “*Strukturë Agro-turistike pritëse 2 kat + nënçati dhe rrethim pasurie*” Leje zhvillimi: “*Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../1, datë 07.05.2021*”, Leje ndërtimi: “*Vendimi i Kryetarit të Bashkisë nr. .../1, datë 02.07.2021*”, Aplikanti: S. S., Zhvilluesi: A. D., Projektuesi: S. S., Pasuria: Zona Kadastrale 2,592, me nr. pasurie 680/1 sipërfaqe 1,801 m², me pronar A. D.. Vlera e Preventivit: 8,273,871 lekë, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë: 286,517 lekë. Të dhënat e objektit: Sipërfaqe prone: 1801 m², Sipërfaqe ndërtimi gjurmë: 136 m², Sipërfaqja mbi toke (me ballkone) (m²): 343 m² Leje ndërtimi nr. .../1, datë 02.07.2021 i përket - Njësia Strukturore B.2.538. Nga auditimi rezulton se në sistemin e-leje mungojnë mendimet e Institucioneve dhe dokumenti “*Vërtetim për Riskun*”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 165-171 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që të reflektohen sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse të dhëna gjatë opionencës teknike të projektit, në lidhje me ndikimin potencial në mjedis të zonës ku do të zbatohet projekti si dhe në vazhdimësi të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur të reflektohen të gjitha mendimet e institucioneve përkatëse sipas kriterëve që kërkohen.

Menjëherë dhe në vijimësi

18.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit nuk na u vu në dispozicion dokumentacioni justifikues në lidhje me rekomandimin e sipërcituar.

Pa zbatuar

19. Gjetje nga auditimi: Bashkia Dibër është audituar nga KLSH në vitin 2021 dhe në vijim, por nga auditimi konstatohet se njësia vendore nuk ka marrë masa të plota për realizimin e të gjitha rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Nga 14 masa organizative të lëna për zbatim, nuk janë zbatuar 14 prej tyre. Nga 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën **11,230,470** lekë nuk është kontabilizuar e gjithë vlera, dhe nuk janë realizuar arkëtimet. Në zbatim të rekomandimeve të KLSH, Agjencia e Prokurimit Publik nuk është dërguar vendim, në të cilin duhej të merrej masë administrative për punonjësit e atakuar në auditimin e mëparshëm.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 171-198 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

19.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdohet ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara dhe të përshpejtohet zbatimi i tyre. Drejtoria juridike të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerave për shpërblim dëmi prej 11,230,470 lekë, të lëna nga KLSH.

Menjëherë dhe në vijimësi

19.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara në Bashkinë Dibër nga KLSH me shkresën nr. 371/9 datë 25.10.2022 protokolluar në bashkinë Dibër nr. 4952 datë 26.10.2022 për masat shpërblim dëmi rezulton se bashkisë i janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi. Gjendja e tyre aktualisht paraqitet si vijon:

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të merren masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **8,494,504 lekë**, sipas subjekteve në vijim:

- Subjekti "A." ShPK & "B." ShPK, për vlerën 3,074,174 lekë;
- Subjekti "L." ShPk, për vlerën 2,386,410 lekë;
- Subjekti "L." ShPK, për vlerën 88,425 lekë;
- Subjekti "H." ShPK për vlerën 2,945,495 lekë

Menjëherë

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Bashkisë Dibër, janë dërguar shkresa nr.127 prot datë 17.01.2022 subjektit "A." shpk "kërkesë për shlyerje detyrimi". Nga ana e subjektit është bërë kthim përgjigjja datë 23.02.2022.

Është dërguar shkresa nr.128 prot, datë 17.01.2022 subjektit L. Shpk, "kërkesë për shlyerje detyrimi financiar".

Është dërguar shkresa nr.130 prot datë 17.01.2022 subjektit H. Shpk, "kërkesë për shlyerje detyrimi financiar". Nga ana e subjektit është bërë kthim përgjigjja me shkresën nr.02 prot, datë 28.01.2022.

Është dërguar shkresa nr.131/1 prot, datë 14.02.2022 subjektit "L.", "kërkesë për shlyerje detyrimi". Nga ana e subjekti është bërë kthim përgjigjje nr.46 prot datë 28.02.2022.

Pas marrjes së përgjigjeve nga ana e subjekteve është bërë likuidimi i vlerës datë 10.07.2023.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **1,151,623 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve "S." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019, me objekt "Sistemim Asfaltim i rrugës së fshatit Melan, Nj.A Melan Bashkia Dibër", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr.1682 prot, datë 19.05.2022 subjektit OE "S." SHPK, i është dërguar njoftimi "kërkesë për shlyerje detyrimi". Nga ana e subjekti është kthyer

përgjigje me shkresën nr 19/1 prot datë 31.05.2022 ku nuk ka rënë dakord me vlerën e detyrimit të konstatuar.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **336,610 lekë pa TVSH**, nga OE “R.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 48/9 prot., datë 20.11.2018, me objekt “Rikonstruksion i godinave në pronësi të Njësisë të Qeverisjes Vendore për strehim social”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Me shkresën nr.1681 prot, datë 19.05.2022 subjektit OE “R.” ShPK, i është dërguar njoftimi “kërkesë për shlyerje detyrimi”. Nga ana e subjekti nuk është kthyer përgjigje deri në momentin e verifikimit*

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Dibër dhe Drejtoria Juridike të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **250,150 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve “E.” ShPK & “S.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 35/13 prot datë 01.08.2019, me objekt “Sistemim Asfaltim i lagjes Llixha-Banjë-Bunisht, NjA Peshkopi”, Bashkia Dibër, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Me shkresën nr.1679 prot, datë 19.05.2022 subjektit “E.” ShPK & “S.” ShPK, i është dërguar njoftimi “kërkesë për shlyerje detyrimi”. Nga ana e subjekti nuk është kthyer përgjigje deri në momentin e verifikimit.*

5.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërbllimin e këtij dëmi nëbshumën **129,600 lekë**, nga sipërmarrësi i punimeve “E.” SHPK.

Menjëherë

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Me shkresën nr.1680 prot, datë 19.05.2022 subjektit “E.” SHPK, i është dërguar njoftimi “kërkesë për shlyerje detyrimi”. Nga ana e subjekti nuk është kthyer përgjigje deri në momentin e verifikimit.*

Sa më sipër, në bazë të rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit në lidhje me subjektet e sipërpërmendura të cilat i kane shkaktuar dëm ekonomik njësisë vendore si pasojë e likuidimeve të punimeve të pakryera nga sektori juridik janë nisur njoftimet subjekteve debitore si dhe është njoftuar sektori i prokurimeve prokurimeve në lidhje me pjesën e debitore. Afati i përcaktuar nga KLSH për zbatimin e këtyre rekomandimeve ka qenë menjëherë. Sektori juridik, është mjaftuar vetëm njoftime për ekzekutim vullnetar dhe duhet të ndjek procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimit.

Zbatuar pjesërisht

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat e familjarëve është në vlerën 15,550,000 lekë, ndërkohë që realizimi është në vlerën 4,871,643 lekë ose 31%.

Nga auditimi i detyrimeve të popullatës, rezultoi vlera debitore **25,793,372 lekë** (7,829,438lekë taksa e ndërtesës + 13,652,334 lekë tarifa e pastrimit + 4,311,600 lekë tarifa e ndriçimit), e cila

përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave të familjarëve të bashkisë Dibër deri në datën 31.12.2021. Diferenca e faktit nga plani për vitin 2021 është në vlerën 10,678,357 lekë.

Taksa e tokës në vitin 2021 është realizuar në masën 12%.

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 421 familje, për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës por nuk është arkëtuar. Nga auditimi i taksës së tokës bujqësore, deri në datën 31.12.2021 rezultoi vlera debitore **9,176,356 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër. Diferenca e faktit nga plani për vitin 2021 është në vlerën 690,052 lekë.

Këto vlera detyrimesh të papaguara janë të pakontabilizuara sipas personave debitorë.

Sa më sipër, është në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masapër të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Dibër dhe Qarku Dibër). Për familjet fermere debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **9,176,356 lekë** dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

1.1.1. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Nga ku rezulton se me shkresat nr. 4742 datë 13.10.2022 i është kërkuar informacion njësisive administrative për përditësuar e regjistrin të familjeve që disponojnë tokë bujqësore. Deri në momentin e verifikimit nuk kanë kthyer përgjigje.

Në proces zbatimi/

1.2. Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Dibër, të marrë masa për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **25,793,372 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.1. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Deri në momentin e verifikimit shtate ngelet e pa ndryshuar

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrin të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i zhvillimit ekonomik në Bashkinë Dibër, rezultoi se ka 278 subjekte debitorë nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie e kamatëvonesat përkatëse), nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu fund të vitit 2020 numri i debitorëve ishte 150 subjekte në vlerën 4,075,003lekë, ndërsa në fund të vitit 2021 numri i debitorëve ishte 278 subjekte në vlerën progresive **9,957,563 lekë**, (8,164,115 lekë detyrim + 1,763,448 lekë kamatëvonesat) e cila përfaqëson taksat dhe tarifave vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Dibër. Për vitin 2021 borxhi tatimor është në vlerën

5,002,360 lekë.

Referuar pasqyrave si më sipër dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga DTTV konstatohet se nuk disponohen të dhëna të plota dhe të sakta të debitorëve që në krijimin e tyre sipas llojit të taksave, pasi debitorët e krijuar para vitit 2019, duke filluar nga viti 2011 janë mbajtur në programin Excel i cili është mbajtur në listim subjektsh debitore me shumë progresive të debisë deri në fund të 2018, pa analizë detyrimesh sipas llojit të taksave të ngarkuara për çdo subjekt.

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitore, strukturat tatimore të Bashkisë Dibër, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë, duke vepruar në mospërputhje ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, neni 93 dhe 94. Gjithashtu nga strukturat tatimore të Bashkisë Dibër, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH” me ndryshime neni 181, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Bashkia Dibër, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj subjekteve debitore në vlerën **9,957,561 lekë** (sipas Pasqyrave në Anekset e Raportit Përfundimtar të Auditimit), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare, bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Dibër, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Për vitin 2022 me shkresën 4742/1 datë 13.10.2022 janë bërë njoftimi dhe kërkesa për pagesën e taksave dhe tarifave vendore të gjithë subjekteve debitorë në fraksion të kësaj shkrese. Dhe me shkresën nr. 5210 datë 09.11.2022 I është dërguar urdher bllokimi për llogarit bankare të subjekteve debitore. Nga vlera e rekomanduar është arkëtuar vlera 1,996,125 lekë për vitin 2022 si efekt i detyrimeve të prapambetura dhe është shtuar vlera 5.235,170 lekë. Në fund të vitit ushtrimor 2022 gjendja debitore paraqitet në vlerë 13,166,608 lekë, si vijon:

Nr	Emërtimi	Periudha Krijimit	PERIUDHAT				
			Gjendja ne 31.12.2021	Kamatevonesa	Shtesat viti 2022	Paksimet viti 2022	Gjendja ne 31.12.2022
1	Debitore subjektet e medha 31.12.1019	2015-2019	700,338		183,150		883,488

2	Debitore subjektet evogla NJA Peshkopi	2015-2019	5,473,387		4,301,450	1,768,305	11,543,142
3	Debitore subjektet evogla NJ. Administrative	2015-2019	1,990,390		750,570	227,820	2,968,780
4	TOTALI		8,164,115	1,763,448	5,235,170	1,996,125	13,166,608

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2021 është realizuar në shumën 18,720,797 lekë nga 10,000,000 lekë të planifikuara ose në masën 187%.

Deri në 31.12.2021, janë dhënë 198 leje legalizimi, për sipërfaqen ndërtimore 45,149.41 m², e cila rezulton se ka gjeneruar një debi në vlerën 7,523,047 lekë.

Për vitin 2021 janë dhënë 68 leje legalizimi për sipërfaqen ndërtimore 15,257.28 m², e cila rezulton se ka gjeneruar një debi në vlerën 2,567,760 lekë.

Nga Drejtoria e planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit, Bashkia Dibër, nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 27, pika 2/1 dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Dibër, në vlerën totale **10,090,807 lekë**.

Drejtoria e planifikimit, kontrollit dhe zhvillimit të territorit nuk ka zhvilluar rregullisht korespondencë zyrtare dhe nuk ka patur komunikim me ZVRPP Dibër sot Agjencia Shtetërore Rajonale e Kadastrës Dibër (perfshi ish-ALUIZNI dhe ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për ti propozuar për lidhjen e një aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Dibër dhe ASHK Rajonale Dibër, me qëllim që ky institucion të bëhet barrikadë për mosdhënien e lejeve të legalizimeve dhe çertifikatave të pronësisë subjekteve private pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, me VKM-në nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, pika 2/1 dhe VKB vjetore përkatëse për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Dibër.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Bashkia Dibërnëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Dibër, që të mos lëshojë dhe të pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Dibër. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe administrimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet në vlerën totale **10,090,807 lekë**, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Pasqyrat A20, A21, A22 dhe A23, bashkëlidhur Projekt Raportit Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Nga ku rezulton se me shkresën nr. 1802 datë 25.05.2022 është dërguar lista e personave debitor.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i taksave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se aktualisht në Bashkinë Dibër ushtrojnë aktivitetin 18 subjekte të cilat tregtojnë hidrokarbure, karburante.

Për subjektet “S.” ShPK, “A.” ShPK, “K.” ShPK, “B.” ShPK, “M.” ShPK, “O.” ShPK, “H.” ShPK dhe “A.” ShPK, është llogaritur pagesa në masën 200,000 deri në 400,000 lekë, për një periudhë 1 vjeçare, gjë që është e gabuar, pasi në VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, përcaktohet se vlera e licencimit është taksative 1,000,000 lekë, për një periudhë maksimale prej 5 vjetësh. Pra, nëse nga autoriteti vendor përcaktohet kohëzgjatja e licencës së tregtimit ndërsa pagesa nuk ndryshon.

Nga auditimi i pagesave për pajisjen me licenca për tregtimin e hidrokarbureve, u konstatua se për 18 subjekte nuk është tarifuar e plotë vlera e detyrimit të licencës, për shkak të ndarjes në pjesë të pagesës totale, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Dibër në vlerën **5,200,000 lekë**.

Sa më sipër, është në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 51-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Dibër, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej **5,200,000 lekë**, sipas Aneksive bashkëlidhur Projekt Raportit të Auditimit, Pasqyra A24. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2. Nga verifikimi rezultoi se: Referuar urdhrin nr. 636 datë 07.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është ngarkuar sektori i taksave dhe Tarifave Vendore për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Nga vlera e rekomanduar prej 5,200,000 lekë deri më datë 28.12.2022 është arkëtuar vlera prej 800,000 lekë dhe k angel pa u arkëtuar vlera prej 4.400,000 lekë si vijon;

Nr.	Subjekti	Nipt	Afati i Autorizimit		Detyrimi për autorizimin	Pagesat e kryera	Diferenca
			Fillimi	Mbarimi			
1	“S.”	J.....E	12/5/2021	11/5/2025	1,000,000	1,000,000	0
2	“D.” Shpk	K.....C	14/09/2021	1/7/2025	1,000,000	1,000,000	0
3	“M.” Sh.p.k	J.....N	22/06/2021	21/06/2025	1,000,000	1,000,000	0
4	“K.” Sh.p.k	J.....P	5/3/2021	5/3/2025	1,000,000	1,000,000	0
5	“K.” Sh.p.k	J.....P	14/06/2021	12/6/2025	1,000,000	1,000,000	0
6	“G.” shpk	K.....T	24/03/2021	23/03/2026	1,000,000	1,000,000	0
7	“D.” shpk	J.....B	10/3/2021	9/3/2025	1,000,000	1,000,000	0
8	“S.” shpk	K.....V	17/06/2021	26/06/2023	1,000,000	600,000	400,000
9	“A.” shpk	L.....S	3/8/2020	2/8/2021	1,000,000	200,000	800,000
10	“K.” shpk	J.....M	13/09/2021	12/9/2022	1,000,000	400,000	600,000
11	“B.” shpk	J.....J	16/09/2021	15/09/2022	1,000,000	400,000	600,000
12	“M.” shpk	J.....J	19/07/2021	18/07/2022	1,000,000	400,000	600,000
13	“O.” shpk	L.....K	24/06/2021	24/06/2023	1,000,000	800,000	200,000
14	“H.” shpk	L.....P	4/10/2021	3/10/2022	1,000,000	400,000	600,000
15	“A.” shpk	J.....H	19/07/2022	18/07/2023	1,000,000	400,000	600,000

16	"T."shpk	K.....P	17/02/2020	16/02/2025	100,000	100,000	0
17	"I."shpk	K.....V	3/8/2020	2/8/2025	100,000	100,000	0
18	R. X.	K.....P	19/03/2021	18/03/2026	100,000	100,000	0
SHUMA					15,300,000	10,900,000	4,400,000

Burimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore

Në proces zbatimi

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 "Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së", shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil", i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dibër, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Sipas urdhrin nr 636 datë 07.11.2022 janë ngarkuar personat përgjegjës si dhe është bere verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH, dhe sipas shkresave të poshtcituara është vendos masë disiplinore "Vrejtje" si me poshtë:

Lista analitike e masave te rekomanduara dhe zbatuara

	Emri Mbiemri	Pozicioni Zyrtar	Rekomandimi i KLSH dhe I APP	Masa e zbatuar	
				Shkresa apo vendimi nr data	Lloji i masës së zbatuar
1	L. C.	Drejtori i Drejtorisë Ekonomike	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.524 dt 07.12.2022	Vërejtje
2	M. S.	Përgjegjës i Sektorit të Financës	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.525 dt 07.12.2022	Vërejtje
3	B. M.	Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.518 dt 07.12.2022	Vërejtje
4	E. P.	Specialist në sektorin e tatim-taksave	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.517 dt 07.12.2022	Vërejtje
5	M. G.	Specialist në sektorin e tatim-taksave	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.520 dt 07.12.2022	Vërejtje
6	R.G.	Specialist i Rakordimit në sektorin e tatim-taksave	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.519 dt 07.12.2022	Vërejtje
7	I. S.	Përgjegjës i Njësisë Prokurimit dhe anëtar i KVO-së	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.526 dt 07.12.2022	Vërejtje
8	E. S.	specialist pranë DPZHT	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.523 dt 07.12.2022	Vërejtje
9	R. K.	Anëtar i Njësisë Prokurimit dhe Kryetar/Anëtar i KVO-së	<i>Rekomanduar ne kompetence te titullarit</i>	Nr.527 dt 07.12.2022	Vërejtje

1. Z. L. C., në funksion Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa "Vërejtje" me Nr.524 dt 07.12.2022.

2. Z. M. S., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa "Vërejtje" me Nr.525 dt 07.12.2022.

3. **Z. B. M.**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.518 dt 07.12.2022.
4. **Z. E. P.**, me detyrë Specialist në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.517 dt 07.12.2022.
5. **Z. M. G.**, me detyrë Specialist në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.520 dt 07.12.2022.
6. **Z. R. G.**, me detyrë Specialist i Rakordimit në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.519 dt 07.12.2022.
7. **Z. I. S.**, me detyrë Përgjegjës i Njesisë Prokurimit dhe anëtar i KVO-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.526 dt 07.12.2022.
8. **Z. E. S.**, ish/specialist pranë DPZHT, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.523 dt 07.12.2022.
9. **Z. R. K.**, në cilësinë Anëtar i Njesisë Prokurimit dhe Kryetar/Anëtar i KVO-së Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr.527 dt 07.12.2022.
10. **Z. E. M.**, në cilësinë Anëtar i KVO-së dhe KBVV-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr prot 528 dt 07.12.2022.
11. **Z. F. Z.**, Anëtar i Njesisë Prokurimit dhe KVO-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 529 dt 07.12.2022.
12. **Znj. B. M.**, në cilësinë Anëtare e Njesisë Prokurimit dhe Kryetare/Anëtare e KVO-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 522 dt 07.12.2022.
13. **Z. F. M.**, për llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të veçanta në një procedurë; Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 533 dt 07.12.2022.
14. **Z. A. D.**, për llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të veçanta në një procedurë; Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 531 dt 07.12.2022.
15. **Z. M. M.**, në cilësinë Anëtar i Njesisë së Prokurimit dhe KSHA-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr prot 521 dt 07.12.2022.
16. **Z. B. S.**, me detyrë ish/Drejtor i DPZHT, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me
17. **Znj. E. L.**, me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Juridik, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 530 dt 07.12.2022.

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Dibër**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. **Znj. D. B.**, ish/zv. Kryetare Bashkie, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr prot 541 dt 07.12.2022
2. **Znj. V. L.**, Specialiste Juriste, konceptuese e rregullores së brendshme, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm; Nga verifikimi rezultoi se:.....
3. **Z. D. A.**, me detyrë Specialist në sektorin e tatim-taksave, p Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 537 dt 07.12.2022.
4. **Znj. M. B.**, me detyrë Specialiste në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 536 dt 07.12.2022.
5. **Z. O. I.**, me detyrë Specialist në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 535 dt 07.12.2022.
6. **Znj. M. H.**, me detyrë Punonjëse e hedhjes së të dhënave në sistem, në sektorin e tatim-taksave, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 538 dt 07.12.2022.
7. **Z. Q. S.**, në cilësinë Anëtar i KVO-së dhe KBVV-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 534 dt 07.12.2022.
8. **Z. M. D.**, Anëtar i Njësisë Prokurimit, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me Nr prot 542 dt 07.12.2022.
9. **Z. F. T.**, Anëtar i Njësisë Prokurimit, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me N r prot 540 dt 07.12.2022.
10. **Znj. M. L.**, Anëtare e KVO-së. Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 532 dt 07.12.2022.
11. **Z. O. Ç.**, në cilësinë Anëtar të KBVV-së, Nga verifikimi rezultoi se për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit u vendos masa “Vërejtje” me nr prot 539 dt 07.12.2022.

Zbatuar

Përmbledhëse e Masave Disiplinore dhe Administrative

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

Nr	Lloji i masës rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar
a	b	1	2	3
2	Vërejtje me shkrim	28	28	
	Gjithsej	28	28	

Sa sipër nga 28 masa të rekomanduara gjithsej nga KLSH, rezulton se janë zbatuar 27 masa dhe nuk është zbatuar nje mase pasi personi i cituar ne raport nuk eshte ne marrëdhënie pune ne Bashkine Diber.

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Dibër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Dibër 28 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 4 masë organizative, janë në proces zbatimi 16 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa si dhe nuk janë zbatuar 6 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Rekomandimi 7.1: Bashkia Dibër, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet dhe familjarët, tarifat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë, të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Dibër, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Menjëherë

2. Rekomandimi 7.2: Bashkia Dibër, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Dibër ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Menjëherë

3. Rekomandimi 9.1: Drejtoria Ekonomike dhe Financës të bëjë sistemimin e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” duke shpërndarë vlerën e secilit projekt sipas investimeve të kryera.

Menjëherë

4. Rekomandimi 10.1: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”; 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*” dhe 215 “*Mjete transporti*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

Menjëherë

5. Rekomandimi 11.1: Drejtoria e Financës, të marrë masa për analizimin e saktë dhe sistemimin e vlerave të këtyre llogarive, duke i saktësuar përkatësisht sipas posteve në bilancin kontabël.

Menjëherë

6. Rekomandimi 12.1: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera, për të cilat subjektet përkatëse kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Dibër për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik. Për ato subjekte, të cilat kanë përmbushur detyrimet kontraktuale dhe është plotësuar afati i garancisë së punimeve, të bëhet likuidimi i vlerës të garancisë së fondeve.

Menjëherë

7. Rekomandimi 18.1: Titullari i Bashkisë Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që të reflektohen sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse të dhëna gjatë opionencës teknike të projektit, në lidhje me ndikimin potencial në mjedis të zonës ku do të zbatohet projekti si dhe në vazhdimësi të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur të reflektohen të gjitha mendimet e institucioneve përkatëse sipas kriterëve që kërkohen.

Menjëherë

8. Rekomandimi 19.1: Kryetari i Bashkisë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdohet ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara dhe të përshpejtohet zbatimi i tyre. Drejtoria juridike të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerave për shpërblim dëmi prej 11,230,470 lekë, të lëna nga KLSH.

Menjëherë

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Dibër ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara si dhe përshpejtimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi.

Menjëherë

Aneksi i zbatimi i rekomandimeve në Bashkinë Dibër, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	28	28	4	2	16	6
Masa për 3E në të ardhura (Nr.)	5	5	-		5	
Masa për 3E në të ardhura (vlerë)	60,218,096	60,218,096			60,218,096	
Masa Disiplinore/Administrative	28	28	28			

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Klos: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORT I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.07.2022 DERI
31.01.2023, BASHKIA KLOS”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-19
	<i>Drejtimit e Auditimit.....</i>	4
	<i>A.Masa Organizative.....</i>	4-12
	<i>B. Masa Shpërblim Dëmi</i>	12-14
	<i>B.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efincë dhe efektivitet të fondeve publike.....</i>	14-16
	<i>C.Masa Disiplinore.....</i>	16-18
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	18-19

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 629/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Klos, më datë 28.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. H. I., z. S. H. dhe Z. V. S., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Klos rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 882/9 datë. 23.01.2023, ndërsa nga Bashkia Klos për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2567/37 Prot., datë 01.02.2023. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Klos është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2567/38 datë. 01.02.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.
- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 882/9 prot., datë. 23.01.2023 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 23.07.2023. Nga ana e Bashkisë Klos është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 2567/42 prot., datë 20.07.2023. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 14 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 14 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 6 dhe është zbatuar pjesërisht 1 masa.

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 737,636 lekë, deri me datë 28.07.2023 janë arkëtuar 2 masa në vlerë 302,736 lekë si dhe janë nisur njoftimet për likuidimin vullnetar të detyrimit për 2 subjekte në vlerë 434,900 lekë.

Për masat shpenzim në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohen 5 masë në vlerën 61,725 mijë lekë, nga e cila është arkëtuar vlera 1,477 mijë lekë, është në proces vlera 60,247 mijë lekë.

Për masat disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Klos dhënia e masës disiplinore ndaj 5 personave masa të cilat janë zbatuar.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 23.01.2023 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Klos, sipas programit të auditimit nr. 629/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. H. I., përgjegjës i grupit;
2. S. H. , anëtar,
3. V. S., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 882/9 prot., datë. 23.01.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Klos në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 882/9 prot., datë. 23.01.2023, rezulton se nga **29** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **26** masa ose 89.6% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **3** masa ose 11.4% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 80%, nga ana e Bashkisë Klos, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Klos rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 882/9 datë. 23.01.2023, ndërsa nga Bashkia Klos për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 2567/37 Prot., datë 01.02.2023. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë **brenda 20 ditësh**, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Klos është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2567/38 datë. 01.02.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Klos, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 882/9 datë. 23.01.2023 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 23.07.2023.

Nga ana e Bashkisë Klos është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 2567/42 prot., datë 20.07.2023. Pra është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH janë respektuar kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, ku përcaktohet se: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Klos ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 2567/38 prot., datë. 01.02.2023, **dhe ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

Zbatuar

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar

për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Klos 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masë organizative, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Sektori i Financës në procedurën e kontabilitetit nuk ka mbajtur librin e madh apo librin centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 43-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

1.1.Rekomandimi: Sektori i Financës të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare, duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve, që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Në fund të kryejë saktë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke i evidentuar në librin e madh apo centralizator dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Me shkresën nr. 1054 prot datë 09.03.2023 janë dërguar pasqyrat financiare Degës së Thesarit Mat, protokolluar në degën e thesarit me shkresën nr. 159 datë 30.03.2023 sektori i Financës ka mbajtur ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, ta cilat duhet të jenë të balancuara dhe në përputhje me funksionin e tyre. Është në proces evidentimi në librin e madh apo centralizator dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e gjendjes llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2021 prej 45,732,902 lekë, që i përgjigjet vlerës së 49 projekteve, ku 1 projekt në vlerën 498,000 lekë është projekt i vitit 2021, 10 projekte në vlerën 9,669,382 lekë i përkasin investimeve në proces të filluara që nga vitet 2020, ndërsa për vlerën e mbetur në fund të vitit 2021 prej 35,565,520 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale për 38 projekt-studime për investime të pa kryera nuk është llogaritur amortizim në masën 15%, ndërkohë që këtyre projekt-studimeve, duke mos gjetur zbatim në vitin e hartimit u ka kaluar koherenca. Për këtë vlerë

ekziston inventar kontabël, por nuk ka inventar fizik. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II, pika 16/b.d, Kreu III pika 36, Aneksi 1 pika 2 klasa 2, me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kreu III. pika 26, 27,30, Kreu IV. pika 73,74,78. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 51-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

2.1 Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Klos të kryejë inventarin fizik të aktiveve afatgjatë jo materiale “studim-projektme” të blera gjendje në llog. 202 “Studime dhe Kërkime”, të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet kontabël përkatëse.

Deri me datë 31.04.2023

2.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Me shkresën nr. 1054 prot datë 09.03.2023 janë dërguar pasqyrat financiare Degës së Thesarit Mat nga ku rezultoi se sektori i financës në Bashkinë Klos ka bërë sistemimin e llog. 202 “Studim-projektme” dukë e pakësuar në vlerën 5,211,113 lekë e përbërë nga 4 projekte të cilët janë shtuar llogarive përkatëse në aktiv të bilancit, respektivisht në llog 212 dhe 213.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit publik për procedurat “Shërbim konsulence” me objekt “Ndërtim KUZ në Fshatin Kurdari (Hurdhë)” dhe “Sistemimi i Rrethimit të Varrezave të qytetit”, janë vendosur kritere të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme në hartimin e kriterëve të veçanta të DST, bien në kundërshtim me kërkesat e, nenit 26, pika 5, neni 27, neni 61 pika 2 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe neni 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që të kenë lidhje të ngushtë me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Kryetari i Bashkisë Klos ka analizuar arsyet dhe ka nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST ku sipas urdhrin nr. 32 datë 08.02.2023 është ngritur Komisioni Disiplinor dhe ka bërë verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH duke vendosur dhe masë disiplinore. Gjithashtu Njësia e prokurimit në procedurat e zhvilluara ka vendosë kritere të veçanta për kualifikim, që kanë lidhje të ngushtë me volumin dhe natyrën e objektit që prokurohet.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të prokurimit publik, u konstatua se nuk është kryer Oponenca Teknike e objekteve të ndërtimit “Ndërtim KUZ në Fshatin Kurdari (Hurdhë)” dhe “Sistemimi i Rrethimit të Varrezave të qytetit”, në kundërshtim me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4, faqe 68-76; të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos të marrë masa që të gjitha objektet që prokurohen si “punë publike”, të pajisen me oponencën teknike para fillimit të procedurës së prokurimit, me qëllim që të jenë konformë standardeve të projektimit, për të patur objekte cilësore dhe që tu shërbejnë sa më mirë komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2.Nga verifikimi rezultoi se: Referuar planit të veprimit të sipërcituar kryetari i bashkisë ka ngarkuar sektorin e Investimeve që për objektet që prokurohen si “punë publike”, të pajisen me oponencën teknike para fillimit të procedurës së prokurimit.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin e Inspektoriatit të Mbrojtjes Territorit Vendor (MTV) mbi kontrollin e territorit për ndërtimet pa leje, rezulton se për objektin “ Banesë familjare në pronësi të Y. T., është mbajtur proces verbal konstatimit nr. 18, datë 12.02.2021, duke mos marrë asnjë masë tjetër në vijim, si dënim me gjobë etj.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 52 të ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 104-105 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

5.1. Rekomandimi: Inspektoriatit të Mbrojtjes Territorit vendor (MTV) të vlerësojë me saktësi kundërvajtjet e konstatuara gjatë kontrolleve në terren dhe në vazhdimësi të aplikojë masën e duhur të gjobës në përputhje me llojin e kundërvajtjes së identifikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2. Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Bashkia Klos referuar proces verbal konstatimit nr. 18, datë 12.02.2021 të mbajtur me z. Y. T. nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër pasi çështja është referuar në prokurori dhe z. Y. T. ka kthyer në gjendjen e mëparshme objekt terrenin.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e mbuluar me auditim nuk është paguar në mënyrë vullnetare asnjë nga gjobat e vendosura nga IMTV. Gjobat e vendosura në vitin 2021 nuk janë paguar brenda afateve ligjore. IMTV ka njoftuar subjektet kundërvajtës dhe ka njoftuar Kryetarin e Bashkisë dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve Financiare. Kryeinspektori nuk ka dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për secilën gjobë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 30 pika 1 pika 3 dhe pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën nr.7, faqe 105-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

6.1 Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme. Kryeinspektori të dërgojë në gjykatë vendimet për-nxjerrjen e titujve ekzekutiv për gjobat e vendosura.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i IMT për shkeljet e konstatuara dhe dënimin me gjobë të kundërvajtësve dhe në pamundësi të shndërrimit të gjobës në titull ekzekutivë i është drejtuar Drejtorisë Juridike më shkresat përkatëse për vazhdimin e procedurave të shndërrimit të gjobës në titull ekzekutivë.

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve të kontratave me objekte: “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse” dhe “Ndërtim KUZ në fshatin Kurdari (Hurdhë)” u konstatua se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Klos, nuk ka miratuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore për projektin e zbatimit. Ky veprim është në kundërshtim me Nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe neneve 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar. Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e AK Bashkisë Klos.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 85-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të marrë masa që të pajisin me Leje Ndërtimi Infrastrukturore për çdo projekt zbatimi sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Klos ka hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2567/38 datë. 01.02.2023 dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Klos nuk ka marrë masa të plota për eliminimin e risqeve buxhetore nga mos likuidimi në kohë i detyrimeve ndaj të tretëve. Për këtë arsye janë krijuar detyrime të prapambetura, me të cilat në datën 31.12.2021 kanë vlerën progresive 52,760,736 lekë, prej së cilës vlera 12,707,217 lekë, është krijuar si detyrim vetëm gjatë vitit 2021. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101 “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 33-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Klos me shkresën nr. 552/1 datë 17.02.2023 ka dërguar në MFE monitorimin e zbatimit të buxhetit të 12 mujor të vitit 2022 ku vlera e detyrimeve të prapambetura është në masën 7.01% të totalit të shpenzimeve të miratuara, në vlerë nominale 23,869 mijë lekë.

Zbatuar pjesërisht

9. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të paraqitura për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore rezulton të jetë i ulët në Bashkinë Klos për vitin 2021, pasi realizimi është në masën 69%, nga 53,497 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 36,678 mijë lekë. Ky veprim në kundërshtim me VKB nr. 80, datë 24/12/2020 “Për miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Klos” konfirmuar në Prefekturë me nr. 37/1Prot., datë 11.01.2021. Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; datë 27.02.2019 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 35-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

9.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos të angazhohet gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.2.Nga verifikimi rezultoi se: Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 59 datë 24.12.2023 është miratuar buxheti i vitit 2022, nga ku rezulton se të ardhurat e vetë bashkisë janë realizuar në masën 54%, nga 70,000 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 38,075 mijë lekë.

Në proces zbatimi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve rezultoi se nuk janë zbatuar plotësisht masat e kërkuara nga KLSH-ja me shkresën nr. 865/15 prot., datë 10.01.2022 dhe, konkretisht:

- Janë rekomanduar 12 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 9 prej tyre, 2 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë organizative nuk është zbatuar.

- Është rekomanduar 1 masë për eliminimin e efekteve dhe rezulton se është zbatuar.

-Janë rekomanduar 6 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 3 prej tyre, dhe 3 masa nuk janë zbatuar.

Veprimet e mësipërme janë në shkelje të nenit 15, shkronja (j) dhe nenit 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit” dhe shkresën nr. 865/15 prot., datë 10.01.2022 “Për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Klos”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 103-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Klos të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. 865/15 prot., datë 10.01.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë projekt raport auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit”.

Menjëherë

10.2.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Klos ka marre masa për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. 865/15 prot., datë 10.01.2022, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë projekt raport auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit”.

Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NJAB Klos përgjatë periudhës 2021, u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

- NjAB ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Në dosje nuk ka plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për 6 – mujorin para ardhës e cila plotësohet nga njësia publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari jo me vonë se 20 ditë pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i dërguar njësisë, në kundërshtim kjo me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.

-Për vitin 2021, në Bashkinë Klos, është kryer Zbatimi i Rekomandimeve (detyrat e lëna), të vitit paraardhës, por nuk është kryer për 6-mujorin paraardhës nga Sektori i Auditit të Brendshëm.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 për “Ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

11.1. Rekomandimi:

Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Klos, të marrë masa për :

-hartimin e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për 6 – mujorin paraardhës, për plotësimin e dokumentacionit dhe kërkesave, në dosjet e auditimit, që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, si dhe për krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.2.Nga verifikimi rezultoi se; Sektori i Auditit të Brendshëm me shkresën nr. 215 prot. datë 17.01.2023, ka planifikuar dhe realizuar verifikimin e realizimit të rekomandimeve të lëna në përfundim të anagazhimeve të auditimit për 6 – mujorin e parë të vitit pasardhës dhe plotësimin e kërkesave në dosje sipas Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Gjithashtu lidhur me rekomandimin për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rezulton se Ligji 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ka ndryshuar me ligjin Nr. 12, datë 2.02.2023 “Për disa ndryshime e shtesa në ligjin 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Neni 13 “Komiteti i Auditimit”, është riformuluar dhe pika 3 e këtij ligji shprehimisht citon: “Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për financat”. Akoma nuk ka një Vendim të Këshillit të Ministrave në funksion të kësaj pike të nenit 13 të ligjit të ndryshuar.

Zbatuar

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

-Në strukturën e Bashkisë së Klos nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.164 datë 05.10.2017; si dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) nënkategori të ndryshme si: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjin nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ë; Ligjin nr.15/2019 dt.13.03.2019“ Për Nxitjen e Punësimit” neni 3 pika 4 “Grupe të veçanta” (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika 3.

-Bashkinë Klos për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri 31.12.2021 nuk ka hartuar Regjistër i Riskut. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, të bëjë të mundur planifikimin e pozicioneve me status “ekselent”, për punonjësit e rinj që mund të rekrutohen në bashkinë Klos.

12.1/1.Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Klos dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore, në planifikimin e strukturës së radhës do planifikojë pozicione me status “ekselent”, për punonjësit e rinj që mund të rekrutohen në Bashkinë Klos.

Zbatuar

12.2 Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa për hartimin e regjistrit të riskut.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.2.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Me shkresën nr. 793 prot., date 27.02.2023 është hartuar Plani i Veprimit per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe është dërguar në Minsitrine e Financave dhe Ekonomisë dhe me shkresën nr. 1488 prot., date 13.06.2023 është miratuar Strategjia e Menaxhimit të Riskut në Bashkinë Klos si dhe është në proces përgatitja për hartimin e rregjistrimit të riskut.

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në 3 raste në procedurat e prokurimit publik me fond limit **20,757,884 lekë** janë kualifikuar dhe shpallur fitues operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet standarde të tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, përkatësisht si vijon:

- “Ndërtim KUZ në Fshatin Kurdari (Hurdhë)”, Bashkia Klos, me vlerë të fondit limit 9,424,551 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE “E” SHPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, në kontratën **me vlerë 11,183,382 lekë me TVSH**.

- “Blerje Fadrome”, Bashkia Klos, me vlerë të fondit limit 3,000,000 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE “A.” SHPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, në kontratën **me vlerë 3,600,000 lekë me TVSH**.

- “Blerje Naftë”, Bashkia Klos, me vlerë të fondit limit 8,333,333 lekë pa TVSh, zhvilluar në vitin 2021, është shpallur fitues OE “M.” SHPK, i cili nuk plotëson të gjitha kriteret e veçanta të DST, por është kualifikuar dhe shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik, në kontratën **me vlerë 10,000,000 lekë me TVSH**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm: neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, germa (ç), neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa (a). (*Më hollësisht trajtuar në pikën nr.4, faqe 65-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Klos, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik për vlerën **24,783,382 lekë** me TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DT, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

13.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Sipas urdhrorit nr. 32 datë 08.02.2023 është ngritur Komisioni Disiplinor dhe ka bërë verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH ku ka nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DT, dhe ka marrë masë disiplinore për personat përgjegjës. Gjithashtu rekomandimet e KLSH janë mbajtur në konsideratë dhe janë reflektuar në DST e shpaluara në SPE.

Zbatuar

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30/4/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Klos), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 737,636 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Ndërtimi i Muzeut Historik-Kulturor”, Bashkia Klos**, me vlerë të kontratës 15,171,192 lekë (me tvsh), fituar nga BOE “U.” ShPK & “T” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likujduara në vlerën **77,400 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2458 prot datë 30.09.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Klos dhe BOE “U” ShPK & “T” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4.4/4 faqet 95-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Klos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,400 lekë pa TVSH** nga BOE “U” ShPK & “T” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2458 prot datë 30.09.2020, me objekt “Ndërtimi i Muzeut Historik-Kulturor”, Bashkia Klos.

Deri më datë 30.04.2023

1.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos ka njoftuar subjekti “U” SH.P.K, për detyrimin e konstatuar nga diferenca në volumin e punimeve në vlerën 77,400 lekë pa TVSH dhe sipas mandat arkëtimin vlera e sipërcituar është derdhur për llogari të Bashkia Klos

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse”, me vlerë 1,596,783 lekë me TVSH, fituar nga OE “N.” SHPK , rezultuan diferenca në volume, për punime të pakryera, por të likujduara, për zërin e punimeve: “Struktura monolite b/betoni C 12/15 me 20% gur, për riparim kanali vaditës”, në vlerën **55,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1348 prot., datë 01.06.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Klos dhe OE “N.” SH.P.K. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 84-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimi*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **55,000 lekë pa TVSH** nga OE “N.” SH.P.K për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1348 prot., datë 01.06.2021 me objekt “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse”.

Deri me datë 30.04.2023

2.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos me shkresën nr. 572 prot., date 03.02.2023 “Njoftim për shlyerje detyrimi” ka njoftuar Subjektit “N.” Sh.p.k për likuidimin vullnetar të detyrimit dhe me shkresën 577/1 prot., date 21.06.2023 “Rinjoftim për shlyerje detyrimi”. Deri në datën 27.07.2023 nuk është arkëtuar asnjë vlerë.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim i rrethimit të varrezave të qytetit Klos”, me vlerë 3,072,336 lekë

me TVSH, fituar nga OE “S.” SHPK , rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Strukturë monolite betoni C 16/20, t=15 cm, sheshi + parkimi” dhe zërin “Shtresë betoni C 16/20”, në vlerën **195,900** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1018 prot., datë 21.04.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Klos dhe OE “S.” SH.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 87-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **195,900 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve “S.” SH.P.K për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me nr. 1018 prot., datë 21.04.2021 me objekt “Sistemim i rrethimit të varrezave të qytetit Klos”.

Deri me datë 30.04.2023

3.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos me shkresën nr. 571 prot., date 03.02.2023 “Njoftim për shlyerje detyrimi” ka njoftuar Subjektit “S.” Sh.p.k për likuidimin vullnetar të detyrimit dhe me shkresën 571/1 prot., date 21.06.2023 “Rinjofitim për shlyerje detyrimi”. Deri në datën 27.07.2023 nuk është arkëtuar asnjë vlerë.

Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Klos dhe zonave përreth, Lugina e Klosit, Lagjia Dalti, Ura e Degës, Bashkia Klos”, me vlerë 82,591,336.66 lekë me TVSH, fituar nga OE “D.” SHPK , rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “F.V Tub e rakorderi ujësjellësi, PE d=20 mm, t=2 mm, PN 10”, “F.V Tub e rakorderi ujësjellësi PE d=40 mm, t=3 mm, PN 10”, “Punime Gërmimi në rrjetin e shpërndarës Lugina e Klosit ” në vlerën **225,336 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 640 prot., datë 28.02.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Klos dhe OE “D.” SH.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 90-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën prej **225,336 lekë pa TVSH** nga shoqëria “D.” SH.P.K , në cilësinë e sipërmarrësit për punime të pakryera në kontratën me nr. 640 prot., datë 28.02.2020 me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Klos dhe zonave përreth, Lugina e Klosit, Lagjia Dalti, Ura e Degës, Bashkia Klos ”.

Deri me datë 30.04.2023

4.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos ka njoftuar subjekti “D.” SH.P.K, për detyrimin e konstatuar nga diferenca në volumin e punimeve në vlerën 225,336 lekë pa TVSH dhe sipas mandat arkëtimit të date 11.05.2023 vlera e sipërcituar është derdhur për llogari të Bashkia Klos

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim KUZ në fshatin Kurdari (Hurdhë)” Bashkia Klos, me vlerë 11,183,382 lekë me TVSH, fituar nga OE “E” SHPK , rezultuan diferenca në volume për zërin e punimeve: “Zëri 4(2.261) Mbushje me rërë” në vlerën **184,000 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 920 prot., datë 12.04.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Klos dhe OE “E” SH.P.K. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4/4.4 faqe 91-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **184,000 lekë pa TVSH** nga OE “E” SH.P.K për punime të pakryera në kontratën me nr. 920 prot., datë 12.04.2021 me objekt “Ndërtim KUZ në fshatin Kurdari (Hurdhë)” Bashkia Klos.

Deri me datë 30.04.2023

5.1.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos me shkresën nr. 570 prot., date 03.02.2023 “Njoftim për shlyerje detyrimi” ka njoftuar Subjektin “E” Sh.p.k për likuidimin vullnetar të detyrimit dhe me shkresën 570/1 prot., date 21.06.2023 “Rinjoftim për shlyerje detyrimi”. Deri në datën 27.07.2023 nuk është arkëtuar asnjë vlerë.

Zbatuar pjesërisht

D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Klos nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve nga taksapaguesit e kategorisë familjar dhe privat dhe për këtë arsye janë krijuar debitorë, vlera progresive e detyrimit të së cilëve në datën 31.12.2021 është 56,874,723 lekë, e ardhur e munguara në buxhetin e Bashkisë Klos, prej së cilës vlera 14,093,722 lekë është krijuar vetëm gjatë vitit 2021.

Vlera e mësipërme progresive përbëhet nga:

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat familjare në shumën 24,148,970 lekë;

Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve në shumën 32,725,753 lekë për 274 biznese;

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89, 90, 91, 93. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 24-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

1.1. Rekomandimi:

Spektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- 32,725,753 lekë për 274 biznese;

- 24,148,970 lekë nga taksat dhe tarifatat vendore për familjet;

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Spektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Spektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Spektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në Bashkinë Klos të bashkërendojë punën me QKB, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2.Nga verifikimi rezultoi se:, Bashkia Klos ka hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2567/38 datë. 01.02.2023 dhe ka ngarkuar Spektorin e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për vazhdimin e procedurave të mëtejshme nga ku rezultoi se:

Janë dërguar njoftime subjekteve Biznesi i Madh me nr. 887 prot., date 04.04.2022.

Janë dërguar njoftime subjekteve Biznesi i Vogël me nr. 888 prot., date 04.04.2022.

Janë dërguar njoftime vlerësimi te detyrimit tatimor subjekteve Biznesi i Madh me nr. 2102 prot., date 12.08.2022.

Janë dërguar Urdhër Bllokimi subjekteve me nr. 2319 prot., date 12.09.2022.

Në proces zbatimi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave për taksën e tokës bujqësore, rezulton se nuk është paguar vlera **1,477,640 lekë**, vlere e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë. Ky veprim në kundërshtim me:

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

V.K.M nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar.

V.K.M nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

V.K.B nr. 80, datë 24/12/2020 “Për miratimin e paketës fiskale, taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 në Bashkinë Klos” konfirmuar në Prefekturë me nr. 37/1Prot., datë 11.01.2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 28-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

2.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrin masa dhe të ndjekin të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **1,477,640 lekë** nga qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për tokën e marrë me qira.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave ka arketuar vleren **1,477,640 lekë** nga qiramarrësit për tokën e marrë me qira.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Klos ka pajisur me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë. Subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në territorin e Bashkisë Klos pa autorizim, rezultojnë të krijojnë efekt financiar me vlerë totale 272,777 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Klos. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20. VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 28-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

3.1. Rekomandimi:

Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “A.”, “S.” SH.P.K, dhe “M.”, të paguajnë detyrimet ndaj Bashkisë Klos me vlerë vjetore **272,777 lekë** secili.

Qershor 30.06.2023

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Klos ka hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve me shkresën nr. 2567/38 datë. 01.02.2023 dhe ka ngarkuar Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimit.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor Bashkia Klos për vitin 2021 janë vendosur 4 gjoba (z. Y. T., z. L. D., z. L. K. dhe z. F. K.) për ndërtime të kundraligjshme në vlerën 3,100,000 lekë, vlerë e cila nuk është arkëtuar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5. Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9, neni 22. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 28-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).*

4.1. Rekomandimi: Sektori i të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 3,100,000 lekë. Gjithashtu, IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.1.Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i IMT për shkeljet e konstatuara dhe dënimin me gjobë të kundërvajtësve dhe në pamundësi të shndërrimit të gjobës në titull ekzekutivë i është drejtuar Drejtorisë Juridike më shkresat përkatëse për vazhdimin e procedurave të shndërrimit të gjobës në titull ekzekutivë

Në proces zbatimi

E. MASA DISIPLINORE.

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Klos, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Sipas urdhrin nr. 32 datë 08.02.2023 është ngritur Komisioni Disiplinor dhe ka bere verifikimin rast pas rasti të konstatimeve të KLSH, dhe sipas vendimit shkresave të poshtëpërmendura ka vendosur 4 masa disiplinore “Vërejtje” një masë disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” si dhe për z. F. R., me detyrë Specialist Finance nuk është vendosur masë disiplinore pasi është transferuar në ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimet ShA. Klos. Të detajuara paraqiten si vijon:

Lista analitike e masave te rekomanduara dhe zbatuara

Nr	Emri Mbiemri	Pozicioni Zyrtar	Rekomandimi i KLSH dhe I APP	Masa e zbatuar	
				Shkresa apo vendimi nr data	Lloji i masës së zbatuar
1	A. M.	P/Sektori Planifikimit dhe Ndjekjes se Investimeve	Sipas performancës, llojin e shkeljeve dhe shkalla e përgjegjësisë	Shkresa Nr. 800 prot., date 27.02.2023	Verejtje
2	A. G.	N/Kryetar Bashkie	Sipas performancës, llojin e shkeljeve dhe shkalla e përgjegjësisë	Shkresa Nr. 801 prot., date 27.02.2023	Verejtje
3	F. M.	Sekretar i Pergjithshem	Sipas performancës, llojin e shkeljeve dhe shkalla e	Shkresa Nr. 798/2 prot., date 03.03.2023	Verejtje

			përgjegjësishë		
4	A. G.	Specialist Jurist	Sipas performancës, llojin e shkeljeve dhe shkalla e përgjegjësishë	Shkresa Nr. 799/2 prot., date 03.03.2023	Verejtje
5	F. K.	P/Sek. Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Liçensave	Sipas performancës, llojin e shkeljeve dhe shkalla e përgjegjësishë	Shkresa Nr. 941 prot., date 17.03.2023	Largim nga Sherbimi Civil

1. **Z. F. M.**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 798/2 prot., date 03.03.2023 është vendosur masa disiplinore “Verejtje”.

2. **Z. A. G.**, me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Klos, Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 801 prot., date 27.02.2023 është vendosur masa disiplinore “Verejtje”.

3. **Znj. F. K.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Ardhurave, Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 941 prot., date 17.03.2023 është vendosur masa disiplinore “Largim nga Sherbimi Civil”.

4. **Z. A. G.**, me detyrë Specialist i Çështjeve Juridike, Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 799/2 prot., date 03.03.2023 është vendosur masa disiplinore “Verejtje”.

Zbatuar

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masa Disiplinore”, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Klos**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësishë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

5. **Znj. A. M.**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit dhe Ndjekjes Investimeve, Nga verifikimi rezultoi se me shkresën nr. 800 prot., date 27.02.2023 është vendosur masa disiplinore “Verejtje”.

6. **Z. F. R.**, me detyrë Specialist Finance, Nga verifikimi rezultoi se z. F. R. referuar ndryshimeve strukturore të vitit 2023 është transferuar tek ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimet ShA. Klos dhe nuk është në varësi të Bashkisë Klos.

Zbatuar

Përmbledhëse e Masave Disiplinore dhe Administrative

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

Nr	Lloji i masës rekomanduar nga KLSH	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar
1	Verejtje deri në Largim nga shërbimi civil	6	6	0
	Gjithsej	6	6	0

1	Gjoha IMTV			
2	Gjoha APP			
	Gjithsejt	6	6	0

Sa sipër nga 6 masa të rekomanduara gjithsej nga KLSH, rezulton se janë zbatuar 5 masa duke mos u zbatuar 1 konkretisht z. F. R. pasi referuar ndryshimeve strukturore të vitit 2023 është transferuar tek ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimet ShA. Klos dhe nuk është në varësi të Bashkisë Klos.

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, në Bashkinë Klos për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, të pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Klos 14 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masë organizative, janë në proces zbatimi 6 masa organizative dhe zbatuar pjesërisht 1 masë organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Rekomandimi 8.1: Bashkia Klos të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Klos ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe të pa zbatuara si dhe përsheptimin e procedurave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar në proces zbatimi.

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga KLSH janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi në vlerë 737,636 lekë, deri me datë 28.07.2023 janë zbatuar 2 masa shpërblim dëmi në vlerë 302,736 lekë si dhe janë zbatuar pjesërisht 3 masa shpërblim dëmi në vlerë 434,900 lekë, për të cilët KLSH i kërkon Bashkisë Klos të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përsheptuar punën për zbatimin e rekomandimeve të zbatuara pjesërisht, si vijon:

1. Rekomandimi 2.1: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **55,000 lekë pa TVSH** nga OE “N.” SH.P.K për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 1348 prot., datë 01.06.2021 me objekt “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse”.

Menjëherë

2. Rekomandimi 3.1: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **195,900 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve “S.” SH.P.K për punime të pakryera në volumet e situacionuara në kontratën me nr. 1018 prot., datë 21.04.2021 me objekt “Sistemim i rrethimit të varrezave të qytetit Klos”.

Menjëherë

3. Rekomandimi 5.1: Bashkia Klos të arkëtojë vlerën **184,000 lekë pa TVSH** nga OE “E” SH.P.K për punime të pakryera në kontratën me nr. 920 prot., datë 12.04.2021 me objekt “Ndërtim KUZ në fshatin Kurdari (Hurdhë)” Bashkia Klos.

Menjëherë

Aneksi i zbatimi të rekomandimeve në Bashkinë Klos, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	14	14	7	1	6	
Masa shpërblim dëmi (Nr)	5	5	2	3		
Masa shpërblim dëmi (vlerë)	737,636	737,636	302,736	434,900		
Masa për 3E (Nr)	4					5
Masa për 3E (vlerë)	61,725,500	61,725,500	1,477,640		60,247,500	
Masa Disiplinore/Administrative	1	6	6			-

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN
2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Raport përfundimtar për auditimin tematik të ushtruar në Bashkinë Skrapar

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË SKRAPAR

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-6
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
II.	Hyrja	1. Objekti	6-8
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	8-25	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	8	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	8-9	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	9	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	9-15	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	15-17	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	17-20	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	20-25	
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	25-31	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

I.Përmbledhje Ekzekutive

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Bashkinë Skrapar, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyllës me përfaqësuesit e Bashkisë Skrapar.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 798/15 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p>1.1-8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 577,473 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p> <p>9.1-11.1 Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 20,213 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta</p>	15-17	E LARTË	Rekomandim: 1.1. Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p> <p>12.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 4,926 mijë lekë (principal dhe kamatë vonesë).</p> <p>13.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.</p> <p>14.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.</p> <p>14.2 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat dhe tarifatat familjare prej 54,741 mijë lekë.</p> <p>15.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.</p> <p>16.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 15,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.</p> <p>17.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË SKRAPAR

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 1,800,000 lekë.</p> <p>18.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 603,000 lekë.</p> <p>19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.</p> <p>19.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, të marrë masat e nevojshme për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të qirasë me tarifën simbolike 1 euro të lidhura me subjektin HEC V Sh.P.K, duke ndjekur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit.</p> <p>-Për rastin e kontratës së qirasë me objekt "tokë pa fryt" të lidhur me subjektin E.2 Sh.A, përpara përfundimit të afatit të kontratës së qirasë më datë 16.07.2023 dhe në rast se subjekti i mësipërm do të shfaqë interes për rinovimin e saj, t'i drejtohet ministrisë përgjegjëse për ekonominë, me qëllim marrjen e konfirmimit për të rinovuar kontratën e qirasë për objektin e mësipërm.</p> <p>19.3 Rekomandim: Drejtoria e shërbimit pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.</p> <p>-Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.</p> <p>20.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, Drejtoria Ekonomike të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve të reja kryesisht për largimet e punonjësve nga puna, shpronësime të objekteve të prishura dhe monitorimit të zbatimit të</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur rritje të efekteve financiare negative në buxhetin e bashkisë.			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Bashkinë Skrapar, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 52%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative, 3 masa shpërblim dëmi, 24 masa me 3E, 2 masa administrative dhe 28 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 27 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, janë në proces zbatimi 16 rekomandime dhe janë pazbatuar 8 rekomandime.

Për shpërblim dëmi janë lënë 3 masa në vlerën 17,804 lekë, të cilat janë zbatuar të gjitha.

Janë lënë 24 masa me 3E nga të cilat një është zbatuar, 2 janë në proces dhe dy janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 19 janë pazbatuar.

Janë lënë 2 masa administrative nga të cilat 2 janë zbatuar.

Nga 28 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 15, ndërsa 13 nuk janë zbatuar.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Skrapar “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 628/5, datë 07.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O.L, Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
3. B.B, auditues
4. F.C, auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Skrapar dhe përgjegjësi, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Skrapar, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

II. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Skrapar është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Skrapar.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 798/15 prot, datë 24.01.2023, ka dërguar në Bashkinë Skrapar Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.
- Nga Kryetari janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.193 prot., datë 15.04.2021 nga ana e Bashkia Skrapar është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Nga ana e Bashkisë Skrapar nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.1646 prot., datë 26.07.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **84 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **27 masa organizative**, nga të cilat 12 janë zbatuar, ndërsa 7 janë në proces zbatimi
- **3 masa shpërblim dëmi**, nga të cilat 3 janë zbatuar
- **24 masa me 3E**, 1 është zbatuar, ndërsa 4 janë në proces zbatimi (2 zbatuar pjesërisht)
- **2 masa administrative**, nga të cilat 2 janë zbatuar
- **28 masa disiplinore**, nga të cilat 15 janë zbatuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr . per	Në mijë/lek	Nr . per	Në mijë/lek	Nr . Pers	Në mijë/lek	Nr . pers	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	27	12	7	8								
2.	Masa për përmirësim ligjor												
3.	Shpërblim demi	3	3				17,804		17,804				
4.	Masa efekt financiar	24	1	4	19		722,310				534		721,776
5.	Masa disiplinore	28	15		11								
	Totali	82	31	11	38		740,114				534		721,776

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjorë atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, caktimin e koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimit të riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të bashkisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë sigurisë së Sistemeve IT sipas përcaktimeve në aktet ligjore.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit” i cili ngarkon Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave, por që nuk është hartuar.

1.2 Rekomandim: GMS të marrë masa për hartimin dhe miratimin e planit strategjik dhe planit vjetor për aktivitetet dhe çështjet që duhet të analizojë dhe grafikun e takimeve që do realizojë, për hartimin e raporteve vjetore, si një rregullator për mbarëvajtjen e proceseve të ndryshme të punës për çdo drejtori dhe njësi varësie, për të arritur objektivat institucionale në shërbim të komunitetit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

1.3 Rekomandim: Drejtoria Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për të hartuar programe trajnimi për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë, të plotësojë dosjet e personelit sipas kërkesave ligjore/nënligjore, të kontribuojë në krijimin e një strukture organizative dhe organigramën e saj sa më efektive, për të rritur efektivitetin e shërbimeve dhe funksioneve që i atribuon ligji, në dobi të komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për krijimin e një njësie të plotë të Auditit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM dhe Manualin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave;

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **pa zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

2.2 Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të ndjekë rregullisht trajnimet e detyrueshme vjetore, të bëjë një rivlerësim të koeficientit të riskut të Fve /sistemeve objekt i misioneve audituese, për të përfshirë në planet strategjike dhe vjetore sektorët e Fve me risk, siç janë : zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, etj si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Skrapar;

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

2.3 Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm, të ndjekë me korrektësi çdo fazë të misionit



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

auditues me praktikën dokumentare përkatëse, rihartimin e atyre planeve vjetore ku ka patur ndryshime të misioneve audituese dhe miratimin e tyre të titullari i bashkisë; si dhe me dërgimin e raportit përfundimtar në subjektin e audituar t'i kërkojë menaxherit të saj të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht NJAB sipas afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit; Drejtuesi i Auditimit Brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t'ia përcjellë menaxhimit nëpërmjet raporteve informuese progresin ose jo të bërë për zbatimin e rekomandimeve, kjo sipas Manualit të AB.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

3.1 Rekomandim: Në Bashkinë Skrapar, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e Ekonomike të marrin masa për të miratuar me Vendim të veçantë në Këshillin Bashkiak Planin vjetor të buxhetit, të analizojnë çdo tregues të mos/realizimit të buxhetit vjetor dhe të tregojnë vëmendje për të planifikuar në buxhet fonde për ato programe që janë pjesë e Planit të zhvillimit vendor dhe Strategjive Kombëtare kryesisht atyre të mjedisit, për të hartuar një plan të buxhetit vjetor dhe afatmesëm sa më real dhe në koherencë me nevojat dhe interesat e komunitetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

4.1 Rekomandim: Në Bashkinë Skrapar, Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve; të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhëse, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, për të evituar diferencat e dukshme të planifikimit me realizimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t'u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

6.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë në proces punimesh.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Me kalimin e Ujsjelles Sh.A Skrapar ne varesi te Sh.A. Ujsjellesit Berat ka ndryshuar dhe % e aksioneve qe i takojne bashkise Skrapar, kemi kerkuar nga Sh.A -Ujsjelles Berat vleren e aksioneve por akoma skemi mare nje pergjigje. Ky rekomandim do te plotesohet me mbylljen e Bilancit te vitit 2023 duke pasqyruar ne llogarin 26- Pjesmarrjen ne kapitalet e veta.

9.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per llogarin 202 -Studime dhe kerkime, eshte pasqyruar amortizimi vjetor ne bilancin e vitit 2022, sipas rekomandimit te lene.

10.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i papranuar, dhe i pazbatuar.

Ndërmarrja e shërbimit pyjor sipas shkresës nr.66 prot., datë 07.03.2023 sqaron se kjo pikë është e pazbatueshme për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe pamjaftueshmërisë së kapaciteteve financiare.

10.2 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Do të zbatohet me mbylljen e Bilancit të vitit 2023.

11.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për ndarjen e qartë të përgjegjësisë në planifikimin, faturimin dhe vjeljen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Për zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”. Ndarja e përgjegjësisë është e përcaktuar qartë në paketën fiskale.

12.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Kadastrës, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por pa zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

13.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Skrapar, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

14.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, për punët/mallrat/shërbimet të cilat është e mundur ndarja e saj në lote, të marrë masa për hartimin e kërkesave të veçanta për secilin lot, pasi diversiteti që vjen nga kontratat e shumta apo lotet mund të përmirësojë konkurrencën dhe të rrisë efikasitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit eshte përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

15.1 Rekomandim: Komisioni për Vlerësimin e Ofertave, të marrë masa në procedurat ku lejohet nënkontraktimi që edhe dokumentet e nënkontraktorit t'i nënshtrohen vlerësimit nëse përmbushin apo jo kriteret kualifikuese, dhe AK të shprehet për miratimin ose jo të nënkontraktorit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

16.1 Rekomandim: Drejtori i NSHP, në cilësinë e titullarit, të marrë masa për vendosjen nëpër



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

komisionet e ngritura për procedurat e prokurimit publik, të persona me kualifikimin e duhur. Të merren masa për vendosjen e specifikimeve teknike, për krijimin e kushteve për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

17.1. Rekomandim: Bashkia Skrapar të marrë masa që të pajisin me Oponencë Teknike për çdo projekt zbatimi me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë sipas legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

18.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Skrapar, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënia mendimi, përpara miratimit të lejes. Për objektet mbi 50 m², kur është rasti, të kërkohet pajisja e subjekteve e subjekteve me *Certifikatën Paraprake për Performancën e Energjisë*.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për ngritjen Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por pa zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

19.2 Rekomandim: Të merren masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i tyre të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi inxhinierik i inspektorit/kryeinspektorit, kjo për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por pa zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

19.3 Rekomandim: Të hartohen dhe të administrohen me procesverbal dhe në dosjet përkatëse praktikat e konstatimit të situatave ndërtimore. Procesverbalet të jetë sipas formatit të miratuar.

-Lidhur me konstatimet e mbajtura për punime ndërtimore pa leje, në çdo rast të mbahet penaltiteti përkatës duke vendosur gjobë, shoqëruar me pezullimin e punimeve dhe prishjen e ndërtimit pa leje kur është rasti.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por pa zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit eshte pergatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot.264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

20.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 241/54 prot., datë 13.04.2021 “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rikërkua” si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 21.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

-Për zbatimin e 2 masave organizative,

- Për të ndjekur gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e shumës 1,127,669 lekë të 3 masave shpërblim dëmi.

- Për zbatimin e rekomandimit për Masa me Efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, efincencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 1,250,000 lekë.

- Për zbatimin e dy rekomandimeve për detyrime për taksat dhe tarifat vendore me efekte në të ardhurat në vlerën 891,325,200 lekë.

- Vënien në dijeni shkrirësish KLSH-në brenda afatit 20 ditor mbi planin e veprimit dhe brenda atij 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **pa zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.45 date 01.02.2023, prot. 264 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat e KLSH”, shkronja (b) dhe (c) dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Bashkia Skrapar, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi Zbatues të ndiqet procesi me qëllim **shpërblimin e dëmit në vlerën 18,407,542 lekë** si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar të arkëtojë vlerën prej **17,804,226** lekë pa TVSH nga sipërmarrësi i punimeve BOE “SH.I” sh.p.k & “F” sh.p.k dhe nënkontraktori OE “L.O” sh.p.k për punime të pakryera, diferenca në volume pune krahasuar me volumet e situacionuara, vendosje pajisje hidraulike të përdorura në stacionin e pompimit ,parashikuar në kontratën me nr. 1436 prot., datë 20.05.2020 me objekt “Rehabilitim i Ujësjellësit të Qytetit Çorovodës dhe fshatrave Çerenisht dhe Sharovë, Bashkia Skrapar”.

Zbatimi: Nga verifikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit rezulton:

Bashkia Skrapar me shkresën nr.315 prot., datë 07.02.2023 ka bërë njoftim për likuidim të efekteve financiare drejtuar shoqërisë SH.I shpk referuar rekomandimeve të lëna nga KLSH. Me shkresën nr.357 prot., datë 10.02.2023 kërkesë për informacion, shoqëria ka kërkuar nga bashkia informacion më të detajuar lidhur me rekomandimin e KLSH. Bashkia Skrapar me shkresën nr.522 prot., datë 27.02.2023 dërguar shoqërisë mbikëqyrëse I shpk, për dijeni Kryetarit të KLSH, ka



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

kërkuar raportim lidhur me konstatimet. BOE SH.I shpk & F shpk me shkresën nr.9 prot., datë 23.02.2023 dërguar bashkisë dhe për dijëni Kryetarit të KLSH, kërkesë për verifikim punimesh duke pretenduar se procedura e auditimit është kryer në periudhën që objekti ka qenë në fazë zbatimi, pra i papërfunduar Gjatë kësaj periudhe BOE ka angazhuar të gjitha kapacitetet për të realizuar zërat e punimeve të parashikuara. Për këtë ka kërkuar rivefikim dhe riinspektim të punimeve. Me shkresën nr. 798/18 prot., datë 18.04.2023 dërguar KLSH nga subjekti mbikqyrës I shpk ka vënë në dijëni lidhur me kryerjen e zërave të punimeve të konstatuara me mangësi gjatë auditimit në terren, bashkëlidhur ka dërguar dokumentacionin tekniko ligjor që pasqyron kryerjen e punimeve. Pas përfundimit të punimeve Bashkia Skrapar ka marrë masa për kryerjen e kolaudimit të objektit. Me shkresën nr.1031 datë 24.04.2023 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës Mbetjeve ka kërkuar caktimin e dy specialistëve të licensuar për kryerjen e procedurave të kolaudimit të objektit. AKUKIM ka kthyer përgjigje me shkresën nr.797/1, datë 06.05.2023 duke i vënë në dijëni të përcaktimit të dy inxhinierëve të licensuar si pjesë e grupit të kolaudimit të objektit. Akti i kolaudimit të objekteve është kolauduar më datë 06.06.2023 duke konfirmuar realizimin e punimeve në përputhje me projektin dhe specifikimet teknike dhe realizimin e plotë e të gjithë zërave të punimeve dhe instalimin e paisjeve sipas kontratës. Pas përfundimit të procesit të kolaudimit të objektit Kryetari i Bashkisë Skrapar me urdhërin nr.1451 prot., datë 13.06.2023 ka ngritur Komisionin e marrjes në dorëzim të objektit “Rehabilitim i ujësjetës së Qytetit të Corovodës dhe fshatrave Cerenisht dhe Sharovë”. Grupi i punës ka hartuar certifikatën e marrjes së përkohëshme në dorëzim të punimeve më datën 19.06.2023 në prezencë të kontraktorit dhe subjektit mbikqyrës ku konfirmohet zbatimi i punimeve sipas kushteve të kontratës. Referuar dokumentacionit të sipërcituar nuk është arkëtuar vlera e rekomanduar për arsye sepse sipas këtij dokumentacioni është cilësuar kryerja e punimeve të pakryera pas periudhës së auditimit të kryer nga KLSH.

Lidhur sa trajtuar në aktin e verifikimit nr. 1, Nga Bashkia Skrapar janë paraqitur observacione, dërguar me shkresën nr. 1900/2, datë 31.07.2023, marrës KLSH me nr. 628/6, datë 02.08.2023.

Ku sqarohet lidhur me zbatimin e rekomandimit të pikës 4 të aktverifikimit dhe rekomandimet e tjera.

Pretendimi i subjektit:

Nga Titullari i Bashkisë Skrapar, sqarohet dhe shpjegohet, lidhur me procedurën e ndjekur në zbatim të rekomandimit nr. 1, që nga dërgimi i shkresës për zbatimin e rekomandimeve me nr. 798/15, datë 24.01.2023 e në vijim. Ndër tjera shpjegohet se BOE, i kontraktuar për ndërtimin e ujësjetës, që nga periudha e kryerjes së auditimit nga KLSH, ka angazhuar të gjitha kapacitetet për të realizuar zërat e punimeve të parashikuara në rekomandimin e lënë nga KLSH-ja. Me shkresën nr. 12, datë 13.03.2023, protokolluar në Bashkinë Skrapar me nr.678, datë 13.03.2023, ka njoftuar përfundimin e punimeve. Pas marrjes së njoftimit Bashkia Skrapar duke vlerësuar objektin si të një rëndësie të veçantë, me shkresën nr. 1031, datë 24.04.2023, i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, “Kërkesë për caktimin e një grupi ekspertësh të fushës”, e cila ka caktuar si pjesë e grupit të kolaudimit 2 specialistë të fushës. Nga Bashkia Skrapar i është vënë në dispozicion të grupit të kolaudimit të objektit, të gjitha rekomandimet e lëna nga KLSH-ja lidhur me zbatimin e këtij objekti, gjithashtu në kontratën e nënshkruar grupit të kolaudatorëve i janë dhënë detyra specifike që lidhen me rekomandimet e KLSH-së. Grupi Kolaudimit ka dorëzuar aktin e kolaudimit me datë 06.06.2023, për objektin “Rehabilitim i ujësjetës së Qytetit Corovodë dhe fshatrave Çeremisht dhe Sharovë”, ku theksohet: “Mbështetur në: kontrollin fizik, sasior dhe cilësor të punimeve të kontratës, kontrollit të dokumentacionit të punimeve: Funksionimin normal të dhe pa probleme të kësaj vepre, duke qenë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

se ato u gjetën të rregullta dhe objekti në funksion të plotë, në përputhje me projektin dhe ndryshimet e miratuara me kushtet teknike të ndërtimit dhe specifikimet teknike të realizimit të çdo procesi pune në veçanti, Punimet e kësaj vepre kolaudohen”. Titullari i institucionit pasi njihet me aktin e kolaudimit, ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim të objektit, i cili në prezencë të mbikëqyrësit, kolaudatorit, ka bërë verifikime nga ana vizuale duke marrë në dorëzim objektin dhe njëkohësisht është hartuar Certifikata e Përkohshme e marrjes në dorëzim të objektit. Duke marrë në konsideratë rrethanat e mësipërme, dokumentacionin e administruar dhe pasqyruar në akt verifikimin nr. 1, datë 25.07.2023, faktin që objekti është kolauduar dhe marrë në dorëzim, faktin që objekti është vënë në funksion të qytetarit, faktin që objekti është kontrolluar nga KLSH, në një fazë të pa përfunduar, si dhe faktin që është brenda garancisë së punimeve, lutemi opinionin tuja lidhur me adresimin/trajtimin e këtij rekomandimi nga ana e Bashkisë Skrapar.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Referuar dokumentacionit shqyrtuar nga grupi i auditimit si akti i kolaudimit, certifikata e marrjes në dorëzim, raport monitorimi dhe dokumentacioni shoqërues (librezë masash, fotografi etj.) dërguar në KLSH me nr.prot., 798/18, datë 18.04.2023 rezulton se ky dokumentacion është hartuar pas dërgimit të rekomandimeve nga KLSH përcjellë me shkresë 798/15 prot, datë 24.01.2023. Sipas këtij dokumentacioni konfirmohet realizimi i kontratës si nga ana sasiore dhe cilësore, për rrjedhojë rekomandimi do të konsiderohet i ezauruar.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar të arkëtojë vlerën **139,416 lekë pa TVSH** nga OE “D.” SH.P.K për punime të pakryera në kontratën me nr. 2567 prot., datë 19.08.2020 me objekt “Mbrojtje nga lum, në krahun e majtë në zonën e quajtur Verori, Çorovodë” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Skrapar të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **463,900 lekë** pa TVSH nga shoqëria “D.C” SH.P.K, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 985 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave Gjrbës dhe Kakrukë, Bashkia Skrapar” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

2.1 + 3.1. Rekomandimi:

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar.

Bashkia ka dërguar njoftimin me shkresën 314, datë 07.02.2023, subjektit “D. shpk”.

Bashkia ka prerë faturën e arkëtimit me nr. 5, datë 07.02.2023.

Subjekti ka likuiduar vlerën prej 603,316 lekë për dy rekomandimet nr. 2 dhe 3 (139,416 + 463,900 lekë), sipas mandat arkëtimit date 29.03.2023 nga BKT.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar** për vlerën **603,316 lekë**.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

1.1-8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej **577,473 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **pa zbatuar**.

9.1-11.1 Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësi të kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej **20,213 mijë lekë** pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **pa zbatuar**.

12.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 4,926 mijë lekë (principal dhe kamatë vonesë).

13.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.

Zbatimi 12.1+13.1: Nga Bashkia Skrapar janë nxjerrë njoftimet dhe janë arkëtuar pjesërisht për vlerën 534,509 lekë nga vlera debitore 8,272,254 (pas përllogaritjeve).

Koment: Ky rekomandim është **pranuar dhe zbatuar pjesërisht**.

14.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifavat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.

Zbatimi: Nuk është zbatuar pasi tarifa familjare vendore nuk është mbledhur nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, pasi është në diskutim.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar**.

14.2 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore nga taksat dhe tarifavat familjare prej 54,741 mijë lekë.

Zbatimi: Bashkia Skrapar ka nxjerrë njoftimet.

Koment: Ky rekomandim është **në proces**.

15.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

Zbatimi: Bashkia Skrapar nuk ka evidentuar familjet e pataksuara me taksa e tarifa vendore.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

16.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 15,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

Zbatimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon shkresa (procedurat ligjore) për arkëtimin e vlerës prej 15,337 mijë lekë vlerë debitore.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

17.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 1,800,000 lekë.

Zbatimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon shkresa (procedurat ligjore) për arkëtimin e vlerës prej 1,800,000 lekë vlerë debitore, por është mjaftuar me.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

18.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 603,000 lekë.

Zbatimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon shkresa (procedurat ligjore) për arkëtimin e vlerës prej (603,000 lekë sipas KLSH-së) ose 419,277 lekë sipas përlllogaritjes nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.

Zbatimi: Për 15 HEC-e dhe Gurore nuk është kryer asnjë arkëtim për vlerën totale 45,514,301 lekë.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

19.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, të marrë masat e nevojshme për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të qirasë me tarifën simbolike 1 euro të lidhura me subjektin HEC V Sh.P.K, duke ndjekur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit. -Për rastin e kontratës së qirasë me objekt “tokë pa fryt” të lidhur me subjektin E.2 Sh.A, përpara përfundimit të afatit të kontratës së qirasë më datë 16.07.2023 dhe në rast se subjekti i mësipërm do të shfaqë interes për rinovimin e saj, t’i drejtohet ministrisë përgjegjëse për ekonominë, me qëllim marrjen e konfirmimit për të rinovuar kontratën e qirasë për objektin e mësipërm.

Zbatimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon dokumentacion për prishje kontratash për subjektet e parregullta për qiratë.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

19.3 Rekomandim: Drejtoria e shërbimit pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura.

-Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Zbatimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk disponon dokumentacion për prishje kontratash për subjektet e parregullta për qiratë.

Koment: Ky rekomandim **nuk është zbatuar.**

20.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Grupi i Menaxhimit Strategjik, Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, Drejtoria Ekonomike të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjeve të detyrimeve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

të reja kryesisht për largimet e punonjësve nga puna, shpronësime të objekteve të prishura dhe monitorimit të zbatimit të kontratave të investimeve/shërbimeve si dhe për minimizimin e vlerës së detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme, duke zbatuar aktet ligjore /nënligjore në likuidimin e tyre në afat, për të shmangur rritje të efekteve financiare negative në buxhetin e bashkisë.

Zbatimi: Ky rekomandim është në proces.

2.6.Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore, u konstatua si vijon:

A. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7 dhe 12 , Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimit Nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, ndryshuar me Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Skrapar t’i kërkojë Kryeinspektorit pranë Prefekturës Berat, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 3 (tre) mbikëqyrës** punimesh, si më poshtë:

1. Z. A.K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, dhe drejtues teknik i shoqërisë “**I**” SH.P.K dhe licencë MK.2406/1, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratën e zbatimit me nr. 1436 prot., datë 20.05.2020 me objekt: “Rehabilitim i Ujësjetës së Qytetit Çorovodës dhe fshatrave Çerenisht dhe Sharovë, Bashkia Skrapar”, me sipërmarrës punimesh BOE “SH.P” sh.p.k me licencë NZ.1495/21, me administrator Z. B.C dhe “F” sh.p.k me licencë NZ.1163/17, me administrator Z. SH F dhe nënkontraktor OE “L.O” sh.p.k përfaqësuar nga administratori L. D., me pasojë dëm ekonomik në vlerën **17,804,226** lekë pa TVSH për diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara, zëra punime të pakryera fare në objekt dhe vendosje pajisje hidraulike të përdorura në stacionin e pompimit.

1. Rekomandimi:

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, pasi mbikëqyrësi A.K ka arkëtuar vlerën 50,000 lekë, sipas mandat arkëtimit të R. bank, datë 31.03.2023.

Nga Inspektori i ndërtimit të bashkisë Skrapar Z. Z.M është vendosur gjobë sipas vendimit 716, datë 17.03.2023, i cili është dërguar mbikëqyrësit me shkresën nr. 723, datë 23.03.2023 dhe është prerë fatura me nr. 29/3, datë 27.03.2023 (*Bashkëngjitur dokumentet*).

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar për vlerën 50.000 lekë gjobë e arkëtuar**

2. Z. A.B F.M, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shoqërinë “**M.C**” SH.P.K dhe licencë MK.3522/3, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e punimeve të ndërtimit, për kontratë e zbatimit me nr. 985 prot., datë 08.04.2021 me objekt: “Furnizimi me ujë i fshatrave Gjerbës dhe Kakrukë,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Bashkia Skrapar”, me sipërmarrës punimesh OE “D.C” sh.p.k me licencë NZ.2383/19, me administrator Znj. S.SH, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **463,900** lekë pa TVSH për diferenca në volume pune të pakryera në fakt, por të likuiduara.

2. Rekomandimi:

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, pasi mbikëqyrësi “M.C” shpk me përfaqësues F.M dhe A.B, kanë arkëtuar vlerën 50,000 lekë, sipas mandat arkëtimit të BKT, datë 29.03.2023.

Nga Inspektori i ndërtimit të bashkisë Skrapar Z. Z.M është vendosur gjobë sipas vendimit 715, datë 17.03.2023, i cili është dërguar mbikëqyrësit me shkresën nr. 722, datë 20.03.2023 (*Bashkëngjitur dokumentet*).

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar për vlerën 50.000 lekë gjobë e arkëtuar**.

B. MASA DISIPLINORE

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Në mbështetje të shkronjës (c) – Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për:

zj.R.LI, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Ligjore, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor, dhe në lidhje me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura të prokurimit publik.

Zbatimi: Kjo masë disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, është **zbatuar pjesërisht**, pasi i është dhënë masë me ulje “Mbajtja 1/5 e pagës/mujore” sipas proces-verbalit të komisionit disiplinor datë 17.02.2023, mbi bazën e të cilit është zbardhur vendimi 442 prot., datë 17.02.2023.

Për ndalesën ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 123, datë 03.04.2023, protokolluar me nr. 846, datë 03.04.2023

Ndalesa është kryer në muajt prill edhe maj 2023 **për vlerën 7,300 lekë/muaj ose 14,600 lekë** sipas borderove përkatëse.(Bashkëlidhur dokumentet e arkëtimit)

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar**.

b- Masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për:

zj. XH.S, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura; (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 122-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

zj. S.H, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 2 (dy) procedura.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

zj.H.B., përgjegjëse e STTV nga muaji Mars i vitit 2021 dhe në vazhdim, për mangësitë e konstatuara në 12 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: Kjo masë disiplinore “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*” nuk është zbatuar pasi:

-Xh.S.me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore nuk i është dhënë masë disiplinore.

-S.H, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit nuk i është dhënë masë disiplinore, sipas vendimit të komisionit disiplinor miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 444, datë 17.02.2023.

-H. B., me detyrë përgjegjëse e STTV nuk i është dhënë masë disiplinore, sipas vendimit të komisionit disiplinor miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 443, datë 17.02.2023.

Për sa më sipër për 3 personat disponohet proces-verbali i komisionit disiplinor datë 17.02.2023. (Bashkëlidhur dokumentet)

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe **nuk është zbatuar për 3 punonjësit.**

c- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

z.N.G., Drejtor i Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura; (*Më hollësisht trajtuar në pikën*

z.B.M., Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në 2 raste, për mos bashkëpunimin me sektorin e taksave dhe tarifave vendore në përcjelljen e informacionit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Skrapar, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura;

zj.M.B., Inspektore Kadastrore për vitin 2020 për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore

Zbatimi: Kjo masë disiplinore “Vërejtje” nuk është zbatuar në 2 raste, ndërsa në 1 rast punonjësi ka dalë në pension (M.B).

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe **nuk është zbatuar për 2 punonjësit.**

E.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” shkronjat “e” dhe “ç”, të nenit 1, Kreu IV dhe nenet 37 dhe 44 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Masat disiplinore të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

a- Masa disiplinore “Ndërprerje të kontratës së punës”, për:

z.T.L., Drejtor i NSHP Bashkia Skrapar për periudhën 2020-2021, për mangësitë e konstatuara në 19 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

Zbatimi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi është ndryshuar masa nga “Ndërprerje të kontratës së punës” në “Vërejtje”, sipas urdhrit të Drejtorit të NSHPyjtore Besnik Demko me nr. 5, datë 09.02.2023, protokolluar me shkresën nr. 19, datë 09.02.2023.

z.H.B., Inxhinier i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara, në 9 raste, në marrëdhëniet



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht, pasi është ndryshuar masa nga “Ndërprerje të kontratës së punës” në “Verejtje”, sipas urdhrorit të Drejtorit të NSHPyjure B.D. me nr. 5, datë 09.02.2023, protokolluar me shkresën nr. 19, datë 09.02.2023.

Masa disiplinore “Verejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

z.V.K, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 11 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Nuk është zbatuar.

b- Masa disiplinore “Verejtje”, për:

z. A.L, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura.

Zbatimi: Nuk është zbatuar.

zj. XH.LL, me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 4 (katër) procedura.

Zbatimi: Nuk është zbatuar.

z. G.M, me detyrë Topograf në Sektorin e Menaxhimit të Ujërave, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 2 (dy) procedura.

Zbatimi: Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 93, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 685, datë 13.03.2023.

z.XH.LI, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 4 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Nuk është zbatuar.

z.E.L, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 4 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Larguar nga puna në vitin 2021.

z.D.B, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 4 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Larguar nga puna

z.B.H, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 5 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Larguar nga puna.

z.M.H, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 3 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Nuk është zbatuar.

z.K.D, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 2 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Larguar nga puna

zj.L.N, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

Zbatimi: Rekomandimi është zbatuar sipas urdhrorit të Drejtorit të NSH Pyjore B. D. me nr. 5, datë 09.02.2023, protokolluar me shkresën nr. 19, datë 09.02.2023.

z.G.H, Inspektor i taksave në NJA Qendër, për mangësitë e konstatuara në 7 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 98, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 690, datë 13.03.2023.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

z.N.K, Inspektor i taksave në NJA Bogovë për mangësitë e konstatuara në 7 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: *Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 99, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 691, datë 13.03.2023.*

z.F.F, Inspektor i Taksave në NJA Gjerbës për mangësitë e konstatuara në 7 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: *Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 97, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 689, datë 13.03.2023.*

zj.F.C, Inspektor i taksave në NJA Potom për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore

Zbatimi: *Dalë në pension.*

z.TH.SH, Inspektor i taksave në NJA Zhepë për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: *Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 96, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 688, datë 13.03.2023.*

z.S.B, Inspektor i taksave në NJA Çepan për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: *Nuk është zbatuar.*

zj.L.B, Inspektore e taksave në NJA Leshnjë për mangësitë e konstatuara në 5 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 78-84 të Raportit të Auditimit)*

Zbatimi: *Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 95, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 687, datë 13.03.2023.*

z.N.D, Inspektor i taksave në NJA Vëndreshë për mangësitë e konstatuara në 5 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Zbatimi: *Është zbatuar sipas Urdhrit të kryetarit me nr. 94, datë 13.03.2023 protokolluar me shkresën nr. 686, datë 13.03.2023.*

Për punonjësit e larguar.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte:

“Largim nga shërbimi civil”, për:

-z.S.A, ish Përgjegjës i STTV deri në muajin Mars të vitit 2021.

“Vërejtje” deri “Vërejtje me paralajmërim”, për:

-zj.J.S, ish specialiste juriste.

-z.F.O, ish përgjegjës i sektorit juridik.

-z.F.B, ish Inspektor Kadastre.

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Skrapar, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “për Nëpunësin Civil” i ndryshuar.

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, por **nuk është zbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 798/15 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, caktimin e koordinatorit të riskut, të hartojë dhe të miratojë gjurmët e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, për forcimin e aktiviteteve të kontrollit të bashkisë, ku ti kushtohet rëndësi e veçantë sigurisë së Sistemeve IT sipas përcaktimeve në aktet ligjore.

2.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për krijimin e një njësie të plotë të Auditit të Brendshëm, sipas standardeve dhe metodologjisë së miratuar në përputhje me ligjin, VKM dhe Manualin, për të përmbushur misionin e saj në arritjen e objektivave;

10.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

10.2 Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Skrapar, të marrë masat e nevojshme, për hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

12.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Kadastrës, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të marrë masa për ngritjen Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

19.2 Rekomandim: Të merren masa që krahas ngritjes së inspektoratit, arsimimi i tyre të jetë sipas fushës së përcaktuar, ku të synohet arsimimi inxhinierik i inspektorit/kryeinspektorit, kjo për të bërë të mundur inspektimin dhe verifikimin e situatave ndërtimore në mënyrë cilësore.

19.3 Rekomandim: Të hartohen dhe të administrohen me procesverbal dhe në dosjet përkatëse praktikatat e konstatimit të situatave ndërtimore. Procesverbalet të jetë sipas formatit të miratuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

-Lidhur me konstatimet e mbajtura për punime ndërtimore pa leje, në çdo rast të mbahet penaltiteti përkatës duke vendosur gjobë, shoqëruar me pezullimin e punimeve dhe prishjen e ndërtimit pa leje kur është rasti.

20.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 241/54 prot., datë 13.04.2021 “Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të rikërkua” si dhe Akt Verifikimit nr.1 të datës 21.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre, të hartojë plan pune të veçantë dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e plotë të tyre, respektivisht:

-Për zbatimin e 2 masave organizative.

- Për të ndjekur gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e shumës 1,127,669 lekë të 3 masave shpërblim dëmi.

- Për zbatimin e rekomandimit për Masa me Efekte negative të konstatuara në administrimin, menaxhimin pa ekonomikitet, eficencë dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 1,250,000 lekë.

- Për zbatimin e dy rekomandimeve për detyrime për taksat dhe tarifave vendore me efekte në të ardhurat në vlerën 891,325,200 lekë.

- Vënien në dijeni shkrirësish KLSH-në brenda afatit 20 ditor mbi planin e veprimit dhe brenda atij 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna (*Më hollësisht trajtuar në faqe 9-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 798/15 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1-8.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 577,473 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

9.1-11.1 Rekomandim: Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë lidhjen e kontratës me operatorë ekonomikë të kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, për vlerën totale të prokurimit prej 20,213 mijë lekë pa TVSH. Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

12.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitore 4,926 mijë lekë (principal dhe kamatë vonesë).

13.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 6,629 mijë lekë.

14.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Skrapar, me qëllim që taksat dhe tarifat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit.

15.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrimit të familjeve me gjeneralitet përkatëse, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2021, rezultojnë 972 mijë lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Skrapar.

16.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve, të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 15,337 mijë lekë nga taksa e tokës bujqësore.

17.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 1,800,000 lekë.

18.1 Rekomandim: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës debitorë 603,000 lekë.

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës 45,514,301 lekë.

19.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe Drejtoria Juridike, të marrë masat e nevojshme për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të qirasë me tarifën simbolike 1 euro të lidhura me subjektin HEC V Sh.P.K, duke ndjekur procesin gjyqësor në të gjitha shkallët e gjykimit.

-Për rastin e kontratës së qirasë me objekt “tokë pa fryt” të lidhur me subjektin E.2 Sh.A, përpara përfundimit të afatit të kontratës së qirasë më datë 16.07.2023 dhe në rast se subjekti i mësipërm do të shfaqë interes për rinovimin e saj, t’i drejtohet ministrisë përgjegjëse për ekonominë, me qëllim marrjen e konfirmimit për të rinovuar kontratën e qirasë për objektin e mësipërm.

19.3 Rekomandim: Drejtoria e shërbimit pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura.

-Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme (*Më hollësisht trajtuar në faqet 17-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 798/15 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

F.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

Në mbështetje të shkronjës (c) – Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

b- Masa disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për:

zj. XH.S, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë Juridike, Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.3 faqe 122-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

zj. S.H, me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për problemet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 2 (dy) procedura.

zj.H.B, përgjegjëse e STTV nga muaji Mars i vitit 2021 dhe në vazhdim, për mangësitë e konstatuara në 12 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

c- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

z.N.G, Drejtor i Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura; *(Më hollësisht trajtuar në pikën*

z.B.M, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në 2 raste, për mos bashkëpunimin me sektorin e taksave dhe tarifave vendore në përcjelljen e informacionit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në Bashkinë Skrapar, dhe mangësitë që lidhen me kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në 7 (shtatë) procedura;

zj.M.B, Inspektore Kadastre për vitin 2020 për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore

E.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” shkronjat “e” dhe “ç”, të nenit 1, Kreu IV dhe nenet 37 dhe 44 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Masat disiplinore të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Skrapar, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mëposhtëm:

Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për:

z.V.K, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 11 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor.

b- Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

z. A.L, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, në 5 (pesë) procedura.

zj. XH.LL, me detyrë Nënkyetare e Bashkisë Skrapar, për mangësitë e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve në disa procedura prokurimi jo në përputhje me natyrën e kontratës, dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË SKRAPAR

kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST në 4 (katër) procedura.

z.XH.LI, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 4 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

z.M.H, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 3 raste, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

zj.L.N, Specialist i pyjeve në DSHP, për mangësitë e konstatuara në 1 rast, në marrëdhëniet kontraktore të Bashkisë Skrapar me palët e treta, për dhënien me qira të fondit pyjor/kullosor.

z.S.B, Inspektor i taksave në NJA Çepan për mangësitë e konstatuara në 6 raste, në administrimin e taksave dhe tarifave vendore (*Më hollësisht trajtuar në faqet 20-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Skrapar dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

Raport përfundimtar për auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Selenicë

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
II.	Hyrja	1. Objekti	4-6
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	6-19	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	6	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	6-7	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	7	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	7-15	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	15-16	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	16-17	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	17-19	
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	19-25	



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Bashkinë Selenicë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblylës me përfaqësuesit e Bashkisë Selenicë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 799/16 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p>1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 508,648 lekë pa TVSH nga BOE “J” SHPK & “C” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1423 Prot. datë 10.05.2021, me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 138,400 lekë pa TVSH nga OE “A.A2” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 818/1 Prot. datë 16.03.2021, me objekt “Rehabilitim Ura Brataj”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 254,080 lekë pa TVSH nga OE “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 830 Prot. datë 17.03.2021, me objekt “Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej</p>	15-16	E LARTË	Rekomandim: 1.1. Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHËTIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>471,240 lekë pa TVSH nga BOE “A.A2” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1031 Prot. datë 06.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 486,900 lekë pa TVSH nga OE “I.G” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 Prot. datë 12.05.2021, me objekt “Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p>			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Bashkinë Selenicë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 66%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 32 masa organizative, 5 masa shpërblim dëmi, 5 masa me 3E dhe 16 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 32 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 12 rekomandime, janë në proces zbatimi 10 rekomandime, 1 është zbatuar pjesërisht dhe janë pazbatuar 9 rekomandime.

Për shpërblim dëmi janë lënë 5 masa në vlerën 2,828 lekë, të cilat janë në proces zbatimi.

Janë lënë 5 masa me 3E nga të cilat një është zbatuar pjesërisht, 3 janë në proces dhe një është pazbatuar.

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 3, 5 janë në proces, ndërsa 8 nuk janë zbatuar.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Selenicë “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 628/5, datë 07.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O.L, Përgjegjës Grupi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

2. L.K, auditues
3. B.B, auditues
4. F.C, auditues

1. Objektivat e auditimit

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujour të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Selenicë dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Selenicë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

II. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Selenicë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Selenicë.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 799/16 prot, datë 24.01.2023, ka dërguar në Bashkinë Selenicë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Kryetari janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr. prot. 258/23, datë 23.02.2023) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr. 193 prot., datë 15.04.2021 nga ana e Bashkia Selenicë është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Nga ana e Bashkisë Selenicë janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.1646 prot., datë 26.07.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **58 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **32 masa organizative**, nga të cilat 16 janë zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 janë në proces zbatimi
- **5 masa shpërblim dëmi**, me status në proces
- **5 masa me 3E**, 3 janë zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 është në proces zbatimi
- **16 masa disiplinore**, nga të cilat 3 janë zbatuar, dhe 5 janë në proces

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr . per	Në mijë/lek	Nr . per	Në mijë/lek	Nr . Pers	Në mijë/lek	Nr . pers	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	32	16	6	9								
2.	Masa për përmirësim ligjor												
3.	Shpërblim dëmi	5		5			2,828				2,828		
4.	Masa efekt financiar	5	3	1	1		368				368		
5.	Masa disiplinore	16	3	5	8								
	Totali	58	22	17	18		3,196				3,196		

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

1.1 Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë Selenicë të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të përcaktohen procedurat antikorrupsion, rregulla të shkruara për sinjalizimin e parregullsive, si dhe të hartohen programe trajnimit për punonjësit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i zbatuar**.

1.2 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të hartohen rregulla të shkruara lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me anë të Kodit të Punës.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **në proces zbatimi**.

1.3 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa që në Rregulloren e Brendshme hartimi i detyrave dhe përgjegjësisve të shtrihet për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm në nivel drejtorie, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrën funksionale dhe përgjegjësit sipas pozicionit të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i zbatuar**.

2.1 Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihet edhe auditimi i procedurave të prokurimeve me vlera të larta dhe ato me vlera të vogla. T'u kërkohet subjekteve të audituara plani i veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve nga kjo Njësi me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **zbatuar**.

2.2 Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Selenicë të merren masa që të hartohen dhe plotësohen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dosja e auditimit, duke zbatuar njëkohësisht edhe detyrimet e ligjore të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm. Të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **zbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

3.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrë të gjitha masat për hartimin e Projekt Buxhetit Afatmesëm:

- Të hartojnë dhe të miratojnë Udhëzimi i Brendshëm për hartimin e PBA-së;
- Të përgatisë dhe të dërgojë për miratim në KB Tavanet Përgatitore të PBA-së brenda datës 15 mars të vitit përkatës;
- Të ngrihen Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) dhe të dokumentohet puna e tyre në hartimin e PBA-së;
- Të zbatohen afatet në miratimin e projekt dokumentit të PBA-së;
- PBA të hartohet mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, njësitë e varësisë, etj;
- Procesi i ndjekur për hartimin e PBA-së të dokumentohet në çdo fazë të tij, si dhe të bëhet publikimi brenda afateve;
- Në dokumentacionin që shoqëron procesin e hartimit të PBA-së të trajtohen risqet financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por në proces zbatimi.

4.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare të marrin masa që:

- Për ndryshimet e bëra në buxhetin vjetor të hartohet relacioni shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit si dhe të bëhet analiza e duhur se si ndikojnë ndryshimet në realizimin e objektivave të synuara të bashkisë;
- Të përgatitet dhe të paraqitet brenda afateve raporti përkatës pranë Këshillit Bashkiak për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Bashkia Selenice nepermjet Drejtorise se Finances ka bere te argumentuar ne Keshillin e Bashkise duke lene gjurme per cdo ndryshim te bere nga Keshilli i Bashkise.

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare në bashkëpunim me Ekipet e Menaxhimit të Programeve të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme dhe të përgjegjshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara. Planifikimi të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar Drejtoria e Shërbimeve Financiare të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të pa likuiduara të prapambetura, të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Të monitorohet me kujdes zbatimi i buxhetit si dhe të hartohen raportet periodike të monitorimit duke plotësuar të gjitha anekset përkatëse, të cilat më pas të paraqiten në Këshillin Bashkiak si dhe të dërgohen në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Zbatimi : Bashkia Selenice nepermjet Drejtorise se Finances ne nxjerrjen e llogarisë vjetore ka bashkelidhur relacionin spjegues te pasqyrave financiare .

6.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të bashkëpunojë me strukturat e tjera të bashkisë si dhe me institucionet e varësisë me qëllim



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

grumbullimin në mënyrë periodike të informacionit të nevojshëm për planifikimin e të ardhurave të veta të bashkisë. Gjithashtu, në vijim të analizojë të gjithë zërat e taksave dhe tarifave vendore me qëllim identifikimin e saktë të nivelit të realizimit duke argumentuar dhe dokumentuar realizimin e saktë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Bashkia Selenice nepermjet Drejtorise se Finances ne nxjerrjen e llogarisë vjetore ka bashkelidhur relacionin shpjegues te pasqyrave financiare .

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Bashkia Selenice nepermjet Drejtorise se Finances ne nxjerrjen e llogarisë vjetore ka bashkelidhur relacionin shpjegues te pasqyrave financiare .

8.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të sistemojë llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifave vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Deri më datë 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Sistemimi i kësaj llogarie është kryer sipas rekomandimit.

9.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 8,641,700 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

Deri më datë 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Sistemimi i kësaj llogarie është kryer sipas rekomandimit.

10.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

10.2 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore në pasqyrat e vitit 2022 të bëjë sistemimin e vlerës 58,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Sistemimi i kësaj llogarie është kryer sipas rekomandimit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

11.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të hartohen procesverbalet e transferimit dhe të marrjes në dorëzim të aktiveve nga Bashkia në Shoqërinë Ujësjetllës Selenicë për vlerën kontabël 526,501,279 lekë. Të bëhet pasqyrimi në kontabilitet të efekteve të transferimit.

Deri më datë 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Bashkia Selenice ne muajin korrik 2023 ka bere projekt vendimin per keshillin e Bashkise per kalimin e Sh.A.Ujesjellsit Selenice ne Sh.A Vlore Himare Selenice ketyre aseteve qe formalisht qendrojne prane bashkise selenice ndersa ne perdorim jane ne Sh.Ujesjellsit Selenice .

12.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i pazbatuar.

13.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa në të ardhmen që ngritja dhe përbërja e komisionit të inventarizimit të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe nga komisionet e inventarizimit të hartohet raporti për inventarin fizik në përfundim të procesit të inventarizimit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Zbatimi: Me urdhër nr.185, nr.2696 prot., 21.11.2022 është ngritur Komisioni të Inventarizimit të Aktiveve për vitin 2022.

13.2 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i pazbatuar.

14.1 Rekomandim: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 71,283,867 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

15.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa për kalimin e fondeve të secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimit të kryer për periudhën e garancisë.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

16.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

procedurë të vendosë kritere të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

17.1 Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

18.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Përpara fillimit të procedurës të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.

-Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit.

-Të hartohen dhe nënshkruhen deklaratat e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Të respektohet afati njoftimit për kalimin nga një operatorë ekonomikë tek tjetri në rastet e tërheqjes apo skualifikimit të tyre për procedurat të cilat zhvillohen në Sistemin e Prokurimit Elektronik të APP-së.

-Për rastet në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e përcaktuar në kriteret e ftesës për ofertë si dhe për rastet që mallrat e prokuruarat nuk paraqiten nga operatori ekonomikë brenda afateve të përcaktuara në ftesën për ofertë, të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit referuar përcaktimeve ligjore.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Për çdo dosje të procedurave të prokurimit me vlera të vogla pas përfundimit të vitit ushtrimor të inventarizohen si dhe të kryhet arkivimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

19.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 588/7, datë 08.11.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Selenicë”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

- Nga Këshilli Bashkiak të analizohet dhe të dalë përgjegjësia për ndërtimin pa leje të rikonstruksionit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit Selenicë, Kote dhe Armen, si dhe shpimi i pusit gjeologjik në fshatin Kotë, kryer pa leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore dhe të merren masa për të parandaluar në të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

- Të merren masa për zbatimin e procedurave ligjore dhe të kërkohet zhdëmtimi i vlerës së karburantit të pajustificuar me dokumente nga:

1. F.V ish kryeinspektor i Policisë Bashkiake për periudhën nga data 01.01.2019 deri më 31.01.2020 për vlerën 317,761 lekë;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

2. S.H ish Drejtor i Territorit për periudhën nga data 01.02.2020 deri më 28.02.2020 për vlerën 13,857 lekë.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **zbatuar**.

Zbatimi: Aktualisht çështja është në proces gjyqësor.

19.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH-së.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **zbatuar**.

19.3 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

20.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:

- Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre.
- Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.
- Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave.
- Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

Deri më 31.12.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

21.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të monitorojë rregullisht zbatimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, të dokumentojë këtë proces si dhe të veprojnë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu, në rastet e lidhjes së kontratave të tjera të këtij lloji, Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara të kryejë dhe të dokumentojë procesin e vlerësimit në të gjitha hapat e zhvillimit të tij si dhe dosjet e aplikuesve/fituesve të jenë të plotësuara me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

22.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që:

- Të hartojë planet e mbarështimit të kullotave që ka në administrim;
- Të nxisë blegtorët që ju jep në përdorin kullota pa lidhur kontratat përkatëse që të pajisen me Nipt si dhe të fillojnë regjistrimin e bagëtive në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar;
- Të sigurohet që të gjithë blegtorët të lidhin kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve kullimore;
- Të planifikojë dhe të kryejë investime në përmirësimin e kullotave, riparimin apo ndërtimin e lerave.

Deri më 31.12.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pazbatuar**.

Zbatimi: Mbarështimi i sipërfaqeve kullimore nuk ka filluar për mungesë të fondeve dhe kapaciteteve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

23.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të ardhurat e siguruara nga përdorimi i fondit pyjor dhe kullor të përdoren në funksion të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, kryerjen e punimeve të pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit, etj.

Në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por i pazbatuar.

Zbatimi: Nga ana e drejtorisë përgjegjëse janë bërë kërkesat për planifikimin e fondeve (shkresa nr.2492/2 prot., datë 02.11.2022), por nuk janë miratuar.

24.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave të marrin masa që:

- Të hartojnë Planet e mbarështimit të pyjeve që kanë në territorin e bashkisë;
- Të kryejnë periodikisht procesin e vlerësimit të fondit pyjor me prerje rigjeneruese duke hartuar projektet teknike të shëndetësimit të pyjeve rast pas rasti;
- Të fillojnë procedurat e ankandit për ato ngastra që është miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit projekti për shëndetësimin e sipërfaqeve pyjore;
- Të dokumentohet i gjithë procesi në çdo hap të tij.

Deri në Dhjetor 2023 dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

25.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

1. T'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullor mbetura.
2. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.
3. Të vendosen marrëdhënie kontraktuale me Operatorët Ekonomikë duke hartuar kontratë përkatëse të qirave për sipërfaqen totale prej 1,231.1 ha, duke aplikuar tarifën dysHEME/minimal për të llogaritur vlerat e sakta të qirasë referuar llogaritjeve që ka kryer grupi i auditimit (80,078,812, për 17 subjekte, Aneksi nr. 2.6/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.
5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet "S SHPK", "A SHPK", "T.I SHPK", "B.M.I SHPK" që kanë aktive 6 leje minerare në territorin e Bashkisë Selenicë me detyrime vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe zbatuar pjesërisht.

Zbatimi: Rekomandimi nuk është zbatuar për pikën 4 dhe 5.

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

Nga auditimi u konstatua si vijon:

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **2,828,092 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **508,648 lekë pa TVSH** nga BOE “J” SHPK & “C” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1423 Prot. datë 10.05.2021, me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfra dhe të pa favorizuara”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.
Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,400 lekë pa TVSH** nga OE “A.A2” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 818/1 Prot. datë 16.03.2021, me objekt “Rehabilitim Ura Brataj”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.
Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **254,080 lekë pa TVSH** nga OE “J” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 830 Prot. datë 17.03.2021, me objekt “Sistemim-Asfaltim lagjja Tubo – Rromës (rruga e varrezave, spitalit”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.
Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **471,240 lekë pa TVSH** nga BOE “A.A2” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1031 Prot. datë 06.04.2021, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme me beton”, Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.
Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Selenicë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **486,900 lekë pa TVSH** nga OE “I.G” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1456 Prot. datë 12.05.2021, me objekt “Rehabilitime emergjente për kanalet Mesaplik, Lepenicë, Drashovicë”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

Bashkia Selenicë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Zbatimi: Ndalesa do të bëhet nga garancia e punimeve.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masat e duhura ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 244 debitorë në vlerën 6,251,627 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Drejtoria e të Ardhurave të dërgojë informacion periodik në Drejtorinë e Financës lidhur me listën e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Selenicë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Zbatimi: Janë bërë njoftimet nëpërmjet shkresave përkatëse.

2.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën totale **362,065,059 lekë**, e përbërë nga:

- **4,110,003 lekë** detyrime për taksën e ndërtesës për 6343 familje;
- **255,577,812 lekë** detyrime për taksën e tokës bujqësore për 7516 familje;
- **38,882,100 lekë** detyrime nga biznesi i vogël për 470 subjekte;
- **37,930,263 lekë** detyrime nga biznesi i madh për 15 subjekte;
- **25,510,831 lekë** detyrime për taksat familjare (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim) për 7640 familje;
- **54,050 lekë** detyrime nga tarifa e vaditjes.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Tatim Taksave, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e DAPPLL të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- DAPPLL të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Selenicë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Zbatimi: Janë dërguar njoftimet përkatëse sipas rekomandimit të lënë nga KLSH (dokumentacioni bashkëlidhur).

3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “T.O”, “X.H.G”, “M.O”, që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke kryer pagesa të plota apo të pjesshme. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për subjektet “P SHPK” dhe “D.GJ SHPK” me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, por pa zbatuar.

4.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë të rivlerësojë shkeljet e konstatuara referuar kundërvajtjes dhe të marrë masat për dënim me gjobë bazuar në llojin e shkeljes së kryer. Gjithashtu, në vijimësi për çdo proces verbal të konstatimit të kundërvajtjes të vendosen masat administrative përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar pjesërisht.

Zbatimi: Në proces verbalet të konstatimit të kundërvajtjes janë vendosur masat administrative përkatëse. Ndërsa për shkeljet e konstatuara në vitin 20121 nuk është parë e arsyeshme rivlerësimi për arsye sepse kanë kaluar rreth dy vjet.

Masa 3E

1.1-1.2 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DST, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

2.6.Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore, u konstatua si vijon:

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 germa g, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse referuar nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nga



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

“Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. K.B** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve për problemet e konstatuara në menaxhimin e arkëtimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.

2. **Z. E.F** me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative, Menaxhimi i Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi për vitin 2021 për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

3. **Z. B.K** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e aktiviteteve të zhvilluara në fondin pyjor dhe kullor si dhe aktivitetet e prerjeve rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor.

4. **Z. M.H** me detyrë Jurist / Njësia e Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

5. **Z. A.V** me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (Njësia e Prokurimit) për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Zbatimi: Me urdhër të Kryetarit është ngritur Komisioni Disiplinor më datë 22.02.2023, por deri më tani nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, kontratën individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Selenicë** që bazuar në shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1. **Z. R.G** me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

2. **Zj. E.H** me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

3. **Z. V.T** me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

4. **Z. V.S** me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

5. **Z. D.A** me detyrë inspektor në IMTV për problemet e konstatuara në lidhje me planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

6. **Z. C.H** me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

7. **Z. O.GJ** me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

8. **Z. A.C** me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

9. **Z. P.H** me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **zbatuar pjesërisht**.

Zbatimi: Punonjësit e mësipërm kanë marrë masë disiplinore “Vërejtje”, përveç punonjësit P.H, R.G dhe E.H.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË
BASHKINË SELENICË

III. Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit

Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit të pleqërisë nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë por i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Selenicë të marrë masat për të ndërprerë marrëdhëniet e punës për:

1. Z. L.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

2. Z. SH.D me detyrë Inxhinier Pyjesh në Drejtorinë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave.

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, por **nuk është zbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 799/16 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

12.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa për hartimin e regjistrit të aktiveve që Bashkia zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së institucionit dhe mirë menaxhimin e tyre.

13.2 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrin masa në të ardhmen që në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

14.1 Rekomandim: Me qëllim që të mos krijohen detyrime të prapambetura dhe planifikimi i shpenzimeve të një viti buxhetor të mos rëndoj shpenzimet e vitit pas ardhës, Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe Drejtoria e Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për pagesën e faturave të pa likuiduara në vlerën totale 71,283,867 lekë gjithashtu të paraqesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë grafik për shlyerjen e tyre, në përputhje me kërkesat ligjore për radhën e pagesave.

16.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë të analizojë arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë e anomalive të konstatuara në hartimin e kriterëve të veçanta të DST. Njësia e prokurimit në çdo procedurë të vendosë kriterë të veçanta për kualifikim që të kenë lidhje të ngushtë me volumin e natyrën e kontratës.

17.1 Rekomandim: Titullari i AK të analizojë arsyet e anomalive në vlerësimin e ofertave nga KVO, lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa që në të ardhmen të eliminohen praktika të tilla nga KVO.

19.3 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masat që të njoftojë Departamentin e Administratës Publike lidhur me marrjen e masave disiplinore për nëpunësit e bashkisë referuar shkeljeve të konstatuara nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil.

20.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë Selenicë të marrë të gjitha masat për të filluar procesin e inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:

- Të ngrejë një grup pune për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

- Të vendosë komunikim me ASHK-në me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.
- Të angazhojë Drejtorinë Juridike për verifikimin e gjendjes juridike të pronave.
- Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

22.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që:

- Të hartojë planet e mbarështimit të kullotave që ka në administrim;
- Të nxisë blegtorët që ju jep në përdorin kullota pa lidhur kontratat përkatëse që të pajisen me Nipt si dhe të fillojnë regjistrimin e bagëtive në Sistemin e Informacionit Blegtoral dhe Veterinar;
- Të sigurohet që të gjithë blegtorët të lidhin kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqeve kullimore;
- Të planifikojë dhe të kryejë investime në përmirësimin e kullotave, riparimin apo ndërtimin e lerave.

23.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë të marrë masa që të ardhurat e siguruar nga përdorimi i fondit pyjor dhe kullor të përdoren në funksion të mbrojtjes dhe rimëkëmbjes së pyjeve, ndërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës pyjore, zhvillimin dhe shtimin e sipërfaqes së pyjeve dhe volumit të tyre, hartimin dhe zbatimin e planeve të mbarështimit, kryerjen e punimeve të pastrimit, të mirëmbajtjes e të përmirësimit, etj.

25.1 Rekomandim: Bashkia Selenicë, Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave duhet të marrë masa të menjëhershme lidhur me:

4. Gjatë hartimit të raporteve tekniko-ekonomike rast pas rasti të vlerësohet saktë lloji i bimësisë dhe lëndës drusore që ndodhet në sipërfaqen për të cilën po hartohet raporti, si dhe llogaritja e vlerës të jetë gjithashtu referuar llojit të bimësisë apo lëndës drusore.

5. Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që të ngarkojë subjektet “S SHPK”, “A SHPK”, “T.I SHPK”, “B.M.I SHPK” që kanë aktive 6 leje minerare në territorin e Bashkisë Selenicë me detyrime vendore referuar përcaktimeve të Vendimit të Këshillit Bashkiak për miratimin e Pakës Fiskale (*Më hollësisht trajtuar në faqe 7-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 799/16 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

3.1 Rekomandim: Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa që subjektet “T.O”, “X.H.G”, “M.O”, që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke kryer pagesa të plota apo të pjesshme. Gjithashtu, DAPPLL të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për subjektet “P SHPK” dhe “D.GJ SHPK” me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

4.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Selenicë të rivlerësojë shkeljet e konstatuara referuar kundërvajtjes dhe të marrë masat për dënim me gjobë bazuar në llojin e shkeljes së kryer. Gjithashtu, në vijimësi për çdo proces verbal të konstatimit të kundërvajtjes të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

vendosen masat administrative përkatëse (Më hollësisht trajtuar në faqe 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 799/16 prot, datë 24.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64 germa g, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse referuar nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nga “Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, në proporcion me shkeljen, për punonjësit e mëposhtëm:**

- 1. Z. K.B** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve për problemet e konstatuara në menaxhimin e arkëtimeve nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.
- 2. Z. E.F** me detyrë Kryeinspektor në Inspektoratin Tatimor të Kundërvajtjeve Administrative, Menaxhimi i Debitorëve, Konfiskimi dhe Sekuestrimi për vitin 2021 për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.
- 3. Z. B.K** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e aktiviteteve të zhvilluara në fondin pyjor dhe kullor si dhe aktivitetet e prerjeve rigjeneruese dhe shfrytëzimin e lëndës drusore në fondin pyjor.
- 4. Z. M.H** me detyrë Jurist / Njësia e Prokurimit për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.
- 5. Z. A.V** me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, Burimeve Natyrore, Mjedisit, Projekteve dhe Investimeve (Njësia e Prokurimit) për shkeljet e konstatuara në hartimin e kriterëve të kualifikimit për procedurat e prokurimit.

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, kontratën individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Selenicë që bazuar në shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së, të fillojnë**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË
BASHKINË SELENICË

procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. R.G me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

2. Zj. E.H me detyrë inspektor në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave për veprimet dhe mosveprimet në menaxhimin e të ardhurave dhe borxhit tatimor.

9. Z. P.H me detyrë Inspektor në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave për problemet e konstatuara në menaxhimin dhe mbrojtjen e pyje kullotave.

III. Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit

Për punonjësit që kanë mbushur moshën e pensionit të pleqërisë nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara ekzistojnë por i rekomandojmë Titullarit të Bashkisë Selenicë të marrë masat për të ndërprerë marrëdhëniet e punës për:

1. Z. L.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Financiare, Juridike dhe Burimeve Njerëzore.

2. Z. SH.D me detyrë Inxhinier Pyjesh në Drejtorinë së Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve Kullotave (*Më hollësisht trajtuar në faqe 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Selenicë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË
LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Pustec

Raport Përfundimtar Auditimi Tematik

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË PUSTEC

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
II.	Hyrja	1. Objekti	4-6
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodot e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	6-16	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	6	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	6	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	6-7	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	8	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	8-12	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	12-13	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	13-14	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	14-16	
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	16-25	



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Bashkinë Pustec, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyllës me përfaqësuesit e Bashkisë Pustec.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p><u>1.1. Rekomandim:</u> Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 847,620 lekë pa TVSh nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për arkëtimin e vlerës prej 847,620 lekë pa TVSh nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p>1.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën 17,853,280 lekë.</p>	12-14	E LARTË	<p>Rekomandim: 1.1. Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.</p> <p>Rekomandim: 2.1. Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës ekonomike e cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondit të prokuruar.</p> <p>Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Bashkinë Pustec, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 87%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 22 masa organizative, 2 masa shpërblim dëmi, 3 masa me 3E, 10 masa administrative dhe 1 masë disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 22 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 5 rekomandime, janë në proces zbatimi 13 rekomandime, 1 është zbatuar pjesërisht dhe janë pazbatuar 3 rekomandime.

Për shpërblim dëmi janë lënë 2 masa në vlerën 6,450 lekë, nga të cilat një është zbatuar në vlerën 5,602 lekë ndërsa tjetra është në proces zbatimi.

Janë lënë 3 masa me 3E nga të cilat një është zbatuar pjesërisht, një janë në proces dhe një është pazbatuar.

Janë lënë 10 masa administrative të cilat janë zbatuar të gjitha.

Përsa i përket masave disiplinore, është rekomanduar 1 masë e cila është zbatuar.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Pustec “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 628/5, datë 07.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O.L, Përgjegjës Grupi
- 2 L.K, auditues



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

3. B.B, auditues

4. F.C, auditues

1. Objekti

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujour të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Pustec dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Pustec, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Pustec është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Pustec.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, ka dërguar në Bashkinë Pustec Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.

- Nga Kryetari janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr. prot.145, datë 30.01.2023) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.193 prot., datë 15.04.2021 nga ana e Bashkia Pustec është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Bashkisë Pustec janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË PUSTEC

Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.1646 prot., datë 26.07.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **38 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **22 masa organizative**, nga të cilat 12 janë zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 janë në proces zbatimi
- **2 masa shpërblim dëmi**, nga të cilat 1 është zbatuar
- **3 masa me 3E**, 1 është zbatuar, 1 është zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 është në proces zbatimi
- **10 masa administrative**, nga të cilat 10 janë zbatuar
- **1 masë disiplinore**, nga të cilat 1 është zbatuar

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr për	Në mijë/lek	Nr për	Në mijë/lek	Nr për	Në mijë/lek	Nr për	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	22	12	6	3								
2.	Masa për përmirësim ligjor												
3.	Shpërblim dëmi	2	1	-	1		6,450		5,602				848
4.	Masa efekt financiar	3	1	1	-		17,853				1,856		15,997
5.	Masa disiplinore	1	1										
	Totali	28	15	7	4		24,303		5,602		1,856		16,845



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe vijimësi

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, por **është zbatuar pjesërisht**.

Per vitin 2021 nuk eshte bere asnje veprim per strategjinë e risqeve , gje e cila u permiresua per vitin 2022 dhe ne vazhdim ;Jane kryer nje sere investimesh ne sistemin kompjuterik dhe po punohet per programet lehtesuese , ne fushen e finances tatim taksave dhe urbanistikes.

Eshte hartuar programi i trajnimit te punonjesve ne bashkepunim me ASPA.

1.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec në bashkëpunim me Sektorin Juridik, të marrë masa për përmirësimin e rregullores së brendshme në drejtim të dorëzimit të detyrës nga personat e larguar, duke përcaktuar detyrimin që ka punonjësi për dorëzimin e aktiveve që ka në inventar dhe të gjithë punës së kryer, dosjeve shkresore, dokumentacionit elektronik, e gjithçka të krijuar nga punonjësi gjatë qëndrimit të tij në detyrë, e cila duhet të konsiderohet “pronë e institucionit”. Gjithashtu të përcaktohen edhe detyrimet e strukturave përkatëse të institucionit për këtë qëllim: sektori i shërbimeve, burimeve njerëzore, financës, etj.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Eshte punuar nga sektori i burimeve njerzore mbi permiresimin e rregullores (kjo miratuar me vendim te Keshillitit te bashkise Nr 18 dt28.02.2023 Nr302/1 Prot (Miratimin e rregullores per organizimin dhe funksionimin.detyrat dhe pergjegjesite e strukturave te institucionit te bashkise Pustec)



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

1.3 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për hartimin e rregullave për ruajtjen e aktiveve, duke përfshirë edhe ruajtjen dhe sigurinë e informacionit elektronik, për shpeshësinë e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, llojet e raporteve që i përgatiten etj. Në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Nuk është hartuar regjistri i risku, por po punohet për vitet në vazhdim, Raportimet në shkallë hirarkie behen në mënyrë shkresore ose të drejtperdrejt në takimet e punës.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec, të marrë masa për ngritjen dhe miratimin në strukturën organizative të Bashkisë Pustec, Njësinë e Auditit të Brendshëm për kryerjen e funksioneve kontrolluese të veprimtarisë ekonomike financiare të kësaj njësie vendore. Në rast të mos plotësimit të kësaj strukturë me personel të kualifikuar, të shikohet mundësi e lidhjes së aktmarrëveshjes me bashkitë kufitare për kryerjen e këtij shërbimi, si Bashkisë Korçë, Maliq ose Devoll.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Bashkia ka pas një marrëveshje për audit të brendshëm me bashkinë e Devollit por perfundoi afati dhe po punon për të mundësuar një marrëveshje të re me bashkinë e Devollit për sigurimin e auditit të brendshëm.

3.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 2,339,662 lekë, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është pazbatuar**.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Pustec të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit.

Menjëherë dhe vijimësi

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

5.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa për kontabilizimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën 17,853,280 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Sektori i finances ka bërë kontabilizimin e llog 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 17,853,280 leke e cila është nxjerrë nga sektori i tatim taksave si detyrim pa paguar nga ana e komunitetit të bashkisë sonë, kjo vlerë u pasqyrua në bilancin e vitit 2022.

6.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “Studime e kërkime”, duke bërë kreditimin e saj në debi të Aktiveve Afatgjata Materiale si pjesë e kostos së tyre, në vlerën 2,865,892 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Sipas Rekomandimit 6.1 mbi shpërndarjen e llog 202 “studime e kërkime” për shumën 2,865,892 lekë për 22 projektet u krye shpërndarja e saj sipas investimeve perkatëse nga sektori i finances dhe është pasqyruar në bilancin e vitit 2022.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

7.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Sipas Rekomandimit 7.1 sektori i finances ne llog 212 “Ndertesa konstruksione”, u shtuan shtesat per rikonstruksion dhe mirmbajtjen e ketyre aseteteve e cila u pasqurua ne mbylljen e bilancit 2022.

8.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të vlerave të këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Sipas Rekomandimit 8.1 sektori i financës ne llog 213 “Rruge rrjete vepra ujore”, u shtuan shtesat per rikonstruksion dhe mirëmbajtjen e ketyre aseteteve e cila u pasqurua ne mbylljen e bilancit 2022.

9.1 .Rekomandimi: Sektori i Financës të kryej transferimin e asetëve që i përkasin Ujësjellës Kanalizime SHA Pustec me akte marrje në dorëzim të firmosura nga të dy palët dhe të kryhen veprimet kontabël duke zbritur nga llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” vlerën për investimet e kryera në shumën 1,750,944 lekë.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është në zbatim**.

Nga verifikimi rezultoi se, eshte ne procest transferimi me shkrirjenn e SHA- bashkia pustec dhe kalimin në shoqëri te perbashket K.

10.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, të marrë masa për sistemimin e llogarive të Klasës së 4 të Pasivit të bilancit për diferencën në vlerën 1,143,781 lekë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Eshte kryer sistemimi i llogarive te klases 4 te pasivit per diferencen 1,143,781 lek dhe eshte pasqyruar ne bilancin e vittit 2022.

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Drejtoria Korçë dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Grupi i ngritur me Urdhrit të Kryetarit të bashkisë nr. 166 datë 31.10.2019 mbi ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e objekteve prioritete të bashkisë sipas listës përfundimtare për transferimin e pronave të paluajtshme në juridiksionin territorial të bashkisë Pustec ndryshuar me Udhërit nr. 149 prot, datë 27.09.2021 (zëvendësimi i një anëtari të larguar) ndryshuar me Urdher Nr 147.dt 17.08.2022(per zevendesim te nje anetari). Ndërsa sektori i finances ngarkuar per kontabilizimin e tyre.

12.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë dhe vijimësi

Komente: Rekomandimi është pranuar, por nuk është zbatuar.

13.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë dhe vijimësi

Komente: Rekomandimi është pranuar, por nuk është zbatuar.

14.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec, të analizojë mangësitë e konstatuara nga grupi i KLSH në procedurën me objekt “*Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi të ndryshme*”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për vlerësim jo të drejtë të procedurës, si dhe të marrë masa që në të ardhmen të analizojë raportet e komisionit të vlerësimit të OE fitues që të jenë në përputhje me kuadrin ligjorë dhe në plotësim të kriterëve të DST të miratuara nga AK.

Brenda datës 30.03.2023

Komente: Rekomandimi është pranuar, dhe është në proces.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec, në cilësinë e titullarit të AK të marrë masa që në të ardhmen në mungesë të personelit të kualifikuar të argumentojë marrjen në komision si anëtarë të NJHDT/KVO të specialistëve të jashtëm me profil sipas tipologjisë së procedurës që zhvillohet dhe jo të çfarëdolloj.

Gjithashtu në rastet e largimit të anëtarëve të komisionet e NJP/KVO të argumentohet arsyeja dhe të kryhet sipas afateve ligjore pa filluar procedura e aplikimit të kriterëve ose vlerësimit të dokumentacionit të OE pjesëmarrës.

Në vijimësi

Komente: Rekomandimi është pranuar, dhe i zbatuar.

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit të infrastrukturës nga Sektori i Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë. Gjithashtu duke qenë se Bashkia Pustec bën pjesë në zonat e mbrojtura, përpara hapjes së ndonjë procedure prokurimi në investime e cilat prekin zonat e mbrojtura të merret paraprakisht miratimi nga instancat përkatëse për zhvillimin ose jo të zonës ku do shtrihet projekti.

Në vijimësi

Komente: Rekomandimi është pranuar, dhe është në proces.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Pustec (*grupi i punës apo komisioni përkatës*), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të parashikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

Në vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË
LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **i zbatuar**.

18.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për përshejtimin e zbatimit të plotë të rekomandimeve në proces zbatimi, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 870/9, prot, datë 23.12.2021 “Për zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Pustec”, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre.

Brenda datës 31.03.2023

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është në proces**.

19.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pustec të merren masa, duke ngritur grupe pune me përbërje inxhinierë të fushës, që para likuidimit të situacioneve pjesore dhe përfundimtare, të bëhet kontrolli sipas librezave të masave të paraqitur nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve, të cilat duhet të shoqërojnë situacionet përkatëse në çdo fazë punimesh.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është në proces**.

20.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pustec të merren masa, që për zërin e ri të punës “ FV tubacion PE100RC me Dj 110 mm Pn16”, për të cilin nuk administrohen faturat në lidhje me çmimet e blerjes, Komisioni i Marrjes në Dorëzim të objektit, në bashkëpunim me mbikëqyrësin, të hartojnë analizën korrekte të çmimit, referuar faturave të blerjes dhe analizave teknike në fuqi, me vlerën ekonomike më të mirë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është në proces**.

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **6,450,180 lekë**, si më poshtë:

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe nuk është zbatuar.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pustec të ngrëjë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, të vlerësojnë e të analizojnë zërin e punimeve “Mbushje me zhavorr në rrugë”, i cili nuk është i situacionuar sipas librezës së masave në vlerën **5,602,560 lekë** nga sipërmarrësi i punimeve, për të përcaktuar volumet sipas punimeve të kryera në fakt, duke bërë rakordimin në situacionin përfundimtar dhe në rast difference në volume, të merren masa për arkëtimin e kësaj vlere nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”.

Menjëherë

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar.

Nga verifikimi rezulton se me shkresën nr. 514 prot., datë 06.04.2023, është nxjerrë urdhri i titullarit të bashkisë nr. 66, datë 06.04.2023 “Për ngritjen e grupit të Punës”, për të verifikuar zërin (mbushje me zhavorr në rrugë) i përberë nga tre specialist. Akt vlerësimi i grupit të punës, konstaton në terren se këto punime në fakt janë kryer. Akti i vlerësimit është firmosur prej sipërmarrësit të punimeve, mbikëqyrësi të punimeve dhe komisionit të bashkisë. (Bashkëlidhur Dokumentacioni).

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

1.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **17,853,280 lekë**.

Brenda datës 31.03.2023

Zbatimi: Në bazë rekomandimeve të KLSH-së me nr. 884/11 prot., datë 18.01.2023, Sektori i Tatim Taksave për të arkëtuar detyrimet tatimore të prapambetura ka marrë masat si më poshtë: Janë dërguar njoftim vlerësimi tatimor subjekteve për shumën e debisë prej 261,452 lekë dhe familjarëve për shumën 17,591,828 lekë, në total 17,853,280 lekë. Janë bërë urdhër bllokime të llogarive bankare për subjektet me urdhër bllokimi nr. 179 prot datë 07.02.2023. Debitorët janë pakësuar për vlerën 1,856,632 lekë për 104 subjekte dhe familje. Në mars 2023 gjendje debitorësh paraqitet për vlerën 15,996,648 lekë për 1205 subjekte dhe familje.

Është dërguar Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Korçë kërkesë për vendosjen e barrës së sigurisë për mjetet me nr. 180 prot datë 07.02.2023.(Bashkëlidhur dokumentacioni)

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në vitin paraardhës, sasi e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Bashkia Pustec ka planifikuar dhe miratuar noramtivat e karburantit sipas automejetve të saj dhe i ka miratuar në këshillin bashkiak, sipas vendimit nr. 12 dhe 13, datë 09.02.202 “Për miratimin e normës së harxhimit të karburantit për automjetet e bashkie Pustec”. (Bashkelidhur dokumentacioni)

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar.

3.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pustec në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertës ekonomike e cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondit të prokuruar.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Zbatimi: Ky rekomandim është në proces zbatimi për vitin 2023 dhe në vazhdim.

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është proces zbatimi.

2.6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore, u konstatua si vijon:

D. MASA DISIPLINORE

D/1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Në zbatim të këtij rekomandimi titullari i Bashkisë Pustec ka nxjerrë vendimin nr.2, datë 21.07.2023 administruar me nr.927 prot., ka vendosur marrjen e masave disiplinore për 1 punonjës Donka Sotiri “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”.

E. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 2.4 faqe 50-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pustec që në zbatim të nenit 132, të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, **t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **10 (dhjetë)** punonjësve/ dhe ish- punonjësve, si më poshtë:

1. **Zj. F.S**, në cilësinë e Përgjegjës të Procedurës, specialiste e jashtëm sipas aktmarrëveshje datë 30.12.2020, me profil Jurist.
2. **Z. V.A**, me detyrë me detyrë inxhinier Bashkia Pustec.
3. **Zj. S.M**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Burimeve Njerëzore.
4. **Zj. L.C**, me profesion inxhinier Gjeodet, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis Bashkisë Pustec.
5. **Zj. H.G**, me profesion inxhinier Mjedisi me profil trajtim të ujërave, specialiste e jashtme sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020 të lidhur midis bashkisë Pustec.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në aplikimin e kriterëve jo të mirë argumentuara në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, në shkelje të nenit 77, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe jo në përshtatje me objektin e procedurës së prokurimit, duke çuar në mospjesëmarrjen e OE apo në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme.

6. **Z J.K**, me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë Pustec.
7. **Z. V.S**, me detyrë Specialist në Sektorin e Procedurave.
8. **Zj. N.K**, specialiste e jashtme me arsim të lartë “shkenca politike”, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
9. **Zj. E.B**, specialist i jashtëm me profil ing. Elektrik, sipas aktmarrëveshjes datë 30.12.2020.
10. **Z. I.M** me detyrë ish- specialist Sektori i Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Furnizimi me ujë i Bashkisë Pustec*” me fond limit 456,525,537 lekë, ku bashkimi i OE “*G C.*” *shpk* & “*SH*” *shpk*, i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, dhe **është zbatuar**.

Kryetari i bashkisë Pustec i është drejtuar APP-së me shkresën nr.249 prot., datë 20.02.2023 lidhur me vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga KLSH dhe marrjen e masave përkatëse për personat përgjegjës. APP me vendimin nr.46, datë 29.06.2023 dërguara Bashkisë Pustec me shkresën nr.2476/6 datë 29.06.2023, për dijeni KLSH ka vendosur marrjen e masave administrative me gjobë për personat përgjegjës sipas rekomandimit të KLSH, si dhe i ka propozuar bashkisë Pustec marrjen e masave disiplinore për dy punonjës në cilësinë e anëtarëve të KVO për prokurimet me vlerë të vogël.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË PUSTEC

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

Komente: Rekomandimi është **pranuar**, por **nuk është zbatuar**.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Pustec, me atributet e Kryetarit të GMS, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryejë procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara.

Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurojë raportime të vazhdueshme nga menaxherët të programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe Ndikimi/Efektiviteti. Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

3.1.Rekomandimi: Sektori i Financës, për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën 2,339,662 lekë, sipas nivelit të realizimit të të ardhurave.

12.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "*Shpenzime në proces për rritjen e AQT*", deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

13.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Pustec, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e më parë (vlera 918,857 lekë), për të cilat ka humbur e drejta e përfitimit të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Korçë, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik (*Më hollësisht trajtuar në faqe 8-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Pustec të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera, për arkëtimin e vlerës prej **847,620 lekë pa TVSh** nga BOE “G” SHPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 194/4 prot, datë 06.04.2021, me objekt “Furnizimi me ujë i fshatrave të Bashkisë Pustec”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera (*Më hollësisht trajtuar në faqe 12-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Pustec, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 17,853,280 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqe 13-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 884/11 prot, datë 18.01.2023, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

Për punonjësit për të cilët do merret masë disiplinore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të **ndërmarrë veprimet si më poshtë:**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË
LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË PUSTEC

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në faqe 16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
- 1.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përkatëse, për rekomandimin e evidentuar më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tij.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN
2022” NË BASHKINË KORÇË

Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Korçë

Raport Përfundimtar Auditimi Tematik

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-6
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
II.	Hyrja	1. Objekti	6-7
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodot e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	7-25	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	8	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	8-9	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	9	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	9-13	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	13-15	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	16-19	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	19-25	
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	25-35	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

I.Përmbledhje Ekzekutive

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt “Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022” në Bashkinë Korçë, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmblyllës me përfaqësuesit e Bashkisë Korçë.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p>Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, Titullari i Njësisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 33,912,481 lekë, si më poshtë:</p> <p><u>1.1. Rekomandimi:</u> Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 385,650 lekë në ngarkim të z. P.P me funksion ing. Hidroteknik, Përgjegjës i Sektorit të Kullimit Ujitjes në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Korçë, si rrjedhojë e mos respektimit të kuadrit përkatës ligjor</p>	13-15	E LARTË	Rekomandim: 1.1. Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>në drejtim të përcaktimit të fondit limit në objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion i pritave malore në fshatrat Polenë, Mborje, Barç dhe mur mbrojtës në Shkozanj”.</p> <p>2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të mallit (asfaltobetoni) me vlerë 7,045,282 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës: komisioni i marrjes në dorëzim M.H, K.Z dhe A.H dhe Drejtori i NSHP Bashkia Korçë z. I.D, në mënyrë të barabartë.</p> <p>2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Korçë të analizojnë me kujdes kërkesën e NSHP Bashkia Korçë për fondet e kërkuara dhe të deleguara për riparimin e rrugëve në juridiksionin e Bashkisë Korçë, duke kërkuar një analizë të detajuar të rrugëve të riparuar në vitin që mbyllet dhe atyre që do riparohen në vitin vijues.</p> <p>2.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të angazhojë me shpesh Njësinë e Auditit të Brendshëm Bashkia Korçë, për kryerjen e misionëve të auditimit në NSHP Bashkia Korçë, mbi mënyrën e përdorimit të fondeve publike të deleguara nga bashkia, për të pasur një situatë reale të menaxhimit të këtyre fondeve.</p> <p>3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë të pajisjeve prej 339,235 lekë, rënduar padrejtësisht vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti “A.C” shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.</p> <p>4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të karburantit me vlerë 3,063,534 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës, për zbatimin e procedurave ligjore për harxhimin e karburantit, I.D, A.N, V.D, P.M, E.Sh, në mënyrë të barabartë.</p> <p>4.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të angazhojë në mënyrë të vazhdueshme Njësinë e Auditit të Brendshëm Bashkia Korçë, për kryerjen e misionëve të auditimit në NSHP Bashkia Korçë, mbi mënyrën e përdorimit të</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>fondeve publike të deleguara nga bashkia, për të pasur një situatë reale të menaxhimit të këtyre fondeve, për shpërndarjen dhe konsumin e karburantit.</p> <p>6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 464,076 lekë pa TVSh nga OE "I" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7460/2 prot datë 14.10.2020 me objekt "Rikonstruksioni i rrugës "Koço Glozheni", Fshati Dardhë", Bashkia Korçë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 17,556,990 lekë në ngarkim të 13 subjekteve, për përlogaritje të pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të dhënat në Tabelën Aneks 5/1 bashkëlidhur.</p> <p>8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për përcaktimin dhe saktësimin e personave përgjegjës në shpalljen fitues të shoqërisë "V.K" shpk në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DST dhe skualifikimin e OE me ofertë me të leverdishme prej 4,943,554 lekë pa TVSh, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e saj.</p>			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Bashkinë Korçë, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 51%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 15 masa organizative, 11 masa shpërblim dëmi, 15 masa me 3E, 20 masa administrative dhe 10 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 15 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 3 rekomandime, 3 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 janë në proces zbatimi.

Për shpërblim dëmi janë lënë 11 masa në vlerën 33,912 mijë lekë, nga të cilat është zbatuar vetëm një në vlerën 114 mijë lekë, 3 janë në proces dhe 1 është zbatuar pjesërisht nga të cilat janë arkëtuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

781 mijë lekë, ndërsa 4 rekomandime nuk janë zbatuar. Në total ngelen pa arkëtuar 33,017 mijë lekë.

Janë lënë 15 masa me 3E nga të cilat një është zbatuar në vlerë 794 mijë lekë, 3 janë zbatuar pjesërisht në vlerën 100,041, ndërsa 11 janë në proces zbatimi. Në total ngelen pa arkëtuar 568,321 mijë lekë.

Nga 10 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 4, ndërsa 6 nuk janë zbatuar.

II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Korçë “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 628/5, datë 07.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O.L, Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
3. B.B, auditues
4. F.C, auditues

1. Objekti

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditore dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Korçë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Korçë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhërave, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

II. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Korçë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Korçë.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimt). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

1.Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, ka dërguar në Bashkinë Korçë Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.
- Nga Kryetari janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr.8312/1 prot., datë 30.09.2022) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.193 prot., datë 15.04.2021 nga ana e Bashkia Korçë është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Nga ana e Bashkisë Korçë janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr. 2048 prot., datë 10.03.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **71 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **15 masa organizative**, nga të cilat 8 janë zbatuar, 3 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 1 janë në proces zbatimi
- **11 masa shpërblim dëmi**, nga të cilat 1 është zbatuar, 3 janë në proces dhe 1 është zbatuar pjesërisht
- **15 masa me 3E**, 6 janë zbatuar, 3 janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 6 janë në proces zbatimi
- **20 masa administrative**, nga të cilat asnjë nuk është zbatuar
- **10 masa disiplinore**, nga të cilat 4 janë zbatuar

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr . per	Në mijë/lek	Nr . per	Në mijë/lek	Nr . Pers	Në mijë/lek	Nr . pers	Në mijë/lek



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

1.	Masa organizative	15	8	1	3							
2.	Masa për përmirësim ligjor											
3.	Shpërblim demi	11	3	1	6	33,912		114		781		33,017
4.	Masa efekt financiar	15	6	3	-	669,156		794		100,041		568,321
5.	Masa disiplinore	10	4	-	6							
	Totali	51	20	6	15	703,068		908		100,795		601,338

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësim në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësim ligjor atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë të marr masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë, sipas strukturës së miratuar me 4 punonjës të certifikuar, kërkesë e parashikuar në kriteret për krijimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Menjëherë

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, pasi 2 auditues janë pajisur me certifikate të audituesit dhe njeri është në proces certifikimi.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar**.

2.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të shpenzimeve për investime dhe në raste kur mungojnë projekte këto shpenzime të adresohen në shërbime të tjera. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin e buxheteve paraardhës duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar ne për vitin 2023.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar**.

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masa të bëjë hyrje në magazinë 27 projekte për studime dhe projekttime në vlerën 5,738,038 lekë.

Menjëherë

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, duke i bërë hyrje projektet në vlerën 5,738,038 leke, sipas fletëhyrjeve nr. 43 deri nr.48 date 22.06.2022 (bashkengjitur).

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar**.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Korçë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht, për regjistrimin e pasurive të paluajtshme në ASHK Korçë, sipas certifikatave të pasurisë dhe aplikimeve bashkëlidhur.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar pjesërisht**.

5.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “*Aktive afatgjata materiale*” dhe llogarisë 109 “*Diferenca nga rivlerësimi*”.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi, për rivlerësimin e aktiveve, sipas shkresës nr. 10679 date 12.12.2022 në adrese të Drejtorisë Kontrollit të Zhvillimit Territorit.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **në proces zbatimi**.

6.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes, së pari nëpërmjet parashtrimit të të gjithë problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, si dhe të ndërmarra të gjitha procedurat ligjore për rivlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të Bashkisë Korçë, por nuk kanë të përcaktuar vlerën respektive, me qëllim rivlerësimin e tyre dhe paraqitjen në Pasqyrat financiare të vitit 2022.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar, pasi disa prona nuk janë pasqyruar në kontabilitet në vlerë, por vetëm në sasi.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe **nuk është zbatuar**.

7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërorë. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu arkëtuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative me mungesë të ardhurash, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkuara nga KLSH-ja.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

Menjëherë

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar pjesërisht, për disa rekomandime të lënë me pare nga KLSH dhe të pazbatuara, pasi:

- Nga IKMT Korçe janë arkëtuar 6 gjoba ndaj mbikëqyrësve, sipas mandateve bashkëngjitur, nga 7 gjoba të rekomanduara, pra ka mbetur 1 rast i parketuar ndaj mbikëqyrësit K.S =50,000 leke gjobe.

- Disa janë në proces gjyqësorë,

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar pjesërisht**.

8.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë të marrë masa për kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

Në vijimësi

8.1. Rekomandimi:

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

9.1. Rekomandimi: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Bashkia Korçë nëpërmjet strukturave të specializuara për hartimin e fondit limit në procedurat për blerje automjetesh, të marrë masa për studimin e të gjitha metodave që përcakton ligji i procedurave të prokurimit dhe në çdo rast subjektet duhet të jenë të licencuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga NSHP.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes Shërbimeve Bashkia Korçë të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendjet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në viti, **sasi e cila duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Korçë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga NSHP dhe është zbatuar pjesërisht, për normativat e karburantit sipas automjeteve, pasi është ngritur komisioni sipas urdhrin titullarit nr. 1168 date 29.09.2022 dhe është mbajtur procesverbali përkatës, por nuk ka miratim nga titullari dhe KB.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar pjesërisht**.

11.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm atëherë kur distancat e objektit në zhvilluar plotësojnë qartazi treguesit e distancave ndërmjet objektit të ri dhe ekzistues, kufirit të pronës dhe trupit të rrugës.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga DPKT të bashkisë dhe është duke zbatuar në vazhdimësi, për miratimin e lejeve zhvillimit dhe ndërtimit duke respektuar distancat nga kufiri i pronës.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

12.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që në vazhdimësi të miratojnë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi vetëm kur të jenë reflektuar mendimet e Institucioneve në lidhje me



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

përputhshmërinë e planvendosjen së sheshit të ndërtimit me kartelat e pasurisë ku do të zhvillohet objekti si dhe kur distancat e objektit të zhvilluar plotësojnë qartazi distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga DPKT te bashkisë dhe është ne proces zbatimi ne vazhdimësi, për miratimin e lejeve zhvillimit dhe ndërtimit duke respektuar mendimet e institucioneve.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

13.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrin masa që të reflektohen sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse të dhëna gjatë oponencës teknike të projektit, në lidhje me ndikimin potencial në mjedis të zonës ku do të zbatohet projekti si dhe në vazhdimësi të miratohen lejet e ndërtimit vetëm kur të reflektohen të gjitha rekomandimet e Institutit të Ndërtimit gjatë kryerjes së Oponencës Teknike.

Në vijimësi

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga DPKT te bashkisë dhe është duke zbatuar ne vazhdimësi, për marrjen parasysh te oponencës teknike te projektit ne lidhje me ndikimin potencial ne mjedis te zonës ku zbatohet projekti dhe te merren parasysh rekomandimet e Inspektoratit ndërtimit.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

14.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrë masa që të ndërpritet zhvillimi i objektit pasi janë ndërhyrje në qendrën historike të qytetit të Korçës si dhe të merren masa që në vazhdimësi të miratojë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi në mbrojtjen, konservimin e integruar të zonës historike së mbrojtur nga VKM nr.207 datë 15.03.2017.

Menjëherë

Zbatimi: Ky rekomandim është pranuar nga DPKT te bashkisë dhe nuk është zbatuar, pasi nuk është ndërprerë zhvillimi i objektit ne qendrën historike te qytetit Korçe, ne kushtet e mospërputhjes te lejes ndërtimit qe parashikon 1-kat nen toke dhe projektit te miratuar ne KKR ku nuk parashikohet dhe nuk miratohet 1-kat nëntokë.

Koment: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **nuk është zbatuar**.

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrë masa që të ndërpritin zhvillimet e objekteve pasi janë ndërhyrje në qendrën historike të qytetit të Korçës si dhe ndryshim funksioni nga banim në shërbim jo në përputhje me aktet ligjore për zonën e mbrojtur. Të merren masa që në vazhdimësi të miratojë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi në mbrojtjen, konservimin e integruar të zonës historike së mbrojtur nga VKM nr.207 datë 15.03.2017.

Menjëherë

Zbatimi: Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **33,912,481 lekë**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **385,650 lekë** në ngarkim të **z. P.P** me funksion ing. Hidroteknik, Përgjegjës i Sektorit të Kullimit Ujitjes në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Korçë, si rrjedhojë e mos respektimit të kuadrit përkatës ligjor në drejtim të përcaktimit të fondit limit në objektin “Ndërtim dhe rikonstruksion i pritave malore në fshatrat Polenë, Mborje, Barç dhe mur mbrojtës në Shkozanj”.

Brenda datës 31.12.2022

Zbatimi. Ky rekomandim nuk është i pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar. Disponohet urdhri i kryetarit bashkisë nr. 1132 date 25.10.2022 për rillogaritjen e fondit limit me komision, disponohet raporti dhe analiza e këtij komisioni bashkëngjitur.

Koment: Ky rekomandim **nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar**, për arkëtimin e vlerës **385,650 leke nga P.P**, p/sectorit te kullimit ujit ne NSHP Korçë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të mallit (asfaltobeton) me vlerë **7,045,282 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës: *komisioni i marrjes në dorëzim M.H, K.Z dhe A.H dhe Drejtori i NSHP Bashkia Korçë z. I.D*, në mënyrë të barabartë.

Brenda datës 31.12.2022

Zbatimi. Ky rekomandim nuk është i pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar, por disponohet urdhri i kryetarit bashkisë nr. 1130 date 25.10.2022 për ngritjen e komisionit, nëse asfaltobeton është përdorur sipas kushteve teknologjike, ku justifikohet sipas procesverbalit 31.10.2022 te komisionit te DPKZHT dhe DMKI.

Koment; Ky rekomandim **nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar**, për arkëtimin e **7,045,282 leke nga M.H, K.Z, A.H**.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Korçë të analizojnë me kujdes kërkesën e NSHP Bashkia Korçë për fondet e kërkuara dhe të deleguara për riparimin e rrugëve në juridiksionin e Bashkisë Korçë, duke kërkuar një analizë të detajuar të rrugëve të riparuar në vitin që mbyllet dhe atyre që do riparohen në vitin vijues.

Me miratimin e fondeve buxhetore të vitit 2023

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është ne proces zbatimi,

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe është ne proces zbatimi.

2.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të angazhojë me shpesh Njësinë e Auditit të Brendshëm Bashkia Korçë, për kryerjen e misioneve të auditimit në NSHP Bashkia Korçë, mbi mënyrën e përdorimit të fondeve publike të deleguara nga bashkia, për të pasur një situatë reale të menaxhimit të këtyre fondeve.

Menjëherë dhe vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, pasi ka dale urdhri dhe programi i auditimit të NSHP.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe është i zbatuar.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë të pajisjeve prej **339,235 lekë**, rënduar padrejtësisht vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti “A.C” shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

Deri më datë 31.12.2022

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga NSHM Arsimit e Çerdhe dhe nuk është zbatuar. Disponohet urdhri i kryetarit bashkisë nr. 5 date 30.10.2022, shkresa përcjellëse dhe njoftim nr. 89 date 08.03.2023 ndaj subjektit “A.C” shpk për përmbushje të detyrimit 339,235 leke dem ekonomik bashkëngjitur. Ndërsa është kryer kontabilizimi nga NSHMAC, e cila është me bilanc vete. Problem vonesa e shkresave në 2023 ne vend që të bëheshin në 2022.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe **nuk është zbatuar**, për arkëtimin e vlerës **339,235 leke nga subjektit “A.C” shpk**.

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të karburantit me vlerë **3,063,534 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës, për zbatimin e procedurave ligjore për harxhimin e karburantit, **I.D, A.N, V.D, P.M, E.Sh**, në mënyrë të barabartë.

Brenda datës 31.12.2022

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga NSHP Korçë dhe nuk është zbatuar.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe **nuk është zbatuar**, për arkëtimin e vlerës **3,063,534 leke nga I.D, A.N, V.Dh, P.M E.Sh** me ndarje të barabartë.

4.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë të angazhojë në mënyrë të vazhdueshme Njësinë e Auditit të Brendshëm Bashkia Korçë, për kryerjen e misionëve të auditimit në NSHP Bashkia Korçë, mbi mënyrën e përdorimit të fondeve publike të deleguara nga bashkia, për të pasur një situatë reale të menaxhimit të këtyre fondeve, për shpërndarjen dhe konsumin e karburantit.

Menjëherë dhe vijimësi

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar, pasi ka dale urdhri dhe programi i auditimit të NSHP.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe është i zbatuar.

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **114,160 lekë pa TVSh** nga OE “G” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5987/2 prot datë 31.08.2020, me objekt “Ndërtimi i pritave malore dhe mur mbajtës në Barç dhe Voskop”, Bashkia Korçë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar, për arkëtimin e vlerës **114,160 leke nga subjekti “G” shpk**, sipas MA bankes Credinss –bank date 17.11.2022.

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **464,076 lekë pa TVSh** nga OE “I” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7460/2 prot datë 14.10.2020 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Koço Glozheni”, Fshati Dardhë”, Bashkia Korçë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar, pasi është në proces gjyqësor. Bashkia Korçë ka çelur kërkesë padi ndaj subjektit “I” shpk, ku me vendimin e gjykatës shkalles pare Korçë nr. 1139 date 10.05.2023 është rrezuar padia. Disponohet edhe ankimimi i bashkisë date 22.06.2023 ndaj subjektit dhe KLSH, për detyrimin e subjektit.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe nuk është zbatuar, pasi nuk është arkëtuar vlera **464,176 leke** nga subjekti “I” shpk,

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **17,556,990 lekë** në ngarkim të **13 subjekteve**, për përlogaritje të pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të dhënat në Tabelën Aneks 5/1 bashkëlidhur.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga DPKZHT Korçë dhe është zbatuar pjesërisht, pasi arkëtim paraqitet vetëm 1 rast për 781,539 leke, ndërsa 12 rastet tjera s’ka arkëtim.. Disponohet urdhri i kryetarit bashkisë nr. 1131 date 25.10.2022 dhe relacioni përkatës, për përlogaritjen sakte të taksës ndikimit infrastrukturës për ndërtimet e reja, pra kjo detyre është kryer sipas subjekteve.

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht, pasi nga 13 raste në vlerën 17,556,990 leke është arkëtuar 1 rast në vlerën **781,539 leke nga subjekti E.T**, sipas MA bankës “O. bank Albania”.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorin e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për përcaktimin dhe saktësimin e personave përgjegjës në shpalljen fitues të shoqërisë “V.K” shpk në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DST dhe skualifikimin e OE me ofertë me të leverdishme prej **4,943,554 lekë pa TVSh**, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e saj.

Brenda datës 31.12.2022

Zbatimi. Ky rekomandim nuk është pranuar nga NSHM Arsimit e Çerdhe Korçë dhe nuk është zbatuar për vlerën 4,943,554 leke. Disponohet urdhri i kryetarit bashkisë nr. 1134 date 25.10.2022 dhe relacioni përkatës 30.11.2022, për rrëzimin e këtij zbulimi të KLSH.

Koment; Ky rekomandim nuk është pranuar dhe nuk është zbatuar, për vlerën 4,943,554 leke.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **476,248,277 lekë**.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga Drejtoria e Taksave Vendore Korçë dhe është në proces zbatimi, pasi debitorët në vlerën 476,248 mijë leke, janë arkëtuar 66,089 mijë leke dhe kane



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

mbetur 410,159 mije leke për te cilet vazhdon arkëtimi. Disponohen njoftime dhe bllokime bankare për subjektet debitore (ngjitur evidencat dhe dokumentet).

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht, pasi debitorët nga 476,248 mije leke, janë arkëtuar 66,089 mije leke dhe kane mbetur 410,159 mije leke.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, me shkresë zyrtare të dërgojë listat në Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit për kontabilizimin e detyrimeve me qëllim arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet pa leje për **250 subjekte dhe individë** me vlerë **11,336,222 lekë**, sipas *Tabela Aneks nr.2/11 bashkëlidhur*.

Kryetari i Bashkisë Korçë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Korçë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga Drejtoria e Taksave Vendore Korçë dhe DPKZHT dhe është në proces zbatimi, pasi debitorët e taksës infrastrukturës ndaj 250 subjekteve objekt legalizimi, rezulton se mbi 50 % e tyre janë arkëtuar (5,501,722) nga vlera total debitor (11,336,222 leke), pra kane mbetur 5,834,500 leke pa u arkëtuar. Veprimet janë kontabilizuar për vlerën 11,336,222 leke, sipas urdhri i kryetarit bashkisë nr. 1151 date 28.10.2022 (*ngjitur gjithë dokumentacioni*).

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht, pasi mbi 50 % e taksës së infrastrukturës objekt legalizimi është arkëtuar, konkretisht: **5,501,722 leke arkëtuar** nga vlera totale 11,336,222 leke, pra mbetur 5,834,500 leke e pa u arkëtuar.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet të **vlerës 50,948,323 lekë**, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

Menjëherë

Zbatimi. Vlera totale debitore 50,948,323 leke detyrime ndaj bashkisë, për te ardhura nga qiratë objekteve dhe tokave në 10 raste. Ky rekomandim është zbatuar vetëm për një rast “V.A”, për vlerën 217,500 lekë për 250m², sipas dokumentit të thesarit datë 20.01.2023 dhe 18.11.2022. Ndërsa për 9 raste nuk janë kryer arkëtime, pretendohet se janë në procese gjyqësore, c'ka nuk e pengon ekzekutimin e detyrimeve të lëna nga KLSH-ja.

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Korçë nëpërmjet strukturave të specializuara për hartimin e fondit limit në procedurat për blerje automjetesh, të marrë masa për studimin e të gjitha metodave që përcakton ligji i procedurave të prokurimit dhe në çdo rast subjektet duhet të jenë të licencuara nga Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Koment: Ky rekomandim është pranuar dhe është i zbatuar.

4.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës, për shpalljen fitues të shoqërisë “A.G” shpk pa plotësuar specifikimet teknike të përcaktuara në DST, si dhe të komisionit të marrjen në dorëzim të mallit pa plotësuar specifikimet teknike, duke sjellë përdorimin e fondeve pa efencë në vlerën **10,621,364 lekë**.

Menjëherë dhe vijimësi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË KORÇË

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

5.1. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publikë Bashkia Korçë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Në vijimësi

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

5.2. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publikë Bashkia Korçë, në raste të mungesë së stafit profesional për lloje të veçanta procedurash, NSHP Bashkia Korçë t'i drejtohet Bashkisë Korçë për përfshirjen si anëtarë të komisioneve (NJP/ KVO), të punonjësve të kësaj bashkie sipas profileve dhe me eksperiencë në zhvillimin e procedurave.

Në vijimësi

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

5.3. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publikë Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësisimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë **48,751 mijë lekë**.

Brenda datës 31.12.2022

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

6.1. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Në vijimësi

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **i zbatuar**.

6.2. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, në raste të mungesë së stafit profesional për lloje të veçanta procedurash, NSHP Bashkia Korçë ti drejtohet Bashkisë Korçë për përfshirjen si anëtarë të komisioneve (NJP/ KVO), të punonjësve të kësaj bashkie sipas profileve dhe me eksperiencë në zhvillimin e procedurave.

Në vijimësi

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

6.3. Rekomandimi; Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësisimit të të gjitha kritereve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur përdorimin pa efektivitet të fondeve me vlerë **36,666 mijë lekë**.

Brenda datës 31.12.2022



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

7.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Bashkia Korçë të analizojnë me kujdes kërkesën e NSHP Bashkia Korçë për fondet e kërkuara dhe të deleguara për riparimin e mjeteve të NSHP, Bashkia Korçë, duke kërkuar një analizë të detajuar të mjeteve të riparuar në vitin që mbyllet dhe atyre që do riparohen në vitin vijues, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë **523,500 lekë**.

Menjëherë

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorin e NSHP Bashkia Korçë, të marrë masa për eliminimin e praktikave të llogaritjes së fondit limit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, për të siguruar mirëpërdorimin të fondeve të prokuruar në raport me llojin e procedurës, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë e personave në llogaritjen më shumë të fondit limit prej **4,820,720 lekë pa TVSh**, si rrjedhojë e mos respektimit të kuadrit përkatës ligjor në drejtim të përcaktimit e fondit limit në objektin “*Asfalta beton, viti 2020*”.

Menjëherë

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **ne proces zbatimi**.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që, ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga Drejtoria e Financës dhe është zbatuar pjesërisht, për faturat e pa likuiduara dhe për vendimet gjyqësore te formës prere te pa likuiduara ne vlerën totale 28,449, 840 leke, pasi janë likuiduar 24,230,663 leke, pra kane mbetur pa u likuiduar edhe 4,219,176 leke (*Bashkëngjitur dokumentacioni*).

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe është **zbatuar pjesërisht**, pasi është **arkëtuar vlera 24,230,663 leke** nga vlera totale 28,449,839 leke, pra mbetur pa u likuiduar vlera 4,219,176 leke.

10.1.Rekomandimi: Sektori i Pyjeve Bashkia Korçë, të marr masa për riklasifikimin e fondit pyjor/kullor të pezulloj veprimtarinë e subjekteve deri sa sipërfaqe pyjore që shfrytëzojnë, të hiqet nga fondi pyjor dhe vazhdimin e procedurave për lidhjen e kontratës për pyllëzimin e sipërfaqes që kanë marrë për shfrytëzim dhe lidhjen e kontratave me subjektin “R.E” për, HEC C.1 dhe C.3, që shfrytëzon sipërfaqe pyjore për ndërtim kanali në sipërfaqe për një gjatësi prej 5 km, në vlerën 725,000 lekë/vit (5 km x 145,000 lekë/km/vit), dhe subjektin “D.E”, që shfrytëzon sipërfaqe pyjore për shtrirje tubacioni në sipërfaqe për një gjatësi prej 480 ml, në vlerën 69,600 lekë/vit (0.48 km x 145,000), gjithsej në vlerën 794,600 lekë.

Menjëherë

Zbatimi. Ky rekomandim është i pranuar nga Sektori i pyjeve ne bashkinë Korçë dhe është zbatuar, për 3 subjekte detyrime kontraktore për përdorim sipërfaqe pyjore e kullorore, konkretisht:

-R.E= 741,675 leke arkëtuar (435,000 leke + 16,675 leke + 290,000 leke), sipas MA te U. date 12.11.2022 dhe date 08.02.2023. Për HEC ÇERMENICA 1 E 2, nga 725,000 leke detyrimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

-D.E =186,8181 leke arkëtuar (117,218 leke + 69,600 leke), sipas MA te F. date 01.12.2022 dhe date 04.10.2022, nga 69600 leke detyrimi vjetor.

Koment; Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar, pasi është arkëtuar vlera 741,675 leke nga 725,000 leke detyrimi dhe vlera 186,818 leke nga 69600 leke detyrimi vjetor.

2.6.Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore, u konstatua si vijon:

MASA ADMINISTRATIVE

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 4 faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë që në zbatim të nenit 132, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, t’i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative ose disiplinore në raport me shkeljet e konstatuara, për 20 (njëzet) punonjës, si më poshtë:

a- **Për Bashkinë Korçë.**

1. z. K.C me funksion Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shërbimit,
2. z. A.H me funksion Përgjegjës në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
3. z. D.Sh me detyrë Shofer në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 10,621,364 lekë të procedurës me objekt “Blerje të dy automjeteve zjarrfikës”, në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeve” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. znj. D.Th, me detyrë Zv/Kryetare e Bashkisë Korçë.
5. z. K.J, me detyrë Specialist në Drejtorinë Juridike.
6. znj. E.DH, me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Blerje të dy automjeteve zjarrfikës”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve/specifikimeve teknike të miratuara në DST nga AK Baskia Korçë, pasi mungon pjesa kryesore depozita e shkumës me sasi 100 litra, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeve”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, , si dhe VKM nr. 285,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b- Për Ndërmarrje e Shërbimeve Publike (NSHP), Bashkia Korçë

7. zj. P.R, me detyrë Specialiste e Prokurimeve në NSHP.

8. z. P.N, me detyrë Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore në NSHP.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të NJHDT në NSHP bashkia Korçë, në procedurën me objekt “Materiale ndërtimi, viti 2020”, me fond limit 51,509,975 lekë, ku janë aplikuar kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe në kundërshtim me nenin 46 të LPP dhe neneve 26 dhe 27 të VKM nr. 29.12.2014, i ndryshuar, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. z. K.Z, me detyrë brigadier në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Trotuareve.

10. z. A.H, me detyrë brigadier në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Trotuareve

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 39,733,600 lekë të procedurës me objekt “Asfalto beton, viti 2020”, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11. L.N, me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Asfalto beton, viti 2020”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kritereve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kritereve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12. M.H, me detyrë Drejtor i Njësive Administrative.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të KVO në procedurën me objekt “Asfalto beton, viti 2020”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kritereve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

13. z. I.ZH me funksion Përgjegjës i Sektorit Mekanik.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 5,416,67 lekë të procedurës me objekt “Blerje fadromë viti 2021”, në kundërshtim me nenin Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

c- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Cerdhes (NSHMAC), Bashkia Korçë

14. z. Y.M, me detyrë Drejtor i NSHMAC.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e Titullarit të AK të NSHMAC Bashkia Korçë, për miratimin e kriterëve në kundërshtim me llojin e procedurës dhe miratimin e raportit përmbledhës dhe marrjen e vendimit për shpalljen fituese OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga AK NSHMAC Bashkia Korçë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15. z. A.Q, me detyrë Teknik, Mesëm Sp. Ndryshme Elektracist, kald, te ≠

16. z. V.T, me detyrë Përgjegjës Sektorit të Prokurimeve.

17. z. V.P, me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për aplikimin e kriterëve në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78, duke aplikuar kriterë jo në përputhje me procedurën, në procedurën me objekt “Montim kaldajë e plotë me djegie + linja e furnizimit me GNL” me fond limit 9,582,934 lekë, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë.

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në aplikimin e kriterëve jo të mirë argumentuara në procedurën me objekt “MERIMETIME” me fond limit 24,083,331 lekë, në shkelje të nenit 77, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe jo në përshtatje me objektin e procedurës së prokurimit, duke çuar në mospjesëmarrjen e OE apo në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18. z. P.X, me detyrë Kujdestar Konvikti.

19. zj. S.Z, me detyrë specialiste në Sektorin e prokurimeve ne NSHMAC.

20. zj. I.L, me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Montim kaldajë e plotë me djegie + linja e furnizimit me GNL” me fond limit 9,582,934 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHMAC Bashkia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “MERIMETIME” me fond limit 24,083,331 lekë, për skualifikim të padrejtë të OE pjesëmarrës në garë dhe shpallje fitues të OE në kushtet e mos plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHMAC Bashkia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, veprime financiare me efekt negativ të përdorimit të fondeve në vlerën 4,943,554 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar dhe nuk është zbatuar, pasi nuk ka shkresë në adrese të APP ndaj **20 punonjësve** nga bashkia Korçë.

Koment; Ky rekomandim është **pranuar**, por **nuk është zbatuar**, pasi nuk ka masa administrative ndaj **20 punonjësve** dhe nuk ka shkresë në adrese të APP nga bashkia Korçë.

MASA DISIPLINORE

E/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **4 (katër) punonjës**, si më poshtë:

a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

1. znj. ZH.L, me funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

2. z. E.GJ, me funksionin e Përgjegjës të Sektorit për Planifikimin e Territorit.

3. z. N.L, me funksionin e specialistit projektues në Sektorin e Planifikimit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për miratim të lejeve zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit jo në përputhje me VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” si dhe VKM nr.207, datë 15.03.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, për lejet e dhëna në zonë të mbrojtur (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 128-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. z.O.P, me funksionin e specialistit të buxhetit dhe të specialistit të përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Për shkeljet e mëposhtme:

Përlllogaritje jo në përputhje me paketën fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja (Më hollësisht trajtuar në pikë 5, faqe 128-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

E/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë**, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

a- Nga “Vërejte” deri në “Largim nga puna” për 5 punonjës.

1. z. N.M, me detyrë Specialist i Logjistikës.

2. znj. I.J, me detyrë llogaritë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e peronave përgjegjës marrjen në dorëzim të mallit (automjet zjarrfikës copë 2), të procedurës me objekt “Blerje të dy automjeteve zjarrfikës”, pasi OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të specifikimeve teknike të miratuara në DST nga AK Baskia Korçë, **ku mungon pjesa kryesore depozita e shkumës me sasi 100 litra**, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 83-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

b- Masa “Largim nga puna”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, për 4 punonjës.

1. z. P.M me detyrë Përgjegjës për Menaxhimin e Kontratave njëkohësisht mbajtësi i kartave elektronike të karburantit, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtëm:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në cilësinë e anëtarëve të NJHDT në NSHP bashkia Korçë, në procedurën me objekt “Materiale ndërtimi, viti 2020”, me fond limit 51,509,975 lekë, ku janë aplikuar kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe në kundërshtim me nenin 46 të LPP dhe neneve 26 dhe 27 të VKM nr. 29.12.2014, i ndryshuar, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. z. I.D, në cilësinë e Titullarit të AK të NSHP Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtëm:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 39,733,600 lekë të procedurës me objekt “Asfalto beton, viti 2020”, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. z. A.N me detyrë Drejtor i Punëve Publike të Qytetit, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtëm:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Asfalto beton, viti 2020”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4. z. E.Sh me detyrë Specialist i Sektorit Mekanik dhe Transportit në NSHP, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtëm:

Për përdorimin e mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Zbatimi. Ky rekomandim është pranuar dhe është zbatuar pjesërisht (*rekomanduar 10, zbatuar 4 dhe 6 nuk janë zbatuar*), pasi nuk janë dhënë masa për 4 punonjës me status nëpunësit civil dhe për 2 punonjës me kod pune, ndërsa janë dhënë 4 vërejtje me zbutje nga masa “*largim nga puna*” e rekomanduar, sipas dokumenteve bashkëngjitur.

Koment; Ky rekomandim është **pranuar** dhe **është zbatuar pjesërisht**, pasi nuk janë dhënë masa për 4 punonjës me status nëpunësit civil nga 4 te rekomanduar dhe për 2 punonjës me kod pune nga 6 te rekomanduara.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

4.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Korçë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

6.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes, së pari nëpërmjet parashtrimit të të gjithë problematikës në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve dhe masat konkrete për minimizimin e tyre, si dhe të ndërmarrë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin e aktiveve të cilat janë pjesë e inventarit të aktiveve të Bashkisë Korçë, por nuk kanë të përcaktuar vlerën respektive, me qëllim vlerësimin e tyre dhe paraqitjen në Pasqyrat financiare të vitit 2022.

7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Korçë, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërorë. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu arkëtuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shpërblimit të dëmit, masave organizative me mungesë të ardhurash, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkuara nga KLSH-ja.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Ndërmarrjes Shërbimeve Bashkia Korçë të marrë masa për ngritjen e një strukturë të veçantë për planifikimin vjetor të nevojave për karburant, bazuar në numrin e mjeteve, gjendet teknike të tyre, normativave të harxhimit sipas katalogut ose me procesverbal argumentimi, volumit të punës që kryhen në viti, sasi e cila duhet të miratohet nga Kryetari i Bashkisë Korçë.

14.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrë masa që të ndërpritet zhvillimi i objektit pasi janë ndërhyrje në qendrën historike të qytetit të Korçës si dhe të merren masa që në vazhdimësi të miratojë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi në mbrojtjen, konservimin e integruar të zonës historike së mbrojtur nga VKM nr.207 datë 15.03.2017.

15.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të marrë masa që të ndërpritin zhvillimet e objekteve pasi janë ndërhyrje në qendrën historike të qytetit të Korçës si dhe ndryshim funksioni nga banim në shërbim jo në përputhje me aktet ligjore për zonën e mbrojtur. Të merren masa që në vazhdimësi të miratojë leje zhvillimore dhe leje ndërtimi në mbrojtjen, konservimin e integruar të zonës historike së mbrojtur nga VKM nr.207 datë 15.03.2017 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 9-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njësisë Publike** në bashkëpunim me **Nëpunësin**



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **33,912,481 lekë**, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 385,650 lekë në ngarkim të z. P.P me funksion ing. Hidroteknik, Përgjegjës i Sektorit të Kullimit Ujitjes në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, Korçë, si rrjedhojë e mos respektimit të kuadrit përkatës ligjor në drejtim të përcaktimit të fondit limit në objektin “*Ndërtim dhe rikonstruksion i pritave malore në fshatrat Polenë, Mborje, Barç dhe mur mbrojtës në Shkozanj*”.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të mallit (asfaltbetoni) me vlerë 7,045,282 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës: *komisioni i marrjes në dorëzim M.H, K.Z dhe A.H dhe Drejtori i NSHP Bashkia Korçë z. I.D*, në mënyrë të barabartë.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë të pajisjeve prej 339,235 lekë, rënduar padrejtësisht vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti “A.C” shpk, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të nxjerr urdhër zhdëmtimi të karburantit me vlerë 3,063,534 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin nga personat përgjegjës, për zbatimin e procedurave ligjore për harxhimin e karburantit, I.D, A.N, V.D, P.M, E.Sh, në mënyrë të barabartë.

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Korçë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 464,076 lekë pa TVSh nga OE “I” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7460/2 prot datë 14.10.2020 me objekt “*Rikonstruksioni i rrugës “Koço Glozheni”, Fshati Dardhë*”, Bashkia Korçë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

7.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, me Drejtorinë e Financës dhe Drejtorinë Juridike, të marrin masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 17,556,990 lekë në ngarkim të 13 subjekteve, për përlllogaritje të pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, të dhënat në Tabelën Aneks 5/1 bashkëlidhur.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Korçë në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse Arsimit dhe Çerdhes Bashkia Korçë, të marrë masa për përcaktimin dhe saktësimin e personave përgjegjës në shpalljen fitues të shoqërisë “V.K” shpk në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të DST dhe skualifikimin e OE me ofertë me të leverdishme prej **4,943,554 lekë pa TVSh**, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e saj (*Më hollësisht trajtuar në faqet 13-15 të Raportit Përfundimtar të të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën 476,248,277 lekë.

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë, me shkresë zyrtare të dërgojë listat në Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit për kontabilizimin e detyrimeve me qëllim arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet pa leje për 250 subjekte dhe individë me vlerë 11,336,222 lekë, sipas *Tabela Aneks nr.2/11 bashkëlidhur*.

Kryetari i Bashkisë Korçë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Korçë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

3.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet të vlerës 50,948,323 lekë, duke njoftuar subjektet për detyrimin që kanë ndaj bashkisë.

9.1.Rekomandimi: Bashkia Korçë, Drejtoria Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbartimore, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që, ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbartuesit gjyqësor (*Më hollësisht trajtuar në faqet 16-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 4 faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë** që në zbatim të nenit 132, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, **t'i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **20 (njëzet) punonjës**, si më poshtë:

a- Për Bashkinë Korçë.

1. z. K.C me funksion Drejtor në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shërbimit,

2. z. A.H me funksion Përgjegjës në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

3. z. D.Sh me detyrë Shofer në Drejtorinë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 10,621,364 lekë të procedurës me objekt “*Blerje të dy automjeteve zjarrfikës*”, në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeve*” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009”.

4. znj. D.Th, me detyrë Zv/Kryetare e Bashkisë Korçë.

5. z. K.J, me detyrë Specialist në Drejtorinë Juridike.

6. znj. E.DH, me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Blerje të dy automjeteve zjarrfikës*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve/specifikimeve teknike të miratuara në DST nga AK Baskia Korçë, pasi mungon pjesa kryesore depozita e shkumës me sasi 100 litra, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeve*”, neni 98, “*Anulimi i një procedure*”, neni 76 “*Kriteret detyruese për skualifikim*”, neni 92, “*Shqyrtimi i ofertave*”, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “*Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*”, neni 67, “*Klasifikimi i ofertave*”, neni 83, “*Njoftimi i fituesit*”, si dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III.

b- Për Ndërmarrje e Shërbimeve Publike (NSHP), Bashkia Korçë

7. zj. P.R, me detyrë Specialiste e Prokurimeve në NSHP.

8. z. P.N, me detyrë Jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore në NSHP.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të NJHDT në NSHP bashkia Korçë, në procedurën me objekt “*Materiale ndërtimi, viti 2020*”, me fond limit 51,509,975 lekë, ku janë aplikuar kriteret jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe në kundërshtim me nenin 46 të LPP dhe neneve 26 dhe 27 të VKM nr. 29.12.2014, i ndryshuar, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë.

9. z. K.Z, me detyrë brigadier në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Trotuareve.

10. z. A.H, me detyrë brigadier në Sektorin e Mirëmbajtjes së Rrugëve dhe Trotuareve

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 39,733,600 lekë të procedurës me objekt “*Asfalto beton, viti 2020*”, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

11. L.N, me detyrë Specialiste në Sektorin e Financës

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Asfalto beton, viti 2020*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021*” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*.

12. M.H, me detyrë Drejtor i Njësisë Administrative.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarit të KVO në procedurën me objekt “*Asfalto beton, viti 2020*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

13. z. I.ZH me funksion Përgjegjës i Sektorit Mekanik.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e personit përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 5,416,67 lekë të procedurës me objekt “*Blerje fadromë viti 2021*”, në kundërshtim me nenin Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 3, “*Parimet e përzgjedhjeje*” si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 12/1 të ligjit nr. 9573, datë 3.7.2006 “*Për Autoriparimin, Shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to*” ndryshuar me ligjin nr. 10137 / 2009”.

c- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse, Arsimit dhe Çerdhes (NSHMAC), Bashkia Korçë

14. z. Y.M, me detyrë Drejtor i NSHMAC.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e Titullarit të AK të NSHMAC Bashkia Korçë, për miratimin e kriterëve në kundërshtim me llojin e procedurës dhe miratimin e raportit përmbledhës dhe marrjen e vendimit për shpalljen fituese OE me mangësi në plotësimin e kriterëve të miratuara nga AK NSHMAC Bashkia Korçë.

15. z. A.Q, me detyrë Teknik, Mesëm Sp. Ndryshme Elektricit, kald, te ≠

16. z. V.T, me detyrë Përgjegjës Sektorit të Prokurimeve.

17. z. V.P, me detyrë Specialist në Sektorin e Prokurimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, për aplikimin e kriterëve në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 78, duke aplikuar kriterë jo në përputhje me procedurën, në procedurën me objekt “*Montim kaldajë e plotë me djegie + linja e furnizimit me GNL*” me fond limit 9,582,934 lekë, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar pjesëmarrjen e OE në garë.

Në cilësinë e anëtarit të NJHDT, në aplikimin e kriterëve jo të mirë argumentuara në procedurën me objekt “*MERIMETIME*” me fond limit 24,083,331 lekë, në shkelje të nenit 77, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe jo në përshtatje me objektin e procedurës së prokurimit, duke çuar në mospjesëmarrjen e OE apo në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 82-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

18. z. P.X, me detyrë *Kujdestar Konvikti*.

19. zj. S.Z, me detyrë *specialiste në Sektorin e prokurimeve ne NSHMAÇ*.

20. zj. I.L, me detyrë *Specialist në Sektorin e Prokurimeve*

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Montim kaldajë e plotë me djegie + linja e furnizimit me GNL*” me fond limit 9,582,934 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisht të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHMAC Bashkia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*MERIMETIME*” me fond limit 24,083,331 lekë, për skualifikim të padrejtë të OE pjesëmarrës në garë dhe shpallje fitues të OE në kushtet e mos plotësisht të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHMAC Bashkia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, veprime financiare me efekt negativ të përdorimit të fondeve në vlerën 4,943,554 lekë (*Më hollësisht trajtuar në faqe 19-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 364/9 prot., datë 12.09.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

E/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin Civil:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, geramat (b, c, ç) e nenin 58-“*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **4 (katër) punonjës**, si më poshtë:

a- Masa “Vërejte”, shkronja (a) e nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”

1. znj. ZH.L, me funksionin e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

2. z. E.GJ, me funksionin e Përgjegjës të Sektorit për Planifikimin e Territorit.

3. z. N.L, me funksionin e specialistit projektues në Sektorin e Planifikimit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për miratim të lejeve zhvillimore dhe lejeve të ndërtimit jo në përputhje me VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” si dhe VKM nr.207, datë 15.03.2017 “Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth”, për lejet e dhëna në zonë të mbrojtur.

4. z.O.P, me funksionin e specialistit të buxhetit dhe të specialistit të përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Për shkeljet e mëposhtme:

Përlllogaritje jo në përputhje me paketën fiskale të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

E/II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Korçë**, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

a- Nga “Vërejte” deri në “Largim nga puna” për 5 punonjës.

1. **z. N.M**, me detyrë Specialist i Logjistikës.

2. **znj. I.J**, me detyrë llogaritare.

Për shkeljet e mëposhtme:

Në cilësinë e peronave përgjegjës marrjen në dorëzim të mallit (*automjet zjarrfikës copë 2*), të procedurës me objekt “*Blerje të dy automjeteve zjarrfikës*”, pasi OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të specifikimeve teknike të miratuara në DST nga AK Baskia Korçë, **ku mungon pjesa kryesore depozita e shkumës me sasi 100 litra**, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, kapitulli III.

b- Masa “Largim nga puna”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, për 4 punonjës.

1. **z. P.M** me detyrë Përgjegjës për Menaxhimin e Kontratave njëkohësisht mbajtësi i kartave elektronike të karburantit, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në cilësinë e anëtarëve të NJHDT në NSHP bashkia Korçë, në procedurën me objekt “*Materiale ndërtimi, viti 2020*”, me fond limit 51,509,975 lekë, ku janë aplikuar kritere jo në përputhje me procedurën e zhvilluar dhe në kundërshtim me nenin 46 të LPP dhe neneve 26 dhe 27 të VKM nr. 29.12.2014, i ndryshuar, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë çuar në mospjesëmarrjen e OE në garë.

3. **z. I.D**, në cilësinë e Titullarit të AK të NSHP Bashkia Korçë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË KORÇË

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në cilësinë e personave përgjegjës për hartimin e fondit limit në vlerën 39,733,600 lekë të procedurës me objekt “*Asfalto beton, viti 2020*”, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014” Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

3. z. A.N me detyrë Drejtor i Punëve Publike të Qytetit, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përdorimin i mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Asfalto beton, viti 2020*”, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenet 1, 2, 20, 24, 46, 53 dhe 55 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 797, datë 29.12.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të këshillit të ministrave,” për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

- Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021*” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

4. z. E.Sh me detyrë Specialist i Sektorit Mekanik dhe Transportit në NSHP, Bashkia Korçë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për përdorimin e mjeteve dhe konsumi i karburantit për sasinë **18,569.8 litra me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**, me vlerë **3,063,534 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar, neni 2, pika 5 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 36,38,42 dhe 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikë 7, faqe 183-191 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën me objekt “*Blerje Karburant, vaj, graso dhe gaz, viti 2021*” me fond limit 20,431,667 lekë, ku OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësimit të të gjithë kriterëve të miratuara në DST nga AK NSHP Baskia Korçë, veprime në kundërshtim me nenin 82 të ligjit 162/2020 “Për procedurat e prokurimit” dhe nenit 26- *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit* të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në faqe 19-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Korçë dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN
2022” NË BASHKINË KORÇË

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN
2022” NË BASHKINË DURRËS

Raport Përfundimtar për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Durrës

Raport Përfundimtar Auditimi Tematik

SHTATOR 2023



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

PËRMBAJTJA			
I.	Përmbledhje Ekzekutive	1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-8
		2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
		3.Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	
II.	Hyrja	1. Objekti	8-9
		2. Qëllimi i Auditimit	
		3. Identifikimi i çështjes	
		4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
		5. Përgjegjësitë e audituesve	
		6. Kriteret e Vlerësimit	
		7. Standartet e auditimit	
		8. Metodatat e auditimit	
		9. Dokumentimi i auditimit	
III	Përshkrimi i auditimit	9-26	
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	9	
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9	
2.1	Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".	9-11	
2.2	Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	11	
2.3	Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandime nuk janë zbatuar.	11-18	
2.4	Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	18-22	
2.5	Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.	22-23	
2.6	Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.	23-26	
IV.	Gjetje dhe Rekomandime	26-35	



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

I. Përmbledhje Ekzekutive

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (në vijim KLSH) ushtroi auditimin tematik me objekt "Mbi nivelin e zbatimit të të rekomandimeve të lëna në auditimin e vitit 2022" në Bashkinë Durrës, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me verifikimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë auditimit në terren nga grupi i auditimit është mbajtur 1 akt-verifikim, sipas çështjeve respektive, i cili është dorëzuar në protokollin e subjektit. Në përfundim të punës në terren është kryer takimi përmbyllës me përfaqësuesit e Bashkisë Durrës.

I.2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon:

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1.	<p>1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 369/43 prot, datë 30.12.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:</p> <p>1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 9,076,702 lekë, nga shtatë subjektet si vijon, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë:</p> <ul style="list-style-type: none">-Subjekti "M" ShPK, në vlerën 2,240,140 lekë;-Subjekti "V.H" ShPK, në vlerën 2,595,552lekë;-Subjekti "K.K" ShPK, në vlerën 1,865,700 lekë;-Subjekti "J" ShPK, në vlerën 435,776 lekë;-Subjekti "D" ShPK, në vlerën 279,754 lekë-Subjekti "K.O" ShA, në vlerën 1,077,876 lekë;-Subjekti "P" ShA, në vlerën 581,904 lekë. <p>2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 3,100,000 lekë pa TVSh nga BOE "B.K" SHPK & "A.C" ShPK, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht si rezultat i rritjes fiktive të fondit limit.</p> <p>3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 522,937 lekë pa TVSh, nga sipërmarrësi "E.2" ShPK, shumë kjo si</p>	18-22	E LARTË	Rekomandim: 1.1. Kryetari i Bashkisë Durrës dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.</p> <p>4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 565,400 lekë pa TVSh, nga sipërmarrësi “D.A” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.</p> <p>5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 270,000 lekë nga sipërmarrësi “I” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.</p> <p>6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 359,470 lekë pa TVSh nga sipërmarrësi Senka ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.</p> <p>7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 383,800 lekë pa TVSH nga BOE “N.C” SHPK & “F.B & C.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 533/10 prot., datë 10.02.2021, me objekt: “Riforcimi i njësive të banimit në ndërtesat (pallat), të cilat janë kualifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturor ose dëmtime shumë të rënda jostrukturor dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para” Bashkia Durrës, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 144,516 lekë pa TVSH nga BOE “R.N” ShPK & “G.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9477/49 Prot., datë 13.10.2020, me objekt: “Loti 1: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët, “Glaukia – Hysen Kërtusha - Aleksandër Goga – Telat Noga”, në kuadër të procesit të rindërtimit” Bashkia Durrës, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</p> <p>10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 205,360 lekë pa TVSh nga OE “K” ShA për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 3638/125.,</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>datë 16.07.2021 me objekt “<i>Loti 5: Riforcim godina banimi i rruga “Varoshi” nr. 43 me kod GIS 26082, rruga “Kristo Sotiri” nr. 55 me kod GIS 19070, rruga “Horizonti” nr. 7 me kod GIS 19056</i>” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e Rindërtimit të tërmetit).</p> <p>11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerën prej 272,000 lekë pa TVSh nga OE “I” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 9477/46 prot., datë 12.10.2020 me objekt “<i>Loti 6: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët, Bulevardi Dyrrah-Epidam-Mars 93- Egnatia, në kuadër të procesit të rindërtimit</i>” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e Rindërtimit nga tërmetit).</p> <p>12.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej 474,906 lekë pa TVSh nga shoqëria “E” ShPK , për punime të pakryera sipas kontratës me nr. 9477/50 prot., datë 13.10.2020 me objekt: “<i>Loti 8: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët Segmentit të rrugës Pavarësia - Duna - Bajram Curri - Kanali ujërave të larta - segmenti rrugës Pavarësia - vija bregdetare e plazhit Hotel Adriatik – Kavalishenca në kuadër të procesit të rindërtimit</i>”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e rindërtimit nga tërmeti).</p> <p>13.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 464,558 lekë pa TVSh nga shoqëria “C” ShPK, për punime të pakryera, për kontratën me nr. 305 prot datë 22.06.2021 me objekt “Rikonstruksion i tregut fshatar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore Bashkia Durrës.</p> <p>14.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 106,000 lekë pa TVSH nga BOE “B” ShPK & “B.II” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 309/11 prot., datë 20.05.2021 me objekt “Rikonstruksion Rruga Danubi” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>14.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës t'i kërkojë BOE “B” ShPK & “B.II” ShPK, të kryejë riparimin e shtresave asfaltike në volumnin 121 m² me vlerë 169,400 lekë pa TVSh në rrugicat e dëmtuara, duke siguruar realizimin e punimeve me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe KTZ, brenda periudhës së garancisë duke garantuar siguri maksimale të lëvizjes së automjeteve.</p> <p>15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 114,650 lekë pa TVSh nga shoqëria BOE “C.M & K.” ShPK, për punime të pakryera sipas kontratës me nr. 1017/9 prot., datë 08.06.2021 me objekt “Konstruksion rruga Kashta e Kumtrit” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.</p> <p>16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 155,094 lekë pa TVSh nga shoqëria BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 1077/10 prot., datë 06.05.2021 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Ohrit (Loti II)” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.</p> <p>17.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 141,765 lekë pa TVSh nga shoqëria “Sh” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 311/8 prot., datë 14.05.2021, me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Shën Pjetër” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore. Sipërmarrësi i punimeve të kryejë riparimin e vijëzimeve së dëmtuar me vlerë 20,400 lekë nga OE “Sh” ShPK, për punime të kryera pa cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike në rrugën “Shën Pjetër” sipas kontratës nr. 311/8 prot., datë 14.05.2021, para përfundimit të garancisë së defekteve me datë 02.10.2023.</p> <p>18.1.Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 156,212 lekë pa TVSh nga sipërmarrësi i punimeve BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 303/11 prot., datë 06.05.2021 me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Shkumbini” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.</p> <p>18.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të kërkojë realizimin e zërit të punimeve “Mbushje me zhavorr të kanalit</p>			



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	FAQE	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
	<p>ekzistues” në vlerën 264,000 lekë pa TVSh nga BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK në përputhje me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike në rrugën “Shkumbini,” sipas kontratës nr. 303/11 prot., datë 06.05.2021, para përfundimit të garancisë së punimeve me datë 20.12.2023.</p> <p>19.1.Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës 59,520 lekë pa TVSh nga BOE “S.U” ShPK & “B” ShPK për punime të pakryera në kontratën me nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Tepelena” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.</p> <p>19.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të kërkojë nga BOE “S.U” ShPK & “B” ShPK, të kryhet riparimi i shtresave asfaltike të dëmtuar në rrugicat tërthore në vlerën 98,143 lekë, sipas kontratës me nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Tepelena” dhe “Universi”. Nga kontraktori të sigurohet realizimi i punimeve me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe KTZ, duke garantuar siguri maksimale të lëvizjes së automjeteve, në rast të kundërt nga Bashkia Durrës, volumi i shtresave të dëmtuara të konsiderohet dëm ekonomik për kontraktorin.</p>			

I.3. Konkluzione dhe opinioni i auditimit

Mbështetur në standardet e INTOSAI-t, Manualit të Përputhshmërisë, Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, nga auditimi tematik i kryer në Bashkinë Durrës, rezultoi se niveli i zbatimit të rekomandimeve plotësisht ose proces zbatimi, është në nivelin 73%. Rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm janë pranuar plotësisht, ku për përmirësimin e gjendjes janë lënë 33 masa organizative, 22 masa shpërblim dëmi, 3 masa me 3E dhe 40 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes nga 33 masa organizative të lëna rekomandim nga KLSH, janë zbatuar plotësisht 6 rekomandime, janë në proces zbatimi 25 rekomandime dhe janë pazbatuar 2 rekomandime.

Për shpërblim dëmi janë lënë 22 masa në vlerën 17,534 lekë, nga të cilat është zbatuar një, janë në proces 17 dhe ngelen pa zbatuar 4 rekomandime. Janë arkëtuar gjithsej 7,225 mijë lekë dhe ngelen pa arkëtuar 10,309.

Janë lënë 3 masa me 3E nga të cilat një është zbatuar dhe 2 janë në proces.

Nga 40 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar vetëm , ndërsa 37 nuk janë zbatuar.

II. HYRJE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Bashkinë Durrës “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: verifikimin e respektimit të afatit 20-ditor dhe 6-mujor për kthim përgjigje mbi përgatitjen e plan-veprimit dhe informacionin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve; verifikimin e nivelit të zbatimit të masave për përmirësim ligjor, organizative, të ardhura të munguara dhe masave disiplinore.

Sipas Programit të Auditimit, nr. 628/5, datë 07.07.2023, auditimi u krye nga grupi auditues, si vijon:

1. O.L, Përgjegjës Grupi
2. L.K, auditues
- 3.B.B, auditues
- 4.F.C, auditues

1. Objekti

Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, procedurave për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të tyre, mbi zbatimin e afatit 20 ditor dhe 6 mujor të kthimit të përgjigjes, si dhe mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e zbatimit të rekomandimeve.

2. Qëllimi i auditimit

Të vlerësojë dhe evidentojë masat e marra nga subjektet përkatëse për zbatimin e rekomandimeve, hartimin e matricave (plan veprimi ose masash) për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë aktet administrative përkatëse (urdhurat) të nxjerra për zbatimin e rekomandimeve. Të vlerësojë dokumentacionin që shoqëron dhe vërteton zbatimin e rekomandimeve, si dhe të verifikojë nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore dhe pasqyrimin në dosjen personale të punonjësve. Të verifikojë dhe dokumentojë me kujdes nëse janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit ekonomik ose gjobave të vendosura.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Durrës dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Durrës, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e objektiv e profesional mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

6. Kriteret e vlerësimit

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikën, është pasur si kriter vlerësues në radhë të parë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Rregullorja e Procedurave të Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, e ndryshuar me Vendimin nr.107, datë 08.09.2017 të Kryetarit Të KLSH-së.
- Manuali për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe regjistri elektronik institucional, miratuar me Vendimin nr.67, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH-së.

7. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar, si rrjedhojë edhe Projekt Raporti i Auditimit është plotësuar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, Rregullores së Procedurave të Auditimit, Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve.

8. Metodologjia e auditimit

1. Auditim i plotë sipas cilësimeve të bëra në drejtimet e auditimit.
2. Verifikimi i Urdhrëve, Udhëzimeve dhe çdo dokumenti ligjor të nevojshëm për zbatimin e rekomandimeve.

9. Dokumentimi i auditimit

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar është përgatitur Projektraporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit për ridërgimin e rekomandimeve.

III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Bashkia Durrës është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes Vendore", Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Durrës.

2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Hartimi i programit (plani i veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

1. Hartimi i plan-veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Nga auditimi u konstatua se:

- Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 369/43 prot, datë 30.12.2022, ka dërguar në Bashkinë Durrës Raportin Përfundimtar të Auditimit së bashku me rekomandimet përkatëse.
- Nga Kryetari janë marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH duke hartuar plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve (njoftuar KLSH me shkresë nr.prot.32/1, datë 23.01.2023) të lëna nga KLSH. Sipas plan veprimit dhe urdhërave përkatës janë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

caktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve, afatet për zbatimin e tyre, si dhe treguesi i rezultateve të arritura, në përputhje me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 15, gërma j. Me shkresë nr.193 prot., datë 15.04.2021 nga ana e Bashkia Durrës është kthyer përgjigje brenda 20 ditëve për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 gërma (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Nga ana e Bashkisë Durrës nuk janë marrë masa për respektimin e afatit prej 6 (gjashtë) muajsh për raportimin në KLSH me anë të një informacioni të hollësishëm për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me Ligjin nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, neni 30, pika 2. Me shkresë nr.1646 prot., datë 26.07.2023 është përcjellë relacioni për zbatueshmërinë e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Niveli i pranimit dhe statusi sipas llojit të rekomandimit në numër dhe në vlerë

Nga ana e KLSH janë lënë **98 rekomandime** gjithsej, nga këto:

- **33 masa organizative**, nga të cilat 16 janë zbatuar, ndërsa 15 janë në proces zbatimi
- **22 masa shpërblim dëmi**, nga të cilat 1 është zbatuar, ndërsa 17 janë në proces zbatimi
- **3 masa me 3E**, 1 është zbatuar, ndërsa 2 janë në proces zbatimi
- **40 masa disiplinore**, nga të cilat 3 janë zbatuar

Pasqyra e realizimit të detyrave të rekomanduara paraqitet si me poshtë:

Nr	Emërtimi	Rekomandimet ne numër :				Nga rekomandimet gjithsej: Sa me dëme ekonomike							
		Rekomandim gjithsej	Nga rekomandimet janë:			Rekomanduar Gjithsej		Nga rekomandimet janë:					
			Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar			Zbatuar arkëtuar		Zbatuar pjesërisht (në proces)		Pa zbatuar	
						Nr. perr	Në mijë/lek	Nr. perr	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek	Nr. pers	Në mijë/lek
1.	Masa organizative	33	16	15	2								
2.	Masa për përmirësim ligjor												
3.	Shpërblim demi	22	1	17	4		17,534		396		6,829		10,309
4.	Masa efekt financiar	3	1	2			923,129				923,129		
5.	Masa disiplinore	40	3		37								



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

	Totali	98	21	34	43	940,663	396	929,958	10,309
--	---------------	-----------	-----------	-----------	-----------	----------------	------------	----------------	---------------

2.2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Duke qenë se nuk nga auditimi i mëparshëm i KLSH nuk janë lënë rekomandime për përmirësime ligjore atëherë kjo pikë e programit ezaurohet me këtë shënim.

2.3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve me karakter organizativ të lëna nga KLSH, u konstatua si vijon:

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtorët e Drejtorive të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Për proceset kryesore të punës të hartohet regjistri i riskut, gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës për çdo drejtori. Të hartohen rregulla për ruajtjen e informacionit elektronik dhe ruajtjen e aktiveve. Në plotësimin e deklaratës vjetore të vlerësimit të funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, të bëhet vlerësimi i të pesë elementëve të këtij sistemi dhe të përcaktohen nevojat për përmirësimin e tij.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Për zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 "Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit".

Me shkresën nr.8990 prot. date 16.05.2023 nga Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është dërguar raporti për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Durrës, me ane të cilit janë dhënë rekomandime pas vlerësimit pjesërisht efektiv. Bazuar në këtë raport vlerësimi Bashkia Durrës është në proces të përmbushjes së rekomandimeve të lëna.

2.1.Rekomandim: Nga Kryetari i Bashkisë, të hartohen rregulla të shkruara për veprimet që kryhen nga punonjësi dhe strukturat përkatëse të kësaj njësie gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës në rastet e fillimit, ndërprerjes së marrëdhënieve të punës apo transferimeve. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve, Financës, etj., të merren të gjitha masat e nevojshme që përpara largimit nga puna, punonjësi të bëjë dorëzimin e plotë të dokumentacionit shkresor dhe elektronik që ka krijuar për shkak të detyrës, si dhe të inventarit fizik në ngarkim, sipas kartelës përkatëse për këtë qëllim.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

3.1. Rekomandim: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike etj., në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Njesia e Auditimit te Brendshem në planin vjetor të auditimit miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr.8430 datë 17.10.2022 ka planifikuar auditimin e disa fushave kryesore te veprimtarise se institucionit ku perfshihen auditimi i Sektorit te Prokurimeve ne Drejtorine e Sherbimeve (auditim i kryer sipas shkreses se njoftimit prot.2336 date 28.02.2023), auditim i Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore etj.

4.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrin masa për disiplinimin në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, të veprimtarisë së subjekteve që zhvillojnë veprimtarinë e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë. Për këtë të evidentohen subjektet të cilat plotësojnë kriteret ligjore për zhvillimin e kësaj veprimtarie dhe të pajisën me licencë, kundrejt pagesës përkatëse. Për subjektet të cilat nuk plotësojnë kriteret, të merren masat e duhura në bashkëpunim me institucionet e tjera, sipas përcaktimeve ligjore për mos lejimin e kryerjes së këtij aktiviteti në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektori i transportit publik me shkresen prot.11000 date 21.12.2022 ka vene ne dijeni Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial, Tirane mbi subjektet qe ushtrojne veprimtarine e stacionit te shitjes te karburanteve ne territorin e Bashkise Durres.

5.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për plotësimin e regjistrit të taksapaguesve familjar me të gjithë elementët e nevojshëm, si adresa, numri i identifikimit etj.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore eshte kryer plotesimi i regjistrit te taksapaguesve familjare me te gjithë elementet e nevojshem nga muaji janar 2011 deri ne dhjetor te vitit 2022.

6.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin të gjitha masat e nevojshme, nëpërmjet rishikimit të organizimit të punës në këtë drejtori apo përmirësimit të programit elektronik të punës, në mënyrë që të bëhet e mundur faturimi i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për familjarët çdo muaj.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”

Nga Bashkia Durrës është kryer tenderi për blerjen e një programi të ri elektronik për të gjitha drejtoritë pjesë e institucionit, për të rritur cilësinë e punës dhe në rastin e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për të bërë të mundur faturimin e detyrimeve online për taksat dhe tarifat vendore për të gjithë taksapaguesit.

7.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e regjistrimit të taksapaguesve privat dhe familjar për taksën e tokës bujqësore, duke evidentuar qytetarët të cilët kanë marrë tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, në hektar për secilin. Mbi bazën e këtij regjistri të llogariten dhe arkëtohen detyrimet për taksën e tokës bujqësore, si dhe të hartohet lista e debitorëve.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Gjithashtu është përgatitur urdhri i kryetarit prot.16 date 14.06.2023 “Për regjistrimin në sistem dhe mbledhjen e detyrimeve të papaguara të taksës mbi token bujqësore”, sipas të cilit është ngritur grupi i punës për regjistrimin dhe mbledhjen e detyrimeve të papaguara të qytetarëve që disponojnë toka bujqësore në qendrat administrative të Bashkisë Durrës.

8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të marrin masa për të evidentuar në rregulloren “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Durrës”, edhe përcaktimin e bërë në paketën fiskale, në struktura përgjegjëse për vjeljet e kësaj takse është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, por **i pa zbatuar**.

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për të bërë ndryshimet përkatëse në paketën fiskale, duke parashikuar që taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja pavarësisht sipërfaqes së ndërtimit, të paguhet e gjitha përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

Deri më 31.01.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **pa zbatuar**.

10.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, veçanërisht për taksën “Taksën mbi pasurinë e paluajtshme”. Ky planifikim të bëhet mbështetur në realizimet faktike të viteve të fundit dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave, duke shmangur edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizuar plotësisht.

Deri më 31.01. 2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”

11.1.Rekomandim: Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të marrë masa për administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja që janë në proces legalizimi, duke kërkuar për këtë qëllim bashkëpunimin me ASHK Durrës, me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për këtë proces.

Deri më 31.01.2023



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

12.1.Rekomandim: Për taksapaguesit të cilët nuk paguajnë detyrimin tatimor në afatet e përcaktuara në paketën fiskale, të marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimit, menjëherë me përfundimin e afatit të pagesës të përcaktuar në paketën fiskale.

Menjëherë dhë në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”

13.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, si dhe supervizori i kontratës, të marrin masa për mbikëqyrjen e kontratës me objekt “Kryerja e shërbimit të pastrimit të njësisë administrative Sukth”, në përputhje me kriteret, specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe elementët e kontratës e lidhur midis palëve.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Me urdher nr.202/1 date 02.03.2023 “Per ndjekjen dhe kontrollin e shërbimit te pastrimit per vitin 2023”, Drejtori i NSHK Durres ka percaktuar personin pergjegjes per te monitoruar, kontrolluar dhe vendosur per nderhyrje dhe caktuar permiresime nese do te kete nevojë per realizimin e objektivave te kesaj kontrate. Gjithashtu eshte mbajtur proces verbal nr.1 date 01.04.2023 per te pasqyruar ecurine e derimetanishme te ketyre punimeve.

14.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa për dëmshpërblimin e 123 familjeve të zonës së Porto Romanos, të cilët janë pjesë e listës së miratuar nga Këshilli i Qarkut Durrës, dëmtuar si rezultat i përmbajtjeve të vitit 2018.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Eshte ngarkuar Drejtoria Juridike dhe Emergjencat Civile per te perpiluar listen per Keshill Bashkiak.

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Buxhetit, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur në realizimet e mëparshme, si dhe mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

16.1.Rekomandim: Nëpunësi zbatues të marrë masa për pasqyrimin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, të vlerës 22,722,660 lekë, e cila përfaqëson një detyrim të lindur, por të pa paguar. Drejtoria e Urbanistikës të përcjellë në vijimësi në financë situatën e gjendjes së debitorve për taksat që kjo drejtori mbulon.

Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2022

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”

17.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për regjistrimin e 1801 pronave në AShK Durrës, vlerësimin dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare.” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 91-95 të raportit të auditimit).

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

18.1. Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa që për çdo projekt zbatimi të nxjerrë leje ndërtimi në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe zbatuar.

Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktues Publike per cdo projekt zbatimi aplikon per nxjerrjen e lejes se ndertimit.

19.1.Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa që për projektet e zbatimit me vlerë të preventivit mbi 100 milion lekë, të kryhet oponenca teknike nga institucionet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim rritjen e sigurisë për cilësinë e projekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe zbatuar.

Drejtoria e Projekteve dhe Infrastruktues Publike ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per projektet e zbatimit me vlere te preventivit mbi 100 milion leke ka kryer oponencen teknike.

20.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës nëpërmjet komisioneve të vlerësimit të ofertave, të marrë masa për eliminimin e praktikave në të cilat një operatorë ekonomik shpallet fitues njëkohësisht në më shumë se një procedurë prokurimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

21.1.Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Durrës, të marrë masa që në gjatë hartimit të kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit, këto kriterë të argumentohen dhe të kenë lidhje të ngushtë me natyrë dhe vlerën e objektit të prokurimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

22.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga AK, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

23.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procesit të mbikëqyrjes së sasisë së mbetjeve që depozitohen çdo ditë nga Bashkia Durrës në landfillin e Sharrës.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

Me urdher te titullarit eshte ngritur grupi i mbikqyresve i cili ben kontrollin e faturave te leshuara ne raport me mjetet, pergatit nje relacion teknik dhe gjithashtu miraton situacionin.

24.1.Rekomandim: Nga Bashkia Durrës të merren masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore që sipërmarrësi të kryej punimet për vendosjen ose montimin e dyerve dhe vetratave, të cilat ende nuk janë vendosur. Për këtë të ngrihet grup pune për verifikimin konkretisht në teren të situatës. Nëse sipërmarrësi I ShPK nuk eliminon të gjitha mangësitë brenda vitit 2022, në përputhje me kontratën e nënshkruar, atëherë detyrimet e pa përmbushura të konvertohen në vlera financiare, sipas çmimeve të ofruara prej tij në ofertë dhe ti zbriten kontraktorit nga fondi i garancisë së punimeve.

Deri më 31.01.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

25.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit, pa shqyrtuar përputhshmërinë ndërmjet planit të vendosjes së strukturave të miratuar për leje ndërtimi dhe projektit të ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

26.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa për eliminimin e anomalive të mësipërme, duke respektuar të gjitha kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në rregulloren në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

27.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

28.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

29.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa për të mos miratuar lejen e ndërtimit pa respektuar distancën e nevojshme nga trupi i rrugës ose nga traseja e hekurudhës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

30.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa për të mos miratuar lejen e ndërtimit pa verifikuar më parë statusin e pronësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe i zbatuar.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

31.1.Rekomandim: Nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit Bashkia Durrës, të merren masa për të mos miratuar leje ndërtimit pa plotësuar më parë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

32.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në raportin e auditimit të fundit, sipas shkresës nr. nr. 775/34 prot., datë 24.09.2021, të përshkruara në mënyrë të detajuar në këtë projekt raport auditimi, pika “Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në auditimin e fundit”.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

33.1.Rekomandim: KLSH i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Durrës dhe strukturës së IMT Bashkia Durrës, ndjekjen me përparësi të kësaj çështjeje, sipas kuadrit ligjor në fuqi deri në zgjidhjen përfundimtare të saj, duke eliminuar vonesat e pa nevojshme në kohë.

Deri më 31.01.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, dhe në proces zbatimi.

Per zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

2.4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i Njësisë Publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **17,534,905 lekë** si më poshtë:

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **9,076,702 lekë**, nga shtatë subjektet si vijon, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë:

- Subjekti “M” ShPK, në vlerën 2,240,140 lekë;
- Subjekti “V.H” ShPK, në vlerën 2,595,552lekë;
- Subjekti “K.K” ShPK, në vlerën 1,865,700 lekë;
- Subjekti “J” ShPK, në vlerën 435,776 lekë;
- Subjekti “D” ShPK, në vlerën 279,754 lekë
- Subjekti “K.O” ShA, në vlerën 1,077,876 lekë;
- Subjekti “P” ShA, në vlerën 581,904 lekë.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i pazbatuar**.

Per zbatimin e plan veprimtimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **3,100,000 lekë pa TVSh** nga BOE “B.K” SHPK & “A.C” ShPK, vlerë e cila është përfituar padrejtësisht si rezultat i rritjes fiktive të fondit limit.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/22, datë 14.07.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **522,937 lekë** pa TVSh, nga sipërmarrësi “E.2” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i pazbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **565,400 lekë pa TVSh**, nga sipërmarrësi “D.A” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i pazbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

5.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **270,000** lekë nga sipërmarrësi “T” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/14, datë 27.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

6.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **359,470 lekë pa TVSh** nga sipërmarrësi S. ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/23, datë 14.07.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

7.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **383,800 lekë pa TVSH** nga BOE “N.C” SHPK & “F.B & C.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 533/10 prot., datë 10.02.2021, me objekt: “Riforcimi i njërive të banimit në ndërtesat (pallat), të cilat janë kualifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturor ose dëmtime shumë të rënda jostrukturorë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para” Bashkia Durrës, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/7, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **144,516 lekë pa TVSH** nga BOE “R.N” ShPK & “G.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9477/49 Prot., datë 13.10.2020, me objekt: “Loti 1: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët, “Glaukia – Hysen Kërtusha - Aleksandër Goga – Telat Noga”, në kuadër të procesit të rindërtimit” Bashkia Durrës, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i pazbatuar**.

9.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerën **396,472** lekë pa TVSh nga BOE “R.N” ShPK & “G.C” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 3638/44., datë 02.06.2021 me objekt “Loti 2. Riforcim godina banimi 10-11 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë, rruga “Neki Libohova” nr. 15, rruga “Abaz Celkupa” nr. 26, kod GIS 2492307, 24923”, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e Rindërtimit të tërmetit).

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Ky detyrim është paguar, vërtetuar kjo sipas mandatit të arkëtitimit datë 10.07.2023, pagesa është kryer nëpërmjet bankës C.

10.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **205,360** lekë pa TVSh nga OE “K” ShA për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 3638/125., datë 16.07.2021 me objekt “Loti 5. Riforcim godina banimi i rruga “Varoshi” nr. 43 me kod GIS



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

26082, rruga “Kristo Sotiri” nr. 55 me kod GIS 19070, rruga “Horizonti” nr. 7 me kod GIS 19056” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e Rindërtimit të tërmetit).

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/4, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

11.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerën prej **272,000** lekë pa TVSh nga OE “I” ShPK për punime të pakryera, parashikuar në kontratën me nr. 9477/46 prot., datë 12.10.2020 me objekt “Loti 6: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët, Bulevardi Dyrrah-Epidam-Mars 93- Egnatia, në kuadër të procesit të rindërtimit” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e Rindërtimit nga tërmetit).

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/14, datë 27.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

12.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **474,906 lekë pa TVSh** nga shoqëria “E” ShPK , për punime të pakryera sipas kontratës me nr. 9477/50 prot., datë 13.10.2020 me objekt: “Loti 8: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët Segmentit të rrugës Pavarësia - Duna - Bajram Curri - Kanali ujërave të larta - segmenti rrugës Pavarësia - vija bregdetare e plazhit Hotel Adriatik – Kavalishenca në kuadër të procesit të rindërtimit”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit (Fondet e rindërtimit nga tërmeti).

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/13, datë 27.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

13.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **464,558 lekë pa TVSh** nga shoqëria “C” ShPK, për punime të pakryera, për kontratën me nr. 305 prot datë 22.06.2021 me objekt “Rikonstruksion i tregut fshatar”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore Bashkia Durrës.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/12, datë 27.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

14.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **106,000 lekë pa TVSH** nga BOE “B” ShPK & “B.II” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 309/11 prot., datë 20.05.2021 me objekt “Rikonstruksion Rruga Danubi” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Deri më 28.02.2023

14.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës t’i kërkojë BOE “B” ShPK & “B.II” ShPK, të kryejë riparimin e shtresave asfaltike në volumin 121 m² me vlerë **169,400 lekë pa TVSh** në rrugicat e dëmtuara, duke siguruar realizimin e punimeve me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe KTZ, brenda periudhës së garancisë duke garantuar siguri maksimale të lëvizjes së automjeteve.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/11, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

15.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **114,650 lekë pa TVSh** nga shoqëria BOE “C.M & K.” ShPK, për punime të pakryera sipas kontratës me nr. 1017/9 prot., datë 08.06.2021 me objekt “Konstruksion rruga Kashta e Kumtrit” vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/10, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

16.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **155,094 lekë pa TVSh** nga shoqëria BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 1077/10 prot., datë 06.05.2021 me objekt “Rikonstruksion i rrugës Ohrit (Loti II)” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/5, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

17.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **141,765 lekë pa TVSh** nga shoqëria “Sh” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 311/8 prot., datë 14.05.2021, me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Shën Pjetër” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore. Sipërmarrësi i punimeve të kryejë riparimin e vijëzimeve së dëmtuar me vlerë 20,400 lekë nga OE “Sh” ShPK, për punime të kryera pa cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike në rrugën “Shën Pjetër” sipas kontratës nr. 311/8 prot., datë 14.05.2021, para përfundimit të garancisë së defekteve me datë 02.10.2023.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/8, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

18.1.Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **156,212 lekë pa TVSh** nga sipërmarrësi i punimeve BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK, për punime të pakryera në kontratën me nr. 303/11 prot., datë 06.05.2021 me objekt “Rikonstruksioni i Rrugës Shkumbini” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/6, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

18.2.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të kërkojë realizimin e zërit të punimeve “Mbushje me zhavorr të kanalit ekzistues” në vlerën **264,000 lekë pa TVSh** nga BOE “L.C” ShPK & “I” ShPK në përputhje me projektin e zbatimit dhe specifikimet teknike në rrugën “Shkumbini,” sipas kontratës nr. 303/11 prot., datë 06.05.2021, para përfundimit të garancisë së punimeve me datë 20.12.2023.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/6, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

19.1.Rekomandim: Bashkia Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës **59,520 lekë pa TVSh** nga BOE “S.U” ShPK & “B” ShPK për punime të pakryera në kontratën me nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës Tepelena” vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore.

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/9, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

19.2. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të kërkojë nga BOE “S.U” ShPK & “B” ShPK, të kryhet riparimi i shtresave asfaltike të dëmtuar në rrugicat tërthore në vlerën **98,143 lekë**, sipas kontratës me nr. 313/12 prot., datë 08.04.2021 me objekt “Rikonstruksioni i rrugës “Tepelena” dhe “Universi”. Nga kontraktori të sigurohet realizimi i punimeve me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike dhe KTZ, duke garantuar siguri maksimale të lëvizjes së automjeteve, në rast të kundërt nga Bashkia Durrës, volumi i shtresave të dëmtuara të konsiderohet dëm ekonomik për kontraktorin.

Deri më 28.02.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.32/9, datë 23.06.2023 është njoftuar subjekti për arkëtimin e vlerës së mësipërme.

2.5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet. Ecuria e zbatimit dhe analizimi i rekomandimeve: sa rekomandime janë pranuar dhe nga këto sa rekomandime janë zbatuar plotësisht, sa janë zbatuar pjesërisht, sa janë në proces zbatimi dhe sa rekomandimi nuk janë zbatuar.

Nga auditimi u konstatua si vijon:

1.1.Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa paguara nga kategoria e taksapaguesve privat në vlerën progresive 923,129,434 lekë. Gjithashtu nëpërmjet agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime Durrës ShA, të kërkohet arkëtimi i vlerës debitorë për vitin 2021 prej 25,093,771 lekë nga taksapaguesit familjarë, si dhe evidentimi prej tij edhe i vlerës së debisë progresive për secilin debitor, me qëllim njohjen e situatës së debisë për taksapaguesit familjar dhe marrjen e masave për arkëtim.

Deri më 31.03.2023

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Me shkresë nr.6709 nga ana e Bashkisë Durrës është kërkuar bllokimi i llogarive bankare për 2852 subjekte në total për vlerën totale 716,884,867 lekë.

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për diferencat në volumin e shërbimit të pastrimit, nga mosparaqitja e dokumentacionit tekniko-ligjor nga supervizimi i realizimit të shërbimit (referuar përlllogaritjes së fondit limit, DT, specifikimeve teknike e ofertës fituese), si dhe të marrë masa për ndërprerjen e kësaj anomalie.

Menjëherë

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **në proces zbatimi**.

Për zbatimin e plan veprimit është përgatitur urdhri i kryetarit nr.209 date 19.06.2023, prot.32/3 “Për marrjen e masave në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, por nuk është marrë asnjë masë në zbatim të këtij urdhri.

3.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria Ligjore të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore, si dhe të dalin përgjegjësitë administrative. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar**.

Me shkresë nr.32/25 prot., datë 18.07.2023 nga ana e Drejtorisë Ligjore janë analizuar rastet përktëse dhe nga kjo Drejtoria janë dhënë rekomandimet përkatëse në funksion të uljes apo eliminimit të mundshëm të efekteve negative financiare në buxhetin e Bashkisë Durrës.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

2.6.Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative. Fillimi i procedurave për dhënien e masave disiplinore dhe administrative. Sa rekomandime janë pranuar dhe ecuria e tyre për masat e dhëna.

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve për masa disiplinore, u konstatua si vijon:

A. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Durrës, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Largim nga shërbimi civil”, në proporcion me shkëlqjen, për punonjësit e mëposhtëm:**

1- Z. E.L., me detyrë specialist për periudhën 01.07.2017- 21.09.2020, ndërsa për periudhën 21.09.2020 deri në 31.12.2021 me detyrë drejtor i DPKZHT, Bashkisë Durrës, për parregullsitë e konstatuara në 19 leje ndërtimit, si dhe për parregullsitë e konstatuara në mënyrën e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për 2 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;

2- Znj. K.A., me detyrë specialiste nga periudha 01.07.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 16 lejet e ndërtimit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;.

3- Z. E.L., me detyrë drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 6, faqe 303-322.

4- Znj. V.Q., me detyrë drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit, për parregullsitë e konstatuara në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.1, faqe 35-69;

5- Z. A.I., me detyrë drejtor i Drejtorisë Ligjore, për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 6, faqe 303-322;

6- Z. L.D., me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për parregullsitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave vendore, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.2, faqe 69-91;

7- Z. L.B., me detyrë përgjegjëse i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Apelit, në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190, si dhe për anomalitë e konstatuara në menaxhimin e borxhit të krijuar nga mospagesa e taksapaguesve, trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2., faqe 69-91;

8- Znj. N.S., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave, për parregullsitë e konstatuara në fushën e të ardhurave, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.2, faqe 69-91;

9- Z. A.L., me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190, si dhe për parregullsitë e konstatuara në aktivitetin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2, faqe 69-91;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

- 10- Z. D.M**, me detyrë kryeinspektor i IMTNJV Durrës nga periudha 19.03.2021 e në vazhdim, si dhe me detyrë inspektor i IMTNJV Durrës për periudhën 01.07.2017-19.03.2021, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren për 3 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 11- Z. S.M**, me detyrë inspektor i IMTNJV Durrës nga periudha 17.06.2019 e në vazhdim, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të 2 lejeve të ndërtimit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 12- Znj. E.K**, me detyrë përgjegjëse sektori nga data 01.07.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 2 leje e ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 13- Z. V.S**, me detyrë specialist nga data 01.06.2021 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 2 leje e ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 14- Znj. I.K**, me detyrë specialiste për periudhën prej 01.07.2017 deri më 02.09.2020, për parregullsitë e konstatuara në 1 leje e ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302, si dhe në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 15- Z. G.H**, me detyrë kryeinspektor i IMTNJV Durrës nga data 19.03.2021 e në vazhdim, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren për 1 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 16- Z. A.T**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 17- Z. G.D**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 18- Znj. R.U**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 19- Z. O.G**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 20- Z. M.J**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 21- Znj. A.K**, me detyrë pecaliste në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 22- Znj. I.H**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 23- Znj. E.T**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 24- Znj. J.M**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 25- Z. V.S**, me detyrë specialist në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

26- Znj. K.B., me detyrë specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

27- Z. L.F., me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

28- Z. E.B., me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

29- Znj. R.T., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, kontratën individuale të punës, neni 9, në pikën 1, germa (i), neni 29 të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në nenit 82 dhe 84 të “Rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Durrës**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1- Z. A.N., me detyrë inspektor, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

2- Z. SH.B., me detyrë inspektor, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

3- Z. F. A. – Specialist NSHK, anëtar i hartimit të specifikimeve teknike;

3- Z. O.Sh, me detyrë inspektor mjedisi në NSHK, në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, si dhe në cilësinë e supervizorit në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësisë Administrative Sukth, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190.

4- Znj. I.A., me detyrë specialiste në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

5- Z. A.K., me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

6- Z. A.T., me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

7- Z. D.D., me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

8- Znj. M.Xh., me detyrë inspektor për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

9- Z. E.K., me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, si dhe si supervizor në kontratën me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës”, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

10- Z. K.D., me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e supervizorit, në kontratën me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës”, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022" NË BASHKINË DURRËS

11- Z. S.T, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e supervizorit, në kontratën me objekt "Shërbimi i pastrimit të njësisë administrative Ishëm", trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

Komente: Ky rekomandim konsiderohet **i pranuar**, dhe **i zbatuar pjesërisht**, pasi me urdhër nr. 230, datë 04.07.2023 është urdhëruar Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komisioni Disiplinor për fillimin e procedurave përkatëse për marrjen e masave disiplinore në proporcion me shkeljet e konstatuara vetëm për punonjësit E. K. me detyrë përgjegjëse sektori, K. A. me detyrë specialiste dhe V. S. me detyrë specialist. Deri më tani nuk është arritur me një vendim përfundimtar për këto masa.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

Për përmirësimin e punës në të ardhmen, rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 369/43 prot, datë 30.12.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

8.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të marrin masa për të evidentuar në rregulloren "Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Durrës", edhe përcaktimin e bërë në paketën fiskale, se struktura përgjegjëse për vjeljet e kësaj takse është Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

9.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për të bërë ndryshimet përkatëse në paketën fiskale, duke parashikuar që taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja pavarësisht sipërfaqes së ndërtimit, të paguhet e gjitha përpara marrjes së lejes së ndërtimit.

(Më hollësisht trajtuar në faqet 11-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 369/43 prot, datë 30.12.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

1.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 9,076,702 lekë, nga shtatë subjektet si vijon, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë:

-Subjekti "M" ShPK, në vlerën 2,240,140 lekë;

-Subjekti "V.H" ShPK, në vlerën 2,595,552lekë;

-Subjekti "K.K" ShPK, në vlerën 1,865,700 lekë;

-Subjekti "J" ShPK, në vlerën 435,776 lekë;

-Subjekti "D" ShPK, në vlerën 279,754 lekë

-Subjekti "K.O" ShA, në vlerën 1,077,876 lekë;

-Subjekti "P" ShA, në vlerën 581,904 lekë.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

3.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 522,937 lekë pa TVSh, nga sipërmarrësi “E.2” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 565,400 lekë pa TVSh, nga sipërmarrësi “D.A” ShPK, shumë kjo si rezultat i situacionimit më tepër për zërat e punimeve që cilësohen më sipër.

8.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 144,516 lekë pa TVSH nga BOE “R.N” ShPK & “G.C” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 9477/49 Prot., datë 13.10.2020, me objekt: “Loti 1: Rikonstruksion ose riparimin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (Pallat), në rrugët, “Glaukia – Hysen Kërtusha - Aleksandër Goga – Telat Noga”, në kuadër të procesit të rindërtimit” Bashkia Durrës, që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera (*Më hollësisht trajtuar në faqet 18-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr. 369/43 prot, datë 30.12.2022, nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet si vijon:

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë Durrës, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**”, deri në “**Largim nga shërbimi civil**”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

1- Z. E.L., me detyrë specialist për periudhën 01.07.2017- 21.09.2020, ndërsa për periudhën 21.09.2020 deri në 31.12.2021 me detyrë drejtor i DPKZHT, Bashkisë Durrës, për parregullsitë e konstatuara në 19 leje ndërtimit, si dhe për parregullsitë e konstatuara në mënyrën e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për 2 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;

3- Z. E.L., me detyrë drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit Financiar në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 6, faqe 303-322.

4- Znj. V.Q., me detyrë drejtoreshë e Drejtorisë së Buxhetit, për parregullsitë e konstatuara në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.1, faqe 35-69;

5- Z. A.I., me detyrë drejtor i Drejtorisë Ligjore, për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 6, faqe 303-322;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

- 6- Z. L.D**, me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore, për parregullsitë e konstatuara në planifikimin dhe realizimin e taksave dhe tarifave vendore, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.2, faqe 69-91;
- 7- Z. L.B**, me detyrë përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Borxhit dhe Apelimit, në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190, si dhe për anomalitë e konstatuara në menaxhimin e borxhit të krijuar nga mospagesa e taksapaguesve, trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2., faqe 69-91;
- 8- Znj. N.S**, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave, për parregullsitë e konstatuara në fushën e të ardhurave, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 2.2, faqe 69-91;
- 9- Z. A.L**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190, si dhe për parregullsitë e konstatuara në aktivitetin e stacioneve të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, trajtuar më gjerësisht në pikën 2.2, faqe 69-91;
- 10- Z. D.M**, me detyrë kryeinspektor i IMTNJV Durrës nga periudha 19.03.2021 e në vazhdim, si dhe me detyrë inspektor i IMTNJV Durrës për periudhën 01.07.2017-19.03.2021, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren për 3 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 11- Z. S.M**, me detyrë inspektor i IMTNJV Durrës nga periudha 17.06.2019 e në vazhdim, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren të 2 lejeve të ndërtimit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 14- Znj. I.K**, me detyrë specialiste për periudhën prej 01.07.2017 deri më 02.09.2020, për parregullsitë e konstatuara në 1 leje e ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302, si dhe në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 15- Z. G.H**, me detyrë kryeinspektor i IMTNJV Durrës nga data 19.03.2021 e në vazhdim, për parregullsitë e konstatuara në zbatimin në terren për 1 leje ndërtimi, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 5, faqe 257-302;
- 16- Z. A.T**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 17- Z. G.D**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 18- Znj. R.U**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 19- Z. O.G**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 20- Z. M.J**, me detyrë specialist i Drejtorisë së Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 21- Znj. A.K**, me detyrë përcjelle në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 22- Znj. I.H**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2022” NË BASHKINË DURRËS

- 23- Znj. E.T**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 24- Znj. J.M**, me detyrë Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zbatimit të Lejeve, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 25- Z. V.S**, me detyrë specialist në Sektorin e Projekteve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike të tenderit, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 26- Znj. K.B**, me detyrë specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 27- Z. L.F**, me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 28- Z. E.B**, me detyrë specialist në Sektorin e Menaxhimit të Gjeoinformacionit, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 29- Znj. R.T**, me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Mjedisit, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin 139/2015” Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 e nenit 15, kontratën individuale të punës, neni 9, në pikën 1, germa (i), neni 29 të ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në nenit 82 dhe 84 të “Rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Durrës**, që bazuar në shkeljet e konstatuara në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, **në proporcion me shkeljen**, për punonjësit e mëposhtëm:

- 1- Z. A.N**, me detyrë inspektor, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 2- Z. SH.B**, me detyrë inspektor, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 3- Z. F.A – Specialist NSHK, anëtar i hartimit të specifikimeve teknike;
- 3- Z. O.SH**, me detyrë inspektor mjedisi në NSHK, në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, si dhe në cilësinë e supervizorit në tenderin me objekt “Shërbimi i pastrimit të Njësisë Administrative Sukth, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190.
- 4- Znj. I.A**, me detyrë specialiste në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 5- Z. A.K**, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të hartimit të specifikimeve teknike, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;
- 6- Z. A.T**, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN
2022” NË BASHKINË DURRËS

7- Z. D.D, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

8- Znj. M.Xh, me detyrë inspektor për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

9- Z. E.K, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e anëtarit të KVO, si dhe si supervizor në kontratën me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës”, trajtuar më gjerësisht në raportin e auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

10- Z. K.D, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e supervizorit, në kontratën me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane Bashkia Durrës”, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190;

11- Z. S.T, me detyrë specialist në NSHK, për parregullsitë e konstatuara në cilësinë e supervizorit, në kontratën me objekt “Shërbimi i pastrimit të njësisë administrative Ishëm”, trajtuar më gjerësisht në raportin përfundimtar të auditimit, pika 4.1, faqe 106-190 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 23-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Durrës dhe strukturat përkatëse, për rekomandimet e evidentuara më sipër, të marrin masa për ndjekjen e procesit deri në realizimin e plotë të tyre.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Shkodër: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUdhËN
01.07.2022 DERI 31.01.2023, BASHKIA SHKODËR”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-20
	Drejtimit e Auditimit.....	4
	A.Masa Organizative.....	4-12
	B.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....	12-19
	C.Masa Disiplinore.....	19-20
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	21-23

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 627/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Shkodër, më datë 26.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. Sh. H., z. K. H. dhe Z. L. B., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar. Me shkresën nr. 627/10 prot., datë 04.08.2023 është dërguar Projekt Raporti i Auditimit subjektit Bashkia Shkodër.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, ndërsa nga Bashkia Shkodër me shkresën nr. 5450/18 prot., datë 08.08.2022, **brenda afatit 20 ditore**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 18.01.2023. Nga ana e Bashkisë Shkodër nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.*

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 17 **masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 17 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 12 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 14 masa, të cilat janë pranuar plotësisht. Janë zbatuar 3 masa, janë në proces zbatimi 5 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masë dhe nuk janë zbatuar 4 masa.

d. Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Shkodër dhënia e masës disiplinore ndaj 5 personave, nga të cilat sipas plan veprimit do të vlerësohen rast pas rasti. Nuk është marrë asnjë masë tjetër.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 18.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Shkodër, sipas programit të auditimit nr. 627/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Sh. H., përgjegjës i grupit;
2. K. H., anëtar,
3. L. B., anëtar

Auditimi ka filluar më datë 10.07.2023.

Auditimi ka përfunduar më datë 28.07.2023.

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Shkodër në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 373/8 prot, datë 18.07.2022, rezulton se nga **36** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **22** masa ose 61% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **14** masa ose 39% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë shumicën e tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 60% nga ana e Bashkisë Shkodër, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, ndërsa nga Bashkia Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 5450/18 prot., datë 08.08.2022 brenda afatit 20 ditor.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 18.01.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

Pa zbatuar

3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Shkodër ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 373/8 prot, datë 18.07.2022, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.”

Pa zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Shkodër 17 masa organizative, janë pranuar prej tyre 17 masa, janë zbatuar plotësisht 12 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, është realizuar pjesërisht 1 masë dhe nuk janë zbatuar 2 masa. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave për investime me afat financimi 2021-2023, miratuar me VKB nr.63, datë 28.12.2020, konstatohet se përgjatë vitit 2021 nga Bashkia Shkodër në 8 raste, janë lidhur kontrata në vlerën 76,659 mijë lekë, pa pasur në dispozicion minimalisht 20% të vlerës së kontratës në vitin e parë të financimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 9, 10 të nenit 3, nenin 40, nenin 50 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 1 në nenin 47 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Pika

1, paragrafi II në nenin 76 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Pikat 1 dhe 4 në nenin 106 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për kontratat e tjera. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme në mënyrë që lidhja e kontratës me operatorët ekonomik të bëhet vetëm pasi fondi i nevojshëm sipas vlerës së kontratës, të jetë në dispozicion (jo më pak se 20% për kontratat shumëvjeçare) të autoritetit kontraktor. Për çdo rast të angazhimeve buxhetore, kryesisht të investimeve për punë publike, Nëpunësi Zbatues të japë opinion me shkrim, për fondin buxhetor që është i disponueshëm për lidhjen e kontratës përkatëse.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e Financës, rezulton se ka marrë masa që të mos marrë angazhime buxhetore për periudhë më të gjatë se 12 mujore.*

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës u konstatua se për vitin 2021 në 28 raste në vlerën totale 96,852,384 lekë, faturat tatimore janë paraqitur në degën e thesarit jashtë afatit 30 ditor.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se në fillim të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (çelja e llogaria 401-408 dhe çelja e llogarisë 467) ka qenë 149,042,632 lekë dhe fund të vitit 2021 vlera e faturave të palikuiduara (teprica kreditore e llogarisë 401-408 dhe llogarisë 467) është 209,368,206 lekë, ose 60,325,574 lekë më tepër në krahasim me fillim-vitin 2021.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare, konkretisht llogarive të detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata të Bashkisë Shkodër ndaj palëve të treta, konstatohet se stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021 sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit është në vlerën 248,490,839 lekë të shpenzimeve të institucionit, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE është 3,376,220 lekë, e cila tregon se Drejtoria e Financës raporton në MFE një vlerë të detyrimeve të prapambetura prej 245,114,619 lekë më pak se vlera e tyre e pasqyruar në raportimin e vetëvlerësimit financiar.

-Gjithashtu sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se në 5 raste nuk është respektuar radha e likuidimit të tyre, pra detyrimi i parë në radhën kohore nuk është likuiduar i pari. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, si dhe pikën 15 në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

2.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Janë testuar 4 investime nëse likuidimet e faturave janë brenda afatit 30 ditor dhe konkretisht:*

-“Rehabilitim ndriçim lulishte plazh Velipojë”;

-“Ndërtim i strehëzës për qentë e rrugës”;

-“Blerje materiale sinjalistikë horizontale dhe vertikale”;

-“Blerje kazanë”.

Nga verifikimi i procedurave të mësipërme, rezulton se likuidimet janë kryer brenda afatit 30 ditor.

Zbatuar

2.2. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864.

2.3 Nga verifikimi rezultoi se: Rekomandimi i mësipërm nuk është zbatuar, për shkak se raportimi i stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, nuk rakordon me stokun e detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare. Sistemimi në llogarinë 4864 nuk mund të pasqyrohet për shkak se bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, i cili citon llogarinë 486 si llogari rregulluese e cila në fund të vitit mbyllet dhe del me gjendje 0 (zero). Stoku i detyrimeve të prapambetura është pasqyruar në llogarinë nr. 4341.

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara ka diferencë me planifikimin, pasi realizimi i këtij zëri ekonomik në vitin 2021, është në masën 63%. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të investimeve të planifikuara për disa programe ekonomike, si programi ekonomik “Administrimi i pyjeve dhe kullotave” (nuk është realizuar asnjë investim, mosparaqitje të ofertave në tender, mungesa e miratimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të planit të menaxhimit të fondit pyjor/kullor), programi ekonomik “Rrjeti rrugor rural” realizuar në masën 70%, për arsye se shumë projekte janë në proces zbatimi, pasi një pjesë e konsiderueshme e kontratave janë lidhur në fund të vitit 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masa që kontratat me palët e treta të lidhen në një fazë më të hershme gjatë vitit buxhetor, me qëllim përshpejtimin e realizimit të investimeve të planifikuara sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Shkodër, brenda vitit buxhetor.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas parashikimit të buxhetit të vitit 2022, janë planifikuar investime me fondet e veta me vlerë totale 439,573 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar investime në vlerë 227,540 mijë lekë. Sa më sipër, rezulton se realizimet janë në masën 51.7%.

Zbatuar pjesërisht

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i likuidimeve të faturave të lëshuara nga subjektet e kontraktuara për kryerjen e punëve publike dhe kontabilizimit të tyre në llogarinë nr. 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, u konstatua se në 3 raste nga Drejtoria e Financës, janë pranuar fatura, me vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar në PBA 2021-2023 për t’u financuar në vitin 2021. Kjo situatë është konstatuar në kontratat e lidhura për kryerjen e investimeve: “Sistemim - Asfaltim i rrugës Vukatanë – Guri i Kuq, (Loti 2)”; “Sistemim Asfaltim rruga e Gështenjave Rrenc, Gur i Zi” dhe “Rikonstruksion vazhdimi i Rrugës “Ajasëm”. Pranimi i faturave me vlerë më të lartë se buxheti për vitin përkatës në gjykimin e grupit të auditimit

ndikon në rritjen artificialisht të detyrimeve në fund të vitit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 40 në Udhëzimin plotësues të MFE nr.1381/1 prot., datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që të mos ndërmerren angazhime buxhetore shumëvjeçare mbi vlerat e miratuara në planin e buxhetit vjetor dhe PBA.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Duke qenë se nuk janë lidhur kontrata me afat likuidimi më të gjatë se 12 muaj, rezulton se Drejtoria e Financës nuk ka ndërmarrë angazhime buxhetore shumë vjeçare.*

Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Drejtoria e të Ardhurave nuk ka në strukturën e saj sektor të menaxhimit dhe mbledhjes së borxhit. Nisur nga numri i lartë i debitorëve për taksat dhe tarifat vendore, për kategorinë e taksapaguesve biznes dhe familjar, gjykojmë se ky sektor është i nevojshëm për ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore në rend shterues për arkëtimin e debitorëve.

-Gjithashtu në strukturën organizative të Drejtorisë së të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër, konstatohet se nuk është parashikuar pozicioni i përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren, duke sjellë që ky sektor të kontrollohet direkt nga Drejtori i DAV Bashkia Shkodër.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar; Nenin 3 në Ligjin nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Shkronjën “d” në pikën 8 në nenin 8, shkronja “f” në pikën 4 në nenin 9, si dhe shkronjën “b” në pikën 3 në nenin 22 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për plotësimin dhe përshtatjen e strukturës së DAV Bashkia Shkodër sipas natyrës së menaxhimit të të ardhurave, duke krijuar sektorin e menaxhimit të borxhit dhe pozicionin e përgjegjës të sektorit të kontrollit në terren.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Me vendimin nr. 304, datë 06.06.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 1 datë 05.01.2022 për miratimin e strukturës të nëpunësve të administratës dhe të institucioneve në varësi të bashkisë Shkodër për vitin 2022” është ngritur Njësia e Administrimit të Borxhit Tatimor.*

Zbatuar

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Shkodër për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak, për vlerën 223,179,324 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon:

-13,438,000 lekë kamatëvonesa për detyrimet ndaj biznesit dhe institucioneve;

-222,324,563 lekë debitorë kategoria familjar për taksa dhe tarifa vendore krijuar brenda vitit 2021;

-Gjoha të vendosura nga IMTV mbivlerësuar për vlerën 4,432,962 lekë, më tepër për 8,294,277 lekë kamatëvonesa, si dhe më tepër për 144,000 lekë për likuidime brenda vitit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12, Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 11, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësiti e qeverisjes së përgjithshme”, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, ka kontabilizuar dhe regjistruar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” në kundërpartinë e llogarisë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë, për vlerën 2,064,307 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësiti e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, ka sistemuar pjesërisht llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 848,291 lekë. Pjesa tjetër për vlerën për vlerën 1,216,016 lekë sipas tabelës së mëposhtme, nuk është sistemuar.

1	Rikonstrukcion Rruga "Pjeter Spani"(Faza e II)	24,039
2	Ndertim prita malore ne Njesite Administrative,Sit.perfundimtar	100,397
3	Situacion perfundimtar dt. 13.08.2015 Ndriçim rruge dytesore	117,461
4	Upgrade-im i platformes Transparenca e Buxhetit ne mobile App dhe mirembajtje	48,996
5	Upgrade-im i funksionaliteve te sistemit te informacionit te sherbimeve sociale	72,000
6	Upgrade-im i aplikimit SIZIN dhe STTV permes ëeb,integrimi ne platformen e-Albania	249,600
7	Ndertimi i rrjetit te brendeshem te komunikimit elektronik (intranet) ne 3 njesi Administrative dhe 5 lagje.	101,724
8	Furnizim vendosje kamera sigurie per ambiente publike	330,676
9	Rehabilitim dhe ndertim i kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres	79,080
10	Rehabilitim dhe ndertim i kendeve te lojrave ne parqet dhe lulishtet e qytetit te Shkodres	63,720
11	Rikonstrukcion Blloku i Pallateve Osja Falltores (krahu i majte) Situacion Nr. 2(perfundimtar)	28,323
	Total	1,216,016

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, është kontabilizuar më pak, për vlerën 79,382,461 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1.1.5 “Grupi i llogarive 15 – Shuma të parashikuara për rreziqe e shfrytëzime” në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësiti e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në llogarinë nr. 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” duke e

debituar atë në momentin e njohjes dhe kredituar llogarinë nr. 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime.

8.3 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, ka kryer kontabilizimet sipas rekomandimit të mësipërm në llogaritë nr. 683 “Shuma të parashikuara të shfrytëzimit” me kundërpartit të llogarisë nr. 150 “Shuma të parashikuara për rreziqe e shpenzime.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërpartit llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve, etj, është pasqyruar më pak, për vlerën 245,114,619 lekë, si rrjedhojë e klasifikimit jo të rregullt të llogarisë nr. 486 për 245,114,619 lekë diferencë (Llogaria nr.467 - 79,357,034 lekë; Llogaria nr.401-408 – 165,757,585 lekë);

Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 15 në udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr.486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, duke kryer mbylljen e saj në debi të llogarisë nr.467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

9.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, Bashkia Shkodër, ka marrë masa dhe ka kontabilizuar në llogarinë nr. 4341 detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve. Kontabilizimi në llogarinë nr. 486, nuk mund të kryhet pasi bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022, i cili citon llogarinë 486 si llogari rregulluese e cila në fund të vitit mbyllet dhe del me gjendje 0 (zero).

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se për shtesat në aktive të bëra gjatë vitit 2021, nuk është përlllogaritur amortizimi për pjesën e mbetur nga data e marrjes në dorëzim të investimit deri në fund të vitit 2021. Përlllogaritur për 362 objekte të vitit 2021 (likuidimi i fundit + 30 ditë shtesë deri në kolaudimin e objektit, si dhe pjesën e mbetur të vitit 2021) në vlerën 9,614,406 lekë. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 2 “Aktivet Afatgjata”, përbërja dhe trajtimi kontabël. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, për vlerën 9,614,406 lekë.

10.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, ka amortizuar llogarinë nr. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” sipas Udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime” të pasqyrave financiare të Bashkisë Shkodër për vitin 2021, u konstatua se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 17,677,741 lekë (kosto historike + shtesa – pakësime * 15%) sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, Klasa 2 “Trajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja “d” në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 72-87, të Raportit të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Drejtorja e Financës Bashkia Shkodër të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 17,677,741 lekë.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtorja e Financës, ka amortizuar llogarinë nr. 202 “Studime dhe kërkime” Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

“Mjedisi i kontrollit”

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta/të plota/mbivendosje.

“Menaxhimi i Riskut”

-Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk janë përcaktuar qartë proceset e punës dhe mbi bazën e të cilave të analizohet risku si dhe të përcaktohen hapat konkret në eliminimin e plotë të tij.

-Regjistri i riskut nuk përditësohet rregullisht (2 herë në vit).

-Nuk ka raportim të riskut operacional, për shkak të strukturave të pa plotësuara.

-Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues i drejtorive pranë Bashkisë Shkodër.

-Programi i kontabiliteti “Alpha” i cili përdoret vetëm për veprimet e magazinës, është i vjetër duke moskryer plotësisht funksionet e sektorit të kontabilitetit, si dhe që ka nevojë të bëhet update dhe back up të të gjitha të dhënave.

“Aktivitetet e Kontrollit”

-Nuk ka procedurë të shkruar specifike për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

“Monitorimi”

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore nuk lidhet me monitorimin e

veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

-Në Bashkinë Shkodër mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 18-26, të Raportit të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër, drejtorët e drejtorive, si dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë impakt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

12.2. Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Shkodër nuk janë hartuar dhe miratuar strategjitë e riskut, por janë mjaftuar vetëm me plotësimin e regjistrit të riskut.*

Në proces zbatimi

12.2. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të licencuar për mbajtjen e kontabilitetit në Bashkinë Shkodër.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Shkodër, rezulton se është publikuar procedura e prokurimit me objekt “Sistem informacioni i integruar për menaxhimin financiar të Bashkisë Shkodër dhe Institucioneve të Varësisë” me Nr. Ref. 86915-02-12-2021 me fond limit 1,666,667 lekë pa tvsh. Në përfundim të procedurës, është lidhur kontrata me OE fitues me datë 24.03.2021. Përgjatë zbatimit të kontratës, ka rezultuar e pasuksesshme implementimi i sistemit sipas kërkesave të AK, për të cilat nuk është arritur krijimi i sistemit për menaxhimin financiar.*

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NJAB Bashkia Shkodër përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

- Nuk janë kryer auditime të teknologjisë së informacionit;

- Nuk janë kryer trajnime për stafin e NJAB Shkodër;

- Nuk janë mbuluar me auditim fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Shkodër, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë, si Drejtoria e Mbrojtjes kundër Zjarrit, Qendra e Zhvillimit, Teatri “Migjeni” etj;

-Dosjet koherente të auditimit të brendshëm të njësive publike nuk arkivohen në arkivin e njësive vendore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin

e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 26-29, të Raportit të Auditimit)*

13.1. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

13.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Për vitin 2023 janë planifikuar me shkresën nr. 15295/1 prot., datë 13.10.2022 plani vjetor 2023-2025, auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemi i menaxhimit buxhetor. Aktualisht në proces auditimi është Sistemi i Menaxhimit Buxhetor.*

Zbatuar

13.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

13.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Shkodër, paraqiti fletën e inventarit të dorëzuar në zyrës e arkivës për subjektin “Drejtoria Ekonomike e Arsimit”, proces të cilin e kryen për të gjitha auditimit e realizuara.*

Lidhur me opinionet e auditimit, u testua me zgjedhje rastësore Raporti Final e Auditimit të “Teatrit Migjeni”, për të cilin është aplikuar opinioni i auditimit.

Zbatuar

13.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

13.4 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk është marrë asnjë masë për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.*

Pa zbatuar

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Shkodër për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 2,285,200 lekë, për 3 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likuidimin e subjektit Gj. S., në urdhrin nr.628, datë 01.07.2021 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit Gj. S., moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Shkodër. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i Bashkisë Shkodër, nuk ka marrë asnjë masë për analizimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e gjyqeve.*

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2021, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA në mënyrë progresive janë 5972 subjekte debitorë në vlerën 777,462 mijë lekë, nga të cilët brenda vitit 2021 janë debitor 4837 subjekte “Biznes dhe Institucione” në vlerën 181,019 mijë lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

-968 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 74,331 mijë lekë;

-3841 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 83,622 mijë lekë;

-28 subjekte “Institucione” në vlerën 23,066 mijë lekë.

-Për vitin 2021 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 12,967 mijë lekë kundrejt planifikimit në vlerën 15,000 mijë lekë. Nga auditimi u konstatua se, ndjekja e kësaj takse aplikohet bazuar në akt-konstatimet e Sektorit të Kontrollit në Terren çdo datë 5 fillim muaj me tarifën e përcaktuar në VKB është 70 lekë/natë/personi për hotele nën 4 yje dhe 175 lekë për hotele 4-5 yje. Në këto akt-konstatime nuk evidentohet se sa netë kanë fjetur këto persona, por është evidentuar thjeshtë numri i tyre.

- Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhës ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se numri i këtyre masave është i ulët, pasi nga 5972 subjekte fizik/ juridik me vlerë 238,686 mijë lekë janë marrë masa shtrënguese vetëm për 802 subjekte ose rreth 14% e totalit të subjekteve. Marrja e këtyre masave nuk është e plotë sepse nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese në rend shterues, si bllokimi i aktivitetit të biznesit, vendosje e barrës hipotekore, barrë siguroese, deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, nenin 114 dhe nenin 117 i Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, nenin 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Nenin 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 777,462 mijë lekë.

2.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e Taksave, rezulton se në fund të vitit 2022, bizneset debitorë janë:*

-OJF, debitorë në vlerën 62,097,429 lekë;

-Biznesi i Madh, debitorë në vlerën 198,949,810 lekë;

Biznesi i Vogël, debitorë në vlerën 356,696,649 lekë;

Ambulant, debitorë subjekte në vlerën 648,448 lekë.

Në total, vlera e debitorëve është 618,392,336 lekë.

Në proces zbatimi

2.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të ngrejë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë

Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

2.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Shkodër, nuk ka ngritur grup pune për evidentimin e numrit të hoteleve që operojnë në këtë bashki.*

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Shkodër dhe NJA vlera debitore e kategorisë “familjar” është 566,030 mijë lekë (216,018 mijë lekë debitor krijuar brenda vitit 2021), nga të cilat:

-16,014 familje debitore në vlerën 187,880 mijë lekë për **taksën e ndërtesës;**

-15,517 familje debitore në vlerën 7,203 mijë lekë për **taksën e truallit;**

-14,683 familje debitore në vlerën 256,764 mijë lekë për **tarifën e pastrimit;**

-14,290 familje debitore në vlerën 82,484 mijë lekë, për **tarifën e ndriçimit;**

-7368 familje debitore në vlerën 31,835 mijë lekë, për **tarifën e gjelbërimit;**

Gjithsej familje të taksuara sipas DAV janë 42,439 familje, ndërkohë rezultojnë 14,730 familje të cilat nuk taksohen/tarifohen, ku vetëm nëse do të bënim llogaritjet vetëm për tarifën e pastrimit, sipas nivelit të aplikuar në NJA, *rezultojnë 39,966,900 lekë të cilat ndikojnë në reduktimin e të ardhurave nga mospërfshirja e numrit të plotë të familjeve.* Për familjet të cilat nuk janë të taksuara dhe tarifuar, DAV Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë veprime ligjore për identifikimin dhe faturimin e tyre, ku mos taksimi çon në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

-Sipas informacionit të pasqyruar në raportin vjetor të zbatimit të buxhetit, llogaritë bankare të Agjentit tatimor Ujësjiellës Kanalizime SHA kanë qenë të bllokuara nga shoqëri përmbarimore në bankat e nivelit të dytë, dhe si pasojë detyrimi që Ujësjiellës Kanalizime SHA ka ndaj Bashkisë Shkodër nuk është transferuar në llogari të saj duke sjellë mosrealizim të ardhurash sipas planifikimit për vitin 2021 me një diferencë prej -50,466 mijë lekë, ose ndryshe -6% më pak të ardhura. Kjo vlerë ka ndikuar gjithashtu edhe në mosrealizimin e zërave kryesorë të të ardhurave si: taksa e ndërtesës, e truallit, tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit etj. Nga DAV Shkodër për këtë situatë nuk janë marrë masat ligjore (aplikimin e gjobave) ndaj agjentit tatimor UK SHA Shkodër, i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore ndaj kategorisë “Familjar”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si dhe nenin 117 në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve me të dhënat e evidentuara në terren, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mostaksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përlllogaritjen e tarifës së pastrimit për vitin 2021, *rezultojnë 39,966,900 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.*

3.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e Taksave, ka rritje të numrit të familjeve të faturuara për taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Shkodër.*

Zbatuar

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK Sh.A, Shkodër (në rolin e

agjentit tatimor), vlerësimin e detyrimit që ka UK Sh.A Shkodër ndaj Bashkisë Shkodër si dhe aplikimin e penaliteteve ndaj UK Sha Shkodër.

3.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *UK Sha Shkodër, vazhdon të ketë llogaritë e bllokuara. Detyrimet e mbledhura nga abonentët familjarë, nuk kalojnë në llogarinë e Bashkisë Shkodër e gjithë vlera e arkëtuar për shkak se një pjesë e detyrimeve shkojnë për likuidimin e kreditorëve të UK Sha Shkodër.*

Pa zbatuar

3.3. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 566,030 mijë lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

3.3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, në fund të vitit 2022 vlera e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, është në vlerën 550,635 mijë lekë.*

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore gjithsej për këtë taksë, progresivisht deri në vitin 2021 është 26,299,610 lekë (nga të cilat 6,306,764 lekë krijuar brenda vitit 2021), vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër.

-Gjithashtu konstatohet se nga të dhënat e vendosura në dispozicion, gjithsej tokë bujqësore në Bashkinë Shkodër dhe Njësitë Administrative janë 16091 Ha, sipërfaqe e cila shërben si bazë për planifikimin e arkëtimeve nga kjo taksë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se taksa e tokës bujqësore është planifikuar në vlerën 21,736,000 lekë, ndërkohë sipas përlllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në kategorinë e bonitetit dhe sipërfaqe tokë bujqësore, rezulton se taksa e tokës bujqësore e cila duhet të përlllogaritet nga Bashkia Shkodër është 25,372,760 lekë pra 3,636,760 lekë planifikuar më pak nga DAV Bashkia Shkodër, vlerë e cila ndikon në reduktimin e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore. Sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën 1.2.2 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër për vitin miratuar me VKB nr.25 datë 20.12.2019, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.

4.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk ka grupe pune të ngritur nga titullari i bashkisë, për evidentimin e të gjitha familjeve me tokë bujqësore.*

Pa zbatuar

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet që kanë tokë bujqësore, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 26,299,610 lekë.

4.3 Nga verifikimi rezultoi se: Debitorët për familjet që kanë tokë bujqësore, janë njoftuar vetëm nëpërmjet faturës së UK Shkodër, dhe nuk janë nxjerr njoftime për secilin prej tyre.

Zbatuar pjesërisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive është 231,342,984 lekë, nga të cilat krijuar në vitin 2021, për 464 posedues të lejes së legalizimit është 29,766,061 lekë, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër. Për arkëtimin e vlerës debitore krijuar në vitin 2021 nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve informale, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, por nga DAV Bashkia Shkodër janë dërguar vetëm urdhrat për bllokimin e llogarive bankare. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 91-93 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të marrë të gjitha masat e nevojshme për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 231,342,984 lekë, për legalizimin e objekteve informale.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga informacioni i administruar nga Drejtoria e të Ardhurave, rezulton se vlera e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale, në fund të vitit 2022 është 204,027,555 lekë.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV dhe Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 256,014,573 lekë, nga të cilat:

-Gjobat e IMTV të paarkëtuara janë gjithsej 254,345,500 lekë (36 gjoba në vlerën 173,468,000 lekë i përkasin vitit 2021);

-Gjobat e Policisë Bashkiake të paarkëtuara janë gjithsej 1,669,073 lekë, nga të cilat në vitin 2021 janë pa u arkëtuar 1405 gjoba në vlerën 1,650,022 lekë;

Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga IMTV Shkodër, rezulton se për gjobat e mësipërme është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë (GJSHP) Shkodër për lëshimin e urdhrat për ekzekutimin e tyre nëpërmjet përmbarimit. Në vijim nga IMTV Shkodër i janë përcjellë vendimet e GJSHP Shkodër zyrtare të përmbarimit për ekzekutimin dhe arkëtimin e gjobave të vendosura, por në vazhdim nuk administrohet informacion se cilat janë masat e marra nga zyrat e përmbarimit, si sekuestrimit e pasurive të luajtshme/palujtshme për likuidimin e gjobës, të cilat në gjykimin e grupit të auditimit vonojnë procesin e arkëtimin të gjobave dhe reduktojnë investimet nga buxheti i Bashkisë Shkodër. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar; Pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Kreun IV.3.8 në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me drejtuesit e sektorëve të mësipërm, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 256,014,573 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

6.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në të gjitha rastet, rezulton se janë bërë kërkesat drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë të pa paguara vullnetarisht. Në vijim, në të gjitha rastet, janë përcjellë pranë zyrës përmbaremore Shkodër për vjeljen forcërisht të titujve ekzekutiv.

Zbatuar

6.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Kryeinspektori i IMTV Shkodër, të marrë masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbareuesit gjyqësor, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/palujtshme) për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vones) të palëve të treta ndaj Bashkisë Shkodër. Për çdo rast, kur nga përmbareuesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, Bashkia Shkodër t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penalitetet ndaj përmbareuesve.

6.3 Nga verifikimi rezultoi se: Nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, janë dërguar shkresa Zyrës Përmbaremore Shkodër me nr. 9662 prot., datë 14.06.2022 e cila kërkon rivendosjen në ekzekutim të të gjithë titujve që nuk janë shlyer deri tani dhe nuk janë pezulluar. Gjithashtu, me shkresën nr. 9661 prot., datë 14.06.2021 IMT ka bërë kërkesë ZPSH për njohjen me dosjet e vëna në ekzekutim me palë kreditore IMT, për tu informuar me gjendjen aktuale të titujve ekzekutiv. Me shkresën nr. 9843, datë 16.06.2022, IMT ka kërkuar ZPSH me listë debitorësh bashkëlidhur me informacionin e shkresave përcjellëse pranë kësaj zyre vendimet e titujve ekzekutiv, dhe gjendje aktuale e tyre. Lidhur me këto kërkesa, IMT Bashkia Shkodër, nuk ka marrë asnjë përgjigje. Është rikërkuar informacion me shkresën nr. 15184 prot., datë 11.10.2022 për të gjitha vendimet e pezullimit të titujve ekzekutiv të bëra të njohura pranë IMT-së, ripërsëritur me shkresën nr. 640 prot., datë 17.01.2023. Mungojnë përgjigjet nga Zyra e Përmbaremit Shkodër.

Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezulton se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Shkodër dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 45 stacione shitje.

-Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 28 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Për këto stacione konstatohet se përgjatë vitit 2021 nuk administrohet dokumentacion për njoftimin e subjekteve për detyrimin e pajisjes me licencë për ushtrimin e aktivitetit, njoftimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa licencë.

-Gjithashtu nga këto stacione shitje të karburantit u konstatua se për 20 prej tyre nuk është kryer pagesa e tarifës së licencimit dhe për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Shkodër në vlerën 13,871,692 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 “...nuk i paguan ato në buxhet” të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikën 15.1 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike të marrë masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve,

me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t'i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët ndërmjet Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundor.

7.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr. 9704-9730, 9733-9735, datë 14.06.2022 është bërë njoftimi ndaj subjekteve për pajisjen me licencë për ushtrimin e aktivitetit me pakicë të karburanteve për 30 subjekte debitorë. U është bërë kërkesë Policisë Bashkiake për mbështetje me shkresa në mënyrë periodike, dhe Drejtorisë së të Ardhurave informacion për gjendjen e debitorëve. Me shkresën nr. 15408 prot., datë 14.10.2022 i është bërë kërkesë për bashkëpunim Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial për ngritje grupi pune të përbashkët për marrje masash për bllokimin e aktivitetit tregtar të subjekteve të pa licencuara, për të cilën nuk ka përgjigje nga ky institucion. Nuk janë marrë masa për bllokimin e aktivitetit për këto subjekte.

Në proces zbatimi

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Shkodër të zbatojë masat shtrënguese, për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve të cilat kanë pasur licencë të ushtrimit të aktivitetit, por nuk kanë paguar tarifën përkatëse, në vlerën 13,871,692 lekë në total.

7.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas informacionit të paraqitur nga Drejtoria e të Ardhurave për pagesat e bëra për licencat e karburanteve, rakorduar me degën e thesarit Shkodër nëpërmjet sistemit SSITV të aplikuar në këtë drejtori, ka rezultuar situata si më poshtë:

-Nga lista e debitorëve në shumën 13,671,692 lekë, rezulton se janë likuiduar detyrimet në vlerën 7,454,397 lekë nga të cilat është likuiduar plotësisht vlera nga 6 subjekte në vlerën 4,699,554 lekë, janë likuiduar pjesërisht 6 gjoba në vlerën 2,754,840 lekë.

-Janë pa likuiduar në total detyrime në vlerën 6,417,295 lekë, nga të cilat 6 debitorë të cilat kanë likuiduar pjesërisht detyrimet në vlerën 2,663,305 lekë, dhe 8 debitorë të cilat nuk ka kryer asnjë likuidim në vlerën 3,553,990 lekë sipas pasqyrës së më poshtë:

Nr.	Subjekti	Adresa ku ushtron aktivitet sipas QKB	Detyrimi	Likuiduar	Diferenca
1	K.	Rruga nacionale Shkoder-Hani Hotit, Dobraq	948,331	948,331	-
2	A.	Rruga "Mbreti Gent"	943,331	-	943,331
3	K.	Shtoj i Ri	959,997	959,997	-
4	D. Gj.	Gomsiqe e Re	463,333	-	463,333
5	G. C.	Rruga "Dasho Shkreli"	416,665	416,665	-
6	G. C.	Rruga "Inxh. Gjovalin Gjadri"	1,759,997	1,759,997	-
7	A. P. Sh.p.k	Rruga nacionale Muriqan-Shkoder	959,997	-	959,997
8	I. Sh.p.k	Shtoj i Ri, Qendër	959,997	413,333	544,664
9	L.	Mbisukë	759,997	159,977	600,020
10	B. M. Sh.p.k	Postribë	959,997	-	959,997
11	J. L.	Fshat i Ri, Rruga nacionale Mes-Shkodër	959,997	93,126	866,871
12	A. Sh.p.k	Rruga Tirana	716,665	716,665	-
13	A. Sh.p.k	Bërdice e Sipërme,	233,332	133,412	99,920
14	G. O.	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Hani Hotit	849,998	687,998	162,000
15	G. O.	Rruga "Pazarit"	133,232	133,232	-
16	R. 2. P.	Rruga "Tiranës"	413,332	220,000	186,500
17	J. A.	Rruga "Agron", perballe Kishes se Zojes.;	216,665	-	216,665
18	J. A.	Dobraq, Rruga nacionale Shkodër- Koplik,	216,665	-	216,665
44	K.	Shtoj i Ri, Rruga nacionale Shkodër-Koplik	516,832	330,332	186,500
45	D. P.	Rruga "Fetih Dizdari"	483,332	483,332	-
	TOTAL			7,456,397	6,417,295

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Shkodër, u konstatua se në vitin 2021 kanë kryer punime ndërtimi me fondet e Bashkisë Shkodër, 3 operatorë ekonomik të shpallur fitues, të cilët nuk kanë paguar tarifën e shërbimit,

duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën 58,666 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 29-72, të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 58,666 lekë.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Është likuiduar detyrimi në vlerën 47,000 lekë nga subjekti C. shpk me faturën e datës 16.12.2022. për 2 subjektet tjera S. shpk me detyrim në vlerën 5,833 lekë dhe 2. shpk me detyrim në vlerën 5,833 lekë, nuk janë nxjerrë njoftim detyrimet.

Zbatuar pjesërisht

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1. Z. Gj. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penaliteteve ndaj agjenteve tatimor DRT Shkodër dhe UK Sh.A Shkodër, keqmenaxhimin mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimin të taksës së tokës bujqësore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29-72) të Raportit të Auditimit)

2. Zj. B. M. me detyrë Drejtor e Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur dispozicion minimalisht 20% të vlerës së projektit të investimit, pranimin e faturave në vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar për financim në vitin e parë të projektit të investimit, në raportimin jo të saktë të vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura, si dhe në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29-72) dhe pikën (2.3) faqe (72-87) të Raportit të Auditimit)

3. Zj. A. P. me detyrë Drejtor e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (18-26) të Raportit të Auditimit)

4. Z. P. Z. me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Auditit të Brendshëm, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve përgjatë vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe (26-29) të Raportit të Auditimit)

5. Zj. M. D. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (72-87) të Raportit të Auditimit)

Nga verifikimi rezultoi se: Sipas plan veprimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Shkodër me nr. 5450/18 prot., datë 08.08.2022, përcaktohet se masat disiplinore do të merren bazuar në rezultatet e vlerësimit rast pas rasti. Nuk ka masa tjera të marra për këtë rekomandim.

Zbatuar pjesërisht

Përsa është trajtuar në Akt Verifikimin Nr. 4 datë 26.07.2023 dhe në Projekt Raportin e Auditimit, nga Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore zj. A. P., është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 627/11 prot., datë 10.08.2023 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit: Bazuar në Akt Verifikimin e mësipërm dhe Projekt Raportin e Auditimit, referuar gërmës D “Masa Disiplinore”, ndaj zj. A. P. është kërkuar marrje mase disiplinore për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Sa më sipër, sqarohet se nuk jam përgjegjëse për implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucion, pasi unë nuk jam në rolin e Titullarit të Njesisë Publike – nëpunës Autorizues (NA) as në rolin e Njësimit Zbatues (NZ) të Njesisë Publike.

NZ i Njesisë Publike është përgjegjës dhe i raporton titullarit të njesisë publike për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Sipas rekomandimeve të KLSH, është miratuar nga Kryetari i Bashkisë plani i veprimit nr. 5450/18 prot., datë 08.08.2022 dhe pas vlerësimit nuk është marrë masë disiplinore.

Prandaj, referuar ligjit sa më sipër, kërkoj që të bëni ndryshimin për mbajtjen e përgjegjësisë dhe riformulimin e përgjegjësisë për zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në institucionet publike.

-Njëkohësisht, me e-mail të datës 31 Korrik 2023 nga adresa b.m.@bashkiashkoder.gov.al është paraqitur observacion Drejtor i Drejtorisë së Financës zj. B. M., e cila kërkon të hiqet rekomandimi nr. 8.2, pasi nuk ka qenë në shkresën nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, dhe lidhur me masën disiplinore, sqaron se janë zbatuar rekomandimet 1.2, 2.1.2, 2.3, 4.2, 9.2, 10.1.2, 11.2, dhe referuar performancës, Kryetari i Bashkisë ka vlerësuar përgjegjësitë dhe nuk ka dhënë masë disiplinore. Edhe për zj. M. D., me detyrë përgjegjëse sektori të kontabilitetit, , sqarohet se ka zbatuar rekomandimet 9.2, 10.1.2 dhe 11.2, dhe Kryetari i Bashkisë Shkodër nuk ka dhënë masë disiplinore.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1.Lidhur me pretendimet e paraqitura, audituesit sqarojnë si më poshtë:

Observacionet e paraqitura nuk pranohen nga ana jonë, pasi referuar shkresës nr. 373/8 prot., datë 18.07.2022, rekomandimi për masat disiplinore i është drejtuar Kryetarit të Bashkisë Shkodër për vlerësimin e përgjegjësive për disa prej punonjësve, dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse. Në zbatim të këtij rekomandimi, Titullari nëpërmjet hartimit të plan veprimit, ka përcaktuar se masat disiplinore do të merren sipas vlerësimit rast pas rasti. Nga shqyrtimit për zbatimin e këtij rekomandimi, audituesit kanë konkluduar se kryetari i Bashkisë Shkodër, me përjashtim të përcaktimit në Plan Veprim për vijimin e procedurës, nuk ka marrë asnjë veprim tjetër për të përcaktuar statusin përfundimtar për marrjen e masave disiplinore për punonjësit, përfshirë edhe 3 observuesit e mësipërm. Referuar rekomandimit të KLSH, është lënë pikërisht në përgjegjësi të Titullarit vijimi i procedurave për zbatimin e këtij rekomandimi, dhe në zbatim të tij, duhet një vendimmarrje prej tij ose personave/komisioneve të ngarkuar për të përcaktuar vlerësimin e masave përkatëse.

Zbatimi i rekomandimeve në Bashkinë Shkodër, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	17	17	12	1	2	2
Masa për 3E	14	14	3	2	5	4
Masa Disiplinore/Administrative	5	5	-	5	-	-

IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajojmë

përshpejtimin e realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, ndërsa për rekomandimet e pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Rekomandimi 2.2: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta, duke kryer sistemimet e nevojshme në llogarinë 4864.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 3.1: Kryetari i Bashkisë Shkodër dhe Drejtoria e Financës, të marrë masa që kontratat me palët e treta të lidhen në një fazë më të hershme gjatë vitit buxhetor, me qëllim përshpejtimin e realizimit të investimeve të planifikuara sipas programeve ekonomike që menaxhon Bashkia Shkodër, brenda vitit buxhetor.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi 13.3: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masa për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1. Rekomandimi 1.1: Kryetari i Bashkisë Shkodër të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 2.2: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të ngrëjë një grup pune me specialit të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi 3.2: Kryetari i Bashkisë Shkodër të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, si rrjedhojë e bllokimit të llogarive bankare të UK ShA., Shkodër (në rolin e agjentit tatimor), vlerësimin e detyrimit që ka UK ShA Shkodër ndaj Bashkisë Shkodër si dhe aplikimin e penaliteteve ndaj UK Sha Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi 4.1: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP, të marrë masa për evidentimin e

të gjithë familjeve me tokë bujqësore sipas të dhënave të Drejtorisë së Bujqësisë, duke evidentuar familjet me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore dhe reduktimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Shkodër.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Rekomandimi 4.2: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Shkodër të nxjerrë njoftim detyrimin për familjet që kanë tokë bujqësore, si dhe të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës 26,299,610 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Rekomandimi 8.1: Drejtoria e të Ardhurave të nxjerrë njoftim detyrimin për tarifën e shërbimit dhe ndjekjen e të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej 11,666 lekë për 2 subjekte.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Shkodër vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1. Z. Gj. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mosaplikimin e penalteteve ndaj agjenteve tatimor DRT Shkodër dhe UK Sh.A Shkodër, keqmenaxhimin mbi procedurat e ndjekura të planifikimit, arkëtimin të taksës së tokës bujqësore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29-72) të Raportit të Auditimit)*

2. Zj. B. M. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Financës, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ndërmarrjen e angazhimeve buxhetore pa pasur dispozicion minimalisht 20% të vlerës së projektit të investimit, pranimin e faturave në vlerë më të lartë se sa vlera e buxhetuar për financim në vitin e parë të projektit të investimit, në raportimin jo të saktë të vlerës së stokut të detyrimeve të prapambetura, si dhe në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29-72) dhe pikën (2.3) faqe (72-87) të Raportit të Auditimit)*

3. Zj. A. P. me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (18-26) të Raportit të Auditimit)*

4. Z. P. Z. me detyrë Përgjegjës i Njesisë së Auditit të Brendshëm, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve përgjatë vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe (26-29) të Raportit të Auditimit)*

5. Zj. M. D. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontabilitetit, për mangësitë e konstatuara në kontabilizimin e saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (72-87) të Raportit të Auditimit)*

Menjëherë

D.2. Nga Kryetari i Bashkisë Shkodër **kërkojmë** analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve sipas Planit të Miratuar.

Për sa më lart, kërkojmë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Fushë Arrëz: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA
NË AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN
01.07.2022 DERI 31.01.2023, BASHKIA FUSHË ARRËZ”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2-3
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-20
	Drejtimit e auditimit.....	4
	A.Masa B.Organizative.....	4-14
	C.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....	14-16
	C2.Të ardhura të munguara.....	16-18
	D.Masa Disiplinore.....	19-20
	G.Për njoftimin e DAP dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.....	20
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	20-23

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 627/5 prot., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Fushë Arrëz, më datë 25.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. Sh. H., z. K. H. dhe Z. L. B., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar. Me shkresën nr. 627/9 prot., datë 04.08.2023 është dërguar Projekt Raporti i Auditimit subjektit Bashkia Fushë Arrëz.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 885/11 prot., datë 20.01.2023, ndërsa nga Bashkia Fushë Arrëz nuk është kthyer përgjigje **brenda afatit 20 ditor**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 885/1 prot., datë 20.01.2023 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.07.2023. Nga ana e Bashkisë Fushë Arrëz nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 23 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative, dhe 8 masa nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 4 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 2 masa, dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Masa për të ardhurat e munguara, janë rekomanduar 4 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 4 masa, është zbatuar plotësisht 1 masë dhe 3 masa janë në proces zbatimi.

Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz dhënia e masës disiplinore ndaj 12 personave, nga të cilat nuk është dhënë asnjë masë.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 25.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Fushë Arrëz, sipas programit të auditimit nr. 885/1 prot., datë 03.10.2022, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Sh. H., *përgjegjës i grupit*;
2. K. H., anëtar,
3. L. B., anëtar

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimin i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 885/11 prot., datë 20.01.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Fushë Arrëz në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 885/11 prot, datë 20.01.2023, rezulton se nga **43** masa të rekomanduara (*organizative, 3-E, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **21** masa ose 49% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **22** masa ose 51% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative që përbëjnë 85 % të tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 49%. Nga masat e marra, Bashkia Fushë Arrëz ka zbatuar vetëm rekomandime për masat organizative.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 885/1 prot., datë 20.01.2022, ndërsa nga Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor.

Pa zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 885/1 prot., datë 20.01.2023, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.07.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

Pa zbatuar

3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kurbin ka hartuar planin e veprimi të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 693/8 prot, datë 12.12.2022, por nuk ka raportuar në këshillin e njesisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njesisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njesisë për progresin në zbatimin e tij.”

Pa zbatuar

Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë zbatuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Fushë Arrëz 23 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, dhe 8 masa organizative nuk janë zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.
- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.
- Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK, i cili të përfshijë aktivitete të planifikuara, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse dhe lidhja me komponentin e sistemit.
- Në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.
- Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.
- Nuk është krijuar regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 16-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

1.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga personat përgjegjës, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

Pa zbatuar

1.2.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

1.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk është marrë asnjë masë nga përgjegjësit e sektorëve të mësipërm për kryerjen e ndryshimeve në rregulloren e brendshme për përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.*

Pa zbatuar

1.3.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

1.3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk është marrë asnjë masë për hartimin e programit të trajnimit profesional për stafin e bashkisë.*

Pa zbatuar

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Fushë Arrëz përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

- Nuk është hartuar plani strategjik i auditimit të brendshëm për periudhën 2021-2023.
- Audituesit pranë këtij sektori nuk janë të pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm.
- Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla objektive për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.
- Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.
- Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se Sektori Auditit të Brendshëm, nuk ka planifikuar kryerjen e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete me risk të lartë që kryen Bashkia Fushë Arrëz, si Sektori i Financës, Sektori Juridik, Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit

të Territorit, prokurimet e realizuara nga Bashkia Fushë Arrëz. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 18-23, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, Përgjegjësi i sektorit të burimeve njerëzore dhe Përgjegjësi i sektorit të auditit të brendshëm, të marrë masa për:

-Certifikimin e audituesve të brendshëm të punësuar pranë NJAB Fushë Arrëz;

-Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

2.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *-Është bërë certifikimi i audituesve të brendshëm, proces i mbyllur me datë 19 Korrik 2023. Njësia ka 2 auditues, të cilët janë certifikuar. Nuk ka Komitet Auditit të Brendshëm.*

Zbatuar

2.2.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësive vendore në arritjen e objektivave institucional.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Në planin vjetor nuk janë planifikuar fushat me risk të cituara më sipër për auditim.*

Pa zbatuar

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Fushë Arrëz për arkëtim ndaj të tretëve, është pasqyruar më pak për vlerën 14,083,752 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën:

-13,686,443 lekë detyrimi i subjektit N. S. E., për kontratën e qirasë.

-397,309 lekë kamatë-vonesa për kategorinë biznes.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitet e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Zyra e financës pranë Bashkisë Fushë Arrëz ka kontabilizuar shumën e sipërpërmendur, të cilën e ka të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022 në Llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”, në formatin F1 Pozicioni Financiar. (Formati F1 Pozicioni Financiar si dhe lista e debitorëve përkatës).*

Zbatuar

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 919,930 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 1 fadrom dhe 1 makinë teknologjike, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, paisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Paisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Paisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe paisje te tjera teknike. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e Financës, ka kryer rregullimet kontabël për llogaritë e mësipërme, duke sistemuar përkatësisht llogarinë 214 dhe 215. Këto të dhëna janë pasqyruar në formatin F1 Pozicioni financiar të Pasqyrave financiare të vitit 2022. *(Formati F1 Pozicioni Financiar si dhe analiza e llogarisë 214 & 215).*

Zbatuar

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 122,100,000 lekë, vlera e aksioneve në shoqërinë aksionare “Ujësjetës Kanalizime Fushë Arrëz Sh.A” me NIPT K19629304M. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e financës ka regjistruar pjesëmarrjen në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” në vlerën 122,100,000 lekë por nuk ka kredituar llogaritë e klasës 5. Ky veprim kontabël nuk është në përputhje me udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022.

Në proces zbatimi

6.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 6,016,237 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në

dorëzim.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas Pasqyrat Financiare të vitit 2022 llogari 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” është në vlerën 9,250,997 lekë. Për vitin 2022 janë çliruar garanci në vlerën 2,432,983 lekë.

Zbatuar

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime”, u konstatua se nuk është kryer amortizimi në vlerën 3,594,080 lekë sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veç sa më sipër konstatohet se në këtë llogari janë të kontabilizuara projekte për investime për punë publike të përfunduara dhe sipas rastit të marra në dorëzim nëpërmjet akt-kolauditimit përfundimtar. Këto projekte duhet të ishin kontabilizuar rast pas rasti në objektin përkatës (llogaritë e klasës 2, ndërtesa, konstruksione, rrugë etj) si pjesë e kostos totale të tij. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2, Klasa 2 “Trajtimi kontabël për AAGJ jomateriale, shkronja “d” në Udhëzimin nr.5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritë me metodën lineare me normë amortizimi 15%”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2022, Zyra e Financës Bashkia Fushë Arrëz ka zbatuar rekomandimin e mësipërm ka amortizuar llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.

Zbatuar

8.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 231 “Investime në proces”, e cila përfaqëson shpenzime për investime në proces, u konstatua se kjo llogari, është mbivlerësuar për vlerën 197,608,607 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun 2, klasa 2 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet sistemimi në kontabilitet i llogarisë nr.231 “Investime në proces” dhe llogarive nr. 213/212 sipas rastit, për objekte të cilat janë marrë në dorëzim, duke kryer veprimin kontabël në debi të llogarisë së aktivitet afatgjatë dhe në kredi të llogarisë së investimeve në proces.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e financës në Bashkisë Fushë Arrëz, ka bërë sistemimet kontabël për llogarinë 231 duke bërë pakësimet përkatëse dhe sistemuar saktë në llogaritë përkatëse kontabël sipas natyrës së investimit. Këto të dhëna janë pasqyruar në Formati F1 Pozicioni Financiar të Pasqyrave financiare të vitit 2022 përkatësisht në llogarinë 231 “Investime në proces”. (Formati F1 Pozicioni Financiar llogaria 231 “Investime në proces” dhe analiza e kësaj llogarie sipas tabelës përkatëse).

Zbatuar

9.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2010-2016, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

-vlerat e trullit nën objekt dhe të trullit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj, sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”.

-vlera e truallit të palestrës së shkollës 70-Vjetori i Pavarësisë, sipas lejes së ndërtimit, sheshi i ndërtimit me sipërfaqe $458 \text{ m}^2 * 1,620^1 \text{ lekë/m}^2 = 741,960 \text{ lekë}$.

-Vlera e 394 pronave me sipërfaqe $65,287,847 \text{ m}^2$ pyje e kullota, të cilat janë regjistruar në ish-ZVRPP Pukë, të evidentuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë. Këto prona janë regjistruar në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fushë Arrëz dhe ish Komuna Qaf Mali.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i llogarive të mësipërme.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 52-65, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.

9.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka ngritur grup pune për verifikimin fizik dhe vlerësimin financiar të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.*

Pa zbatuar

9.2.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

9.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Zyra e financës pranë Bashkisë Fushë Arrëz ju është drejtuar me shkresën nr. 716 datë 10.3.2023, Zyrës së Menaxhimit të territorit dhe Drejtorisë së Administrimit Pyjorë për vënien në dispozicion të listës së trojeve dhe sipërfaqeve pyjore me objekte dhe vlera financiare përkatëse.*

Në proces zbatimi

10.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021 për punë publike mallra dhe shërbime, u konstatua se në 16 raste, në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien

në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 46, pikat 1 dhe 3 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 5 në nenin 26, pikat 1, 3, 5 në nenin 27, pikën 2 në nenin 61 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, Shkronjën “b” të pikës 3 në nenin 15, pikën 4 në nenin 39, pikën 1 të nenit 40, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e përcaktimit të kritereve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

10.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nuk ka marrë asnjë masë dhe nuk ka kryer asnjë analizë për shkeljet e kryera nga NjP.*

Pa zbatuar

10.2.Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

-Njësia e Prokurimit në Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa që në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, në procedurat e prokurimit për blerjen e mallrave me natyrë lëndë djegëse për ngrohje dhe transport, të përcaktohet distanca e favorshme e magazinimit të lëndës djegëse, si dhe e stacionit të shitjes së karburantit, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit në kohë dhe me cilësi.

10.3 Nga verifikimi rezultoi se: *-Përgjatë vitit 2022, Bashkia Fushë Arrëz ka realizuar 13 procedura prokurimi me vlera të larta. U testuan 2 dosje procedurash. Njësia e Prokurimit, në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, ka hartuar në çdo rast kriteret, të cilat janë pasqyruar me procesverbalin përkatës të argumentimit, përmbajtja e të cilit do vlerësohet përgjatë auditimit të radhës në Bashkinë Fushë – Arrëz.*

-Lidhur me procedurën blerje e mallrave lëndë djegëse për ngrohje dhe transport si dhe procedura e karburantit, rezulton se procedurat e ndjekura përgjatë vitit 2022 janë të njëjta me ato të mëparshme, në të cilën nuk janë përcaktuar distancat e arsyeshme për AK për magazinat për lëndët djegëse apo stacioni i shitjes me karburant, kjo pasi këto procedura janë kryer përpara njohjes me rekomandimin e KLSH.

Zbatuar

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se në 16 raste, OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbljes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” në pikën 1 në nenin 24, pika 1 në nenin 46 dhe pika 3 në nenin 53 në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Neni 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”; Pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim mirëpërdorimin e fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetit të institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

-Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nuk ka marrë asnjë masë apo kryer ndonjë analizë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

-Lidhur me vlerësimin e procedurave të kryera përgjatë vitit 2022, ajo do kryhet përgjatë auditimit të radhës në këtë bashki.

Në proces zbatimi

12.Gjetje nga auditimi: Në auditimin për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, në 1 rast për lejen me objekt “Magazinë bujqësore në funksion të bujqësisë, me tarracë të gjelbëruar, 1 kat nëntokë”, personat përgjegjës që administrojnë procesin në sistemin “e-leje”, e kanë miratuar atë në mospërmbushje të dokumentacionit të rregullt sektorial për ndërtimin, pasi janë evidentuar mangësi që lidhen me bashkëveprimin e personave përgjegjës me institucionet përkatëse, të cilave gjatë procesit të miratimit të lejeve të ndërtimit, u dërgohet dosja teknike, për dhënie mendimi. Gjithashtu mungon VNM paraprahe nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, mendimi i institucioneve sipas fushave përkatëse, veprime në kundërshtim me pikën 6 të nenit 10/1, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 122-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1.Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marra masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërtimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënia mendimi, përpara miratimit të lejes.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Për vitin 2022, është miratuar 1 leje ndërtimi. Lidhur me procedurën e miratimit të saj, do verifikohen gjatë auditimit të radhës.*

Zbatuar

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e paligjshme, rezulton se në Bashkinë Fushë Arrëz nuk është krijuar Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit. Për periudhën objekt auditimi, nuk ka asnjë evidencë nga punonjës të bashkisë për veprimtari që mbulojnë fushën e inspektimit dhe kontrollit të territorit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 123-124, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

13.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

13.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Fushë Arrëz, nuk është marrë asnjë masë për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit.*

Pa zbatuar

14.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Fushë Arrëz në marrëdhënien kontraktore me subjektin “O.” Sh.P.K, iniciuar nga ankesa e vetë subjektit, administruar në KLSH me shkresën nr.914 prot., datë 06.10.2022, u konstatua se:

-Vlera e detyrimit 11,616 mijë lekë është njohur dhe kontabilizuar në pasqyrat financiare të institucionit.

-Nga Bashkia Fushë Arrëz, rekomandimi për arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën 11,616 mijë lekë nuk është vendosur në zbatim.

-Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz nuk ka ngritur një grup pune, i cili të evidentojë sipërfaqen e shfrytëzuar faktikisht nga subjekti në raport me sipërfaqen totale të lejes minerare nr.1312, datë 02.02.2009;

-Zbritet sipërfaqja e cila është kontraktuar;

-Duke nxjerrë në këtë mënyrë sipërfaqen e shfrytëzuar nga subjekti dhe që nuk është tarifuar nga Bashkia Fushë-Arrëz;

-Nuk ka hapur proces gjyqësor ndaj subjektit me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 1, 2 dhe 3 në ligjin nr.10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe pika 4 në nenin 13 të ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 129-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, të marrë masat e nevojshme duke ngritur një grup pune me specialist të fushës, të cilët të kryejnë verifikimin në terren dhe vlerësimin e sipërfaqes së shfrytëzuar sipas kontratave të datës 23.09.2009; datë 26.09.2011; Aneks kontratë qiraje datë 15.10.2012, përlllogaritjen e detyrimit, depozitimin e dokumentacionit të mësipërm pranë Gjykatës Administrative të Apelit, me qëllim plotësimin e dosjes gjyqësore, me prova konkrete materiale.

14.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Çështja vijon në proces gjyqësor. Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, nuk ka ngritur grup tjetër pune për kryerjen e verifikimeve në terren.*

Në proces zbatimi

15.Gjetje nga auditimi: Realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Fushë Arrëz ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar. Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën 325,874 mijë lekë, ndërsa realizimi 270,352 mijë lekë, ose në masën 83%. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 26,467 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 14,558 mijë lekë, ose në masën 55 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46 në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Përgjegjësi i Sektorit të Financës, si dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

15.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas buxhetit të vitit 2022 është parashikuar shuma 364,176 mijë lek dhe është realizuar në vlerën 300,318 mijë lekë. Ndikim në mosrealizim kanë patur investimet në proces që janë parashikuar në vlerën 35,046 mije lekë dhe realizimi i tyre është*

në vlerën 18,423 mijë lek ose 53%, dhe llogaria 602 “blerje mallra materiale dhe shërbime) parashikuar në vlerën 52,449 mijë lek dhe realizuar në vlerën 38,342 mijë lekë ose 73.1 %.

Në proces zbatimi

16.Gjetje nga auditimi: Bashkia Fushë Arrëz në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 10,873 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 është planifikuar për likuidim gjatë këtij viti vlera 8,017 mijë lekë, nga e cila është likuiduar vlera 2,633 mijë lekë, ose 32.8% e vlerës së planifikuar.

Pra, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 2,095 mijë lekë, ose në masën prej 19.2%. Rezulton se gjatë vitit 2021 Bashkia Fushë Arrëz ka parashikuar investime të reja nga të ardhurat e veta në vlerën 12,781,000 lekë dhe ka realizuar 10,239,840 lekë, si dhe nga transferta e pakushtëzuar 13,686,000 lekë dhe ka realizuar 4,319,000 lekë. Për sa më sipër rezulton se marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162; Nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës të marrë masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

16.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Fushë Arrëz nuk ka asnjë detyrim të prapambetura të krijuara për punë, mallra apo shërbime. Të vetmet detyrime që Bashkia disponon, kanë lidhje me vendime gjyqate të formës së prerë për largime nga pune e tjerë të cilat janë në vlerën 4,808,461 lekë.*

Në proces zbatimi

17.Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 18 rekomandime të dhëna, 1 prej tyre është zbatuar ose 6%, 2 zbatuar pjesërisht ose 11%, 1 në proces zbatimi ose 6%, si dhe 13 pa zbatuar ose 72%. Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se:

-Janë dhënë 3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 8,271 mijë lekë, të cilat nuk janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 124-128, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë të gjithë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat ende rezultojnë të pazbatuara.

17.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Fushë Arrëz, nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme, ku njëkohësisht nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit për arkëtimin e dëmit në vlerën 8,271,878 lekë.*

Pa zbatuar

18.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Drejtorisë

Rajonale Tatimore Shkodër, Qendrës Kombëtare të Biznesit, rezulton se përgjatë periudhës 2020-2021, në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, kanë ushtruar aktivitet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të minerareve, 10 subjekte në sipërfaqe pyjore/kullosore prej 11.475 km², për të cilat NSHP Bashkia Fushë Arrëz nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj)². Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

18.1.Rekomandimi: Drejtoria e shërbimit pyjor t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

-Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

18.2 Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr. 1406 prot., datë 18.05.2023, është dërguar kërkesa për informacion Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në të cilën kërkohet lista e subjekteve private që ushtrojnë aktivitet minerar apo HEC-e në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz, pasi kanë rezultuar me leje minerare të lëshuar nga MIE por nuk kanë lidhur kontratë me bashkinë për shfrytëzimin e fondit pyjor/kullosor. Në përgjigje të kësaj shkrese, është kthyer përgjigje nga (MIE) me shkresën nr. 4473/1 prot., datë 06.07.2023, sipas së cilës rekomandohet që t’i drejtoheni Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëse zonat e lejuara të shfrytëzimit të listuara në kërkesën tuaj, janë hequr nga fondi pyjor/kullosor.

-Me shkresën nr. 1407 prot., datë 18.05.2023, është dërguar AKBN e njëjta përmbajtje se shkresa e mësipërme. Në përgjigje të kësaj shkrese, AKBN me shkresën nr. 2542/1 prot., datë 23.05.2023 ka sjell listën me subjektet që ushtrojnë aktivitet minerar në Bashkinë Fushë Arrëz, liste e përbërë nga 4 subjekte me 10 leje minerare.

Zbatuar

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **200,000 lekë**, për 3 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa economicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga praktikat e mësipërme të likuidimit u përzgjedhën për auditim mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit financiar dhe ligjor 6 prej tyre, ku rezulton se ka mbetur pa u likuiduar vlera **3,813,562 lekë**, pasqyruar në aneksin nr. 4 të raportit të auditimit. Gjithashtu konstatohet se në 3 raste për likuidimin e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të

vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrëgjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Kemi 7 raste me vlerë totale të palikujduara 4,808,461 lekë. Për vitin 2022 janë bërë likuidime në vlerën 2,744,347 për 8 raste, likuidimi të cilat janë të pjesshme dhe të plota.*

Në proces zbatimi

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2019-31.12.2021, u konstatua se në 5 raste nga NJP nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e fondit limit, duke shkaktuar përdorim pa eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën 3,139,712 lekë.

-Veç sa më sipër, u konstatua se kërkesat për karburant nga sektorë të ndryshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, nuk argumentohen në mënyrë të plotë dhe të saktë. Gjithashtu për mjete të ndryshme nuk është përcaktuar norma e konsumit të karburantit, si p.sh., mjetet e sektorit të zjarrfikëses. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 23 në nenin 3 në Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 59 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme, që të prokurojë shërbimin e prerjes së lëndës djegëse lloji “Dru zjarri” për ngrohje, dhe jo blerjen e tij, me qëllim eliminimin e përdorimit të fondeve publike pa eficiencë dhe ekonomikitet.

-Gjithashtu në bashkëpunim me sektorin e financës, të marrë masa për ngritjen e komisionit, me qëllim përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për mjetet e sektorit të zjarrfikëses, si dhe argumentimin e plotë dhe të saktë të sasisë për karburant nga sektorët përkatës.

-Njësia e Prokurimit Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masat e nevojshme, që për çdo procedurë prokurimi, të argumentojë dhe dokumentojë përlllogaritjen e fondit limit.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *- Lidhur me prokurimin e shërbimit të prerjes së lëndës djegëse “Dru zjarri”, për vitin 2022 nuk është aplikuar, pasi rekomandimi i audituesve ka ardhur pas kryerjes së kësaj procedure. Për vitin 2023, ky shërbim është planifikuar në buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.*

-Mungojnë komisionet për përcaktimin e normativës së konsumit të karburantit.

-Njësia e Prokurimit, Bashkia Fushë Arrëz, ka dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit, saktësia e së cilës do vlerësohet gjatë auditimit të radhës në këtë bashki.

Në proces zbatimi

3.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i procedurës së ndjekur nga Bashkia Fushë Arrëz në marrëdhënien administrative me ish punonjës z. K. Ll., iniciuar nga ankesa e shtetasit K. Ll.,

administruar në KLSH me shkresën nr.2/228 prot., datë 03.06.2022, u konstatua se:

-Urdhri nr.39/52 datë 29.09.2015 i Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz për ndërprerje të marrëdhënieve të punës të z.K. Ll., është nxjerrë në kundërshtim me kuadrin rregullator të fushës dhe është shpallur i pavlefshëm.

-Si rrjedhojë e nxjerrjes së urdhrit në kundërshtim me kuadrin rregullator dhe të pavlefshëm, Bashkia Fushë Arrëz ka krijuar detyrim ndaj palëve të treta shtetasin K. Ll. dhe zyrës së përmbarimit, gjithsej 1,877,920 lekë, duke rënduar buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz.

-Ndaj shtetasit K. Ll. dhe zyrës përmbarimore janë kryer likuidime pjesore në vlerën 420,000 lekë, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona.

-Deri më datë 31.12.2021, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka marrë masat për zbatimin e Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për rikthimin në pozicionin e punës me kushte dhe kategori të njëjtë të shtetasit K. Ll., duke eliminuar në këtë mënyrë krijimin e detyrimit në vlerën 1,877,920 lekë dhe bllokimin e llogarisë bankare të Bashkisë Fushë Arrëz. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 4, 11, 41, 100 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 50 dhe nenin 66/1 në Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar; Pikën 1 në nenin 8 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kreun II në VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”; Udhëzimin nr.1, datë 03.06.2016 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”; Pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8, faqe 129-141, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimit ndaj shtetasit K. Ll., me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura të institucionet ndaj palëve të treta.

3.3 Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Financës nuk ka marrë masat e nevojshme për likuidimin e detyrimit ndaj shtetasit K. Ll.

Pa zbatuar

3.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasit K. Ll., si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

3.3 Nga verifikimi rezultoi se: Nuk është marrë asnjë masë dhe analizë për përcaktimin e shkaqeve.

Pa zbatuar

C.2.TË ARDHURA TË MUNGUARA

1.Gjetje nga auditimi: Rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën 18,441,055 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera 1,059,385 lekë është krijuar brenda vitit 2021. Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Fushë

Arrëz, në procesin e ndjekur për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore, është mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve debitore dhe nuk ka kryer asnjë procedurë tjetër, për të vërtetuar nëse këto subjekte operojnë ose jo. Nuk është kërkuar kallëzim penal bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar. Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenit 45 dhe Kreun XI, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1.Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fushë Arrëz, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 18,441,055 lekë, si më poshtë vijon:

- a- T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare.
- b- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme).
- c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, i ndryshuar.
- d- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Njësitë Administrative, të evidentojë listat emërore të debitorëve familjarë në mënyrë elektronike, si dhe të njoftojë nëpërmjet postës (dhe jo vetëm) familjet të cilat nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës/ tarifën e pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Fushë Arrëz ka bërë 102 njoftime për subjektet debitorë gjatë vitit 2022. Gjendja debitorë për vitin 2022 është 40,859 mijë lekë. Debitorë të shtuar në vlerë për vitin 2022 janë në vlerën 2,870 mijë lekë.

Zbatuar

2.Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se në Bashkinë Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimor 2021, ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar, të cilët nuk kanë paguar detyrimet në vlerë 3,000,000 lekë, vlerë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz, ndërsa 1 subjekt është pajisur me autorizim 1 vjeçar, i cili ka paguar detyrimet në vlerë 200,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1, shkronja “b”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1.Rekomandimi: Drejtoria e shërbimeve publike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tarifës prej 3,000,000 lekë ndaj 3 subjekteve, sipas listës së subjekteve në Kapitullin “Anekse-Aneksi nr.2” të raportit përfundimtar të auditimit.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i Tatim Taksave ka bërë vetëm njoftimet për subjektet e hidrokarbureve për tu licencuar dhe për pagesën e taksave. Sipas rekomandimit të mësipërm asnjë prej 3 subjekteve nuk është licencuar dhe nuk ka paguar taksën në vlerën totale 3,000,000 lekë.

Në proces zbatimi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Fushë Arrëz me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Sektori Juridik, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Fushë Arrëz, përllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz në vlerën 53,839 mijë lekë.

-Gjithashtu në 1 rast, është konstatuar se është lidhur kontratë qiraje në tejkalim të kompetencës ligjore që përcakton kuadri rregullator i fushës, respektivisht “Amendimi i kontratë së qirasë nr.2718 prot, datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A. 2." Sh.P.K përfaqësuar nga administratori z. A. Gj., duke rritur sipërfaqen sipas nenit 4 të kontratës është bërë në kundërshtim me procedurat ligjore. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Nenet 83, 154, 296, 663 dhe 678 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Neni 35 në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 11 në nenin 2 në Kreun I në Ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010; Pikat 5 dhe 6 në Kreun I, shkronja “c” në pikën 15, pika 4 në Kreun II, si dhe shkronja “c” në pikën 1 në Kreun III në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **53,839 mijë lekë**.

3.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Janë dërguar njoftimet për shlyerjen e detyrimeve sipas Raportit Përfundimtar të KLSH-së, konkretisht njoftimet me nr. 1399 prot., datë 18.05.2023 subjektit “A. 2.” shpk, me nr. 1400 prot., subjekti “E. P.” shpk, me nr. 1401 prot., subjektit “V. A.” sha, me nr. 1402 prot., subjektit “N. S. E.” shpk, me nr. 1403 prot., subjektit “H. A.” shpk, me nr. 1404 prot., subjektit “L. I.” sha, me nr. 1405 prot., subjektit “O.” shpk. Data e njoftimeve të mësipërme është 18.05.2023. Nuk ka asnjë përgjigje ndaj këtyre shkresave. Bashkia Fushë Arrëz, nuk ka marrë asnjë masë tjetër për ndjekjen në rrugë gjyqësore për të bërë të mundur arkëtimin.*

Në proces zbatimi

3.2.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori Juridik, në kushtet e konstatimit të mungesës së kompetencës lëndore për procesin e zhvillimit të procedurës dhe lidhjes së kontratës, të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për shpalljen absolutisht të pavlefshme të amendimit të kontratës së qirasë nr.2718 prot., datë 07.11.2017 me qiramarrësin shoqëria "A. 2." Sh.P.K.

3.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Në njoftimin nr. 1399 prot., datë 18.05.2023, në paragrafin e fundit të këtij njoftimi, përcaktohet se “Referuar rekomandimeve të KLSH-së, Bashkia Fushë Arrëz, shpall absolutisht të pavlefshëm amendimin e kontratës nr. 2718 datë 07.11.2017. Për këtë amendim kontrate, do të zbatohen në përpikmëri të gjitha rekomandimet e KLSH-së sipas bazës ligjore bashkëlidhur. Nuk ka urdhër apo vendim për amendimin e kontratës.*

Në proces zbatimi

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”**, për:

1. z. O. Ç, për mangësitë e konstatuara në 6 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

2. z. A. D., për mangësitë e konstatuara në 14 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

3. z. F. D., për mangësitë e konstatuara në 6 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

4. z. S. Ll., për mangësitë e konstatuara në 3 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

5. z. T. P., për mangësitë e konstatuara në 16 raste në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

6. zj. A. I., për mangësitë e konstatuara në 8 raste në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

7. z. E. M., për mangësitë e konstatuara në 7 raste në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*

8. z. S. Gj., për mangësitë e konstatuara në 2 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik, si dhe mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122 dhe pikën 2.1, faqe 16-18, të Raportit të Auditimit)*

Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

- **zj. D. K.**, Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësinë e konstatuar në 1 rast në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (122-123) të Raportit të Auditimit)*

- **z. V. P.**, Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksa, për periudhën 25.05.2021 e në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)*

- **z. B. M.**, Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave për periudhën 25.05.2021 e në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)*

- **z. K. V.**, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për periudhën 05.01.2021 dhe në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e tarifës vendore për

licencimin e subjekteve që tregtojnë karburante. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nuk është marrë asnjë masë nga Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa zbatuar

G.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Fushë Arrëz, Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Nuk janë marrë masat disiplinore dhe sa më sipër nuk është njoftuar DAP dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Pa zbatuar

Zbatimi i rekomandimeve në Fushë Arrëz, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

<i>Lloji i Rekomandimit</i>	<i>Rekomandime gjithsej në numër</i>	<i>Pranuar</i>	<i>Zbatuar plotësisht</i>	<i>Zbatuar pjesërisht</i>	<i>Në proces zbatimi</i>	<i>Pa zbatuar</i>
Masa organizative	23	23	9	-	6	8
Masa për 3E	4	4	-	-	2	2
Masa të ardhura të munguara	4	4	1	-	3	-
Masa Disiplinore	12	12	-	-		12

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Fushë Arrëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajojmë përshpejtimin e realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, ndërsa për rekomandimet e pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B.MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi 1.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 1.2: Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi 1.3: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi 2.2: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Rekomandimi 9.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Rekomandimi 10.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e përcaktimit të kriterëve të kualifikimit në kundërshtim me kuadrin rregullator, si dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.

Menjëherë

7. Rekomandimi 13.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtimet pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Rekomandimi 17.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë të gjithë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat ende rezultojnë të pazbatuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Rekomandimi 3.1: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe Sektori i Financës të marrë masat e nevojshme për likuidimin e plotë të detyrimit ndaj shtetasit K. Ll., me qëllim eliminimin e detyrimeve të prapambetura të institucionet ndaj palëve të treta.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 3.2: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasit K. Ll., si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme

pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”**, për:

- z. O. Ç., për mangësitë e konstatuara në 6 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. A. D., për mangësitë e konstatuara në 14 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. F. D., për mangësitë e konstatuara në 6 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. S. Ll., për mangësitë e konstatuara në 3 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. T. P., për mangësitë e konstatuara në 16 raste në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- zj. A. I., për mangësitë e konstatuara në 8 raste në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. E. M., për mangësitë e konstatuara në 7 raste në hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit në procedurat e prokurimit publik. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122, të Raportit të Auditimit)*
- z. S. Gj., për mangësitë e konstatuara në 2 raste në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit publik, si dhe mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 65-122 dhe pikën 2.1, faqe 16-18, të Raportit të Auditimit)*

Masa disiplinore “Vërejtje”, për:

- zj. D. K., Specialiste në Sektorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, për mangësinë e konstatuar në 1 rast në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (122-123) të Raportit të Auditimit)*
- z. V. P., Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksa, për periudhën 25.05.2021 e në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)*

- z. B. M., Inspektor në Sektorin e Tatim-Taksave për periudhën 25.05.2021 e në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksave dhe tarifave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)*
- z. K. V., Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për periudhën 05.01.2021 dhe në vijim, për mangësitë e konstatuara në administrimin e tarifës vendore për licencimin e subjekteve që tregtojnë karburante. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2.6) faqe (23-52) të Raportit të Auditimit)*

Menjëherë

D.2. Nga Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz **kërkojmë** analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve.

Për sa më lart, kërkojmë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

G.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Fushë Arrëz, Sektori i Administrimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Kurbin: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIUDHËN 01.07.2022
DERI 31.01.2023, BASHKIA KURBIN”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2-3
	/1. Hyrje.....	3
	/2. Objektivat e auditimit.....	3
	/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	/4. Metodologjia auditimit.....	3
	/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	3-16
	Drejtimet e Auditimit.....	3-4
	B.Masa Organizative.....	4-13
	C.Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet.....	13-15
	D.1Masa Disiplinore.....	15-16
IV	Konkluzione dhe rekomandime.....	16-17

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 627/8 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Kurbin, më datë 27.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. Sh. H. dhe z. K. H., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar. Me shkresën nr. 627/8 prot., datë 04.08.2023 është dërguar Projekt Raporti i Auditimit subjektit Bashkia Kurbin.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Kurbin rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 693/8 prot., datë 12.12.2022, ndërsa nga Bashkia Kurbin është kthyer përgjigje me shkresën nr. 6679/8 prot., datë 30.12.2023, **brenda afatit 20 ditë**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 693/8 prot., datë 12.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 12.06.2023. Nga ana e Bashkisë Kurbin është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 6679/10 prot., datë 30.06.2023 (2 javë vonësë) sipas kërkesave të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative, të cilat janë pranuar. Nga të pranuarat janë zbatuar 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 5 masa, të cilat janë pranuar. Është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, dhe 1 masë është e pa zbatuar.

d. Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Kurbin dhënia e masës disiplinore ndaj 6 personave. Është ngritur komisioni i cili ka vendosur për 4 punonjës të merret masa disiplinore dhe për 2 punonjës ka vendosur mos fillimin e ecurisë për marrje mase disiplinore.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 18.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Kurbin, sipas programit të auditimit nr. 627/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Sh. H., *përgjegjës i grupit;*
2. K. H., anëtar,

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 693/8 prot., datë 12.12.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Kurbin në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 693/8 prot, datë 12.12.2022, rezulton se nga **27** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), të cilat janë pranuar. Janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **21** masa ose 78% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **6** masa ose 22% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative dhe ato disiplinore.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është gati 80%, nga ana e Bashkisë Kurbin, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre si dhe janë realizuar të gjitha rekomandimet për masa disiplinore.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kurbin rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 693/8, datë 12.12.2022, ndërsa nga Bashkia Kurbin për zbatimin e

rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 6679/8 prot., datë 30.12.2022 brenda afatit 20 ditor.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kurbin rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 693/8, datë 12.12.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 12.06.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), nga ku rezulton se Bashkia Kurbin ka raportuar sipas shkresës nr. 6679/10 prot., datë 30.06.2023, duke raportuar me 2 javë vonesë.

Zbatuar

3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Kurbin ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 693/8 prot, datë 12.12.2022, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.”

Pa zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Kurbin 16 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2021-2023, u konstatua se:

-Nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Kurbin;

-Nuk është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik, strukturë e cila është përgjegjëse për menaxhimin, garantimin e cilësisë dhe monitorimin e zbatimit të sistemit të integruar të planifikimit;

-Procedura e përgatitjes së PBA 2021-2023 nuk dokumentohet plotësisht, pasi në dosjen përkatëse të PBA, nuk administrohet dokumentacioni mbi kërkesat e bëra për fondet nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Kurbin, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse;

-Në buxhetin vjetor të vitit 2021 nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë

12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020; Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrëjë Grupin e Menaxhimit Strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues i programeve ekonomike.

-Gjithashtu për çdo vit të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe të planifikohen fonde për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Kurbin.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kurbin nuk ka mbajtur procesverbale për konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit. Me urdhër të titullarit të Bashkisë Kurbin Nr. 60. datë 26.02.2021 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe me Urdhër Nr. 61 datë 26.02.2021 është ngritur Ekipi për Menaxhimin e Programit.

Sipas verifikimit të PBA 2022-2024 administrohet dokumentacion me kërkesat për fondet nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë Kurbin.

Nga verifikimi i buxhetit të vitit 2022 janë parashikuar fonde për investime në shtimin dhe përmirësimin e fondit pyjor në shumën 400,000 lekë.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime publike, konstatohet se niveli i realizimit të investimeve kapitale të planifikuara në vitin 2021 paraqitet masën 89%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Kurbin në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifet vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe pikën 24 dhe 25 në nenin 3, nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Kurbin për vitin 2022 sipas buxhetit ka parashikuar investime nga të ardhurat e veta në vlerën 117,806,059 lekë dhe ka realizuar investime në vlerën 36,820,322 lekë (e cila është përdorur vetëm për 3 projekte).

Kjo situatë e realizimit të investimeve në këtë vlerë vjen për shkak sepse Bashkia Kurbin ka qenë e prekur nga procesi i rindërtimit dhe procedurat e rindërtimit kanë qenë më prioritare në krahasim me investimet nga të ardhurat e veta.

Zbatuar pjesërisht

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021, u konstatua se janë të pa likuiduara gjithsej 1344 fatura për vlerën totale 47,605 mijë lekë, nga të cilat 237 fatura të palikujduara janë krijuar në vitin 2021 në vlerën totale 1,552 mijë lekë. Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2021, përcjellë në MFE, rezulton se vlera e detyrimeve

të prapambetura të Bashkisë Kurbin ndaj palëve të treta raportuar në MFE, përbëhet nga detyrime për vendime gjyqësore, shpenzime korrente dhe shpenzime kapitale në vlerën 47,605 mijë lekë, ndërsa sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit referuar të dhënave mbi lëvizjen debitore dhe kreditore të llogarisë 486 me kundërparti llogarinë 467, si dhe llogarinë 401-404, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura ne 31.12.2021, që duhej të raportohet në MFE është në vlerën 48,101 mijë lekë. Në fund të vitit 2021 të ardhurat e trashëguara për vitin 2022 (pa përfshirë fondet e rindërtimit) janë në vlerën 205,916 mijë lekë, ose detyrimet e prapambetura zënë 23% të tyre, ç'ka do të thotë se Bashkia Kurbin mund të likuidojë detyrimet e prapambetura.

-Gjithashtu sa i përket respektimit të radhës së likuidimit të detyrimeve të prapambetura (pra fatura e parë likuidohet më parë), u konstatua se nuk është respektuar ky kriter ligjor në 4 raste. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.26, datë 27.09.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësisë financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”; Kreun XI pika 1, neni 56 në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”; Pikat 8 dhe 184 të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtorja e Financës, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe likuidimin e tyre gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve në dispozicion.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas raportimit në MFE me shkresën Nr. 1055 datë 20.02.2023 për detyrimet e Bashkisë Kurbin deri në datën 31.12.2022 ka qenë në vlerën 113,033,117 leke.

Sipas situacionit të shpenzimeve në muajin qershor 2023 paraqitet situata si më poshtë:

1-Shpenzime elektrike 30,542,152 lekë

2-Vendime gjyqësore 1,860,958 lekë

3-Shpenzime te ndryshme 2,205,521 lekë

4-Invesime nga buxheti 24,120,780 lekë

5-Investime nga te ardhurat e veta 5,817,633 lekë.

Nga verifikimi i mësipërm Bashkia Kurbin nuk ka marrë angazhime te reja buxhetore dhe ka ulur stokun e borxhit me vlerën 48,485,373 lekë.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Kurbin për arkëtim ndaj të tretëve, nuk është pasqyruar saktë, sepse kjo llogari është pasqyruar më pak për vlerën 101,030,695 lekë duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, për vlerën prej:

-1,461,222 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale;

-1,347,673 lekë për taksat dhe tarifatat (principal dhe kamat-vonesë) vendore të biznesit;

-3,679,921 lekë, vlerë e përfshirë brenda shumës totale 59,611,011 lekë, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.

-17,100,000 lekë, detyrime që kanë për të likuiduar 17 subjekte, të cilët janë pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve;

-1,235,438 lekë detyrim për likuidimin e tarifës së qirasë nga subjekti “H. C.” Sh.P.K;

-55,787,323 lekë për taksën e tokës bujqësore;

-20,419,118 lekë për detyrimet e kategorisë “Familjar”, e trashëguar nga vitet e mëparshme dhe që nuk është e analizuar me dokumentacion në mënyrë analitike.

Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të

drejtave për t'u arkëtuar. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ë”, pika 3, neni 12 në ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t'u marrë”.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës ka kryer kontabilizimin e plotë të debitorëve në vlerën 101,030,695 lekë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, por llogaria 468 nuk është regjistruar sipas rekomandimit të mësipërm në kundërpartinë e llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t'u marrë”.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 13,002,996 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës për vitin 2022 ka liruar garancitë në shumën 7,485,833 lekë e cila përbehet nga 9 projekte. Vlera e garancisë 1,667,933 lekë për 13 projekte ndodhet akoma e regjistruar në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, këto janë investime të transferuara nga ish-komunat për të cilat është kryer investimi por nuk janë marrë në dorëzim.

Për 2 projekte në vlerën 9.605,719 leke (“Rikonstruksion i shkollës 3 dhe terreneve sportive, Rindërtim i terreneve sportive Mark Trokthi Laç).

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr.401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 10,565,436 lekë, për fatura të mbërritura, të palikujduara në fund të vitit 2021 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Një pjesë e faturave të mësipërme (dy fatura të muajit tetor të vitit 2021 të subjektit “V.” Sh.P.K në vlerën 496,048 lekë gjithsej) kanë plotësuar afatin 60-ditor pa u likuiduar, e për rrjedhojë duhet të kontabilizohen në llogarinë nr.467 “Kreditor të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.486, me qëllim pasqyrimin e plotë të vlerës së detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2021. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhej vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës ka zbatuar rekomandimin e mësipërm për pasqyrimin e llogarisë 401-408 “Furnitor dhe llogari të lidhura me to”. Kjo llogari pasqyron gjendjen reale për detyrimet të cilat në fund të vitit 2022 janë në vlerën 58,651,112 lekë.

Zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 606,602,230 lekë gjithsej, e ndarë për vlerën prej:

-595,000,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Kurbin Sh.A” me NIPT K07628310A;

-10,727,230 lekë aksione në shoqërinë aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Durrës Sh.A” me NIPT J61819502V;

-875,000 lekë aksione në shoqërinë aksionare “K. i F. L.” me NIPT L. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; Kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës sipas rekomandimit të mësipërm ka kryer regjistrimin në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” 12,843,232 lekë dhe ka kredituar llogarinë 101 “Fondi Bazë” për 3 shoqëritë në të cilat është aksioner sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit. Bashkia Kurbin për regjistrimin e pjesëmarrjes në këto 3 shoqëri nuk është kryer pagesa e pjesëmarrjes.

Në proces zbatimi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, Kullota, Plantacione”, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet 2006-2018, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:

-vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj;

-vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Kurbin,

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i aseteve për dy llogaritë e mësipërme.

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Kurbin nuk ekziston një regjistër kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kapitullin III, neni 9, pika 1.2 në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; Pikat 26, 27, 30 dhe 74 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit

publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve.

8.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Titullari i Bashkisë Kurbin ka ngritur Urdhrin Nr.125 datë 29.09.2022 “Për inventarizimin fizik për aktivet e paluajtshme përkatësisht pyje, troje, plantacione, objekte ndërtime”.

Zbatuar

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, për:

- Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

- Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

8.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës nuk ka hartuar regjistrin e aktiveve të njësisë për llogaritë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.

Pa zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më shumë për vlerën 49,828,544 lekë, si rrjedhojë e kontabilizimit në këtë llogari të disa makinerive, si 3 fadroma, 1 kovë eskavatori dhe 1 rimorkiator, të cilat janë makineri dhe jo mjete transporti, si dhe duhet të klasifikohen në llogarinë nr.214. Për këto makineri duhet të aplikohet normë tjetër amortizimi (5%) dhe jo (20%). Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik-instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune – llogaria 7-shifrore 2140240-Pajisje dhe makineri për konstruksione (ndërtime); 2140260-Pajisje pastrimi për rrugët; 2140320-Mjete dhe pajisje të tjera teknike. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 215 “Mjete transporti”.

9.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin ka kryer transferimin në llogarinë 214 “Materiale, pajisje” mjete në vlerën 49,828,544 lekë. Mjetet që janë transferuar janë 3 fadroma, 1 kovë eskavatori dhe 1 rimorkiator.

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

-Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

-Për vitin 2021 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.

-Nuk është hartuar “Harta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”.

-Për vitin 2021 nuk dokumentohet ngritja dhe funksionimi i GMS.

-Nuk është hartuar regjistri i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-21, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin, si dhe drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

10.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhër nr. 19, datë 31.01.2023 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik të cilat janë përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e një sistemi sa më efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për gjithë veprimtarinë proceset që menaxhojnë të jenë në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe të transparencës etj, si dhe me urdhër nr. 20, datë 31.01.2023 është ngritur edhe Ekipi për Menaxhimin e Programit. Pavarësisht se janë ngritur komisionet/grupet përkatëse, nuk rezulton të jenë hartuar strategji konkrete për menaxhimin e risqeve të cilat mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Zbatuar

10.2. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune në funksion të strukturës organizative të Bashkisë Kurbin.

10.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në vijim të rekomandimeve ndër vite të KLSH për ndryshimet e rregullores së brendshme të institucionit, është ngritur grupi i punës me urdhër nr. 139, datë 10.10.2022 “Për përgatitjen e rregullores mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Kurbin, Njësi Administrative dhe Agjencisë të Varësisë. Grupi i Punës nuk ka përfunduar akoma procesin e ndryshimeve.

Në proces zbatimi

10.3. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

10.3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka hartuar dhe miratuar Program trajnimi për stafin e Bashkisë, por është mjaftuar me trajnimet e organizuara nga ASPA për punonjësit civil.

Zbatuar pjesërisht

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm pranë Bashkisë Kurbin përgjatë vitit 2021, u konstatua se:

-Numri i punonjësve në sektorin e auditit të brendshëm nuk është sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësi të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, sipas të cilës njësi e auditit të brendshëm duhet të ketë 3 punonjës, ndërkohë kanë qenë dy të punësuar.

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit.

-Në auditimet e kryera për vitin 2021, konstatohet se nuk është planifikuar kryerja e auditimeve tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

-Në përfundim të auditimeve të kryera përgjatë vitit 2021 nuk është dhënë opinion i auditimit.

-Për vitin 2021, konstatohet se nuk janë mbuluar me auditim aktivitete që kryen Bashkia Kurbin, të cilat kanë risk të lartë, si Drejtoria e Financës, Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, prokurimet publike etj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bëra në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Pikën 3.1.3 në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 22-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

-Plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në NJAB Kurbin;

-Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

11.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga verifikimi rezultoi se nuk është shpallur asnjë procedurë për rekrutim stafi për auditues të brendshëm për të plotësuar me 3 auditues këtë njësi, ndërkohë rezulton se kjo njësi aktualisht ka vetëm 1 të punësuar në nivel specialist pasi përgjegjësi i njësisë ka dhënë dorëheqjen duke ngelur njësia me vetëm 1 punonjës.*

Pa zbatuar

11.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kurbin, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lartë, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore etj, në mënyrë që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

11.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Me shkresën nr. 5569 prot., datë 18.10.2022 i është përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, DHAB plani vjetor për vitin 2023 sipas të cilit është planifikuar vetëm 1 auditim, konkretisht Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social, kjo për shkak të mungesës së stafit dhe përgjegjësit të sektorit.*

Zbatuar pjesërisht

12. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi se nga 49 rekomandime të dhëna, 27 prej tyre janë zbatuar ose 56%, 3 zbatuar pjesërisht ose 7%, 3 në proces zbatimi ose 7%, si dhe 16 pa zbatuar ose 33%.

-Në vlerë monetare, sa i përket rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, rezulton se:

Janë dhënë 3 rekomandime për shpërblimin e dëmit të krijuar për 3 subjekte në vlerën 6,565 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht nga subjekti, prej të cilave, 2 janë zbatuar dhe arkëtuar për vlerën 5,184 mijë lekë për 2 subjekte, si dhe 1 në proces zbatimi për vlerën 1,381 mijë lekë për 1 subjekt.

Janë dhënë 4 masa për eliminimin e efekteve negative financiare në vlerën 770,658 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, prej të cilave, 1 masë në vlerën 249,059 mijë lekë ose 33% është në proces zbatimi, si dhe 3 prej tyre në vlerën 521,599 mijë lekë ose 67 % nuk janë zbatuar.

Janë dhënë 6 masa për eliminimin e borxhit tatimor, për 16174 subjekte në vlerën 494,850 mijë lekë dhe janë pranuar plotësisht, prej të cilave, është në proces zbatimi 1 masë për 40 subjekte në vlerën

20,000 mijë lekë, ose 4% e tyre në vlerë monetare, si dhe 5 masa në vlerën 474,850 mijë lekë ose 96 % nuk janë zbatuar.

-Janë lënë 2 masa administrative, të cilat nuk janë zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të marrë të gjithë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, të cilat ende rezultojnë të pazbatuara.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga KLSH janë lënë 22 rekomandime gjithsej, nga këto:

- 10 masa organizative;

- 1 masë shpërblim dëmi;

- 4 masa për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike në përputhje me parimin e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit;

- 6 masa për uljen e borxhit tatimor;

- 18 masa disiplinore;

- 2 masa administrative.

a.Për 10 masa organizative, 6 masa rezultojnë të natyrës financiare, të cilat janë në proces të vazhdueshëm, dhe janë audituar edhe përgjatë vitit 2022. Një rekomandim për MFK është gjithashtu rekomandim në vijim, për të cilin janë lënë njëkohësisht rekomandimet përkatëse përgjatë auditimit të kryer gjatë vitit 2022. Rekomandimi për Auditin e Brendshëm është rekomandim i pazbatuar, i cili është rikërkuar përgjatë auditimit të fundit, ndërsa rekomandimi nr. 15 i cili ka të bëjë me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1082/45 prot., datë 05.06.2020, është rekomandim për të cilin ka kaluar afati 3 vjeçar për rikërkimin e tij, sipas pikës 1.5 "Afati përfundimtar i deklaramit të statusit të rekomandimit" sipas Manualit për ndjekjen e zbatimin e rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në proces zbatimi

b.Nuk është zbatuar 1 rekomandimi për Masa Shpërblim Dëmi (Rek.nr. 3) për dëmin ekonomik në vlerën **1,381,125 lekë** ndaj subjektit "H. C." shpk.

Pa zbatuar

c.Lidhur me 4 masat për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara në administrimin e fondeve publike, të cilat lidhen me procedurat e prokurimit publik dhe zbatimin e kontratave, do verifikohen përgjatë auditimit të përputhshmërisë pranë kësaj bashkie.

Në proces zbatimi

-Për 6 masat që lidhen me uljen e borxhit tatimor, janë masa të cilat janë verifikuar dhe verifikohen përgjatë auditimit, një pjesë e të cilave është rikërkuar nga audituesit edhe përgjatë auditit të fundit të kryer pranë kësaj bashkie. Njëra prej masave, konkretisht Rekomandimi nr. 6 e cila lidhet me subjektet e ndërtimit që kanë krye punime pranë Bashkisë Kurbin por nuk kanë likuiduar detyrimet vendore, rezulton se janë njoftuar subjektet për likuidimin e këtij detyrimi nga ku ka rezultuar se janë likuiduar 5 mandate në vlerën 325,000 lekë dhe një mandat arkëtimi ndaj subjektit "S." shpk dhe "2." shpk nuk është arkëtuar. Për 22 vendimet e IMT për gjobat, janë përcjellë të gjitha në gjykatë për titull ekzekutimi, nga të cilat 10 gjoba janë përcjellë zyrës së përmbartimit për ekzekutimin e vendimit. Për gjobat tjera janë dërguar kërkesat për tërheqjen e vendimeve të cilat nuk janë administruar akoma.

Në proces zbatimi

-Lidhur me 2 masat administrative ndaj 1 mbikëqyrësi dhe 1 kolaudatori, IMT, gjatë auditimit ka mbajtur procesverbalet në zbatim të rekomandimit të KLSH ndaj subjektit G. I. në cilësinë e kolaudatorit, për të cilin është vendosur edhe masa e gjobës në vlerën 50,000 lekë dhe subjektit A. K. në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për të cilin është vendosur masa e gjobës në vlerën 50,000 lekë. Të dy subjekteve, u është dërguar njoftimi për shlyerjen e gjobave me datë 20.07.2023.

Në proces zbatimi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2021, rezulton se Bashkia Kurbin për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, ka shpenzuar vlerën 10,915 mijë lekë për 6 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për 6 praktika likuidimi të vendimeve gjyqësore të përzgjedhura në mënyrë rastësore, u konstatua se janë kryer likuidime pjesore, megjithëse Bashkia Kurbin ka pasur disponibilitete në thesar për të likuiduar plotësisht vendimet gjyqësore. Gjithashtu në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Kurbin. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme, që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë grafikun dhe likuidimin e plotë të detyrimeve të prapambetura nga vendimet gjyqësore.

1.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e Financës ka parashikuar në PBA 2022 – 2024 paketën për vendimet gjyqësore. Deri në Qershor 2023, detyrimi për vendimet gjyqësore është në vlerën 1,860,958 lekë.*

Në proces zbatimi

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Kurbin të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Kurbin vazhdon të ketë procese gjyqësore me ish punonjës të cilët janë larguar gjatë periudhës 2014 – 2015 nga procesi i bashkimit të ish komunave me Bashkinë Kurbin. Pas vitit 2015, nuk ka procese gjyqësore për punonjësit e larguar pas këtij viti.*

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Programimi i të ardhurave për vitin 2021 është në vlerën 153,897 mijë lekë dhe janë realizuar në fakt në vlerën 110,498 mijë lekë, pra me një realizim në masën 71.8 %, ku mosrealizimi është në vlerën 43,399 mijë lekë. Detyrimet e papaguara nga taksapaguesit për periudhën 2011-2021 paraqiten në shumën prej 332,560 mijë lekë në progresiv, ku vetëm për vitin 2021 shuma e debitorëve është 103,605 mijë lekë, vlera këto të konsiderueshme, që përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Kurbin. Administrimi i procesit për mbledhjen e detyrimeve tatimore ka mangësi në lidhje me ndjekjen e veprimeve procedurale nga ana e Drejtorisë

së Planifikimit të të Ardhurave Vendore, pasi nuk janë ezauruar të gjitha hapat dhe mekanizmat e përcaktuar në legjislacionin tatimor për të siguruar mbledhjen e këtyre detyrimeve. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar, Kreu XI, nenet 89, 90, 91, 93, 97 dhe 98, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2014 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu VIII, neni 42. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa konkrete ndaj subjekteve debitorë duke ndjekur e zbatuar procedurat tatimore, me qëllim mbledhjen e detyrimeve dhe mos krijimin e detyrimeve të prapambetura për secilën kategori biznesi.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi rezultoi se Drejtoria e të Ardhurave Vendore, ka dërguar njoftimet për detyrimet (abonentë familjarë dhe biznesi), por nuk është marrë asnjë masë tjetër shtrënguese referuar ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH” i ndryshuar.

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktivitetit si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve u konstatua se 17 subjekte nuk kanë paguar tarifën 1,000,000 lekë, për të rinovuar licencën e ushtrimit të aktivitetit, duke krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë në vlerë totale prej 17,100,000 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 9 të VKM nr. 344 datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970 datë 02.12.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Bashkia Kurbin, nëpërmjet Drejtorisë së Ardhurave Vendore të marrë masa që për 17 subjekte debitorë të arkëtojnë tarifat e plota, për diferencën debitorë prej 17,100,000 lekë, detyrim ky për pajisjen me autorizim/licencë për tregtimin me pakicë të karburanteve dhe gazit të lëngshëm vajrave lubrifikante për automjetet. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për pagesën e tarifës së licencë/autorizimit, Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial të ndërmarrin veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Janë paraqitur disa njoftime ndaj subjekteve debitorë për licencën e tregtimit të karburanteve të cilat mbajnë datën 30.03.2022 si dhe janë përcjell njoftimet bashkëlidhur faturën për arkëtim ndaj subjekteve “N. O.” shpk, “I.” shpk, “D. 2.” shpk, “V. O.” shpk, “B.” shpk, “F.” shpk, “T.” shpk, “S. P. A.” shpk, “D. O.” shpk, “L. 1.” shpk, “S.” shpk, “V.” shpk, “E.” shpk, “G. C.” shpk, “E.” shpk”, “V. A.” shpk, “E.” shpk të cilat mbajnë datën 04.07.2022 të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit të Ardhurave Vendore. Lidhur me këtë detyrim, nuk është kryer asnjë likuidim ndaj Bashkisë Kurbin, duke u mjaftuar vetëm me njoftimin e subjekteve dhe nuk është marrë asnjë masë tjetër.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitorë për këtë taksë në mënyrë progresive është 39,481 mijë lekë për 1095 subjekte, nga të cilat 25 subjekte për vlerën 787 mijë lekë janë krijuar në vitin 2021. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Kurbin, nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 në nenin 89 në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5 në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave

vendore” të ndryshuar dhe pikën IV në VKB nr.152, datë 14.12.2020 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 27-79, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit t’i përcjellë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave (DAP) listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAP Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 39,481 mijë lekë.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa zbatuar

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Kurbin dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” ndaj:

Zj. R. K., me detyrë Drejtore e Financës, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe në kontabilizimin jo të saktë dhe të plotë të ngjarjeve ekonomike në pasqyrat financiare të vitit 2021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48 dhe në pikën 2.3, faqe 48-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Z. B. P., me detyrë Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për mangësitë e konstatuara në administrimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informal dhe mos bashkëpunimin me Drejtorinë e Financës për të përcjellë informacionin për kontabilizimin e debitorëve të rezultuar nga mospagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Z. A. B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitore, mosaplikimin e penaliteteve, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Znj. D. R., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të të Ardhurave, për mangësitë e konstatuara në administrimin e tarifës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburantit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Z. A. B., me detyrë Specialist Transporti pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Kurbin, për mangësitë e konstatuara në administrimin e tarifës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburantit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 24-48, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Z. R. V., Specialist pranë Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, për mangësitë në raportimin e debitorëve për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Nga verifikimi rezultoi se: Me urdhër Titullarit me nr. 101, datë 09.06.2023 është ngritur komisioni disiplinor për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Me shkresat nr. 3081 – 3086 prot., datë 30.06.2023 është bërë njoftimi për ecurinë disiplinore ku janë njoftuar të gjithë personat për të cilën janë kërkuar masat disiplinore. Janë mbajtur procesverbalet mbi zhvillimin e seancave dëgjimore me secilin punonjës. Me datë 18.07.2023, komisioni disiplinor, ka vendosur dhënien e 4

masave disiplinore për 4 punonjës, konkretisht A. B., R. V., D. R. dhe A. B.. Për 2 punonjës tjerë, komisioni ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore, konkretisht për punonjësit R. K. dhe B. P..

Zbatuar

Zbatimi i rekomandimeve në Bashkinë Kurbin, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	16	16	5	3	6	2
Masa për 3E	5	5	1	-	3	1
Masa Disiplinore	6	6	6	-	-	-

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Kurbin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajojmë përshtetimin e realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, ndërsa për rekomandimet e pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Rekomandimi 2.1: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 8.2: Drejtoria e Financës Bashkia Kurbin, të marrë masat e nevojshme, për:
 - Kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr.210 “Toka, Troje, Terrene” nr.211 “Pyje, kullota, plantacione”.
 - Hartimin e regjistrit të aktiveve të njësisë, i cili minimalisht duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Rekomandimi 10.3: Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Rekomandimi 11.1: Kryetari i Bashkisë Kurbin dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për:

- Plotësimin e pozicioneve vakante (përgjegjës sektori dhe auditues) në NJAB Kurbin;
- Ngritjen dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë

5.Rekomandimi 11.2: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Kurbin, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore etj, në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1.Rekomandimi 4.1: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit t'i përcjellë Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave (DAP) listën me subjektet debitore për taksën e ndikimit në infrastrukturë, si dhe në vijim DAP Bashkia Kurbin të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitore prej 39,481 mijë lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1.Nga Kryetari i Bashkisë Kurbin **kërkojmë** analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve sipas Planit të Miratuar.

Për sa më lart, **kërkojmë** fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Pukë: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIU DHËN
01.07.2022 DERI 31.01.2023, BASHKIA PUKË”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2-3
	I/1. Hyrje.....	3
	I/2. Objektivat e auditimit.....	3
	I/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	I/4. Metodologjia auditimit.....	3
	I/5. Konkluzione.....	3
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	3
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	3-22
	<i>Drejtimit e Auditimit.....</i>	3-4
	<i>B.Masa Organizative.....</i>	4-17
	<i>C.Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e fondeve publike me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet.....</i>	17-20
	<i>D.1Masa Disiplinore.....</i>	20-22
IV	Konkluzione dhe rekomandime.....	22-24

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 627/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Pukë, më datë 25.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. Sh. H. dhe z. K. H., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar. Me shkresën nr. 627/7 prot., datë 04.08.2023 është dërguar Projekt Raporti i Auditimit subjektit Bashkia Pukë.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Pukë rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022, ndërsa nga Bashkia Pukë është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1650/19 prot., datë 19.01.2023, **brenda afatit 20 ditor**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 mujor** nga momenti i dërgimit të shkresës me nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.06.2023. Nga ana e Bashkisë Pukë është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH me shkresën nr. 1064 prot., datë 14.06.2023 në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30 - *Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit*.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 21 **masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 21 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 7 masa, janë në proces zbatimi 4 masa organizative, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe 7 masa nuk janë zbatuar.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 6 masa, të cilat janë pranuar. Janë zbatuar plotësisht 2 masë, janë në proces zbatimi 3 masa, dhe 1 masë është e pa zbatuar.

d. *Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Pukë dhënia e masës disiplinore ndaj 7 personave. Është ngritur komisioni i cili ka vendosur për 5 punonjës të mos merren masa dhe për 2 punonjës nuk ka vendimmarrje pasi nuk janë më punonjës.*

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 18.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar” të ushtruar në Bashkinë Pukë, sipas programit të auditimit nr. 627/5 prot., datë 07.07.2023, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Sh. H., përgjegjës i grupit;
2. K. H., anëtar,

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Pukë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022, rezulton se nga **34** masa të rekomanduara (*organizative, mungesë të ardhurash dhe disiplinore*), të cilat janë pranuar. Janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **23** masa ose 68% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **11** masa ose 32% e masave të rekomanduara.

Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative dhe ato disiplinore.

II. Opinioni i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është 68%, nga ana e Bashkisë Pukë, ku Drejtoria e Financës ka realizuar pjesën më të madhe të tyre.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të

ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Pukë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022, ndërsa nga Bashkia Pukë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1650/19 prot., datë 19.01.2023 brenda afatit 20 ditor.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Pukë është ngritur grupi i punës, është miratuar plan veprimi dhe personat përgjegjës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Pukë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 797/8, datë 30.12.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.06.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA),për të cilën Bashkia Pukë ka kthyer përgjigje për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1064 prot., datë 14.06.2023.

Zbatuar

3.Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezulton se Bashkia Pukë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 797/8 prot., datë 30.12.2022, por nuk ka raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.”

Pa zbatuar

B. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Pukë 21 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 7 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe 7 masa organizative nuk janë zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen dhe nuk funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë, pasi ky institucion nuk ka ende një profil bashkëkohor të funksionimit të tij. Akoma mbeten pa u kuptuar disa koncepte dhe mungojnë disa procedura në lidhje me 5 komponentët si:

Mjedisi i kontrollit: Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme. Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen.

Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të Kontrollit të Brendshëm.

Nuk janë përcaktuar objektivat konkret, të matshëm, për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të bashkisë në të cilin është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij

Menaxhimi i Riskut: Ka strategji të menaxhimit të riskut, si dhe regjistër risku, sipas nenit 21 i Ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, si dhe Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publike”. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Në Bashkinë Pukë, Drejtoria e administrimit të përgjithshëm, Sektori i financës dhe Sektori i tatim taksave nuk përdorin program për mbajtjen e kontabilitetit por operojnë me programin Excel ku niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë.

Nuk ka asnjë procedurë për menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit.

Nuk është hartuar një regjistër kompleks për gjithë bashkinë, ku të identifikohen dhe të bëhet vlerësimi i risqeve për të gjitha Drejtoritë e NJA si dhe një plan-menaxhimi të risqeve në nivel bashkie për përcaktimin e veprimeve për të adresuar mangësitë.

Regjistri i riskut dhe i plan-veprimit të menaxhimit të MFK nuk është i plotë dhe ka sjellë mosidentifikimin dhe mosvlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut.

Ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Aktivitetet e Kontrollit: Bashkia Pukë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT.

Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka vetëm një specialistë që mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj..

Informimi dhe komunikimi: Sistemi i raportimit nuk ofron informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj. Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

Në Rregullore nuk është përfshirë mënyra e komunikimit brenda institucionit, por në fakt veprime me komunikim verbal, nuk ka sistem IT-së që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Monitorimi: Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

Në Bashkinë Pukë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Në Bashkinë Pukë aktivitetet e vlerësimit të njësisë nuk janë në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshme dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas plan veprimit janë ngarkuar drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve për zbatimin e këtij rekomandimi. Nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tij.

Zbatuar pjesërisht

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2020-31.12.2021, në Bashkinë Pukë nuk është krijuar Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe nuk ka funksionuar procesi i Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj. Nga auditimi nuk u konstatua asnjë procedurë për krijimin e kësaj njësie apo për rekrutimin e punonjësve për këtë strukturë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1., faqe 31-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Pukë dhe menaxhimi i lartë, të merren masa për të krijuar sa më parë Njësinë e auditimit të Brendshëm duke filluar procedurat e rekrutimit të punonjësve.

2.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në strukturën për vitin 2023, miratuar me vendimin nr. 67, datë 30.12.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Pukë, NjA...”, përcaktohet ngritja e Auditit të Brendshëm në nivel sektori, me 2 punonjës. Kjo strukturë vijon të jetë pa staf të rekrutuar, pasi nuk ka aplikime për këtë pozicion pune.

Zbatuar

2.2. Rekomandimi: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Pukë, në koordinim me Drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen

mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëjës nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

2.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk është lidhur asnjë marrëveshje për bashkëpunim me bashki të afërta për kryerjen e auditimit në Bashkinë Pukë.*

Pa zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatuan diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 66 deri 98%, çka do të thotë se, mbështetur në këto të dhëna rezulton se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Pukë dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara. Bashkisë Pukë për vitin 2021 janë realizuar në masën 72%, konkretisht nga 43,088 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 31,194 mijë lekë. Të ardhurat e trashëguara nga viti 2020 në vitin 2021 kanë qenë 20,605 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar e vitit 2021 ka qenë 112,704 mijë lekë, transferta specifike faktike ka qenë 100,676 mijë lekë, nga FZHR nuk ka pasur një çelje fondi për vitin 2021 por nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë investime në ujësjellës në vlerë 128,193 mijë lekë. Përdorimi i të ardhurave për vitin 2020, sipas treguesve të buxhetit, për të ardhurat e veta gjatë vitit 2021 ka qenë 72%. Nga ky planifikim i pabazuar në pritshmërinë reale për realizimin e të ardhurave, ka rezultuar mosrealizimi i zërave të rëndësishëm buxhetorë, duke filluar me pagat e sigurimet shoqërore, për të vazhduar me shpenzimet operative, me transferimet e brendshme, me investimet etj.

Veprime këto jo në përputhje me ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisve të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të këshillit bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masat e duhura që, për hartimin e një buxheti real, të mbështetet në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit. Gjithashtu të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas rakordimit me thesarin për vitin 2022, buxheti i planifikuar për vitin 2022 ka qenë në vlerën 481,519,699 lekë dhe është realizuar në vlerën 423,232,576 lekë, realizim në masën 87 %. Ndikim në mos realizimin e buxhetit, janë investimet e realizuara në masën 69% dhe shpenzimet për blerje mallrash të realizuara në masën 65%.*

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se fondet e krijuar për emergjencat civile nuk është në masën 4% e shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, ku referuar buxhetit përkatës të vitit 2021, ky fond duhej të ishte në vlerën 22,996 mijë lekë. Buxheti i caktuar nga Bashkia Pukë për emergjencat civile është llogaritur 1.7% e totalit të

transfertës dhe të ardhurave të planifikuara për vitin 2021 sipas shkresës të MFE nr. 23189/1 prot., datë 24.12.2019. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen Civile”, pika 1 e nenit neni 65 “Buxheti i bashkive”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që në të ardhmen, të parashikojë shpenzimet për emergjencat civile në nivelin e duhur, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile për komunitetin.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: Në hartimin e buxhetit të vitit 2022, Bashkia Pukë nuk ka parashikuar shpenzime për emergjencat civile sipas rekomandimit të mësipërm.

Pa zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se niveli i realizimit të investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku për vitin 2021 është realizuar në masën 91%, ku nga vlera e planifikuar prej 195,599 mijë lekë është realizuar vlera 177,610 lekë me një diferencë prej 17,989 mijë lekë. Kjo situatë vjen kryesisht nga planifikimi i procedurave pa fonde në dispozicion, në fazën e hartimit dhe miratimit të buxheteve ose planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin, ku sipas të dhënave, të ardhurat për asnjë nga vitet nuk janë realizuar, konkretisht për periudhën 2021 paraqitet 72%, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre. Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësiive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të këshillit bashkiak.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Pukë, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të ardhurave dhe jo të planifikimit, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e Bashkisë Pukë.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Referuar faktit të buxhetit për vitin 2022, shpenzimet për investime janë realizuar në masën 69% dhe shpenzime për blerje mallrash në masën 65% për shkak se shpenzimet për zërat e mësipërm bazohen në planifikimin fillestar të vitit për të ardhurat.

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021, detyrimet në fund të periudhës ushtrimore janë në shumën 47,418 mijë lekë. në fund të vitit 2021, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël, nisur nga fakti se planifikimi i buxhetit të vitit pasardhës hartohet dhe miratohet në muajin nëntor dhe detyrimet nuk kanë dalë të gjitha. Në shumën e paplanifikuar

përfshihen edhe vendimet gjyqësore të mbartura ndër vite. faturat e artikullit 602 paraqiten në shumën 5,694 mijë lekë ose 12.2% të totalit, ku shpenzimet për investime janë në shumën 33,949 mijë lekë ose 71.5% dhe shpenzimet gjyqësore janë në shumën 7,776 mijë lekë ose 16.3% e totalit. Është i paargumentuar fakti se referuar situatës së pasqyrave financiare të vitit 2021, megjithëse në llogarinë 520 ka gjendje monetare të papërdorur, përsëri Bashkia Pukë ka detyrime kreditore të papaguara dhe në vlera të konsiderueshme. Kështu në fund të periudhës së vitit 2021 në llogarinë 520 ka pasur gjendje në vlerën 57,557,514 lekë. Pavarësisht se një pjesë e këtyre fondeve nuk mund të prekeshin për shkak se kanë qenë të specifikuar nga transfertat, pjesa tjetër mund të ishte përdorur për të shlyer plotësisht ose pjesërisht detyrimet e prapambetura. Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit **30 ditor** të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Pukë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për vitin 2021, janë paguar gjithsej 87 fatura me vlerë 3,788 mijë lekë. Nga auditimi i dokumentacionit për detyrimet ndaj vendimeve gjyqësore, u konstatua se deri në fund të vitit 2020 paraqitet vlera totale prej 10,941 mijë lekë. Gjatë vitit 2021 është likuiduar shuma prej 2,575 mijë lekë dhe mbetet për likuidim shuma prej 10,071 mijë lekë. Sa më sipër, kjo bashki është afër klasifikimit me vështirësi financiare, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura paraqitet rreth 14.3% e shpenzimeve vjetore të miratuara. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program dhe radhës së faturave, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

6.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Pukë nuk ka marrë masat për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Raportimi në MFE është bërë në datën 08.02.2023 me shkresën 201/I prot., dhe vlera e detyrimeve të prapambetura është 38,492,000 lekë.

Zbatuar pjesërisht

6.2. Rekomandimi: Bashkia Pukë, drejtorja ekonomike, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe detyrimeve për vendimet gjyqësore të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **47,418 mijë lekë**, nga faturat e papaguara dhe për vlerën **7,776 mijë lekë** nga vendimet gjyqësore (në datën 31.12.2021) si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.

6.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtorja e Financës nuk ka paraqitur me shkresë në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Pukë listën e detyrimeve të prapambetura dhe nuk është hartuar 1 grafik për pagesën e tyre. Në MFE është bërë raportimi i detyrimeve të prapambetura.

Zbatuar pjesërisht

6.3. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa që të ardhurat e papërdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t'i përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas radhës kronologjike të krijimit të tyre.

6.3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masa që të ardhurat e papërdorura të përdoren për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Detyrimet e prapambetura sipas rakordimit me thesarin janë në vlerën 38,492,096 lekë në datën 31.12.2022.

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi dhe kryqëzimi i të dhënave sipas sistemit të pagesave nga Dega e Thesarit dhe Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), rezulton se gjatë vitit 2021 janë likuiduar 64 raste në shumën 14,751,932 lekë nga të cilat 5 fatura janë të vitit 2014 për shumën 6,144,720 lekë, 6 fatura të vitit 2015 për shumën 250,000 lekë, 7 fatura të vitit 2016 për shumën 513,842 lekë, 28 fatura të vitit 2018 në shumën 2,678,509 lekë, 17 fatura të vitit 2019 për shumën 1,751,893 lekë dhe 1 faturë e vitit 2020 në shumën 3,412,968 lekë. Pra këto fatura të likuiduara i përkisnin periudhave të mëparshme dhe nuk janë shpenzime të periudhës raportuese. Këto fatura të viteve të mëparshme janë regjistruar në SIFQ si fatura për t'u likuiduar gjatë vitit 2021. Kjo ka ardhur si pasojë kryesisht për shpenzime të proceseve gjyqësore të vendimeve gjyqësore për punonjës të larguar nga puna dhe në disa raste për fatura e marrjes së angazhimeve pa patur fonde buxhetore në dispozicion duke mos lejuar ekzekutimin e tyre. Pra duke mos patur fonde faturat nuk deklarohen si të pagueshme brenda 30 ditëve, por mbahen të paregjistruara deri në hapjen e fondeve të nevojshme për pagesën e tyre, çka do të thotë se strukturat përgjegjëse kanë patur dijeni për këto detyrime dhe si rezultat i mungesës së fondeve në dispozicion, apo planifikimit jo të drejtë të shpenzimeve për vitin korent, kanë shlyer vetëm një pjesë të tyre. Veprime jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 61, nenin 54, “Kryerja e pagesave”, Ligjin nr. 25 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 15 pika 1, nenin 11 pika 1, Ligjin nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pikën 164.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë duhet të marrë masa për paraqitjen në kohë me besueshmëri të shpenzimeve dhe detyrimeve në llogaritë përkatëse në Pasqyrat Financiare me qëllim, raportim të drejtë të situatës financiare të Njësisë.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2022 për Bashkinë Pukë, drejtoria e financës ka paraqitur në llogaritë 401-408 dhe 467 detyrimet e prapambetura.

Zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe shqyrtimi i zërave të buxhetit të Bashkisë Pukë, referuar të dhënave të Aneksit B4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, konstatohet se: për vitin 2021, të ardhurat nga **43,090 mijë** lekë të planifikuara janë realizuar **31,194 mijë** lekë ose **72%**, pra me një mosrealizim në shumën **11,896 mijë** lekë. Kryesisht, ky mosrealizim përbëhet nga deficieti i krijuar nga taksa/tarifa për të cilat janë arsyet për tejkalimet dhe mosrealizimet të argumentuar ku totali i mosrealizimit për periudhën e audituar është 11,896 mijë lekë, i cili është thelluar edhe për shkak të pandemisë Covid-19. **Mosrealizimi i të ardhurave vendore** është kryesisht për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19 dhe pezullimeve e mbylljeve të bizneseve. Gjithashtu largimi i familjeve përfshirë të gjitha njësitë administrative Pukë ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave vendore. **Mosrealizimi për taksën e tokës bujqësore** ka ardhur për shkak se një numër i konsiderueshëm poseduesish të pasurisë tokë bujqësore kanë vdekur, migruar dhe emigruar dhe trashëgimtarët ligjor nuk kanë shprehur interes për kalimin e pronësisë mbi vete dhe për rrjedhojë ka rezultuar ky mosrealizim i kësaj takes. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për

vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nën-pika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, gjatë hartimit të projekt/planit të buxhetit, të planifikojë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë kontabilizimin e të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurojë rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e degës së thesarit sipas akt-rakordimeve të financës, buxhetit dhe kontabilitetit.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sektori i tatim taksave, ka planifikuar për vitin 2022 të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore vlerën 53,784 mijë lekë e cila është parashikuar sipas regjistrave që disponon zyra e taksave. Realizimi i të ardhurave për vitin 2022 sipas akt rakordimit me thesarin të datës 31.12.2022 është në vlerën 34,618 mijë lekë.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: 1. Nga krahasimi i PF të disponueshme në Bashkinë Pukë, me PF në sistemin e Thesarit, u konstatua se në totalin e Aktivit në PF në bashki, vlera është 1,921,465,572 lekë, ndërsa në totalin e Aktivit në PF në sistemin e Thesarit vlera është 1,860,791,097 lekë, me një diferencë prej 60,674,475 lekë më shumë në PF të subjektit. Në vijim, në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra, në PF në bashki, vlera është 415,191,228 lekë, ndërsa në totalin e Aktiveve Qarkulluese/Afatshkurtra në PF në sistemin e Thesarit vlera është 81,407,464 lekë, me një diferencë prej 333,783,764 lekë më pak në PF në sistemin e Thesarit. Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në PF në subjekt ka vlerën 57,557,514 lekë, ndërsa në PF në sistemin e Thesarit ka vlerën 0. Për sa më sipër, këto llogari nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë.

2. Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në Bashkinë Pukë, u konstatua se nuk janë zbatuar dispozitat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”. Në Bashkinë Pukë disponohen dokumente në lidhje me pasuritë publike të transferuara në vite me VKM të posaçme në ish-komunat të cilat sot janë pjesë e Bashkisë Pukë dhe janë bërë disa regjistrime të pasurive publike të cilat tashmë i përkasin Bashkisë Pukë.

Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 1,202,645 lekë e pandryshuar nga vitit paraardhës.

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje kullota plantacione” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 7,549,626 lekë, me një pakësim prej 728,956 lekë nga viti ushtrimor paraardhës. Gjendja e llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 495,095,832 lekë duke u shtuar në vitin ushtrimor për 29,387,305 lekë nga vitit paraardhës.

Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën 533,846,313 lekë duke u pakësuar në vitin ushtrimor për 13,866,207 lekë nga vitit paraardhës.

Për këto zëra të aktivitetit regjistri i aktiveve nuk është i plotë ku të specifikohen datat e hyrjes së aktivitetit, vlera e tyre në hyrje, shpenzimet kapitale, personat që i kanë në dorëzim.

Në Bashkinë Pukë janë kryer investime të ndryshme nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, punime të

cilat kanë përfunduar dhe duhet të ishin kontabilizuar si asete të Bashkisë Pukë. Për këto investime, nga Bashkia Pukë nuk disponohet asnjë e dhënë financiare dhe nuk është kryer asnjë veprim apo korrespondencë me investitorin.

Nga verifikimi i regjistrave të aseteve, u konstatua se për llogaritë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” dhe 215 “*Mjete transporti*”, paraqiten problematika në lidhje me informacionin mbi të dhënat që duhet të ketë një regjistër aktivësh, siç janë: data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlera e blerjes, data e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme të cilat sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Kryesisht, këto probleme janë të trashëguara nga ish-komunat. Librat e aktivitetit nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 30 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Pukë, të marrë masa për të bërë sistemet përkatëse në kontabilitet, saktësimet e gjendjeve të llogarive dhe rakordimet me Degën e Thesarit të jenë në bazë të shifrave reale, mbështetur në llogaritë analitike.

9.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Pasqyrat Financiare të vitit të deklaruar në thesar, përputhet me PF të Bashkisë Pukë.*

Zbatuar

9.2. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

9.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e Financës, nuk ka marrë asnjë masë për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë.*

Pa zbatuar

9.3. Rekomandimi: Nga Nëpunësi Autorizues të merren masa për nxjerrjen e Urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërat: 210 “*Toka, troje terrene*”; 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”; 212 “*Ndërtime e konstruksione*”; 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”. Në llogaritjen e vlerës së këtyre aktiveve të merret në konsideratë kryerja e vlerësimeve të mëpasshme të aktiveve afatgjata materiale dhe shpenzimet e kryera për mirëmbajtjen e tyre, të cilat nuk janë shtuar në vlerën historike të aktivitetit përkatës.

9.2.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Titullari i Institucionit, me urdhër nr. 336, datë 09.12.2022 ka ngritur urdhrin për “Ngritjen e grupeve të punës për kryerjen e inventarizimit fizik, vlerësimin dhe evidentimin e aktiveve.....”.*

Zbatuar

9.4. Rekomandimi: Nga Bashkia Pukë të merren masa për zhvillimin e korrespondencës së nevojshme me investitorin “*Fondi Shqiptar i Zhvillimit*” dhe me investitorë të tjerë nëse ka, me qëllim marrjen në dorëzim të objekteve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Pukë dhe me përfitues Bashkinë Pukë, si dhe në vijim të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin dhe kontabilizimin e këtyre objekteve në llogaritë përkatëse si Aktive Afatgjata Materiale të pa inventarizuara.

9.5 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Pukë, nuk janë marra masat e nevojshme për kontabilizimin e investimeve të kryera nga “Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.*

Pa zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në datën 31.12.2020, ka qenë në vlerën 11,346,594 lekë, ndërsa në datën 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie ka qenë 16,466,033 lekë ose me rritje në vlerën 5,119,439 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrime të bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme. Nga auditimi u konstatua se për objektet e përfunduara dhe të likuiduara plotësisht, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës, pavarësisht se nuk janë marrë të gjitha në dorëzim nga Bashkia Pukë, nuk është bërë zhblllokimi i garancisë dhe fondet vazhdojnë të jenë të ngurtësuara në degën e Thesarit. Nga Drejtoria e Financës dhe Urbanistikës, nuk janë marrë masa për zhblllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së garancisë sipas objekteve ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Spektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese në marrjen në dorëzim të objekteve sipas kontratave përkatëse, për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021, sipas Aneksit nr. 9 pika 2. Nga auditimi, u konstatua se megjithëse për disa objekte kanë përfunduar punimet, janë paraqitur situacionet përfundimtare, janë bërë likuidimet dhe janë kontabilizuar vlerat përkatëse sipas rastit, nga Bashkia Pukë nuk janë ngritur komisionet për ndjekjen e zbatimit të kontratave dhe marrjen përfundimtare në dorëzim të objekteve, duke bllokuar rrjedhimisht edhe kthimin e garancisë së punimeve për objektet e përfunduara.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, Kap II “Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të VKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2001 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publike” i ndryshuar pikat 42 – 50 të tij, UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kreu II, pikat 6 dhe 15-18, kreu III, pika 33, 36, Aneksi 1, pika 2, “Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël)”, “Aktive afatgjata materiale”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zhblllokimin e fondeve të ngurtësuara.

10.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas verifikimit të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, në këtë llogari gjenden 20 investime për të cilat ka kaluar afati i garancisë dhe titullari i institucionit, nuk ka marrë masa për ngritjen e grupeve të punës për marrjen në dorëzim të këtyre objekteve.*

Pa zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2021 janë lidhur dhe zbatuar 18 kontrata në vlerën totale 297,632,209 lekë për blerje aktivesh materiale dhe jo materiale, si mallra apo projekte investimesh, të financuara nga buxheti i Bashkisë, Qeveria dhe financime të huaja. Për këto kontrata për vitet 2019-2020 nuk është kryer kontabilizimi i veprimeve ekonomike as në momentin e çeljes së fondeve, as në momentin e mbërritjes së faturave. Efektet e veprimeve ekonomike dhe të ngjarjeve ekonomike të kryera, nuk janë marrë në llogari në kohën e kryerjes së veprimit apo të ndodhjes së ngjarjes, por thjesht kur është bërë pagesa. Nuk janë kryer veprimet kontabël në kohën e lindjes të detyrimit për t'u paguar nga njësia ekonomike, detyrime këto që sjellin shpenzime dhe pagesa për ushtrimin e dhënë. Po kështu nuk janë kryer veprimet përkatëse kontabël në lidhje me fondet buxhetore të përdorura për investime deri në momentin e kapitalizimit të aktivitetit. Deri në fund të vitit ushtrimor 2020 janë prekur llogaritë e aktiveve në vlerë pjesore për AQT e blera të cilat nuk janë kapitalizuar plotësisht, ku vlera e tyre e mbetur e pa likuiduar nuk është evidentuar në kontabilitet në llogarinë 476 “*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*”.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” Aneksi 1 “*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*”, Kreu I, “*Të përgjithshme*”, pika 8, Kreu II, “*Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pikat 15/a, b, c, 18/a, b dhe Kreu III, “*Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, pika 32, etj.

(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 61-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Me çeljen e fondeve/mbërritjen e shkresës së dërguar nga MFE për alokimin e fondit pjesor të vitit ushtrimor të detajuar sipas projekteve të investimeve, të kryhet veprimi kontabël për shumat përkatëse në debi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” dhe në kredi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*”.

Me konstatimin e shpenzimit, (mbërritja e faturës shoqëruar me situacion) të bëhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*”.

Në momentin e pagesave të faturave, të kryhet kontabilizimi për çdo pagesë në debi llogarisë 404 “*Furnitorë për investime*” dhe në kredi të llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*”.

Në fund të vitit ushtrimor, për fondet e përdorura për investimet e papërfunduara/në proces, të kryhet veprimi kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*”, në kredi të llogarisë 720 “*Grant korrent i brendshëm*” dhe në kredi të llogarisë 4342, “*Operacione me shtetin (të drejta)*” për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues.

Me përfundimin e investimit, të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimit total të vlerës së kontratës të bëhet kapitalizimi i aktivitetit (hyrje sipas llojit të AQT), për të cilat duhet prerë artikulli kontabël në debi të llogarisë 21 “*Aktive afatgjata materiale*” dhe në kredi të llogarisë 231 “*Investime për aktive afatgjata materiale*”.

Me kapitalizimin e aktivitetit, (për aktivitetin e marra në dorëzim), të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 476 “*Të ardhura të caktuara për t'u përdorur*”, në kredi llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për fondet buxhetore të përdorura për investime, në kredi të llogarisë 1011 “*Shtesa të fondit bazë*” dhe në debi të llogarisë 105 “*Grante të brendshme kapitale*” për vlerën e aktiveve të blera.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës, në bazë të rekomandimit të mësipërm, ka regjistruar në llogaritë përkatëse çeljen e fondeve për investime në llogarinë 520 “*Disponibilitete në thesar*”. Me kryerjen e shpenzimit, janë debituar dhe kredituar llogaritë

përkatëse. Nga verifikimi i llogarisë 231 “Investime për aktive afatgjata materiale”, shuma e regjistruar në këtë llogari përputhet me vlerën faktike të investimeve.

Zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik me fond limit 328,810,018 lekë ose 92% e fondit total të audituar në AK, Bashkia Pukë, nga ana e grupeve të hartimit të specifikimeve teknike dhe të përlllogaritjes së fondit limit, (të trajtuara në çdo procedurë prokurimi), janë hartuar kërkesa për kualifikim të cilat nga ana e NJHDT janë bërë pjesë e kritereve të veçanta për kualifikim për të cilat nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sa vijon: Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7; Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i DT”, pika 2, paragrafi 2.

Konkretisht kërkesat në lidhje me kategoritë e licencave, numri dhe profesioni i stafit drejtues teknik, numrin e punonjësve dhe kategoritë e punësimit, numrin dhe llojin e mjeteve etj., certifikatave ISO, nuk janë argumentuar me zbërthimin e preventivit dhe sipas grafikut të punimeve **në total në 2 raste në shumën 226,824,925 lekë**, ose në 68% të totalit të fondit limit të audituar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Pukë, të marrë masa që në procedurat e prokurimit publik të përcaktojë kërkesa kualifikuese në lidhje të ngushtë me natyrën dhe volumin e objektit të prokurimit.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas regjistrimit të realizimeve, për vitin 2022 janë kryer 3 procedura prokurimi me vlera të larta. Në dosjet e procedurave, kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar dhe dokumentuar nëpërmjet procesverbalit përkatës i cili është bërë pjesë e dosjes. Vlerësimi i kritereve dhe përputhja me objektin e prokurimit, do vlerësohet gjatë auditimit të radhës në këtë bashki.

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik me fond limit 332,810,018 lekë ose 92% e fondit total të audituar në AK Bashkia Pukë, rezultuan me paligjshmëri në shpalljen e operatorit ekonomik fitues, **në total në 5 raste në shumën 312,277,847 lekë**, ose në 86% të totalit të fondit limit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 78-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Pukë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomikë në kushtet e mosplotësimit të kritereve të miratuara në DST, pasi operatorët ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga AK, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit dhe pasi të analizojë procedurat me shkelje, të marrë masa ndaj personave përgjegjës shkaktarë të kësaj situatë dhe eliminimin e tyre në të ardhmen.

13.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga Kryetari i Bashkisë Pukë, nuk është marrë asnjë masë dhe nuk është nxjerrë asnjë përgjegjësi që lidhet me problematikat në vlerësimin e ofertave në procedurat e prokurimit, ku ka rezultuar paligjshmëri në shpalljen e OE fitues. Lidhur me procedurat e realizuara përgjatë vitit 2022, do jenë objekt verifikimi gjatë auditimit të radhës.

Në proces zbatimi

14. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i dokumentacionit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1111/6, datë 06.01.2022, konstatohet se:

a. Mbi zbatimin e *masave organizative* të rekomanduara nga KLSH, konstatohet se nga 12 masa organizative, janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 7 masa, 4 masa janë në proces zbatimi dhe 1 masë organizative nuk është zbatuar.

b. Mbi zbatimin e *masave shpërblim dëmi*, të rekomanduara nga KLSH, konstatohet se nga 1 masë me vlerë 2,300,000 lekë, nga ana e Bashkisë Pukë nuk janë ndjekur rrugët e ankimimit gjyqësor dhe vlera e mësipërme nuk është arkëtuar.

c. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, janë rekomanduara 5 masa, janë pranuar të gjitha dhe janë në proces zbatimi.

d. Janë rekomanduara 2 masa disiplinore, për znj. F. P. me detyrë drejtore e Financës dhe z. N. A. me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave.

Nga Bashkia Pukë është marrë në shqyrtim nga Komisioni i Disiplinës i ngritur me urdhër nr. 24 datë 28.01.2022 ku i është propozuar kryetarit të bashkisë mos marrja e masave disiplinore për këta punonjës. Kryetari i bashkisë me urdhrin nr. 05 datë 11.08.2022 ka vendosur mos marrjen e masës disiplinore për punonjësit e shërbimit civil znj. F. P. dhe z. N. A.. Për sa më sipër, masat disiplinore konsiderohen të ezauruara/zbatuara.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5., faqe 99-108 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Rikërkojmë që Kryetari i Bashkisë Pukë të hartojë menjëherë plan pune dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e Rekomandimeve të pazbatuara ose në proces zbatimi, të cilat janë lënë në auditimin e mëparshëm, më konkretisht 5 masat organizative, 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 2,300,000 lekë dhe 5 masa për eliminimin e efekteve negative.

14.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga verifikimi rezulton se rekomandimi për masat organizative, nga 1 masë e pa zbatuar, vijon i pa zbatuar (rekomandimi 6.1). Gjithashtu, për masa shpërblim dëmi është kërkuar likuidimi i detyrimit në vlerën 2,300,000 lekë për 2 subjekte karburanti për pajisjen me licencë, të cilat nuk janë zbatuar.*

Pa zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 6/1 prot., datë 21.07.2022, protokolluar në Kontrollin e Lartë të Shtetit me nr. 728, datë 25.07.2022, operatori ekonomik “B.” shpk ka paraqitur ankesë për mosshlyerjen e detyrimeve ndaj tij që ka Bashkia Pukë. Ky është një detyrim i trashëguar për shërbimin e kryer nga ky subjekt për pastrimin e qytetit deri në vitin 2011 ku më pas ky shërbim kryhet nga Bashkia Pukë.

Në vitin 2015 vetëm detyrimi ndaj kreditorit “B.” shpk, për tre vendime gjyqësore ka qenë në vlerën 15,269,039 lekë. Ndaj këtij subjekti janë likuiduar dy vendime gjyqësore dhe nga Bashkia Pukë vazhdon likuidimi për vendimin e tretë sipas një programi të përcaktuar pa miratimin e subjektit “B.”. Ndaj këtij kreditori është likuiduar shuma prej 11,642,822 lekë, duke ngelur deri tani pa likuiduar vetëm vlera prej 3,626,217 lekë. Vonesa dhe mos likuidimi i menjëhershëm i detyrimit të njohur me Vendim Gjykate të formës së prerë nga Bashkia Pukë, është në kundërshtim me pikën 107 të UMFE nr. 9 datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.

Subjekti “B.” shpk, duke mos qenë dakord me procedurën e ndjekur nga Bashkia Pukë, ka bërë objekt gjykimi njoftimin për detyrimin tatimor nr. 2434/1 prot., datë 31.10.2019, **për vlerën 3,383,475 lekë**, çështje e cila është rrëzuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, me vendimin nr. 294 (407) datë 26.04.2021. Kjo çështje është ankimuar nga subjekti “B.” shpk dhe ndodhet për shqyrtim në shkallë të dytë.

Subjekti “B.” shpk e ka fituar të drejtën e dëmshpërblimit me Vendim Gjykate të formës së prerë dhe rrjedhimisht i lind e drejta për të kërkuar sërish nëpërmjet Gjykatës interesat e munguara nga

bllokimi i pjesës së mbetur prej **3,626,217 lekë**, detyrime të cilat përsëri do të rëndojnë në buxhetin e Bashkisë Pukë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6., faqe 108-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Duke pasur parasysh që Bashkia Pukë ka fonde të papërdorura, të marrë të gjitha masat për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në adresë të kreditorit “B.” shpk, me numër NIPTI J., për likuidimin e pjesës së mbetur prej **3,626,217 lekë**, brenda buxhetit vjetor të vitit 2022 mbi sasinë e fondeve të mbetura ose të planifikohet të mbyllet jo më vonë se brenda tremujorit të parë të vitit 2023, në zbatim të pikës 107, të Udhëzimit të MFE nr. 9 datë 20.7.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

15.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës ka likuiduar për subjektin B. Shpk vlerën 1,400,000 lekë vlera e mbetur 2,226,217 lekë.

Në proces zbatimi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Të ardhura të munguara nga dhënia me qira e aseteve të bashkisë, si troje, toka bujqësore, pyje e kullota. Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Pukë, u konstatua se për vitin 2021 Bashkia Pukë ka lidhur 17 kontrata me subjekte juridike me afat nga 1–5 vjet, nga të cilat është pa likuiduar vlera totale prej **6,769,972 lekë**. Nga Bashkia Pukë nuk janë llogaritur kamatëvonesat për secilin rast, në kundërshtim me nenin 5 “Llogaritja e kamatëvonesës”, të ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”. Shuma e pa likuiduar ende nga subjektet debitore për kontratat e dhënies me qira të aseteve të Bashkisë Pukë prej **6,769,972 lekë përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e bashkisë. Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar; Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t’u lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,769,972 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga informacioni i marrë nga sektori i tatim taksave, rezultojnë 7 kontrata qiraje për fondin pyjor kullësor me vlerë detyrimi **6,769,972 lekë**. Sektori i taksave dhe sektori pyjor, nuk kanë marrë asnjë masë për ndërprerjen e kontratave dhe nuk kanë ndjekur rrugët administrative dhe ligjore për mbledhjen e këtij detyrimi.

Pa zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2021 është realizuar në shumën **584,101** lekë nga **1,045,000** lekë të planifikuara ose në masën **56%**. Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë Pukë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, u auditua korrespondenca shkresore e Bashkisë Pukë me SHK-në, Drejtoria Shkodër dhe të dhënat për lejet e legalizimit të përfituara nga individë dhe subjekte private, të disponueshme në Bashkinë Pukë. Nga auditimi, u konstatua se për vitin **2021**, janë dhënë 10 leje legalizimi për **1.850** m² ndërtim me vlerë investimi prej 60,809,500 lekë *taksa e ndikimit në infrastrukturë (0.5%) në vlerën 304,096 lekë*. Numri i lejeve të legalizimit, sipërfaqja dhe vlera e TNI është paraqitur në Aneksin A14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Të dhënat për arkëtimet dhe Debitorët nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2021 janë paraqitur në Aneksin A15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Shuma e palikujduar për vitin 2021 **prej 48,204 lekë**, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë. Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike janë evidentuar disa shkaqe për mos realizimin e pagesës të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe konkretisht ky mosrealizim vjen për shkak se, poseduesit e pasurive të legalizuara nuk kanë paraqitur interes për plotësimin me dokumentacion final (pajisjen me certifikatë pronësie) pasi janë larguar dhe për rrjedhojë nuk kanë shlyer taksën e ndikimit në infrastrukturë. Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. Gj. Gj., me detyrë Kryetar i Bashkisë Pukë dhe z. N. A., me detyrë Përgjegjës i sektorit të tatim-taksave vendore. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKB Pukë “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Pukë”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Pukë. Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe administrimit të territorit, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në Aneksin A15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, bazuar në legjislacionin tatimor.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas informacionit nga sektori i tatim taksave kemi vlerën 230,714 për 9 persona. Ky sektor nuk ka bërë kërkesë pranë ASHK-së për vendosje urdhër bllokimi në kartelat e pronave të personave debitorë për taksën e legalizimit.*

Në proces zbatimi

3. Gjetje nga auditimi: Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit (zyrat e tatim-taksave) në Bashkinë Pukë, rezultoi se ka **78** subjekte debitore nga biznesi. Numri i debitorëve nga biznesi në numër dhe në vlerë (për taksën e ndërtesës, tabelës, hotelit, truallit, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjellbërim-ndriçim e kamatëvonesat përkatëse), krahasuar nga viti në vit ka ardhur duke u ulur shumë pak, kështu në fund të vitit 2020 për 90 subjekte paraqitej në shumën 14,909,764 lekë ndërsa për vitin 2021 numri i debitorëve është **78** subjekte në vlerën prej **14,269,555** lekë. Vlera progresive në fund të vitit 2021 është **14,269,555** lekë, e cila përfaqëson taksat dhe tarifave vendore të papaguara, duke shkaktuar borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Pukë. Këto veprime janë jo në përputhje me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes

vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSh” me ndryshime neni 181, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj **78 subjekteve** debitore në vlerën prej **14,269,555 lekë** (sipas Anekseve bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit), duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Pukë, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: Sipas informacionit të përcjellë nga sektori i tatim taksave për vitin 2022 rezulton se taksat për biznesin e vogël rezulton në vlerën 4,349,128 lekë në numër 81 subjekte dhe biznesi i madh në vlerën 8,838,832 lekë dhe në numër 9 subjekte. Për vitin 2022 nuk kemi pagesa për bizneset debitorë për vitet e mëparshme.

Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave dhe dokumentacionit mbi të ardhurat u konstatua se: -Për vitin 2021 nuk kanë paguar 936 familje, për një vlerë totale prej 293,643 lekë. Kjo shumë vjen nga diferenca e familjeve që nuk paguajnë me familjet e përjashtuara me VKB nga pagesa e detyrimeve, nga mosarkëtimi i taksave të familjarëve nëpërmjet agjentit tatimor Ujësjetllës Kanalizime Puka Sh.A. Shuma prej **293,643 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Pukë.

Nga auditimi, u konstatua se me ligjin 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej 5,413 familje për të cilat është planifikuar pagesa e taksës së tokës por nuk është arkëtuar, nuk është faturuar dhe taksapaguesve nuk u është dërguar njoftim për pagesën e detyrimit. Për periudhën objekt auditimi detyrimi i mbetur nga vitet e mëparshme për Njësinë Qendrore paraqitet në shumën **40,417 lekë** dhe njësitë vartëse në shumën **2,706,000 lekë**. Duke mbledhur në mënyrë progresive, shuma e detyrimit të pa arkëtuar nga taksat e tokës rezulton të jetë në vlerën **2,746,417 lekë** e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Pukë për të cilat nuk janë marrë masat e duhura nga drejtimi për vjeljen dhe arkëtimin e tyre. Këto veprime janë jo në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat

Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “*Për Taksat Kombëtare*”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 41-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Pukë dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **2,746,417 lekë** dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

4.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga sektori i tatim taksave Bashkia Pukë është marrë masa për hartimin e regjistrit të tokës bujqësore. Vlera debitorë për këtë taksë është në rritje për vitin 2022. Nuk ka pasur pagesa për debitorë të viteve të mëparshme.*

Në proces zbatimi

4.2. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerave debitorë. Gjithashtu Bashkia Pukë të bashkëpunojë me “*Ujësjetës Kanalizime Puka*” Sh.A. për arkëtimin e vlerës debitorë prej **293,643 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

4.1.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga sektori i tatim taksave Bashkia Pukë janë bërë njoftim detyrimet për detyrimet për taksat e bashkisë. Vlera debitorë është në rritje dhe nuk ka patur arkëtime për debitorët e viteve të mëparshme.*

Në proces zbatimi

4.3. Rekomandimi: Bashkia Pukë, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mbliidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Pukë, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

4.1.4 Nga verifikimi rezultoi se: *Sektori i taksave Bashkia Pukë mban korrespondencë mujore me agjentet tatimor në formë elektronike. Nga agjentët tatimorë, ju përcillen pagesat mujore dhe lista e debitorëve.*

Zbatuar

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, nenin 58 “*Llojet e masave disiplinore*”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin*

civil”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pukë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. **Znj. F. P.**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm dhe Nëpunës Zbatues, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm, në lidhje me kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, në lidhje me Menaxhimin financiar dhe Kontrollin, si dhe për mangësitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm;
2. **Z. B. A.**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të emergjencave civile, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në disa procedura;
3. **Z. N. A.**, me detyrë Përgjegjës i zyrës së tatim-taksave, për problemet e konstatuara në lidhje me mbledhjen e të ardhurave dhe menaxhimin e pronës publike, si dhe për mangësitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm;
4. **Znj. E. P.**, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së menaxhimit të burimeve njerëzore, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm, si dhe për mangësitë e konstatuara në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm;
5. **Z. E. K.**, me detyrë Përgjegjës i sektorit të prokurimeve publike dhe ai juridik, për problemet e konstatuara në lidhje me menaxhimin financiar dhe auditin e brendshëm;

D.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në nenin 15 “*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “*Masa Disiplinore*”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Pukë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

1. **Z. K. M.**, me detyrë Nënkyetar i Bashkisë, për problemet e konstatuara në lidhje me Menaxhimin financiar dhe Kontrollin, si dhe për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në disa procedura;
2. **Znj. B. A.**, me detyrë Sekretare e Këshillit Bashkiak, për kualifikimin e Operatorëve Ekonomikë në mospërputhje me kërkesat e vendosura në DST, në disa procedura;

Nga verifikimi rezultoi se: *Me urdhër nr. 146, datë 12.05.2023 “Për ngritjen e komisionit disiplinor për nëpunësit pjesë e shërbimit civil” është ngritur komisioni i përbërë nga 5 punonjës. Ky komision, me vendimin nr. 13, datë 15.05.2023, ka vendosur për masat disiplinore që janë lënë sipas rekomandimit të KLSH, duke vendosur për secilin nga punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil të mos merret asnjë masë ndaj punonjësve të mësipërm. Nuk disponohej asnjë procesverbal i mbajtur nga komisioni, në të cilën të pasqyrohej ecuria e ndjekur për evidentimin*

e shkeljeve të evidentuara nga KLSH, dhe marrja e masës përkatëse për këta punonjës. Formalisht, nga ana e titullarit është zbatuar ky rekomandim.

-Për 2 punonjësit që rregullojnë marrëdhënien e punës me Kod Pune, nuk janë marrë masa pasi këta punonjës janë larguar nga puna.

Zbatuar

Zbatimi i rekomandimeve në Bashkinë Shkodër, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	21	21	7	3	4	7
Masa për 3E	6	6	2	-	3	1
Masa Disiplinore	7	7	7	-	-	-

IV- KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Pukë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajojmë përsheptimin e realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, ndërsa për rekomandimet e pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Rekomandimi 1.1: Kryetari i Bashkisë Pukë dhe menaxherët kryesorë të marrin masa për implementimin konkret të kërkesave të kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësinë vendore. Për këtë më parë të kryhen trajnime për njohjen e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe kërkesat e “Manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Të hartohen rregulla për ruajtjen e aktiveve, për llojet e raporteve, frekuencën e raportimit me shkrim të Titullari nga secila drejtori/sector, etj. Të hartohet regjistri i riskut në nivel sektori, drejtorie dhe institucioni, gjurma e auditimit dhe lista (harta) e proceseve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Rekomandimi 2.2: Nga menaxhimi i lartë i Bashkisë Pukë, në koordinim me Drejtorinë e përgjithshme të harmonizimit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe Drejtorinë e harmonizimit të auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të shikohen mundësitë për lidhjen e një marrëveshjeje me strukturën e auditimit të brendshëm të njëres nga bashkitë e afërta, duke përdorur edhe praktikatat e ngjashme nga bashki të tjera.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi 4.1: Bashkia Pukë, të marrë masa që në të ardhmen, të parashikojë shpenzimet për emergjencat civile në nivelin e duhur, me qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe sigurimin e mbrojtjes civile për komunitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Rekomandimi 6.1: Bashkia Pukë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat

të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program dhe radhës së faturave, si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.Rekomandimi 6.2: Bashkia Pukë, drejtoria ekonomike, të marrë masa dhe të paraqesë në mbledhjen më të afërt të këshillit bashkiak, një material për gjendjen e faturave dhe detyrimeve për vendimet gjyqësore të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për vlerën **47,418 mijë lekë**, nga faturat e papaguara dhe për vlerën **7,776 mijë lekë** nga vendimet gjyqësore (në datën 31.12.2021) si dhe të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim të plotë në kontabilitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Rekomandimi 6.3: Bashkia Pukë, të marrë masa që të ardhurat e papërdorura në fund të vitit, të mos i mbartë në vitin pasardhës, por t'i përdorë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, kontraktuale dhe gjyqësore, sipas radhës kronologjike të krijimit të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.Rekomandimi 9.2: Nga Nëpunësi Zbatues të merren masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpashme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Rekomandimi 9.4: Nga Bashkia Pukë të merren masa për zhvillimin e korrespondencës së nevojshme me investitorin “*Fondi Shqiptar i Zhvillimit*” dhe me investitorë të tjerë nëse ka, me qëllim marrjen në dorëzim të objekteve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Pukë dhe me përfitues Bashkinë Pukë, si dhe në vijim të kryejnë të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin dhe kontabilizimin e këtyre objekteve në llogaritë përkatëse si Aktive Afatgjata Materiale të pa inventarizuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.Rekomandimi 10.1: Kryetari i Bashkisë Pukë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues të marrë masa për ngritjen në kohë të komisioneve me specialistë të fushës për marrjen në dorëzim të objekteve të përfunduara dhe të mos lejojë likuidimin e situacionit përfundimtar, pa verifikuar cilësinë e punimeve në çdo objekt sipas projekt/preventivit të miratuar nga AK. Pas përfundimit të këtyre veprimeve, në rastet ku nuk konstatohen probleme, të vijohet me zbllokimin e fondeve të ngurtësuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

10.Rekomandimi 14.1: Rikërkojmë që Kryetari i Bashkisë Pukë të hartojë menjëherë plan pune dhe të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e Rekomandimeve të pazbatuara ose në proces zbatimi, të cilat janë lënë në auditimin e mëparshëm, më konkretisht 1 masat organizative dhe 1 mase shpërblim dëmi në vlerën 2,300,000 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1.Rekomandimi 1.1: Bashkia Pukë të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **6,769,972 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

D.1.Nga Kryetari i Bashkisë Pukë **kërkojmë** analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve sipas Planit të Miratuar.

Për sa më lart, kërkojmë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditivi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport për Auditimin Tematik të ushtruar në Bashkinë Malësi e Madhe: “Pë
verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të
evaduar për periudhën 01.07.2022 deri 31.01.2023”.**

RAPORTI I AUDITIMIT TEMATIK

**“PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMIN E MËPARSHËM TË EVADUAR PËR PERIU DHËN
01.07.2022 DERI 31.01.2023, BASHKIA MALËSI E MADHE”.**

Tiranë, 2023

Nr.	PËRMBAJTJA	FAQJA
I.	Përmbledhje.....	2-3
	/1. Hyrje.....	3
	/2. Objektivat e auditimit.....	3
	/3. Qëllimi i auditimit.....	3
	/4. Metodologjia auditimit.....	3
	/5. Konkluzione.....	3-4
II.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	4
III.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	4-25
	Drejtimet e auditimit.....	4
	A.Masa B.Organizative.....	4-15
	C1.Masa Shpërblim Dëmi.....	15-17
	C2.Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike.....	17-22
	C3.Të ardhura të munguara.....	22-23
	D.Masa Disiplinore.....	23
	E.Masa Administrative.....	23-25
IV	Konkluzione dhe Rekomandime.....	25-26

I. PËRMBLEDHJE:

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 627/5 port., datë 07.07.2023 “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar për periudhën 01.07.2022 – 31.01.2023”, në ambientet e Bashkisë Malësi e Madhe, më datë 20.07.2023 u mbajt akt verifikimi nga audituesit e autorizuar të KLSH-së Z. Sh. H., z. K. H. dhe Z. L. B., në prezencë të përfaqësuesve të Institucionit të audituar. Me shkresën nr. 627/6 prot., datë 04.08.2023 është dërguar Projekt Raporti i Auditimit subjektit Bashkia Malësi e Madhe.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

- KLSH ka dërguar në Bashkinë Malësi e Madhe rekomandimet e auditimi me shkresën e saj nr. 263/8 prot., datë 27.07.2022, ndërsa nga Bashkia Malësi e Madhe është kthyer përgjigje me shkresën nr. 675/33 prot., datë 17.08.2022 **brenda afatit 20 ditore**, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- Në lidhje me zbatimin e afatit **6 muajor** nga momenti i dërgimit të shkresës menr. 263/8 prot., datë 27.07.2022 për zbatimin e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, për të cilën duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 27.01.2023. Nga ana e Bashkisë Malësi e Madhe nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pikës 2 e nenit neni 30-Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit.

Sipas llojit paraqiten si më poshtë vijon:

Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 22 **masa organizative**, nga të cilat janë pranuar plotësisht 22 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, janë në proces zbatimi 4 masa organizative, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 8 masa nuk janë zbatuar.

Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa në vlerën 471,113 lekë, nga të cilat janë realizuar 2 masa në vlerën 323,612 lekë, dhe është në proces zbatimi 1 masë për 3 subjekte në vlerën në vlerën 147,501 lekë.

Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, janë rekomanduar 11 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 11 masa, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 6 masa, janë zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 2 masa nuk janë zbatuar.

Masa për të ardhurat e munguara, janë rekomanduar 2 masa, nga të cilat janë pranuar plotësisht 2 masa, 1 masë është në proces zbatimi dhe 1 masë është pa zbatuar.

Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe dhënia e masës disiplinore ndaj 5 personave, të cilat janë zbatuar duke u dhënë masa vërejtje për 5 persona.

Masa administrative, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe t'i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara për 7 persona, nga të cilat rezulton se Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe ka marrë masa për dhënie mase disiplinore ndaj tyre.

I/1. Hyrja:

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me datë 27.07.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” të ushtruar në Bashkinë Malësi e Madhe, sipas programit të auditimit nr. 370 prot., datë 19.04.2022, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, afatet dhe nivelin e zbatueshmërisë, koherencën, si dhe përgjegjshmërinë menaxheriale, referuar standardeve të auditimit.

Auditimi u krye nga:

1. Sh. H., *përgjegjës i grupit;*
2. K. H., anëtar,
3. L. B., anëtar

I/2. Objekti auditimit:

Zbatimin i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën nr. 263/8 prot., datë 27.07.2022, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. Qëllimi auditimit:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. Metodologjia e auditimit:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që kanë lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. Konkluzioni:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Bashkia Malësi e Madhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr. 328/7 prot, datë 09.03.2021, rezulton se nga **50** masa të rekomanduara (*organizative, shpërblim dëmi, 3-E,*

mungesë të ardhurash dhe disiplinore), janë pranuar nga subjekti në masën 100%. Nga të pranuarat janë zbatuar dhe në proces zbatimi, gjithsej **37** masa ose 74% e masave të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar **13** masa ose 26% e masave të rekomanduara. Nga zbatimi i masave, rezulton se pjesa më e madhe e aty që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi, janë masat organizative dhe ato disiplinore që përbëjnë 73% të tyre.

II. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve:

Niveli i realizimit të rekomandimeve është mbi 70%, nga masat e marra, Bashkia Malësi e Madhe ka mundur edhe arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 323,612 lekë nga 2 subjekte, si dhe ka marrë masa disiplinore për 12 punonjës.

DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

1. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Malësi e Madhe rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 263/8 prot., datë 27.07.2022, ndërsa nga Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 675/33 prot., datë 17.08.2022 brenda afatit 20 ditor.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Malësi e Madhe është ngritur grupi i punës, është miratuar plan veprimi dhe personat përgjegjës të ngarkuar për ndjekjen e zbatimit.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

2. Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Malësi e Madhe rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 263/8 prot., datë 27.07.2022, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 27.01.2023 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA), por nuk është raportuar brenda kësaj date në KLSH.

Pa zbatuar

3. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë zbatuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Malësi e Madhe 22 masa organizative, të cilat janë pranuar prej tyre, janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 4 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 8 masa organizative nuk janë zbatuar. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA të hartuar gjatë periudhës 2020-2021, u konstatua se:

-Për PBA 2020-2022 dhe PBA 2021-2023 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Malësi e Madhe.

-Për PBA 2020-2022 dhe buxhetin e vitit 2020 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimin vjetor për përgatitjen e buxhetit.

-Buxheti vjetor i vitit 2020 dhe vitit 2021, nuk është miratuar brenda datës 25 Dhjetor.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” të nenit 5, pika 1 e nenit 35, pika 2 e nenit 39 dhe pika 3 e nenit 41, në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e Financës, të marrë masat e nevojshme që për çdo vit buxhetor të kryen konsultime me grupet e interesit gjatë hartimit dhe miratimit të projekt-buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, si dhe miratimin e buxhetit vjetor në Këshillin Bashkiak brenda afatit ligjor.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e buxhetit Bashkia Malësi e Madhe ka marrë masat e nevojshme për konsultimet për PBA dhe buxhetin e vitit si më poshtë.

-Shkrese Nr. 2801 prot., datë 01.09.2021 “njoftim për dëgjuesë publike”

-Shkrese Nr. 280/prot., datë 05.11.2021 “njoftim për dëgjuesë publike”

-Shkrese Nr. 2977 prot., datë 10.10.2022 “njoftim për dëgjuesë publike”

- Procesverbal Nr.2977/1 prot., datë 24.10.2022 me tematikë konsultim publik për projekt-buxhetin 2023.

- Procesverbal Nr.3160/1 prot., datë 31.10.2022 me tematikë konsultim publik për projekt-buxhetin 2023.

-Shkrese Nr. 3236 prot., datë 01.11.2022 “njoftim për dëgjuesë publike”.

- Procesverbal Nr.3236/1., prot datë 03.11.2022 me tematikë konsultim publik për projekt-buxhetin 2023.

-Shkrese Nr. 3324 prot., datë 09.11.2022 “njoftim për dëgjuesë publike”.

- Procesverbal Nr.3324/1 prot., datë 14.11.2022 me tematikë konsultim publik për projekt-buxhetin 2023.

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i planifikimit të procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli, konstatohet se realizimi i investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele të ulta në vitin 2021, konkretisht në masën 82%. Kjo situatë është krijuar si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Malësi e Madhe në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe nenin 47 në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Malësi e Madhe, nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë me vendim të këshillit bashkiak, duhet të korrigojë edhe plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Parashikimi i të ardhurave është bazuar në informacion që dërgon çdo drejtori apo sektor. Parashikimi bazohet në të dhënat sipas regjistrave të familjeve bizneseve,

institucioneve, kontratave të qirave, listës së karburanteve që operojnë në Bashkinë Malësi e Madhe dhe listës së debitorëve.

Sipas informacionit të përcjellë nga drejtoria e taksave planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 ka qenë 106,503,300 lekë dhe është realizuar në shumën 80,672,443 lekë.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Përgjatë periudhës 2020-2021 konstatohet se në 9 raste Bashkia Malësi e Madhe ka ndërmarrë angazhime të reja buxhetore pas datës 15 tetor, me vlerë totale 57,511,958 lekë, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale me operator ekonomik, për kryerjen e punimeve publike të ndryshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në neni 51 në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe Drejtoria e Financës dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas regjistrit të prokurimeve të Bashkisë Malësi e Madhe ka marrë angazhime buxhetore për 2 projekte pas datës 15 tetor 2022 organizim eventit “Zana e Maleve” me fond limit 1,146,658 lekë dhe shërbim i eventit përmbyllës të projektit “Përmirësimi i ofertës turistike dhe rritja e sezonalitetit në fshatrat Lepushë dhe Vermosh” me fond limit 1,716,667 lekë.*

Pa zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacion shoqëruar në Degën e Thesarit Malësi e Madhe, u konstatua se për periudhën 2020-2021 ky afat nuk është respektuar në 144 raste për vlerën 768,521,299 lekë. Në fund të vitit 2020 detyrimet e Bashkisë Malësi e Madhe ndaj palëve të treta të krijuara gjatë vitit 2020, si rrjedhojë e mos likuidimit të detyrimeve, janë gjithsej 43 fatura për shpenzime për mallra, shërbime dhe investime në vlerën 223,903,557 lekë. Në fund të vitit 2021 detyrimi progresiv deri më datë 31.12.2021 është në vlerën 322,781,244 lekë, nga të cilat krijuar brenda vitit 2021 gjithsej 30 fatura në vlerën 298,918,423 lekë. Gjithashtu sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, u konstatua se, në 6 raste nuk është respektuar radha e likuidimit të tyre, pra detyrimi i parë likuidohet më parë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues, të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, duke paraqitur pranë degës së thesarit, të gjithë dokumentacionin përkatës brenda afatit 30 ditor nga momenti i prerjes së faturës.

-Planifikimin e grafikut të likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke patur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

4.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga grupi i auditimit janë përzgjedhur katër kontrata të cilat janë lidhur në 2022 për të verifikuar në qoftë se është respektuar afati 30 ditor për likuidimin e faturave si më poshtë.*

I-Blerje Autovinç me kosh është respektuar afati fatura elektronike ka ardhur në datë 24.10.2022 dhe urdhër shpenzimi i përket datës 09.11.2022.

2-Sistemim asfaltim rruga Kçar i poshtëm viti 2023 nuk është respektuar afati fatura elektronike së bashku me situacioni janë lëshuar në datën 31.10.2022 dhe urdhër shpenzimet janë në datën 04.11.2022 dhe në datën 19.01.2023.

3-Sistemim asfaltim rruga e re Ndrecaj Bajzë viti 2023 është respektuar afati për pagesën e faturave.

4-Blerje kancelarie nuk është respektuar afati fatura është lëshuar në datë 29.09.2022 dhe urdhër shpenzimi i përket datës 15.12.2022.

Nga informacioni i marrë nga drejtoria e financës ky rekomandim nuk mund të zbatohet për projektet për investime të cilat janë parashikuar për disa periudha buxhetore dhe fatura nga firma e kontraktuar lëshohet në total sipas investimit të kryer.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm” të pasqyrave financiare të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson të drejtat e Bashkisë Malësi e Madhe për arkëtim ndaj të tretëve, është kontabilizuar më pak, për vlerën 8,453,754 lekë, duke mos përfshirë në mënyrë të plotë këto të drejta, si vijon:

-Gjobat e vendosura nga IMTV përgjatë periudhës 2019-2021 në vlerën 2,640,000 lekë;

-Kamatë-vonesat për kategorinë “biznes” në vlerën 5,813,754 lekë.

Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12, Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, pika 1, neni 11, udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 60-68, të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe sipas verifikimit të bilancit 2022 në llogarinë gjobat e IMTV e vendosura janë regjistruar në llogarinë 468 në vlerën 1,650,000 lekë dhe nuk janë regjistruar kamatëvonesat për këto gjoba ndërsa kamatëvonesat për kategorinë biznes nuk janë regjistruar kamatëvonesat. Nuk është zbatuar rekomandimi i mësipërm për të regjistruar në llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë” kundërpartia e 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Zbatuar pjesërisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje” të pasqyrave financiare të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2021, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë, për vlerën 29,545,685 lekë. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 60-68, të Raportit të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën

ruajtje”, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: Nga drejtoria e financës u morr informacion për listën e garancive (5%) që gjenden akoma të regjistruara në llogarinë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” nga tabela e më poshtme rezulton se vlera e mbetur në llogarinë 466 për të cilën ka mbaruar afati i garancisë dhe gjenden akoma në llogari është në vlerën 8,156,388 lekë.

Garancite e Objekteve viti 2021		
Nr.	Pershkrimi	Vlera
1	Derdhur gabim te viteve te meparshme-2009 Komuna Shkrel	165,178
2	5%garanci Qendra shendetsore 2015 Vermosh-Komuna Kelmend	28,674
3	5%garanci rruga Muriq-Vukel-2014 Komuna Kelmend	75,037
4	5%garanci rik.asfaltim rruga Shkrel-Dedaj 2010 -Komuna Shkrel	645,456
5	5%garanci rehabilitim Rrugesh 2013 Komuna Shkrel	49,767
6	5%garanci rik.asf.rruga Sterkuje-Dedaj 2010 - Komuna Shkrel	985,767
7	5%garanci punime pastrimi 2014- Komuna Shkrel	99,300
8	5%garanci rikonstruksion ura Makaj 2014 - Komuna Shkrel	148,447
9	5%garanci rikonstruksion rruges 2014 Komuna Shkrel	122,577
10	5%garanci rikonstruksion trotuaresh 2014 Komuna Shkrel	148,782
11	5%garanci rikonstruksion rrugesh-2015 Komuna Shkrel	66,596
12	5%pajisje Qend.Kulturore-Dedaj 2014 Komuna Shkrel	83,580
13	5%garanci Rik.Rruga Gruemire faza 4 -2014 Komuna Gruemire	64,492
14	5%garanci rikonstruksion ujesjellesa 2014 Komuna Kelmend	32,508
15	Komuna Shkrel-Ministria e Shendetsise-Rikonstruksioni i Q.SH.+ 5 %	196,376
16	Komuna Shkrel-Ministria e Shendetsise-Ndertimi A2 fsh.Lohe e Siper	49,755
17	Komuna Shkrel-Ministria e Shendetsise-Ndertimi A1+ catia fsh.R- 5 %	278,657
18	Sist. Asf. Rruga Ura e Zhajes	2,198,134
19	Rruga Gjorm	5,000
20	Rik. i Sheshit ne Gruemire	150,000
21	Ujesjelles Pedonale	350,000
22	Miermbajtje Objekte	293,776
23	Miermbajtje Rrugesh 2015	294,386
24	Instalim Tabela Elektronike	467,483
25	Ndertim Lera	239,294
26	Skema ujitjes kanale sekondare	247,207
27	detyrime vite meparshme siper marrje punumesh	139,854
28	detyrime vite meparshme siper marrje punumesh	155,600
29	Derdhur gabim, te vitit ne vazhdim	229,231
30	detyrim derdhur gabim te viteve te meparshme(Komua Shkrel)	145,474
	Total	8,156,388

Në proces zbatimi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 202 “Studime dhe kërkime” të pasqyrave financiare të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2021, u konstatua se nuk është kryer amortizimi i llogarisë nr.202 “Studime dhe kërkime”, në vlerën 1,224,890 lekë (kosto historike + shtesa – pakësime * 15%) sipas normës 15% për aktivet afatgjata jomateriale. Veprime dhe mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 36 “Për aktivet afatgjata jo materiale, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%” në udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 60-68, të Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 1,224,890 lekë.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe sipas verifikimit të bilancit 2022 nuk ka kryer amortizimin sipas rekomandimit të mësipërm.

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” të pasqyrave financiare të Bashkisë Malësi e Madhe për vitin 2021, u konstatua se në këtë llogari nuk është bërë kontabilizimi i aksioneve që zotëron Bashkia Malësi e Madhe në “Ujësjetellës Kanalizime Malësi e Madhe SHA, me NUIS “K48420718C”, me vlerë 171,273,725 lekë. Veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 60-68, të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Bashkia Malësi e Madhe mbështetur dhe në zbatim të VKM 302 dt 12.05.2022 “Politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” është krijuar Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A në të cilën Bashkia Malësi e Madhe ka aksione 6.39% te kapitalit. Ujësjetellës Kanalizime Malësi e Madhe sipas VKM 302 do të transferohet tek shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Qarku Shkodër SH.A. Rekomandimi i mësipërm nuk mund të zbatohet.*

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.04.2020-31.12.2021 për punë publike dhe mallra, u konstatua se në 10 raste në dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK, nuk është argumentuar ligjërisht dhe teknikisht vendosja e kriterëve për kualifikim (si kërkesa për certifikatat e standardizimit, numrin e punonjësve, të makinerive, kategorive të licencave të zbatimit të punimeve etj), si dhe nuk janë përcaktuar dokumente konkrete për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve nga operatorët ekonomik. Gjithashtu kriteret e vendosura nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, ku sipas rasteve të caktuara janë vendosur kriterë kualifikimi për palë të treta dhe jo për ofertuesit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 46, pika 3 në Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Pikën 5 në nenin 26, pikat 1, 3, 5 në nenin 27, pikën 2 në nenin 61 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Pikat 2, 3 dhe 4 në nenin 40, pikat 1, 3 dhe 4 në nenin 44, si dhe pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

9.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Malësi e Madhe të marrë masat e nevojshme që kriteret e veçanta për kualifikim në DST të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

9.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Njësia e Prokurimit në Bashkinë Malësi e Madhe, u testuan dokumentet fizike të 3 procedurave. Rezulton se kriteret e veçanta të kualifikimit, formalisht janë argumentuar me procesverbalet përkatëse. Mjetet, makineritë dhe fuqia punëtore është përllëgëritur nga specialisti i fushës, inxhinier ndërtimi punonjës i bashkisë. Lidhur me përputhjen e këtyre kriterëve, vlerësimi i tyre do bëhet gjatë auditimit të radhës.*

Zbatuar

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.04.2020-31.12.2021, u konstatua se në 10 raste OE janë shpallur fitues në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, si dhe nga

KVO nuk është bërë anulimi i procedurës së prokurimit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “ç” në pikën 1 në nenin 24, pika 1 në nenin 46 dhe pika 3 në nenin 53 në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Nenin 98 në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 23.05.2021 “Për miratimin e RPP” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe për shkeljet e konstatuara nga grupi i auditimit të KLSH, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, me qëllim përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, si dhe rritjen e besueshmërisë dhe integritetin e institucionit në vlerësimin dhe përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike.

10.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Lidhur me mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave dhe kualifikimin e padrejtë të OE, Titullari i AK ka marrë masat përkatëse disiplinore ndaj punonjësve, të evidentuara tek Masat Disiplinore dhe Masat Administrative të këtij akti.*

Zbatuar

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.04.2020-31.12.2021, u konstatua se në 10 raste, dokumentacioni i OE shpallur fitues nuk është administruar plotësisht nga personi përgjegjës në njësinë e prokurimit. Konkretisht është konstatuar se nuk administrohet deklarata e konfliktit të interesit e nënshkruar nga anëtarët e NJP, si dhe në 2 raste nga 10 gjithsej, në tenderat “Sistemim asfaltim rruge në Pjetrosan – Lagjia Lashaj” dhe “Sistemim asfaltim rruge në Smajlaj-Gruemirë” është konstatuar se dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues para lidhjes së kontratës, ka mangësi në formë dhe përmbajtje, kusht për refuzimin e lidhjes së kontratës. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “g” të pikës 2 të nenit 105, nenin 135 të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar; Pika 2 në nenin 14 dhe nenin 56 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe pikën 1 në udhëzimin nr.3, datë 24.10.2016 të APP “Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtarët e Prokurimit”; Pikën 3 në udhëzimin Nr.6291, datë 17.8.2005 “Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

11.1. Rekomandimi: Njësia e Prokurimit Bashkia Malësi e Madhe të marrë masat e nevojshme për administrimin e plotë të dokumentacionit të procedurës së prokurimit, konkretisht të nënshkrimit të deklaratës së konfliktit të interesit nga anëtarët e NJP, si dhe në rastet e marrjes në dorëzim të dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues para lidhjes së kontratës, të bëhet verifikimi i formës dhe përmbajtjes së tij.

11.2 Nga verifikimi rezultoi se: *U testuan 3 praktika dosje fizike prokurimi, nga të cilat rezultoi se janë nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit nga anëtarët e NjP. Lidhur me dokumentacionin e OE, janë çështje që do vlerësohen gjatë auditimit të radhës në Bashkinë Malësi e Madhe.*

Zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të zhvilluara përgjatë periudhës 01.04.2020-31.12.2021, u konstatua se në:

-15 raste në dosjen e prokurimit nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

-8 raste nuk dokumentohet përlllogaritja e fondit limit;

- 13 raste dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit përcaktuar në ftesën për ofertë, si dhe një 1 rast nga OE shpallur fitues nuk është dorëzuar asnjë dokumentacion;
- 5 raste rezulton se OE shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret fituese të kërkuara nga AK;
- 5 raste rezulton se nga dokumentacioni i dorëzuar nga OE shpallur fitues, përmban mangësi në formë dhe përmbajtje;
- 5 raste rezulton se AK ka vendosur kriteret fituese të cilat nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit duke kufizuar konkurrencën, kryesisht për bizneset e vogla;
- 10 raste rezulton se në ftesën për ofertë nuk është specifikuar grafiku i lëvrimin të mallit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 1, nenin 26, nenin 40, shkronja “a” në pikën 3 në nenin 45, pika 3 në nenin 46 në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; Pikën 4 në nenin 26, pikën 3 në nenin 27, pikën 5 në nenin 40, nenin 56, pikën 3 në nenin 57, pikën 2 në nenin 75 në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Mbi miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Pikat 7 dhe 16 në udhëzimin nr. 3 datë 08.01.2018 të APP “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

12.1. Rekomandimi: Komisioni i blerjeve të vogla Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme, për të dokumentuar çdo fazë të procedurës së prokurimit, nga përllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve. Gjithashtu në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla.

12.2 Nga verifikimi rezultoi se: *U testuan 3 praktika, të cilat nga ana formale dispononin dokumentacionin e kërkuar për blerjet e vogla. Praktika e plotë e dosjes administrohet nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Çështjet tjera që lidhen me kriteret dhe vlerësimin e ofertave, do verifikohen auditimin e radhës.*

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Urbanistikës Bashkia Malësi e Madhe, u konstatua se:

- Në 4 raste është miratuar leja e ndërtimit pa marrë mendimin dhe/ose konfirmimin nga institucionet përkatëse, si: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoritetit Rrugor Shqiptar, Agjencisë së Zhvillimit të Territorit;
- Në 11 raste është miratuar leja e ndërtimit në kushtet e mungesës së dokumentacionit, si: Projekti i eficiencës energjetikë, leja përkatëse nga Agjencia e Basenit Ujor Shkodër, leja përkatëse nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për hapjen e rrugës hyrëse të objektit në trupin e rrugës;
- Në 3 raste është dhënë leje ndërtimi me objekt “Strukturë Hotelerie Agroturizëm” në kushtet kur nuk plotësohen kërkesat paraprake nga aplikanti për t’u pajisur me leje për ndërtimin e llojit të objektit të mësipërm;
- Në 2 raste është miratuar leja e ndërtimit për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit, në kushtet e mungesës së dokumentacionit, si: Projekti arkitektonik dhe projekti konstruktiv i ndryshuar;
- Në 11 raste nuk janë respektuar distancat e kufirit të pronës nga objektet ekzistuese dhe brezi mbrojtës i rrugës;
- Në 5 raste nuk është respektuar intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të truallit; Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nënpikën 1.1.2 të pikës 1.1/1 në nenin 15, pikën 2 të nenit 20, shkronjën “a” të nenit 29, pikën 2 të nenit 43, pikën 1 të nenit 44 në Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar; Pikën 3 dhe 3/1 në nenin 3, pikat 1 dhe 3 të nenit 14, shkronjën “ë” të

pikës 1 dhe pikën v të pikës 1/1 në nenin 15, pikën 6 të nenit 21 në VKM nr.408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit” e ndryshuar; Pikën 6 në Vendimin nr.12, datë 27.02.2019 të KKT. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 130-148, të Raportit të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e Urbanistikës dhe Projekteve, të marrë masat e nevojshme për plotësimin e dokumentacionit të munguar në lejet e ndërtimit të miratuara përgjatë periudhës 2020-2021, si dhe bashkërendimin e punës, vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të autoriteteve publike kompetente gjatë aplikimit deri në miratimin e lejes së ndërtimit.

13.2 Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me zbatimin e këtij rekomandimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve dhe Kadastrës, ka dhënë sqarimet përkatëse për situatat e miratimit të lejeve, për të cilat, evidentimi i zbatimit të tyre, do të përcaktohet gjatë auditimit të këtyre çështjeve në auditimin e radhës.

Në proces zbatimi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

- Mungojnë raportet periodike të monitorimit të planit të veprimit të kontrollit të brendshëm.
- Nuk janë përcaktuar objektivat konkret dhe të matshëm për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.
- Nuk është hartuar një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit.
- Nuk është hartuar dhe miratuar strategjia e menaxhimit të riskut, si dhe nuk ka një strukturë të miratuar dhe një koordinator të deleguar të riskut.
- Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT.
- Në rregulloren e brendshme të institucionit ka mbivendosje të detyrave, kryerjen e funksioneve të caktuara që me ligj i ngarkohen strukturave të tjera etj;
- Nuk administrohen raportet e monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe efektivitetit. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 21-29, të Raportit të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, drejtorët e drejtorive dhe përgjegjësitë e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve.

14.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Me shkresën nr. 623 prot., datë 01.03.2023, është azhurnuar regjistri i riskut të institucionit me informacion nga të gjitha drejtoritë hartuar nga Burimet Njerëzore. Nuk janë miratuar strategjitë.

Në proces zbatimi

14.3. Rekomandimi: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

14.1.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Për këtë rekomandim, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tij.*

Pa zbatuar

14.4. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregulloren e brendshme të institucionit me qëllim shmangien e mbivendosjes dhe përcaktimin e qartë të objektivave për çdo pozicion pune.

14.1.4 Nga verifikimi rezultoi se: *Me urdhër nr. 108, datë 15.10.2021 të Titullarit, është caktuar grupi i punës për redaktimin e rregullores së brendshme, e cila është miratuar në Janar të vitit 2022. Kjo rregullore, sipas Drejtorit të Drejtorisë Juridike, dhe Drejtorit të Burimeve Njerëzore, janë shmangur mbivendosjet e ndarjes së detyrave.*

Zbatuar

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin dhe veprimtarinë e NJAB Bashkia Malësi e Madhe përgjatë periudhës 2020-2021, u konstatua se:

-Nuk është ngritur Komiteti i Auditimit;

-Nuk është kryer auditim me qëllim vlerësimin dhe monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos ofruar siguri dhe këshilla për titullarin e njësisë publike nëse ky sistem është ngritur në përputhje me rregullat, standardet dhe parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

- Nuk janë planifikuar auditime tematike për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme;

- Nuk janë mbuluar me auditim fusha të aktiviteteve që kryen Bashkia Malësi e Madhe, të cilat janë vlerësuar me risk të lartë.

-Dosjet koherente të auditimit nuk arkivohen në arkivin e njësisë vendore, por mbahen në ambientet e brendshme të sektorit të auditit të brendshëm.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” në nenin 6, nenin 13, shkronja “ç” në nenin 14 në Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Urdhrin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhrin nr.100, datë 25.10.2016”; Udhëzimin nr.42, datë 27.10.2020 “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”; Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.1, faqe 29-33, të Raportit të Auditimit)*

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

15.2. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

15.3. Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Malësi e Madhe, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

15.4 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga verifikimi i rekomandimeve të mësipërme, rezulton se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tyre. Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe nuk ka marrë masa për krijimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Nuk ka planifikime të fushave me risk për auditim. Nuk është bërë arkivimi i tyre si dhe nuk janë aplikuar opinione për auditimet e kryera.*

Pa zbatuar

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e IMTV Bashki Malësi e Madhe për periudhën 01.04.2020-31.12.2021, u konstatua, se kjo strukturë nuk e ka përmbushur qëllimin e saj, në garantimin dhe mbrojtjen për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas kuadrit rregullator të fushës, si dhe ndëshkimin e drejtë të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat ligjore përkatëse. Në mënyrë të përmbledhur është konstatuar se:

-Për vitin 2020 nga 4 raste konstatimi të shkeljes së kuadrit ligjor të fushës për ndërtime të kundërligjshme, vetëm në një prej tyre është vendosur gjobë dhe prishje ndërtimi, ndërkohë në 3 rastet e tjera nuk është vendosur gjobë, marrjen e masës pezullim të punimeve për plotësim dokumentacioni/prishjen e punimeve përkatëse.

-Për vitin 2021 nga 16 raste konstatimi të shkeljes së kuadrit ligjor të fushës, vetëm në 1 prej tyre është vendosur gjobë dhe prishje ndërtimi, ndërkohë në 15 rastet e tjera sipas procesverbal konstatimeve, nuk është marrë masë për vendosjen e gjobës, pezullimin e ndërtimit deri në plotësimin e dokumentacionit, prishjen e punimeve pa leje dhe kallëzim penal.

-Për 2 raste inspektimi ku është marrë vendimi për prishjen e punimeve të ndërtuara pa leje, konstatohet se nuk administrohet procesverbali i dokumentimit të prishjes së punimeve të kundërligjshme, ç'ka nuk vërtetohet ekzekutimi i vendimit për prishjen e punimeve.

-Në strukturën e IMTV nuk ka punonjës me formimin profesional të fushës, si inxhinier ndërtimi, mjedisi, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë dhe hidrogjeologjisë.

-Përgjatë periudhës 2020-2021 Kryeinspektori i IMTV nuk ka miratuar asnjë akt-kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, ku për periudhën e mësipërme janë dhënë 30 leje ndërtimi për subjekte private (përfshirë lejet e infrastrukturës subjektet publike si OST, OSHEE).

-Për periudhën 2020-2021 nuk është hartuar programi vjetor dhe mujor i punës së IMTV.

-Për periudhën 2020-2021 ndërmjet IMTV dhe Drejtorisë së Planifikimit dhe Projekteve, ka munguar bashkëpunimi, për shkëmbimin e informacionit mbi lejet e zhvillimit, ndërtimit, deklaratat paraprake për kryerjen e punimeve, certifikatat e përdorimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Malësi e Madhe. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” dhe “f” në nenin 5 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Pikën 3 të nenin 51 shkronjat “d”, “e” dhe “ë” të pikës 1 dhe pikën 7 të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Pikën 1 germa b/ii dhe pikën 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Pikën 2 në nenin 24 dhe shkronja “a” në nenin 41 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 148-152, të Raportit të Auditimit)*

16.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtorja e Burimeve Njerëzore, të marrë masat e nevojshme për rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

16.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Me vendimin nr. 25, datë 13.02.2023, është emëruar në detyrën e inspektorit F. B., me profesion arkitekt.*

Zbatuar

16.2. Rekomandimi: IMTV Bashkia Malësi e Madhe, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të rikërkohej edhe njëherë në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes Territoriale, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

16.1.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk është marrë asnjë masë nga IMTV për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit dhe nuk ka korrespondencë me IKMT për plane të përbashkëta veprimi.*

Pa zbatuar

16.3. Rekomandimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe IMTV Bashkia Malësi e Madhe të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IMTV, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Malësi e Madhe.

16.4 Nga verifikimi rezultoi se: *IMTV në Bashkinë Malësi e Madhe, disponon llogaritë në sistemin e-leje, të cilët njoftohen për çdo aplikim të praktikave për leje ndërtimi dhe deklarata paraprake për kryerjen e punimeve. Rezulton se nuk janë mbajtur akte kontrolle për lejet e miratuara.*

Pa zbatuar

C.1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Mbështetur në përcaktimet e bëra në shkronjën “b” në nenin 15 në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjën “b” në pikën 1.1 dhe shkronjën “c” në pikën 1.6 në nenin 9 dhe shkronjën “gj” në nenin 64, në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe nenin 2, nenin 32, nenin 66, nenin 68, nenin 153 dhe nenin 154 në Ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Kryetari i Bashkisë të merren masa dhe të kërkohej në rrugë ligjore, shpërblimi i dëmit të krijuar ndaj buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe në vlerën **471,113 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Linaj, faza I”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës (me TVSh) 56,572,930 lekë, realizuar nga BOE “A.” Shpk & “A.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara, por të pakryera në fakt në vlerën 144,050 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 676/4 prot datë 12.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe BOE “A.” Shpk & “A.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 144,050 lekë pa TVSh nga BOE “A.” ShPK & “A.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 676/4 prot datë 12.04.2021, me objekt “Sistemim asfaltim rruga Linaj, faza I”, Bashkia Malësi e Madhe, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Malësi e Madhe, është lëshuar fatura pa numër datë 23.12.2022 e cila është likuiduar me datë 15.02.2023 në llogari të Bashkisë në vlerën 144,050 lekë, ardhur me postën e bankës.*

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Sistemim asfaltim rruga Smajlaj në Gruemirë”, Bashkia Malësi e Madhe, me vlerë të kontratës (me TVSh) 15,366,992 lekë, realizuar nga OE “N.” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara, por të pakryera në fakt në vlerën 170,137 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2094/7 prot

datë 16.10.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe OE “N.” Shpk. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 66-129, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Malësi e Madhe të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 170,137 lekë pa TVSh nga OE “N.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2094/7 prot datë 16.10.2020 me objekt “Sistemim asfaltim rruga Smajlaj në Gruemirë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga Bashkia Malësi e Madhe, është lëshuar fatura pa numër datë 23.12.2022 e cila është likuiduar me datë 31.12.2022 në llogari të Bashkisë për vlerën 170,137 lekë, ardhur me postën e bankës bashkëlidhur edhe mandati.*

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Malësi e Madhe me palët e treta, u konstatua se në 6 raste për pagesa me vonesë të detyrimeve kontraktore, nuk është aplikuar kamatvonesë në masën 0,01% në ditë, por jo më shumë se 10% të vlerës, bazuar në përcaktimin e bërë në kontratat e qirasë, e llogaritur në vlerën 156,926 lekë, e cila përbën të dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në neni 450 në Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pikën 1 në nenin 19 dhe pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Shkronjën “g” në pikën 1 në nenin 17 dhe shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 156,926 lekë ndaj subjekteve:
-S. E. në vlerën 31,407 lekë kamatë vonesë;
-W. E. në vlerën 9,425 lekë kamatë vonesë;
-V. në vlerën 60,594 lekë kamatë vonesë;
-A. në vlerën 55,500 lekë kamatë vonesë.

3.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Janë bërë njoftimet për likuidimin e detyrimit për kamatë vonesat me nr. 1476 prot., datë 22.06.2023 subjektit S. E., me nr. 3291 prot., datë 07.11.2022 subjektit V., me nr. 4 datë 14.01.2021. Asnjëri nga këto subjekte nuk ka kryer likuidimin e kamatës. I vetmi subjekt që ka kryer likuidimin në vlerën 197,925 në të cilin përfshihet edhe kamata në vlerën 9,425 lekë sipas rekomandimit.*

Në proces zbatimi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, përgjatë periudhës 2020-2021 ka shpenzuar vlerën 3,407,683 lekë, për 4 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Gjithashtu konstatohet se në urdhrin e likuidimit nga titullari i institucionit nuk është nxjerrë edhe përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna, moslikuidimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbartimit) ka krijuar detyrime ndaj bashkisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në

kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe udhëzimin nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas verifikimi të llogarisë 467 “Kreditorët ndryshëm” Bashkia Malësi e Madhe nuk ka të regjistruara vendime gjyqësore të reja. Për vendimet gjyqësore të mëparshme është kryer likuidimi sipas vendimit të gjykatës.*

Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifat vendore, për vitin 2020 dhe 2021, u konstatua se në fund të vitit 2020 (progresivisht) janë debitor 287 subjekte në vlerën 30,866,050 lekë (principal dhe kamatvonesë), nga të cilët krijuar brenda vitit 2020 gjithsej 173 subjekte në vlerën 5,656,685 lekë.

Në fund të vitit 2021 (progresivisht) janë debitor 282 subjekte në vlerën 32,360,574 lekë (principal dhe kamatvonesë), nga të cilët krijuar brenda vitit 2021 gjithsej 173 subjekte në vlerën 5,856,700 lekë.

Debitorët progresivisht në fund të vitit 2021 janë si më poshtë vijon:

- 57 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 19,167,623 lekë;
- 217 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 12,947,467 lekë;
- 8 subjekte “Institucione” në vlerën 816,974 lekë.

- Në raport me numrin e subjekteve debitorë në fund të periudhës ushtrimore dhe subjekteve për të cilat është kërkuar në zbatim të ligjit masa shtrënguese, konstatohet se numri i këtyre masave është i ulët. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2020 ka arritur të mbulojë me masa shtrënguese (vetëm nëpërmjet njoftimit për pagesë) 6% të debitorëve gjithësej, ose 71% të kategorisë “biznes”, për vitin 2021 ka mbuluar 12% të debitorëve gjithësej, ose 80% të kategorisë “biznes”. Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 76, neni 114 dhe neni 117 në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 dhe 7 në nenin 4, neni 22/5, neni 26, neni 34 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Neni 64 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKB nr.63, datë 28.12.2020 Për miratimin e buxhetit të vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët e mundshme ligjore për arkëtimin e debitorëve në vlerën 32,360 mijë lekë.

2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga informacioni i pasqyruar nga drejtoria e taksave çelja e debitorëve biznes për vitin 2022 është në vlerën 26,546,820 (pa përfshirë kamatvonesat) parashikimi i likuidimeve për taksat e biznesit është në vlerën 8,599,931 lekë dhe janë kryer pagesa në vlerën 3,680,955 lekë (duke përfshirë edhe detyrimet e viteve të mëparshme). Totali i debitorëve në datë 31.12.2022 është në vlerën 31,465,796 lekë pa përfshirë kamatvonesat.*

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të ardhurave të realizuara nga taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se në fund të vitit 2021 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe NJA janë 5271 familje debitore në vlerën 23,868,595 lekë (nga të cilat 2039 familje në vlerën 11,278,610 lekë krijuar brenda vitit 2021), konkretisht:

- 1152 familje debitore në vlerën 11,043,508 lekë për **taksën e ndërtesës;**
- 1657 familje debitore në vlerën 1,324,640 lekë për **taksën e truallit;**
- 1422 familje debitore në vlerën 10,163,477 lekë për **tarifën e pastrimit;**
- 456 familje debitore në vlerën 888,540 lekë për **tarifën e ndriçimit;**
- 584 familje debitore në vlerën 448,430 lekë, për **tarifën e gjelbërimit.**

Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, konstatohet se për arkëtimin e taksave të popullatës DAV Bashkia Malësi është mjaftuar vetëm duke njoftuar familjet, për detyrimin tatimor, por jo të marrë masa në mënyrë shteruese me qëllim arkëtimin e vlerës debitore. Gjithashtu Bashkia Malësi e Madhe nuk ka përcaktuar mënyra efikente për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore për abonentët familjar nëpërmjet shoqërisë “Ujësjiellësi Kanalizime” Sh.A, sipas pikës (ii) e nenit 5 të ligjit nr.9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ku i jep të drejtën e përcaktimit të mënyrës së mbledhjes së taksës dhe zgjedhjen e agjentit fiskal, veprim i cili do të rriste të ardhurat në buxhetin e institucionit dhe do t’i jepte më shumë mundësi për shërbime dhe investime ndaj komunitetit. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3 në nenin 70 në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar; Pikën 2 të nenit 42 në ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pikën (ii) të nenit 5 në ligjin nr.9642 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Malësi e Madhe, me qëllim që taksat dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” të mbledhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

3.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Nga verifikimi, rezulton se Drejtoria e të Ardhurave nuk disponon sistem elektronik për mbajtjen e taksave të familjarëve, dhe audituesve nuk disponuan të dhëna të mjaftueshme për të verifikuar zbatimin e këtij rekomandimi.*

Pa zbatuar

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 23,868 mijë lekë.

3.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Drejtoria e të Ardhurave, është mjaftuar vetëm me dërgimin e njoftimeve, dhe nuk janë hapur procese gjyqësore për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 23,868 mijë lekë.*

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për planifikimin dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, u konstatua se vlera debitore gjithsej për këtë taksë, krijuar përgjatë periudhës 2020-2021 është 3,896,610 lekë, nga të cilat 2,120,843 lekë vlerë debitore e krijuar brenda vitit 2021, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe. Theksojmë se sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë

për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë njoftim detyrime për të gjithë familjarët që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Shkronja “b” në Kreun I.1 në Paketën Fiskale të Bashkisë Malësi e Madhe. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe në bashkëpunim me Sektorin e Kadastrës Urbane dhe Zhvillimit Rural, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës, për përditësimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga verifikimi në terren.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 3,896 mijë lekë.

4.3 Nga verifikimi rezultoi se: *Nuk janë ngritur grupet e punës me specialistë fushe për përditësimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore.*

-Sipas akt rakordimit të thesarit, të ardhurat për tokën bujqësore për vitin 2022 rezultojnë në vlerën 1,425,150 lekë të cilat përfshinë pagesa të debitorëve edhe për vitet e mëparshme.

Në proces zbatimi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi i objekteve informale, u konstatua se vlera debitorë për këtë taksë në mënyrë progresive është 16,344,507 lekë, e cila përfaqëson të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe, konkretisht krijuar:

Në vitin 2020 –1,141,768 lekë;

Në vitin 2021 - 2,651,900 lekë;

Në numër personash të cilët posedojnë lejen e legalizimit dhe që nuk kanë shlyer detyrimin e taksës vendore të ndikimit në infrastrukturë është 235 posedues, ose 95% e totalit të poseduesve të lejeve të legalizimit. Për arkëtimin e vlerës debitorë, nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 88-91 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 2 të nenit 4, shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 22/5, shkronjën “c” të pikës 3 të nenit 27 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 16,344 mijë lekë.

5.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Pagesat e debitorëve gjatë vitin 2022 për detyrimet e viteve të mëparshme për taksën e ndikimit në infrastrukturë është në vlerën 503,125 lekë e cila është paguar nga 15 debitorë detyrimi i mbetur për këtë taksë është në vlerën 15,841,382 lekë.*

Në proces zbatimi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Malësi e Madhe, u konstatua se deri më datë 31.12.2021 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe në vlerën 2,640,000 lekë, nga të cilat 1,650,000 lekë principal dhe 990,000 lekë kamatvonesë (2 gjoba në vlerën 1,600,000 lekë i përkasin vitit 2020 dhe 2021). Gjobat e

mësipërme janë në formë të prerë dhe që nuk pengohet ekzekutimi i tyre, por nga Kryeinspektori i IMTV nuk është bërë kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të tyre. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

6.1. Rekomandimi: Kryeinspektori i IMTV Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 2,640 mijë lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

6.2 Nga verifikimi rezultoi se: *IMTV Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka marrë asnjë masë për arkëtimin e gjobave të vendosura për periudhat e mëparshme.*

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të subjekteve të licencuara për ushtrim aktiviteti si pikë shitjeje më pakicë të hidrokarbureve rezulton se përgjatë vitit 2021 në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe dhe NJA, është ushtruar aktivitet për tregtimin e karburantit nga 16 stacione shitje.

-Nga numri i stacioneve të mësipërme u konstatua se në 9 prej tyre është ushtruar aktivitet pa u pajisur me licencën përkatëse. Për këto stacione nuk janë marrë masat shtrënguese në mënyrë shteruese deri në kallëzimin penal të tyre. Në mënyrë të përmbledhur si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, për mos marrjen e masave shtrënguese për arkëtimin e tarifës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit në tregtimin e karburanteve efektet e të cilave përfshijnë periudhën 01.04.2020 - 31.12.2021, janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 9,000,000 lekë në buxhetin e Bashkisë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4, pikën “vi” në shkronjën “ç” në nenin 5 në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Shkronjat “a” dhe “b” në pikën 1.3 në nenin 9, shkronjën “c” të pikës 5 në nenin 35 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 2 në nenin 89 dhe shkronja “b” në pikën 1 në nenin 131 *“...nuk i paguan ato në buxhet”* të Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pika 2 në nenin 42 të Ligjit nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve, me qëllim aplikimin dhe licencimin e aktivitetit të tyre. Në rast të kundërt t’i drejtohet me shkresë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ngritjen e një grupi pune të përbashkët ndërmjet Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial për kryerjen e kontrolleve të përbashkëta dhe marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa licencë aktivitetin e tregtimit të karburanteve për përdorim nga konsumatorët fundorë.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: *Janë dërguar njoftimet për vijimin e licencimit të karburanteve dhe likuidimi i detyrimeve përkatës. Nuk janë ngritur grupe të përbashkëta për bllokimin e aktivitetit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetin pa licencën përkatëse.*

Në proces zbatimi

7.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, të zbatojë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 9,000 mijë lekë ndaj subjekteve të cilat kanë ushtruar aktivitet në tregtimin e karburanteve.

7.2 Nga verifikimi rezultoi se: Rezulton se nga vlera 9 milion lekë, është likuiduar vlera 1 milion lekë nga 4 subjekte, likuidim i pjesshëm. Vlera prej 8 milion lekë nuk është likuiduar, nga të cilat 5 subjekte nuk kanë shlyer asnjë detyrim në vlerën 5 milion lekë, dhe 4 subjekte kanë detyrim në vlerën 3 milion lekë sipas tabelës së mëposhtme.

Adresa	periudha e likuidimit	Detyrimi	Vlera e likuiduar	Vlera e detyrimit të ngjelur
A. P.	25.01.2022-24.01.2023 07.02.2023- 6.02.2024	1000000	400,000	600,000
J. O		1000000		1,000,000
B. shpk (Ndryshuar K. 3.)	05.10.2021-04.10.2022	1000000	200,000	800,000
O. B.		1000000	-	1,000,000
D. O. (Ndryshuar E. O.)	06.07.2022-5.07.2023	1000000	200,000	800,000
L. O.		1000000	0	1000000
R. G. (Mbyllur)		1000000	0	1000000
R.		1000000	0	1000000
K. O.		1000000	200000	800000
		9,000,000	1,000,000	8,000,000

Zbatuar pjesërisht

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e të ardhurave nga tarifa e shërbimit për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe, u konstatuan mangësi në 9 raste nga të cilat:

-4 raste nuk është aplikuar tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit;

-5 raste nuk është aplikuar saktë tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë, të cilat janë shpallur fitues në prokurimet e zhvilluara dhe kanë lidhur kontratat për kryerje punime të ndryshme ndërtimi, me fonde publike. Nga përlogaritjet e kryera rezulton se, për periudhën 2020-2021 në 9 raste, të ardhurat e munguara për buxhetin e Bashkisë Malësi e Madhe si rrjedhojë e mangësive të mësipërme janë në vlerën 478,135 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” të pikës 5 të nenit 35 në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Pikën 10 e nenit 3 dhe pika 2 në nenin 18 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 478,135 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë.

8.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Taksave ka dërguar njoftim me nr. 3024-3024/8 prot., datë 12.10.2022 për detyrimet e subjekteve që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike në territorin e Bashkisë Malësi e Madhe. Subjekti E. shpk ka likuiduar vlerën 13,410 lekë në datë 17.10.2022 dhe M. shpk ka likuiduar vlerën 27,710 lekë në datë 18.10.2022. Vlera e mbetur pa likuiduar është 437,015 lekë.

Në proces zbatimi

C.3.TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Malësi e Madhe me palët e treta, u konstatua se në 2 raste nuk është bërë likuidimi i detyrimit vjetor të qirasë, konkretisht nga subjektet S. E. dhe W. E., duke krijuar të ardhura të munguara ndaj buxhetit të bashkisë në vlerën 408,320 lekë. Ndaj dy subjekteve të mësipërme

nuk janë marrë masa për arkëtimin e detyrimit të krijuar deri në zgjidhjen e kontratës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 33-60, të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për arkëtimin e vlerës 408,320 lekë ndaj subjekteve:
-S. E. në vlerën 314,070 lekë;
-W. E. në vlerën 94,250 lekë;

1.1.2 Nga verifikimi rezultoi se: Është dërguar shkresë subjektit “S. E.” me nr. 888 prot, datë 23.03.2022 “ Dërgim fature për detyrime për qira trualli” me anë të cilës është informuar për detyrimin dhe për kamatëvonesat për çdo ditë të likuidimit.

Është dërguar shkresë subjektit nr.1476 prot., datë 22.06.2023 “Dërgim fature për detyrime për qira trualli” me anë të cilës është informuar për detyrimin.

“Është dërguar shkresë subjektit W. E., me nr. 574 prot., datë 22.02.2022 “Dërgim fature arkëtimi për subjektin qiramarrës W. E.” me anë të të cilës i është dërguar edhe fatura për arkëtim me vlerë totale 197,925 lekë. Kjo faturë është likuiduar në datë 23.03.2022.

Në proces zbatimi

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve Bashkia Malësi e Madhe të kontrollojë përmbushjen nga ana e subjekteve (persona juridikë dhe fizikë), që kryejnë veprimtari në sipërfaqet pyjore të dhëna me qira, të detyrimeve kontraktuale dhe të përcaktimeve të bëra në planet e rehabilitimit të fondit pyjor/kullosor, si dhe në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale të propozojë tek Kryetari i Bashkisë zgjidhjen e kontratës.

1.2.2 Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Malësi e Madhe, nuk ka marrë masa për subjektet të cilat nuk kanë përmbushur kushtet e kontratës.

Pa zbatuar

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 15 – Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve të përmendur si më poshtë vijon dhe dhënien e masës disiplinore ndaj:

1. Z. E. D. Përgjegjës i Sektorit të Taksave, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe marrjen e masave për arkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (33-60) të Raportit të Auditimit)

2. Zj. E. V. Drejtore e Urbanistikës, për mangësitë e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (131-150) të Raportit të Auditimit)

3. Z. B. C. Kryeinspektor i IMTV, për mangësitë e konstatuara në veprimtarinë inspektuese të IMTV Bashkia Malësi e Madhe. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (150-155) të Raportit të Auditimit)

4. Zj. P. G. Drejtor i Burimeve Njerëzore, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (21-29) të Raportit të Auditimit)

5. Z. T. T. Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për mangësitë e konstatuara në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve përgjatë periudhës 2020-2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1.1) faqe (29-33) të Raportit të Auditimit)*

Nga verifikimi rezultoi se: Për punonjësit e mësipërm janë marrë masat disiplinore vërejtje nga Titullari i Bashkisë dhe konkretisht E. D. (nr. 9/3 prot., datë 04.01.2023), E. V. (nr. 2618 prot., datë 09.09.2022), B. C. (nr. 2619 prot., datë 09.09.2022), P. G. (nr. 9/4 prot., datë 04.01.2023), T. T. (nr. 9 prot, datë 04.01.2022).

Zbatuar

E. MASA ADMINISTRATIVE.

E.1. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, mbështetur në përcaktimet e bëra në nenet 77, 92 dhe 98, si dhe shkronjave “g”, “gj” dhe “i” të pikës 1 në nenin 132 në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neneve 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Malësi e Madhe, t’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, për punonjësit si më poshtë:

1. Z. E. A. Drejtor i Drejtorisë Juridike, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve kualifikuese në 10 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Blerje karburant per vitin 2021;
- Blerje karburant per vitin 2022;
- Ndërtim i ujësjellësit Bajzë;
- Sistemim asfaltim rruga në Aliaj;
- Sistemim asfaltim rruga në Pjetroschan;
- Sistemim asfaltim rruga Smajlaj;
- Sistemim Asfaltim rruga Gril;
- Sistemim Asfaltim Rruga Kamicë-Flakë;
- Sistemim asfaltim rruga Linaj, Faza I;
- Sistemim asfaltim rruga Deckaj në Hot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

2. Zj. E. L. Drejtor i Drejtorisë së Taksave, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve kualifikuese në 4 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Ndërtim i ujësjellësit Bajzë;
- Sistemim asfaltim rruga në Aliaj;
- Sistemim asfaltim rruga në Pjetroschan;
- Sistemim asfaltim rruga Smajlaj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

3. Z. F. C. Magazinier, për mangësitë e konstatuara në hartimin e kriterëve kualifikuese në 6 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Blerje karburant per vitin 2021;
- Blerje karburant per vitin 2022;
- Sistemim Asfaltim rruga Gril;
- Sistemim Asfaltim Rruga Kamicë-Flakë;
- Sistemim asfaltim rruga Linaj, Faza I;
- Sistemim asfaltim rruga Deckaj në Hot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

4. Z. J. N. Specialist pranë Drejtorisë së Urbanistikës, për mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave të OE në 5 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Ndërtim i ujësjellësit Bajzë;
- Sistemim Asfaltim rruga Gril;
- Sistemim Asfaltim Rruga Kamicë-Flakë;
- Sistemim asfaltim rruga Linaj, Faza I;
- Sistemim asfaltim rruga Deckaj në Hot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

5. Z. P. Ç. Specialist pranë Drejtorisë Juridike, për mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave të OE në 10 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Blerje karburant per vitin 2021;
- Blerje karburant per vitin 2022;
- Ndërtim i ujësjellësit Bajzë;
- Sistemim asfaltim rruga në Aliaj;
- Sistemim asfaltim rruga në Pjetroschan;
- Sistemim asfaltim rruga Smajlaj;
- Sistemim Asfaltim rruga Gril;
- Sistemim Asfaltim Rruga Kamicë-Flakë;
- Sistemim asfaltim rruga Linaj, Faza I;
- Sistemim asfaltim rruga Deckaj në Hot. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

6. Z. G. I. Specialist pranë Drejtorisë së Urbanistikës, për mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave të OE në 3 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Sistemim asfaltim rruga në Aliaj;
- Sistemim asfaltim rruga në Pjetroschan;
- Sistemim asfaltim rruga Smajlaj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

7. Z. F. B. Specialist pranë Drejtorisë së Urbanistikës, për mangësitë e konstatuara në vlerësimin e ofertave të OE në 2 procedura të prokurimit, si më poshtë vijon:

- Blerje karburant per vitin 2021;
- Blerje karburant per vitin 2022. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (66-129) të Raportit të Auditimit)*

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, i ka rekomanduar Titullarit të Institucionit me shkresën nr. 2478 prot., datë 29.08.2022, në të cilën propozon që për masat administrative të marra të lëna për punonjësit e mësipërm, të merret vendimi për masë disiplinore vërejtje, duke pasur parasysh që shkeljet e konstatuara janë shkelje të përsëritura në disa procedura prokurimi. Në zbatim të këtij rekomandimi, ka rezultuar se Titullari i Bashkisë Malësi e Madhe, ka marrë masa disiplinore vërejtje ndaj punonjësve E. A. (nr. 2622 prot., datë 09.09.2022), E. L. (nr. 9/1 prot., datë 04.01.2023), F. C. (nr. 2615 prot., datë 09.09.2022), J. N. (nr. 9/2 prot., datë 04.01.2023), P. Ç. (2626 prot., datë 09.09.2022), G. I. (larguar nga puna), F. B. (2616 prot., datë 09.09.2022).

Zbatuar

Zbatimi i rekomandimeve në Bashkinë Malësinë e Madhe, në mënyrë tabelore paraqitet si vijon:

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime gjithsej të numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në procedurë zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	22	22	9	1	4	8

Masa për shpërblim dëmi	3	3	2	-	1	-
Masa për 3E	11	11	2	1	6	2
Masa për uljen e borxhit tatimor	2	2	-	-	1	1
Masa Disiplinore/Administrative	12	12	12	-	-	-

IV- KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit në Bashkinë Malësi e Madhe për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces zbatimi, inkurajojmë përshejtimin e realizimit të plotë të tyre brenda vitit 2023, ndërsa për rekomandimet e pazbatuara ose të zbatuara pjesërisht, **rikërkojmë** të vazhdojnë procedurat ligjore deri në mbylljen e plotë të tyre, si më poshtë:

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Rekomandimi 3: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe, si dhe Drejtoria e Financës dhe Njësia e Prokurimit, të marrë masa për eliminimin e praktikave të ndërmarrjes së angazhimeve buxhetore pas datës 15 Tetor të vitit buxhetor.

Menjëherë

2. Rekomandimi 5: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr. 470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Rekomandimi 7: Drejtoria e Financës Bashkia Malësi e Madhe të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 202 “Studime dhe Kërkime”, për vlerën 1,224,890 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi 14.3: Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues të marrë masa që të planifikojë dhe kryejë investim në program kompjuterik të licencuar, për mbajtjen e kontabilitetit, administrimin e taksave dhe tarifave vendore etj.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Rekomandimi 15.1: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Rekomandimi 15.2: Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin rrisht të lart, si vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, me qëllim që t’i ofrojë mbështetje titullarit të njësisë vendore në arritjen e objektivave institucional.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Rekomandimi 15.3 Njësia e Auditimit të Brendshëm, Malësi e Madhe, të marrë masa për të arkivuar në arkivin e institucionit dosjet e auditimit dhe të aplikojë opinione auditimi sipas standardeve të auditimit dhe manualit për auditimin në sektorin e brendshëm publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Rekomandimi 16.2: IMTV Bashkia Malësi e Madhe, për ndërtimet e kundërligjshme të nxjerrë urdhrat e ekzekutimit dhe të rikërkohet edhe njëherë në Inspektoratin Kombëtar të

Mbrojtjes Territorit, për hartimin e një plani të përbashkët veprimi duke mbështetur me forca dhe mjete me qëllim zbatimin vendimeve të ekzekutimit të ndërtimeve të kundërligjshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.3. Rekomandimi 16.3: Drejtoria e Urbanistikës dhe IMTV Bashkia Malësi e Madhe të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre, ku për çdo leje ndërtimi të miratuar/deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve ndërtimore, të informohet edhe IMTV, me qëllim miratimin e akt-kontrolleve për lejet e ndërtimit, si dhe rritjen e efektivitetit të inspektimit të zhvillimit të territorit në Bashkinë Malësi e Madhe.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET

1. Rekomandimi 3.1: Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mosarkëtimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK Sh.A Malësi e Madhe, me qëllim që taksat dhe tarifatat vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Rekomandimi 6.1: Kryeinspektori i IMTV Bashkia Malësi e Madhe, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 2,640 mijë lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Rekomandimi 7.2: Drejtoria e të Ardhurave Bashkia Malësi e Madhe, të zbatojë masat shtrënguese në mënyrë shteruese, për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 8,000 mijë lekë ndaj subjekteve të cilat kanë ushtruar aktivitet në tregtimin e karburanteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

C.3.TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1.Rekomandimi 1.2: Drejtoria e Administrimit të Pyjeve Bashkia Malësi e Madhe të kontrollojë përmbushjen nga ana e subjekteve (persona juridikë dhe fizikë), që kryejnë veprimtari në sipërfaqet pyjore të dhëna me qira, të detyrimeve kontraktuale dhe të përcaktimeve të bëra në planet e rehabilitimit të fondit pyjor/kullor, si dhe në rast të mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale të propozojë tek Kryetari i Bashkisë zgjidhjen e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE.

D.1.Nga Kryetari i Bashkisë Malësi e Madhe **kërkojmë** analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë, shkaqet dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve sipas Planit të Miratuar. Për sa më lart, **kërkojmë** fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për personat përgjegjës që nuk kanë zbatuar rekomandimet e pranuar.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT